



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“MBI AUDITIMIN FINANCIAR”
SUBJEKTI BASHKIA FINIQ

Tiranë, 2023

📖 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I.	PËRMbledhje Ekzekutive	4 – 29
1.	<i>Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....</i>	
2.	<i>Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve</i>	
3.	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit</i>	
II	HYRJA	29 – 33
	a. <i>Titulli.....</i>	
	b. <i>Marrësi.....</i>	
	c. <i>Objektivat dhe qëllimi.....</i>	
	d. <i>Identifikimi i çështjes.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	f. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	g. <i>Kriteret e vlerësimit</i>	
	h. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	i. <i>Metodat e auditimi</i>	
	j. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	33 – 137
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	33 – 34
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	34 – 137
2.1.	<i>Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin brendshëm.....</i>	34 – 43
2.2	<i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.....</i>	43 – 52
2.2.6	<i>Menaxhimin e të ardhurave, mbi arkëtimin dhe përdorimin e tyre.....</i>	52 – 83
2.3	<i>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022.....</i>	83 - 111
2.4.	<i>Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit</i>	111 – 127
2.5	<i>Mbi planifikim dhe zhvillim territorin.....</i>	127 – 129
2.6	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e IMT.....</i>	129 – 133
2.7.	<i>Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi fundit.....</i>	133 – 137
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI.....	137 – 162
V.	ANEKSE.....	162 - 184

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1-Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim* KLSH), në periudhën nga data 24/06/2023 deri në 26/05/2023 realizoi auditimin financiar të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkia Finiq, sipas programit të auditimit nr. 312/1prot, datë 19/04/2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën nga data 01/01/2022 deri më 31/12/2022.

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të vitit 2022, mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale në sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimit me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga data baze i thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”; 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”; 467 “Kreditore te ndryshëm”; 602 “Shpenzime operative” dhe 230- 231 “Investime”, si dhe me zgjedhje procedurat e prokurimit zbatimi i kontratave të ndërtimit.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione se në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ dhe të ardhurave të munguara, të cilat i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprind një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
1	Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2022, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.	43-53	<i>I mesëm</i>	<ul style="list-style-type: none">- Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që projektvendimi dhe relacioni për buxhetin vjetor të dërgohet për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda afateve ligjore.- Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që në hartimin e buxhetit të vitit pasardhës të mbahet në konsideratë shuma totale e detyrimeve të papaguara nga viti i mëparshëm me qëllim shmangien e pasojave financiare më tepër se vlera e detyrimit.- Bashkia Finiq, nëpërmjet Drejtorisë së

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
				<p>Financës dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, të marrin masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuara dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi</p>
2	<p>Nxjerrja e pasqyrave financiare, shkeljet të parimeve kontabël për evidentimin e detyrimeve kreditore dhe mos rakordimi I llogarive të pasqyrave financiare me rezultatet e gjendjes fizike nga mos kryerja e inventarëve fizikë për vitin 2022</p>	83-111	I lartë	<p>- Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Finiq dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.</p> <p>- Drejtoria Ekonomike të analizojë vlerën prej 7,603,684 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar së diferencës të ndryshimit të gjendjes së inventarit. Sistemi të kryhet sipas trajtimit kontabël kalimin e vlerës nga llogaria 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.</p> <p>- Drejtoria Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p> <p>- Drejtoria Ekonomike të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 3,369,024 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të marrë masat për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale, si dhe të merren masa për regjistrimin e asetëve si pasuri e saj në ASHK.</p> <p>- Drejtoria Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referencat me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
				<p>nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p> <p>- Drejtoria Ekonomike të analizojë vlerën prej 7,603,684 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar së diferencës të ndryshimit të gjendjes së inventarit. Sistemi të kryhet sipas trajtimit kontabël kalimin e vlerës nga llogaria 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria Ekonomike të marrë masa të menjëhershme për pagesat e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 41,559,983 lekë. Gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria Ekonomike të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi</p>
3	<p>Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për vitin 2022, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE fitues në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 <i>Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve</i> dhe 78 <i>Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit</i>” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe mos zbatimin e kushteve të kontratave.</p>	111-127	I lartë	<p>- Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Finiq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.</p> <p>Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i economicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.</p> <p>- Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Finiq të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 561,540 lekë nga shoqëria ‘N...’ shpk, për mos zbatim të kontratës nr. 1736, datë 04/07/2022.</p> <p>Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve për menaxhimin e kontratave të analizojë dosjen e procedurës me objekt <i>“Mirëmbajtje e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës”</i>, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 68, datë</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
				<p>19/04/2022 (mbi afatin e punimeve), dhe në rast të mungesës së dokumentacionit mbështetës të marri masa në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Finiq duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 287,831 lekë nga subjekti “A...” shpk.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës ose me subjekte të liçencuara për saktësinë e llogaritjes së fondit limit në përputhje me çmimet e manualit për të shmangur mos efektivitetin e fondeve të prokuruar.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.</p> <p>Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.</p>
4	<p>Nga auditimi i lejeve të ndërtimit të dhëna në bashkinë Finiq, rezulton se:</p> <p>1- Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, për të cilën është marrë Vendimi Nr.107, datë 15/04/2022, i Kryetarit të Bashkisë Finiq për objektin “Objekt akomoduese ne funksion te agroturizmit”, me zhvillues V. LL, në Vriion, Finiq.</p> <p>- Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, nga mbivendosja e parcelës me planin, konstatohet se parcela bën pjesë pjesërisht në njësinë strukturore FQ_B_B2_566/1 mbi 50% e sipërfaqes dhe në njësinë strukturore FQ_UB_A1_16/1, të paraqitur në mbivendosjen e mëposhtme. Gjithashtu në dokumentet e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, statusi i tokës është arë dhe nuk është konvertuar në statusin truall. Për këtë arsye, kondicionet urbane dhe kriteret nevojiten të bazohen në parametrat e përcaktuara në njësinë FQ_B_B2_566/1.</p> <p>Duke ju referuar Rregullores Vendore, në Nenin 31 përcaktohet së në njësitë që i përkasin sistemit bujqësorë lejohet zhvillimi i aktiviteteve</p>	127-129	<i>I lartë</i>	<p>Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Finiq gjatë dhënies së lejeve të ndërtimit të marrë masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Respektimin e Planit të Përgjithshëm Vendore dhe Rregulloren Vendore të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.2, datë 10.02.2021. - Respektimin e lejuar të përdorimi të tokës sipas legjisllacionit në fuqi. - Respektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës sipas legjisllacionit në fuqi. - Respektimin e intensitetit të ndërtimit në zbatim të planit të përgjithshëm vendore.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>agroturistike dhe ekoturistike, me kushtet e pasqyruara më poshtë.</p> <p>- Në bazë të VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, Neni 15, pika (c), në planin e vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese nuk pasqyrohet rilevimi topografik i punuar nga një inxhinier topograf i licënsuar.</p> <p>- Në bazë të VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, Neni 15, pika 1/1 “Neni 34, pika 2, përcaktohet se distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:</p> <p>$d = nr. k \text{ obj. A} + nr. k \text{ obj. B} + 2m$. Në bazë të planvendosjen së miratuar, distanca minimale ndërmjet objekteve është ruajtur 2.9 metra -3.3 metra, nga distanca minimale prej 4 metrash që duhet respektuar për objektet në lartësinë e 1 kati, sipas formulës $1k + 1k + 2m = 4$ metra.</p> <p>2- Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, për të cilën është marrë Vendimi Nr.1492, datë 10/06/2022, të Kryetarit të Bashkisë Finiq për objektin:” Magazinë për produkte bujqësore 1 kat”, me zhvillues A. A, në Finiq, u konstatua si më poshtë:</p> <p>- Në bazë të VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, Neni 15, pika c, në planin e vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese nuk pasqyrohet rilevimi topografik i punuar nga një inxhinier topograf i licënsuar</p>			
5	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe verifikimi i bërë në terren mbi procedurat e ndjekura nga IMT Bashkia Finiq, në lidhje me zbatimin në terren të kushteve për lejet e ndërtimit dhe veprimtaria e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë, rezultoi se:</p> <p>Në dy raste nga verifikimi në terren dhe nga foto ajrore evidentohet ndryshimi i gjurmës</p>	129-133	I lartë	<p>Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi. Gjithashtu për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi, IVMT të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referencat me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>së objekteve dhe shtim volumesh ndërtimore, pa u pajisur me leje ndërtimi.</p> <p>Në një rast nga verifikimi në terren dhe nga foto ajrore evidentohet shtuar një volum në ndërtimin ekzistues, të pajisur me leje ndërtimi me vendimin. Objekti ka përfunduar punimet pa bërë deklaratë fillim punimesh dhe është në përdorim pa u pajisur me certifikatë përdorimi. Nga verifikimi i realizimit të ndërtimit të terren evidentohet që fasada veriore nuk është realizuar në përputhje me projektin e ndërtimit. Gjithashtu evidentohet që objekti ka përfunduar punimet dhe është në përdorim pa u pajisur me certifikatë përdorimi. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Finiq, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve, ka sjellë si pasojë mosrealizimin e ndërtimit në përputhje me projektin e ndërtimit dhe përdorimin e tij pa u pajisur me leje ndërtimi. Veprime jo në përputhje me ligjin 107, neni 51, Inspektimi e neni 52, Kundërvajtje administrative dhe ligji nr. 9780, datë 16/07/2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar.</p>			
6	<p>Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:</p> <p><i>a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk është zbatuar 10 masa.</i></p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27/11/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27/04/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”</p>	133-137	I lartë	Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 689/7 datë 01/11/2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”
7	<p>Nga vlerësimi i planit buxhetor për vitin 2022, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë me nr. 51, date 24/12/2021 “Per miratimin e buxhetit të Bashkisë Finiq për vitin 2022”, rezulton që vlera e te ardhurave të</p>	52-83	I lartë	- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për bashkërendimin e punës me të gjithë sektorët e tjerë të cilët funksionojnë në planifikimin e te ardhurave, duke përcaktuar qarte vlerat e te ardhurave që duhet planifikuar sipas burimit të krijimit të tyre. Në planifikim buxhetor për

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>planifikuara për vitin 2022 të jetë në vlerën 91,051,000 lekë, ku kjo vlerë përbehet nga detyrimet e mbartura dhe të pa arkëtuara (Debia) deri me 31/12/2021, e pasqyruar në vlerën 14,176,059 lekë si dhe detyrimi i vitit ushtrimor 2022 që është në vlerën 76,874,941 lekë.</p> <p>Sipas të dhënave të pasqyruara në regjistrin e të ardhurave që administrohet pranë Drejtorisë të të Ardhurave, rezultojnë se të ardhurat për vitin 2022 janë në vlerën 264,863,312 lekë, ku kjo vlerë përbehet nga detyrimet e mbartura dhe të pa arkëtuara (Debia) deri me 31/12/2021 është në vlerën 187,988,971 lekë si dhe detyrimi i vitit ushtrimor 2022 që është në vlerën 76,874,941 lekë. (Vlera e debisë në fund të vitit 2021 që është 187,988,971 lekë është e pasqyruar në regjistër, tek pasqyrat analitike si dhe tek pasqyrat financiare). <i>Pra kemi një planifikim në planin e buxhetit të vitit 2022, me pak për vlerën 173,812,312 lekë.</i></p> <p>Krahas të dhënave të trajtuara rezultojnë se në planifikimin buxhetor të vitit 2022, nuk ka një bashkërendim me sektorët e tjerë përgjegjës për vlerësimin e detyrimeve sipas parashikimeve dhe burimeve që disponojnë për realizimin e të ardhurave, kjo për hartimin e një buxheti sa me afër realitetit, ku krahas të tjerave figurojnë pa u trajtuar fare si në buxhet apo dhe trajtuar në regjistrin e të ardhurave vlerë prej 5,800 mijë lekë si <i>“tarife vendore për pajisjen me leje tregtimi për shitjen e karburanteve”</i>.</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezultojnë një gjendje e lartë e detyrimeve nga taksat e tarifave vendore për vlerën 213,212,631 lekë ose afërsisht 2 fish i planit të të ardhurave vjetore të parashikuara në fillim të periudhave ushtrimore, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Finiq, të cilët nuk mund t'i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe dhe që tregojnë se megjithë punën e bërë nga kjo administratë në rikëtimin e debitorëve, ka akoma vend për përmisim dhe në zbatim të të gjitha dispozitave ligjore për arkëtimin e tyre.</p>			<p>vazhdimësinë të pasqyrohen qarte vlera e debisë së mbartur si dhe detyrimi vjetor që është pasqyruar në regjistrin e të ardhurave. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë të të ardhurave të Bashkisë të merren masat e menjëhershme për vlerësimin e detyrimeve të subjekteve që merren me tregtinë e hidrokarbureve, duke arkëtuar detyrimin prej 5.600.000 lekë, në rast të kundërt të vlerësohen kërkesat e ligjit deri në pezullimin e aktivitetit.</p> <p>Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Finiq, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rregullat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2021 në vlerën 213,212,631 lekë.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referencat me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Nga të dhënat evidentohet se niveli i detyrimeve të paarkëtuara (taksa/tarifa vendore), vjen në rritjen nga njëra periudhë në tjetrën për vlerën 25,224 mijë lekë, ku nga vlera 187,988 mijë lekë në fund të vitit 2021 në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 213,212 mijë lekë.</p> <p>Gjithashtu evidentohet një numër subjektësh të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitetet dhe nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, janë lejuar që të ushtrojnë aktivitetet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite.</p> <p>Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17/12/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligji nr. 68/2017, datë 27/04/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20/03/2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09/03/2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32, Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</p>			
8	<p>Nga vlerësimi i të dhënave mbi numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Bashkisë Finiq, si dhe vlerësimi i statusit të këtyre subjekteve është konstatuar se: Numri i bizneseve në <i>fund të vitit 2021 ishin 222 subjekte</i>, (146 subjekte fizike dhe 76 subjekte juridike) ndërsa në <i>fund të vitit 2022 ishin 220 subjekte</i>, (146 subjekte fizike dhe 74 subjekte juridike).</p> <p>Nga 146 subjekte fizike që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Bashkisë Finiq, jane te regjistruar pranë QKB dhe disponojnë Nipt</p>	52-83	<i>I lartë</i>	<p>Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masat e menjëhershme për verifikimin e statusit të këtyre subjekteve në teren, si dhe të kërkohet zbatimi i procedurave për përfitimin e këtij statusi. Po kështu të kërkohet menjëherë arkëtimi i detyrimeve të pa likujduara nga ana e këtyre subjekteve që është në vlerën 1,757,602 lekë.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>121 subjekte fizike, ndërsa 25 subjekte ushtrijnë aktivitet, paguajnë taksat dhe tarifave vendore, por nuk figurojnë te pajisur me Nipt nga ana e QKB. Gjate vitit 2022, rezultojnë 8 subjekte me statusin “ mbyllje te aktivitetit”, si dhe 2 subjektet te cilat kane kaluar në statusin “subjekte të pezulluara”, ku për këto subjekte të cilat kane ndryshuar statusin nga subjekte aktive në pezullim apo dhe mbyllje aktiviteti, në dosjet e subjekteve nuk disponohej dokumentacioni i duhur për te përfutuar këtë status, Akoma me tepër qe 4 subjektet qe figurojnë me status te mbyllur, figurojnë debitore pranë Bashkisë për vlerën 1,757,602 lekë.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshti me ligjin nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17/12/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.</p>			
9	<p>Nga sipërfaqja totale nen ujë prej 9.550 ha, e transferuar nga Bordi i Fierit në Bashkinë Finiq, sipas te dhënave te Njesisë së Ujitjes dhe Kullimit figurojnë te mbjella 5.565,3 ha. Po sipas te dhënave te kësaj Njesisë pretendohet së vaditen vetëm 1.074,5 ha. Pra vaditen vetëm 19.3% te sipërfaqes së mbjelle, për te cilën nuk ekziston asnjë lloj dokumentacioni mbi monitorimin e 4.491 ha sipërfaqeje e mbjelle dhe qe nuk vaditet.</p> <p>Nga vlerësimi pranë Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore te Bashkisë, rezulton së për vitin 2022, detyrimi i llogaritur për vitin është për 3,335 familje në vlerën prej 1,764,270 lekë, nga e cila është arkëtuar vetëm 712,164 lekë, ose në masen 40.36 %. Gjithashtu është konstatuar së në</p>	52-83	I lartë	<p>Njesisë së Ujitjes dhe Kullimit pranë Bashkisë Finiq të bëjë monitorimin e gjithë sipërfaqes së mbjelle për cdo kulture, te monitoroje kërkesat për vaditje dhe te vlerësoje detyrimin sipas kërkesave te ligjit nr. 24/2017, date 09/03/2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe te kullimit”.</p> <p>- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq në bashkëpunim me Njesisë e Ujitjes dhe Kullimit, të marrë masa të menjëhershme të bëjë njoftimin te gjithë fermerëve mbi detyrimet qe kane pa likjuar për arkëtimin e detyrimeve te mbartura dhe te pa arkëtuar deri në fund te vitit 2022, për vlerën 3,465,443 lekë</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>fund te vitit 2021, për zërin “Detyrim nga vaditja” i krijuar gjate periudhës 2017 deri në fund te 2021, rezulton për 3,454 familje në vlerën 3,061,081 lekë, ku nga ky detyrim gjate vitit 2022 është arkëtuar vetëm 647,744 lekë, ose në masen 21.16%.</p> <p>Pra në fund te vitit 2022, detyrimi i pa arkëtuar nga zëri “Detyrim për vaditjen” është në vlerën 3,464,443 lekë.</p> <p>Ne lidhje me detyrimin e vaditjes për familje në Drejtorinë e taksave te Bashkisë, nuk figuron asnjë lloj dokumentacioni qe te jetë bere konvertimi i tarifës në vartësi te sipërfaqes së mbjelle dhe mënyrës së ujitjes sipas pikës “ç” te paketës fiskale.</p> <p>- Nuk disponohet asnjë lloj monitorimi qe te përcaktojë detyrimin sipas kërkesave te paketës fiskale për “ pike lidhje në ujësjellësit e rezervuarëve, poshtë saraçineskës së ujësjellësit”, qe ka tarifën 1,500 lekë.</p> <p>- Nuk na është vene në dispozicion asnjë lloj njoftimi dërguar për detyrimet e mbartura apo dhe për detyrimin e vitit ushtrimor në fermerë apo familje debitorësh, në nje moment qe ky detyrim në fund te vitit 2022, vetëm për sipërfaqen qe pretendohet së është vaditur është në vlerën 3,465,443 lekë.</p>			
10	<p>Nga auditimi i kontratave verore te lidhura për vitin 2022, rezultoi se, 14 subjekte të cilët kane lidhur kontrata, rezultojnë debitor për shumën 598,500 lekë, ndërsa, nga kontratat dimërore te lidhura për sezonin dimëror 2021- 2022, rezultojnë debitor 64 subjekte për shumën 2,950,000 lekë, nga krahasimi i kërkesës së paraqitur nga qiramarrësi, numrit te krerëve te vaksinuar sipas certifikatës veterinarë, vërtetimit për numrin e krerëve si dhe kontratës së lidhur, ku kontrata është lidhur me pak për numër krerësh. në total, vlera e arkëtuar me pak, për kullotat verore 2022 dhe kullotat dimërore 2022 - 2023 është 3,548,500 lekë.</p>	52-83	<i>I lartë</i>	Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës së detyrimit prej 3,548,500 lekë nga subjektet përkatës sipas trajtimit analitik te bere në kapitullin e auditimit te kontratave te lidhura për dhënien me qira te sipërfaqeve kullimore.
11	<p>Nga auditimi i shlyerjes së detyrimeve qe rrjedhin nga kontratat e lidhura për dhënie me qira te sipërfaqes kullimore dhe pyjore, për aktivitete të ndryshme, rezultuan debitore 3</p>	52-83	<i>I lartë</i>	Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës debitore prej 703,400 lekë nga 3 subjekte debitore , përkatësisht, nga A. I për shumën 146,000 lekë , S. S për shumën 273,600 lekë dhe I. D për shumën 283,800 lekë .

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>subjekte, si me poshtë:</p> <p>1. A. I (Respekt),i cili ka detyrimin vjetor në shumën 20,000 lekë nuk ka shlyer detyrimin e vitit 2022 si dhe figuron debitor edhe për vitet e kaluara në shumën 126.000 lekë, gjithsej 146,000 lekë.</p> <p>2. S. S. ka lidhur 2 kontrata, njëra me vlerën 30,000 lekë/ vit dhe tjetra me vlerë 36,000 lekë/vit, vlera, te cilat nuk jane paguar për vitin 2022 si dhe figuron debitor për vitit e kaluara në shumën 96,000 lekë për kontratën e pare dhe 111,600 lekë për kontratën e dyte, gjithsej 207,600 lekë. Se bashku me detyrimin e vitit 2022, ky subjekt rezulton debitor në shumën totale 273,600 lekë.</p> <p>3. I. D (s'ka dokumentacion), është lidhur kontrata për nje siperfaqe prej 0,3 ha dhe me nje detyrim vjetor prej 66,000 lekë/vit, te cilit në vitin 2022 i ka mbaruar kontrata, por deri në fund te vitit 2022 figuron debitor për shumën 283,800 lekë (4 vite). Gjithsej, detyrimi i papaguar për 6 subjektet është në shumën 703,400 lekë.</p>			
12	<p>Nga verifikimi i kryer, rezultoi se, nga 189 subjekte të ish komunës Mesopotam qe kane marre me qira toka bujqësore te pandara, rezultojnë debitore për vitin 2022, 9 subjekte, për shumën totale 75,158 lekë, ku, 68,016 lekë është detyrimi vjetor dhe 7,142 lekë është kamatëvonesa.</p> <p>Ndërsa, përsa i përket debitorëve te krijuar në vite, deri në fund te vitit 2022, rezultojnë debitore 25 subjekte për shumën totale 4.558.478 lekë, ku, 1,392,673 lekë jane detyrimet dhe 3,165,805 lekë janë kamatëvonesa. Po kështu, figurojnë debitore për mospagimin e kamat vonesës në vite, 136 subjekte për shumën totale 10,605,571 lekë.</p> <p>Gjithsej, shuma totale e detyrimeve të pa arkëtuara deri në fund te vitit 2022 është 15,164,049 lekë, nga e cila 1,392,673 lekë jane detyrime dhe 13,771,376 lekë jane kamatëvonesa.</p> <p>Ndërsa, nga 16 subjekte të ish komunës Finiq, rezultojnë debitore për vitin 2022, 9 subjekte, për shumën totale</p>	52-83	<i>I lartë</i>	<p>Nga auditimi i shlyerjes së detyrimeve qe rrjedhin nga kontratat e lidhura për dhënie me qira te sipërfaqes kulllosore dhe pyjore, për aktivite të ndryshme, rezultuan debitore 3 subjekte, si me poshtë:</p> <p>1. A. I (Respekt),i cili ka detyrimin vjetor në shumën 20,000 lekë nuk ka shlyer detyrimin e vitit 2022 si dhe figuron debitor edhe për vitet e kaluara në shumën 126.000 lekë, gjithsej 146,000 lekë.</p> <p>2. S. S. ka lidhur 2 kontrata, njëra me vlerën 30,000 lekë/ vit dhe tjetra me vlerë 36,000 lekë/vit, vlera, te cilat nuk jane paguar për vitin 2022 si dhe figuron debitor për vitit e kaluara në shumën 96,000 lekë për kontratën e pare dhe 111,600 lekë për kontratën e dyte, gjithsej 207,600 lekë. Se bashku me detyrimin e vitit 2022, ky subjekt rezulton debitor në shumën totale 273,600 lekë.</p> <p>3. I. D (s'ka dokumentacion), është lidhur kontrata për nje siperfaqe prej 0,3 ha dhe me nje detyrim vjetor prej 66,000 lekë/vit, te cilit në vitin 2022 i ka mbaruar kontrata, por deri në fund te vitit 2022 figuron debitor për shumën 283,800 lekë (4 vite).</p> <p>Gjithsej, detyrimi i papaguar për 6 subjektet është në shumën 703,400 lekë.</p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19/03/2007 "Për fondin kulllosor", VKM nr. 632, datë 11/06/2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referencat me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>50,388.16 lekë, ku, 37,324 lekë është detyrimi vjetor dhe 13,064 lekë është kamatëvonesa.</p> <p>Ndërsa, përsa i përket debitorëve të krijuar në vite, deri në fund të vitit 2022, rezultojnë debitorë 14 subjekte për shumën totale 1,742,093 lekë, ku, 377,476.57 lekë janë detyrimet dhe 1,364,616.65 lekë janë kamatëvonesa.</p> <p>Gjithsej, detyrimi i paarkëtuar së bashku me kamat vonesën për të gjitha kontratat është në shumën 16,906,142 lekë, që përbën të ardhur të munguar për Bashkinë.</p>			<p>kositje bari", VKM nr. 391, datë 21/06/2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", VKM nr. 1064, datë 22/12/2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 391, datë 21/06/2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", VKM nr. 799, datë 29.09.2010 "Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme" si dhe Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr. 2, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike.</p>

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

- Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2022, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një *opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes*, për llogaritë vjetore të Bashkisë Finiq, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01/01/2022 - 31/12/2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Finiq bazuar në analizën e riskut¹, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriterë jo të plotësuar, *materiale dhe të përhapura* që janë baza për dhënien e *një opinioni të kualifikuar*, në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me vlerë **24,166 mijë lekë**.

Gjithashtu:

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, ku nga auditimi i 2 kontratave u konstatua dëm ekonomik në vlerën **849 mijë lekë**.

- Në mos zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore në vlerën **231,212 mijë lekë**.

- Në mos zbatimin e akteve ligjore me taksim dhe arkëtimin e taksës së hidrokarbureve për vlerën **5,600 mijë lekë**.

- Në mangësitë e konstatuara në menaxhimin e kontratave të qirave për kullota, toka bujqësore, prona për vlerën **27,086 mijë lekë**.

- Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të bashkisë kaluar me VKM në pronësi të saje.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-paga; 202- Studime dhe kërkime; 401-408-Furnitorë e llogari të lidhura me to; 467-Kreditorë të ndryshëm; 602-shpenzime operative; 215-Mjete transporti; 218-Inventar ekonomik; 32-Objekte inventari dhe 230- 231-investime.

¹ Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

a. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Finiq për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, shënimet shpjeguese, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj, duke konkluduar në një *Opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje*:

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705[2], dhe ISSAI 1200[3], pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”. Këto anomali janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 1,187 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2022, si dhe anomalitë e mëposhtme:

1. Në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve Afatgjata (kosto historike)” është kontabilizuar vlera 4,309,706 lekë e cila është pasqyruar si nxjerrje jashtë përdorimit në referencën e llogarisë 21-28, “II. Totali i Aktiveve Afatgjata Materiale” llogaria 218 “Inventar ekonomik” ndërkohë që këto aktive nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit.

2. Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31/12/2022, paraqitet në vlerën 17,314,771 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 4,927,580 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 12,387,192 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 7,603,684 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë. Kjo situatë ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të vlerës 7,603,684 lekë në llogarinë 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve”.

3. Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera prej 8,030,494 lekë e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve, për pasojë nuk është kryer inventarë fizik. e cila është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq, Livadhja, Dhiver dhe Mesopotam.

4. Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është kontabilizuar edhe vlera 3,369,024 lekë kosto historike e cila i përket 2 projekteve (Projektim rikonstruksion rruga Dermish-Cerkovice (viti 2017) në vlerën 941,623 lekë + Projekti rehabilitimi i kanalit Filipeu në vlerën 2,427,401 lekë), të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë.

5. Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” më datën 01/01/2022, paraqitet në vlerën 0 lekë në vlerën 300,000 lekë ndërkohë që në këtë llogari nuk janë pasqyruar në total 45 ndërtesa me sipërfaqe 140,821 m², 103 sipërfaqe tokë 19,551,687 m²/ml dhe 223 ha dhe 416 sipërfaqe truall 929,652 m²/ml.

6. Llogaria 211 “*Pyje, kullota, plantacione*” më datën 01/01/2022, paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në këtë llogari nuk janë pasqyruar 21,912.62 ha sipërfaqe nga të cilat: 12,012.45 ha sipërfaqe “*Kullotë*” dhe 9,900.17 ha sipërfaqe “*Pyje*”.

7. Në gjendjen e llogarisë 212 “*Ndërtime konstruksione*” për vlerën historike 292,008,026 lekë, është përfshirë vlera prej 99,236,804 lekë, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike e cila është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja.

8. Gjendja e llogarisë 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2022 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat, për vlerën prej 223,919,792 lekë që i përkasin llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” objekti “*Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal nga burimet e Leshnicës Bashkia Finiq*” me vlerë 194,463,572 lekë, “*Rikonstruksioni i rrugës Karroq*” me vlerë 6,499,572 lekë dhe “*Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë*” me vlerë 22,956,648 lekë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0 lekë, kur ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhej pasqyruar në vlerën gjithsej 223,919,792 lekë.

9. Llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 31/12/2022 lekë e cila përbëhet nga 18 shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash et., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

10. Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 48,538,153 lekë.

11. Llogaria 466 “*Kreditorë për mjetet në ruajtje*” paraqitet në vlerën 74,484,868 lekë, nga të cilat 20,228,104 lekë i përkasin ngurtësimeve të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Finiq nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç’bllokimin e këtyre fondeve.

12. Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 367,464,348 lekë dhe totali shpenzimeve është 329,368,466 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 38,095,882 lekë nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor*” në vlerë 34,719,433 lekë me një diferencë në vlerën 3,376,449 lekë.

b- Opinion mbi përputhshmërinë.

Në auditim ne u mbështetëm në analizë risku, duke vlerësuar materialitetit sipas vlerës së popullatës 1,187 mijë lekë.

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Finiq, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**.*

Baza për opinionin:

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01/01/2022 - 31/12/2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkinë Finiq.

Bazuar në analizën e riskut nga **10** procedura prokurime me vlera të larta me fond limit **110,897 mijë** lekë, janë audituar **8** procedura me fond limit **107,981** mijë lekë ose 97% e totalit të procedurave, ku në **3** procedura me fond limit 21,692 mijë lekë janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e zhvillimit të procedurës dhe **3** procedura me fond limit **24,166 mijë** lekë, OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, materiale të por jo të përhapura, veprime në paligjshmëri të procedurave të zhvilluara.

Gjithashtu:

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, ku nga auditimi i 6 kontratave u konstatua dëm ekonomik në vlerën **849 mijë lekë**.
- Në mos zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifrat vendore në vlerën **231,212 mijë lekë**.
- Në mos zbatimin e akteve ligjore me taksim dhe arkëtimin e taksës së hidrokarbureve për vlerën **5,600 mijë lekë**.
- Në mangësitë e konstatuara në menaxhimin e kontratave të qirave për kullota, toka bujqësore, prona për vlerën **27,086 mijë lekë**.
- Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të bashkisë kaluar me VKM në pronësi të saje.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Finiq:

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Finiq, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 312/1prot, datë 19/04/2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 24/06/2023 deri në datë 26/05/2023, në subjektin Bashkia Finiq, për periudhën objekt auditimi nga 01/01/2022 deri në 31/12/2022, u krye auditimi “*Mbi auditimin financiar dhe i përputhshmërisë*”, nga Grupi i Auditimit i përbërë:

1. **K. GJ**, *Përgjegjës Grupi*
2. **E. M**, *auditues*
3. **M. H**, *auditues*.
4. **S. A**, *auditues*

a- Objekti i auditimit, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën 01/01/2022 - 31/12/2022, të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave në fushën e prokurimeve publike, në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, në dhënien e lejeve të ndërtimit, në menaxhimin e asetëve, etj.

b- Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit dhe hartimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (**ISSAI 1315**)².

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve operative dhe investimeve mbi bazën e procedurave të prokurimit të realizuara për to, si dhe menaxhimit të të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

c- Identifikimi i çështjes: Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Finiq, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

d- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Finiq, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

e- Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të të ardhurave

²Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

f- Kriteret e vlerësimit.

- ✓ Legjislacioni bazë e detyësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit;
- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30/06/2015 e ndryshuar;
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08/08/2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22/06/2022;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi “Auditimin e përputhshmërisë”, Manuali i Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27/04/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”;
- ✓ Ligji nr. 137/2020, datë 16/11/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje;
- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30/07/2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27/12/2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28/12/2006”;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21/02/2022 ” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme“;
- ✓ Ligji nr. 162/2000, datë 23/12/2000 “Për Prokurimin Publik”; VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24/04/2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë.
- ✓ VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “,
- ✓ Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

g- Standardet e auditimit:

- ✓ ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ✓ ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ✓ ISSAI 4000 “Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- ✓ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- ✓ INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

✓ Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

h- Metodatat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27/12/2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

j-Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për

përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), shpenzimet operative (602) dhe shpenzimet për investime (231), ku vlera e precizonit për vitin 2022 është në shumën 11,347 mijë lekë (gabim lejuar).

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH³ aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektive* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

k- Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Me shkresën nr. 312/6prot, datë 12/06/2023 nga KLSH në adresë të subjektit Bashkia Finiq është paraqitur Projekt Raport Auditimi për njohje dhe paraqitje e opsioneve kundërshtuese mbi problematikat e trajtuara. Me shkresën nr. 1527 prot, datë 10.07.2023, nga subjekti Bashkia Finiq u paraqitën kundërshtitë e Projekt Raport Auditimit, të cilat pasi u lexuan nga grupi me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri, gjetjet për të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjorë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për njohje dhe zbatim në përmisimin e punës në të ardhmen.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

2.1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Finiq u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar gjatë vitit 2023. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës *por jo të përhapura*.

³Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektivit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Finiq është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27/04/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Finiq.

-Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Bashkia Finiq bën pjesë në Qarkun e Vlorës.

Të dhëna të përgjithshme:

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Finiq kufizohet në veri me bashkinë Delvinë, në jug me bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkinë Sarandë. Kryeqendra e Bashkisë është Finiq.



Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 11,862 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 39,055 banorë në një sipërfaqe prej 441.20 km². Në bazë të dhënave të censurit, densiteti i popullsisë është 26.7 banorë/ km² ndërsa në bazë të regjistrimit civil densiteti është 88.51 banorë/km².

Njësitë administrative përbërëse janë: Finiq, Aliko, Mesopotam, Dhiver dhe Livadhja.

Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e rrethit Sarandë, qarku Vlorë. Për të parë listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Censur 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Vlorë	Fshati Dermish	Livadhja	Fshatrat: Livadhja, Kulluricë, Llazat, Kalcat, Kodër, Lefter Talo, Gravë, Qesarat, Komat, Karroq, Grazhdan, Zminec.	11,862	39055	441.2
		Dhivër	Fshatrat: Dhivër, Rumanxë, Memoraq, Navaricë, Dermish, Leshnicë e Sipërme, Leshnicë e Poshtme, Janicat, Llupsat, Cerkovicë, Shëndre, Malcan			
		Aliko	Fshatrat: Aliko, Çaus, Neohor, Tremul, Rahullë, Pillakë, Jermë, Vurgu i Ri, Halo, Dritas			
		FinIQ	Fshatrat: Finiq, Buronjë, Çlirim, Vrion, Karahaxhë, Bregas			
		Mesopotam	Fshatrat: Mesopotam, Dhrovjan, Krongji, Bistricë, Velahovë, Livinë, Brajlat, Sirakat, Kostar, Fitore, Krane, Ardhosovë			

Profili i bashkisë

Bashkia Finiq është një bashki që shtrihet në zonën bujqësore të fushës së Vurgut dhe në zonën malore të rrëzomës së Vurgut. Banorët e zonës i përkasin minoritetit grek dhe kjo

zonë ka përjetuar hemorragji demografike si pasojë e largimit të popullsisë drejt kërkimit të një jete më të mirë në Greqi.

Zona bujqësore është pjellore dhe aktiviteti bujqësor është rigjallëruar gjatë viteve të fundit.

Infrastruktura e komunës është përmirësuar gjatë dy dekadave të fundit falë investimeve të shumta ndërkuftare por emigrimi ka larguar nga zona pjesën më të madhe të popullsisë, veçanërisht të rinjtë, duke lënë pas njerëz të moshuar.

2.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Pika 1 e programit: Mbi menaxhimin financiare dhe kontrollin e brendshëm.

Titulli i gjetjes 1: *U konstatuan mangësi në plotësimin e kërkesave që kërkojnë 5 komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale për realizimin të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve.*

Situata:

Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

Në Bashkinë Finiq, nuk është miratuar kodi i etikës profesionale në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në papajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 2, datë 06/02/2012 “Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit” pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, neni 4 pika 19 dhe neni 16 pika 2. Gjithashtu, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar.

Lidhur me identifikimin e aktiviteteve më risk, hapjen e regjistrit të riskut si dhe menaxhimin e tij, në Bashkinë Finiq, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore pasi nuk është caktuar koordinatori i riskut në kundërshtim me kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010. Për rrjedhojë nuk është miratuar Strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e riskut.

Nga ana e Titullarit të Bashkisë Finiq, nuk janë nxjerrë urdhër me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, por njësitë organizative kanë të përcaktuar detyrat e tyre në rregulloren e funksionimit të brendshëm të institucionit.

Nga ana tjetër, nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, neni 27.

Për rrjedhojë, Planet e Zhvillimit Strategjik dhe planet buxhetore afat mesëm, nuk janë miratuar nga GMS-ja në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 datë 29/03/2012 “Procedura e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.

Informimi dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17/11/2016.

Ndikimi/Efekti:

Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mos trajnimi për rritjen profesionale të stafit si dhe mos perfeksionimi i sistemeve të IT për ofrimin e informacionit, ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit. Mosfunksionim i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Auditit të Brendshëm. Risku i brendshëm është i lartë.

Shkaku:

Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave. Mosnjohje nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, me nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E Mesëm

Për këtë rekomandojmë: Titullari i njësisë vendore me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat për:

- Hartimin e planit të trajnimeve;
- Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS);
- Aplikimin e programeve elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Caktimin e kordinatorit të riskut.

Nënpika 1.2 e programit: Organizimi i Njësisë së AB dhe vlerësimi i veprimitarisë.

- Organizimi dhe funksionimi i strukturës së Njësisë të Auditit të brendshëm:

Auditimi i Brendshëm në Bashkinë Finiq, është siguruar **si shërbim auditimi** me akt marrëveshjen të lidhur midis titullarëve të njësisë Bashkia Dropull dhe Finiq, me nr. 1333 *prot*, të ofertuesit dhe nr. 2465 *prot*, të përfituesit, datë 04/10/2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 13478/1*prot*, datë 31/10/2016, rikonfirmuar me shkresën e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 17390/1 *prot*, datë 05/11/2021, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja “c”, si dhe nenit 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, të VKM nr. 83, datë 03/02/2016, pika 6 shkronja “a”, “Për miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull, **e cila jep shërbim dhe në Bashkinë Finiq** në mbështetje të Akt marrëveshjes, ka filluar funksionimin e saj nga muaji Prill 2016, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”, e cila, për vitin 2022 funksionon në nivel drejtorie (*sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 62, datë 25/11/2021, vendim i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.1075/1 datë 09/12/2021*).

- Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësisë së auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion dhe që ndodhet pranë zyrës së burimeve njerëzore në Bashkinë Dropull, konstatohet se stafi i NJAB për vitin 2022, kjo njësi auditimi është organizuar me 5 punonjës, në nivel drejtorie me strukture 1 drejtues njësie, 1 përgjegjës sektori dhe 3 auditues.

Në fakt kjo njësi gjatë vitit 2022, kishte në përbërjen e saj 3 punonjës, përkatësisht 1 drejtues, 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialiste auditimi, ku profili arsimor i gjithë stafit të kësaj njësie auditimi, rezulton që të jenë të diplomuar në fushën e ekonomisë, ku i gjithë stafi është i çertifikuar, me përvojë pune në fushën e auditimit, drejtuesi dhe përgjegjësja e sektorit me mbi 10 vjet dhe përvojë profesionale në fushën ku janë diplomuar, duke filluar nga 25-35 vjet, 1 auditues i çertifikuar është me përvojë pune në auditim për 4 vite, me përvojë pune 13 vjet.

Struktura e kësaj njësie auditimi, në formë tabelore për periudhën e audituar për vitin 2021, paraqitet Aneks 1.2 Bashkëlidhur Projekt Raport Auditimit.

- Dokumentacioni baze mbi te cilën ushtron aktivitetin Njësia e Auditimit te Brendshëm.

Nga vlerësimi i kryer nga grupi i auditimit, per vitin 2022, pasi shqyrtoi evidencat dhe korrespondencën e kryerjes dhe raportimit te veprimtarisë audituese, planifikimin strategjik dhe atë vjetor, raportimin vjetor dhe periodik, konstaton se dokumentacioni baze mbi te cilën ushtron veprimtarinë NjAB, është si me poshtë:

1.Karta e Auditimit te Brendshëm është miratuar me Vendimin nr. 1 datë 18/10/2017, *prot* me nr. 2990 *prot* datë 18/10/2017, dërguar Drejtorisë se Harmonizimit te Auditimit te Brendshëm, me shkresën nr. 1367 *prot* datë 20/10/2017, është **përmirësuar** me Vendimin nr.1 datë 09/10/2020, *prot* me nr. 3255/1 datë 09/10/2020, dërguar Drejtorisë se Harmonizimit te Auditimit te Brendshëm, me shkresën nr. 1916/1 *prot* datë 13/10/2020.

2. Plani strategjik si dhe plani vjetor, per vitin 2022, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të “Manualit per Auditimin e Brendshëm ne Sektorin Publik”, si dhe te nenit 14, te ligjit nr. 114/2015, datë 22/10/2015 “Për auditimin e brendshëm ne sektorin publik”, te cilat jane miratuar nga Kryetari i Bashkise Finiq, me shkresën nr. 2910 *prot*, datë 19/10/2021, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë se Harmonizimit te Auditimit te Brendshëm ne Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1870 *prot*, datë 19/10/2021.

Plani vjetor i auditimit si një dokument bazë i veprimtarisë audituese, parashtron kriteret e procedurat të cilat janë parashikuar në dispozita ligjore, si: F... prioritare, frekuencën e auditimeve, përmisimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve njerëzore dhe nevojat për auditim, kosto auditimi, etj.

Ne planin vjetor te auditimit janë përfshire për auditim sistemet me risk te mesëm dhe te larte, ku drejtimet kryesore te auditimit per Bashkinë Finiq, kane gene:

-*Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit ne lidhje me zbatimin e rekomandimeve qe janë lënë ne auditimet e mëparshme, nga audituesit e brendshëm si ne Bashki ashtu dhe ne Shoqërinë “U.” sha Finiq.*

-*Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura, si per Bashkinë Finiq, ashtu dhe per Shoqërinë “U.” sha Finiq.*

-*Vlerësimi mbi funksionimin e shoqërisë “U.” sha, duke vlerësuar hartimin dhe menaxhimin e programit ekonomik financiar, menaxhimin e te ardhurave te krijuara nga shitja e ujit apo dhe shërbimeve te ndryshme qe kryhen ndaj klientit apo dhe nga subvencionet, funksionimi i sistemit kontabël dhe pasqyrat financiare, menaxhimi i fondeve te prokuruar, funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në përputhje me legjislacionin, për arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës, etj.*

-*Vlerësim i rregullshmërisë ligjore baze dhe mbështetëse si dhe rregullorja qe drejton veprimtarinë e subjektit.*

Nga Njësia e Auditimit te Brendshëm, referuar kërkesave te nenit 14, pika ‘ç’ te ligjit nr. 114/2015, datë 22/10/2015 “Për Auditimin e Brendshëm ne Sektorin Publik”, është hartuar Raporti Vjetor i veprimtarisë, se bashku me pasqyrat përkatëse dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm, miratuar nga Titullari dhe dërguar tek Drejtoria e Harmonizimit te Auditimit te Brendshëm ne Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 319 *prot*, datë 14/02/2023.

Veprimtaria e AB për periudhën 2022, i është përmbajtur planit vjetor dhe strategjik te saj, në përputhje me standardet procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e AB dhe Udhëzimin në fuqi, në fushën e AB, e cila paraqitet si me poshtë:

- Angazhim i kombinuar,

1. Ne zbatim te planifikimit per vitin 2022, miratuar me shkresën nr. 2910 *prot*, datë 19/10/2021, është realizuar auditimi i kombinuar ne Shoqërinë “U.” sha Finiq, sipas programit te angazhimit me nr. 71/3 datë 31/08/2022, per veprimtarinë e kësaj Shoqërie, me periudhe 01/01/2021 deri me 31/08/2022, auditim i cili është realizuar brenda 3 mujorit te katërt te vitit 2022.

Objekti i auditimit ishte zbatimi i Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 63 datë 27/01/2016 “Për organizimin e operatorëve qe ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë te pijshëm, grumbullimin dhe trajtimin e ujerave te ndotura”, ne drejtim te administrimit te asetëve, planifikimit dhe realizimit te ardhurave dhe shpenzimeve, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit te brendshëm, etj.

-Vlerësimi i kryer mbi hartimin dhe miratimin e programit ekonomik te shoqërisë.

Veprimtaria e shoqërisë “U.” sha Finiq, është realizuar bazuar ne planin e buxhetit vjetor te hartuar nga ana e Drejtorisë ekonomike, buxhet i miratuar vetëm nga ana e Këshillit te Administrimit, ku ky plan kishte bashkangjitur tabelat përkatëse ne te cilat pasqyroheshin treguesit kryesore te zhvillimit te shoqërisë per vitin ushtrimor.

Ne paraqitjen dhe miratimin e këtij buxheti vjetore, nuk disponohej asnjë relacion shpjegues mbi bazën e marrjes se te dhënave per krijimin e këtij buxheti.

Per periudhën e audituar, nuk është kryer hartimi dhe miratimi i programit ekonomik i shoqërisë, kjo sipas kërkesave te Udhëzimit te Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë me nr.15 datë 02/05/2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik te shoqërive tregtare me kapital shtetëror” pasi:

- *Nuk ka plan ekonomik (buxhet) per parashikimin e dy viteve pasardhëse, por është hartuar dhe miratuar vetëm per vitin ushtrimor.*

- *Nuk është dërguar program ekonomik (buxheti) se bashku me vendimin e Këshillit te Administrimit per miratim përfundimtar ne Ministrinë përgjegjëse per ekonominë.*

-*Nuk është kryer hartimi dhe miratimi i programit ekonomik (buxheti) brenda afateve te përcaktuara, qe është data 1 Dhjetor te çdo viti.*

- *Mos hartimi i programit ekonomik, si dhe mos zbatimi i kriterëve baze mbi hartimin e planit buxhetor ne lidhje me përmbajtjen, relacionet, preventivat, afatet, apo miratimin e tij nga strukturat përkatëse, jane ne kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit te MZHETS, me nr.15, datë 02/05/2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik te shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, veprim qe krijon risk te larte per shoqërinë, pasi funksionon pa nje bosht orientues, si dhe krijon pamundësi realizimi te nje auditimi sa me eficient.*

- Vlerësimi mbi planifikimin e te ardhurave, regjistrimi i tyre, arkëtimi, si dhe ndjekja e debitorëve.

- Nga mbikëqyrja e regjistrit të të ardhurave te shoqërisë, është konstatuar se detyrimi vjetor si dhe debia e mbartur, jane mbajtur bashke në një kollon pa ndare detyrimin vjetor dhe debinë e mbartur sipas viteve apo dhe progresive.

- Nuk është bere ndarja e abonentëve me tarife aforfe, apo dhe atyre me matëse, si dhe sipas llojit te abonentëve familjare, biznese, apo dhe ente shtetërore.

Ne vlerësimin e grupit te auditimit, ne lidhje me mbajtjen dhe trajtimin e te dhënave ne regjistër, jo analitike per çdo abonent te ndare detyrimin vjetor nga ai mbartur (debi) sipas kohës se krijimit te tyre, krijon vështirësi ne vlerësimin e plotë të tyre, pasi paraqitja ne total dhe progresive dhe jo analitike, humbet gjurmët e auditimit mbi krijimin e debitorëve.

- **Tarifat e përdorura** ne vlerësimin e detyrimit per çdo abonent, jane aplikuar ato te miratuara me Vendim te Këshillit Bashkiak, si dhe vendimit te Këshillit te administrimit per çdo vit ushtrimor, kjo si per abonentët me **tarife amorfë** ashtu dhe per **abonentët me matëse**.

- Furnizimi me ujë të pijshëm nga shoqëria e ujësjellësit për konsumatorët, kryet **ne baze të nje kontrate furnizimi** të lidhur mes palëve, **vetëm për abonentët e pajisur me matëse dhe jo për pjesën tjetër të abonentëve pa matëse (amorfë)**, duke mos zbatuar kërkesat e VKM me nr. 236 datë 10.05.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjare dhe jo familjare”, si dhe Vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator me nr.8 datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës Tip”.

- Vlerësimi i kryer nga grupi i auditimit mbi performancën e treguesve ekonomiko-financiare.

- Nga ana e kësaj shoqërie në hartimin e buxheteve për vitin 2022, kjo në planifikimin e të ardhurave, nuk janë marrë në vlerësim të gjitha burimet e krijimit të të ardhurave, ku nga ana e kësaj shoqërie nuk janë vlerësuar të gjithë abonentët familjare, biznese, apo dhe ente shtetërore, që furnizohen me ujë, mos pasqyrimi në planifikimin e të ardhurave mbi vlerën e debitorëve që janë të mbartur pa likujduar deri në fund të vitit 2021, si dhe mos vlerësimi i plote i furnizimit me ujë të 32 fshatrave.

- Në planifikimin buxhetor, për vitin 2022, nga dega ekonomike **nuk janë pasqyruar në planifikim, vlerat reale të debisë që figuron në regjistrin e shoqërisë**, duke ulur fiktivisht vlerën e të ardhurave që duhej të planifikohej për çdo vit, ku paraqitet sa më poshtë:

a. Gjate vitit 2021, është planifikuar nga shoqëria, me pak se sa janë kërkesat e regjistrin për vlerën **37,818,433 mije lekë**, vlere debie e pa trajtuar.

b. Gjate vitit 2022, është planifikuar nga shoqëria, me pak se sa janë kërkesat e regjistrin për vlerën **37,550,062 mije lekë**, vlere debie e pa trajtuar.

Në referencë të të dhënave **sipas rivlerësimit** të realizuar nga grupi i auditimit (referuar gjithmonë shifrave të shoqërisë të përcaktuara në regjistër), **vlera e debisë që duhej të ishte pasqyruar në pasqyrat financiare të fund viti 2021**, të ishte në vlerën **42,400,062 lekë me TVSh** dhe jo **10,742,458 lekë** që ishte e pasqyruar. **Pra kemi një mos pasqyrim të debisë në pasqyrat financiare të fund vitit 2021, në vlerën prej 31,657,604 lekë me TVSh.**

- Nga ana e shoqërisë “U...” sha Finiq, nuk janë lidhur kontratat për furnizimin me ujë me të gjithë abonentët familjare dhe jo familjare, kjo në kundërshtim me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236 datë 10/05/1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjare dhe jo familjare”, i ndryshuar.

- Nga ana e shoqërisë “U...” sha Finiq, nuk ka hartuar planin strategjik për zvogëlimin e humbjeve të ujit në rrjet. Ky plan duhet të përmbajë objektiva dhe masa konkrete, që duhet të ndërmerren nga shoqëria për eliminimin e humbjeve të ujit në rrjet.

- Nga ana e shoqërisë “U...” sha Finiq, nuk ka një program ekonomik si për vitin 2021 dhe për vitin 2022, ku të jete bere bilanci i ujit (analiza e humbjeve teknike dhe menaxheriale).

- Nga ana e Shoqërisë “U...” sha Finiq, **nuk është bere aplikimi pranë ZRPPV për regjistrimin e pronave të paluajtshme, prone shtetërore, të vendosura si kontribut në natyrë në kapitalin themeltar të shoqërisë**, kjo në kundërshtim të plote me Ligjin Nr. 8743, datë 22/02/2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar.

Angazhime përputhshmërie.

Qëllimi i kryerjes së këtij auditimi ishte Vlerësimi paraprak i lindjes së detyrimeve financiare të prapambetura, klasifikimi i tyre sipas standardeve të kontabilitetit publik dhe kohës së krijimit të detyrimeve për çdo kategori, monitorimi i shlyerjes, si dhe përgatitjen e planit të masave për parandalimin e krijimit të këtyre detyrimeve në të ardhmen.

1. Është realizuar angazhim **“Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë”**, në Bashkinë Finiq, në zbatim të planit vjetor 2022, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 2910 prot, datë 19/10/2021, dhe programit të angazhimit me nr. 2285/3 prot, datë 30/08/2022, ku është audituar **“Vlerësimi i sistemit mbi detyrimet e prapambetura”**, për periudhë auditimi deri 31/08/2022.

Nga vlerësimet e kryera nga grupi i auditimit, është konstatuar se:

Gjendja e detyrimeve të prapambetura me datën 31/12/2021 (sipas evidencës analitike) ishte në vlerën prej **52,734,477 lekë**, kjo është klasifikuar sipas llogarive përkatëse, e konkretisht:

- Projekte për investime: Rikonstruksione në vlerën 14,300,176 lekë, supervizimi-kolaudim dhe vlerësim aktivesh në vlerën 4,570,546 lekë, gjithsej 18,870,722 lekë.
- Mallra e shërbimeve për vlerën 33,204,275 lekë.
- **Vendime Gjyqësore** : 2 vendime gjyqësore për vlerën **659,480 lekë**.
- Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në evidencat e detajuara për detyrimet e prapambetura me pasqyrat financiare në fund të vitit 2021, rezulton që ky detyrim përputhet me vlerën e pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2021 në total dhe sipas llogarive përkatëse.
- Gjendja e detyrimeve të prapambetura me **31/08/2022**, rezulton se nga ana e kësaj Bashkie janë shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura që nuk ishin likuiduar për mbyllje limiti dhe nuk janë likuiduar një pjesë e detyrimeve të krijuara për mungesë fondesh apo mungesë dokumentacioni, gjendja e të cilave, në fund të 8-mujorit të vitit 2022, është **63,488,538 lekë nga 52,734,477 lekë** detyrime të prapambetura në fund të vitit 2021.
- Nga ana e Bashkisë nuk është hartuar plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin 2021 dhe për periudhën afatmesme si dhe nuk janë parashikuar për t'u shlyer në planin e buxhetit të vitit 2021, këto detyrime.

Konkluzioni: Vlerësojmë se, Bashkia Finiq ka bërë evidentimin e detyrimeve të prapambetura, por nuk ka punuar për parandalimin e krijimit të detyrimeve financiare, nëpërmjet një planifikimi sa më real të të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi shumë prej detyrimeve janë krijuar për mungesë fondesh, gjë, që ndikon edhe në realizimin e objektivave të përcaktuara për një veprimtari normale të saj.

2. Është realizuar angazhim **“Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë”**, në Shoqërinë **“U...” sha Finiq**, në zbatim të planit vjetor 2022, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 2910 prot, datë 19/10/2021, dhe programit të angazhimit me nr. 05/3 prot, datë 31/08/2022, ku është audituar **“Vlerësimi i sistemit mbi detyrimet e prapambetura”**, për periudhë auditimi deri 31/08/2022.

Nga vlerësimet e kryera nga grupi i auditimit, është konstatuar se:

Gjendja e detyrimeve të prapambetura afatshkurtra me 31/12/2021 figurojnë në vlerën 14,201,363 lekë.

1. Gjendja tek nenllogaria **“Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit”** është pasqyruar në vlerën **12,671,117 lekë**, e cila përbëhet nga:

- Detyrimi ndaj O..., që është në vlerën **12,374,196 lekë**.
- Detyrimi ndaj subjektit "N..." shpk për blerje materiale hidraulike, në vlerën **296,921 lekë**.

Nga vlerësimi është konstatuar **ka mos përputhje të vlerës së trajtuar në evidencën analitike** që është **12,671,117 lekë**, me atë të pasqyruar në pasqyrat financiare të fundit të vitit 2021 që ishte në vlerën **12,667,167 lekë**. Pra, pasqyruar me pak në pasqyrat financiare për vlerën **3,950 lekë**.

2. Gjendja tek nenllogaria **“Te pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore”** është pasqyruar vlera **1,534,196 lekë**, që përfshihen detyrimet e papaguara të fundit të vitit 2021.

Gjendja e detyrimeve të prapambetura, **me datën 31/08/2022**, janë në vlerën **14,084,353 lekë**, e cila përbëhet nga:

- Detyrimi ndaj O..., që është në vlerën **13,822,870 lekë**.
- Detyrimi ndaj subjektit "N..." shpk për blerje materiale hidraulike, në vlerën **166,921 lekë**.
- Detyrimi ndaj subjektit **“T...”** shpk për blerje karburant, në vlerën **79,360 lekë**.

- Detyrim ndaj Postes Shqiptare, 2 % e vlerës se të ardhurave të mbledhura prej saj sipas kontratës së lidhur midis tyre, që është në vlerën **15,202 lekë**.

Nga ana e Shoqërisë nuk është hartuar plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin 2021 dhe për periudhën afatmesme, si dhe nuk janë parashikuar për t'u shlyer në planin e buxhetit të vitit 2022.

Si konkluzion, vlerësojmë se, Shoqëria ka bërë evidentimin e saktë të detyrimeve të prapambetura, por, nuk ka punuar për parandalimin e krijimit të detyrimeve financiare, nëpërmjet një planifikimi sa më real të të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi shumë prej detyrimeve janë krijuar për mungesë fondesh, gjë, që ndikon edhe në realizimin e objektivave të përcaktuara për një veprimtari normale të saj.

3. Është realizuar angazhim **“Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë”**, në Bashkinë Finiq, sipas programit me nr. 2284/2 prot, datë 31/08/2022, për auditimet e realizuara deri në fund të muajit Gusht 2022, në zbatim të Udhëzimit të MFE (Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik) nr. 42, datë 27/10/2020 *“Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”*.

3.1 Në lidhje me rekomandimet e lëna pas përfundimit të **“Auditimit të kombinuar”** të realizuar për veprimtarinë e periudhës 01/01/2017 – 31/05/2018, dërguar Raporti final me shkresën nr. 3226/1, datë 10.01.2019, janë lënë gjithsej 50 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 50 rekomandime, për të cilën **nuk është hartuar plani i veprimit**.

- **Rekomandime të karakterit organizativë**, janë dhënë dhe pranuar 19 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 4 rekomandime, zbatuar pjesërisht ose në proces zbatimi 7 rekomandime si dhe të pa zbatuara 8 rekomandime.

- **Rekomandime të karakterit për arkëtim**, janë dhënë dhe pranuar 31 rekomandime, nga të cilat nuk ka gjetur zbatim asnjë rekomandim.

3.2 Në lidhje me rekomandimet e lëna pas përfundimit të **“Auditimit të përputhshmërisë”** të realizuar për **“Vlerësimi i detyrimeve të prapambetura”**, dërguar Raporti final me shkresën nr. 2648/7, datë 26/11/2021, janë lënë gjithsej 4 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 4 rekomandime, ku deri me sot **nuk është hartuar plani i veprimit**.

- **Rekomandime të karakterit organizativë**, janë dhënë dhe pranuar 4 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 2 rekomandime, si dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime.

3.3 Në lidhje me rekomandimet e lëna pas përfundimit të **“Auditimit të përputhshmërisë”**, në Shoqërinë **“U...” sha Finiq**, dërguar Raporti final me shkresën nr. 32/6 datë 27/04/2021, janë lënë gjithsej 32 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 32 rekomandime, për të cilën **nuk është hartuar plani i veprimit**.

- **Rekomandime të karakterit organizativë**, janë dhënë dhe pranuar 29 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 15 rekomandime, zbatuar pjesërisht ose në proces zbatimi 6 rekomandime, si dhe të pa zbatuara 8 rekomandime.

- **Rekomandime të karakterit për arkëtim**, janë dhënë dhe pranuar 3 rekomandime, nga të cilat të 1 rekomandim është zbatuar, si dhe 2 rekomandime janë të pa zbatuara.

- Vlerësimi i procedurave dhe zbatimit të standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm.

Nga ana e Njësisë së Auditimit të Brendshëm Bashkia Finiq, planifikimi i një angazhimi është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit të AB kapitulli IV, pika 4.1.1 **“Planifikimi i një angazhimi”**, ku nga ana e grupit të auditimit janë zhvilluar takime për njohjen paraprake të subjektit që do të auditohet me subjektin, veprime të cilat janë të dokumentuara me shkrim në procesin e mbledhjes së informacionit dhe përgatitjes së programit të angazhimit.

Gjate kryerjes se angazhimit nga NJAB janë respektuar fazat e planifikimit, si *Autorizimi* për fillimin e auditimit, *Njoftimin paraprak* për fillimin e angazhimit, *takimin fillestar, deklaratën e pavarësisë, vlerësimin e riskut, përcaktimin e drejtimeve të auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos së veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj.*

Janë respektuar kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.6 *“Përgatitja e programit të angazhimit...”*, ku për të arritur objektivat e angazhimit, janë trajtuar si F... prioritare duke planifikuar, auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi prokurimin të fondeve publike, vlerësimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, menaxhimi i burimeve njerëzore, administrimi i buxhetit, deklaratave financiare, etj., pra rezultoi se janë zbatuar drejt kriteret, lidhur me F. prioritare për auditimin e subjekteve, pasi ato kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimtarisë në përputhje me risqet e subjekteve.

Vlerësojmë se në mbështetje me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin MF nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), përgjithësisht programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit.

Nga NJAB të Bashkisë janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj.

Për rastet e parregullive dhe shkeljeve të konstatuara nga Auditimi gjatë ekzaminimit të praktikave dhe dokumentacionit kontabël e administrativ, janë mbajtur dokumentacioni i nevojshëm me personat përgjegjës për fiksimin e shkeljeve të ligjshmërisë dhe të disiplinës financiare.

Kjo strukturë ka plotësuar konformë kërkesave të manualit të auditimit të brendshëm, edhe pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në subjektet që ajo audion, kjo sipas nivelit të riskut, veprim i reflektuar tek formati 7 Kap II të MAB.

Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësi e auditimit, veprime, të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22/10/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”* dhe të kapitullit VI *“Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”* të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016.

- *Vlerësimi i procedurave për rishikimin e brendshëm të cilësisë së punës audituese.*

Nga dosjet objekt auditimi për periudhën audituese, grupi i punës konstatoi se, procedurat e rishikimit të brendshëm të cilësisë së punës audituese janë ndjekur vazhdimisht, siç është parashikuar në kërkesat e manualit të AB (Kap. IV, Pika 4.8.3).

- *Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese.*

Nga njësi e AB të bashkisë, është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohet nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapit. VI *“Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”*, formati 1

“Inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit” si dhe pikës 6.3 “Dosja e përhershme”.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe në zbatim të tij “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor të Republikës së Shqipërisë”. Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim.

Mbi rezultatet e auditimit për vitin 2022, të dhënat janë dhe në pasqyrat shoqëruese bashkëlidhur materialit. (*Mbi rezultatet e auditimit për vitin 2022, të dhënat janë në Aneks 1.2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Titulli i Gjetjes: <i>Mos realizim i auditimit në F...t kryesore të institucionit</i>
--

Situata:

Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në F...t kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si F... me risk të lart, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut.

Kriteri:

Ligji nr. 114/2015, datë 22/10/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Ndikimi/Efekti:

Mos realizimi i auditimit në F. kryesore të institucionit nuk i jep mbështetjen e duhur kryetarit të bashkisë për arritjen e objektivave.

Shkaku:

Angazhimi i audituesve të auditit të brendshëm në 3 bashki njëkohësisht.

Rëndësia: E mesme

Për këtë rekomandojmë: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Finiq të marrë masa për planifikimin në programet e auditimit të F...ve kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si F... me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

Pika 2.2 e programit: Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2022

- *Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022.*

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA-së për vitet 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes konkretisht, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallra e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i taveve të shpenzimeve sipas programeve, etj. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se janë kryer konsultime me grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Me shkresën nr. 123 prot., datë 18.10.2021, dhe Urdhrin nr. 8 prot., datë 18.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë z. K. K është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) i përbërë nga 9 anëtarë si dhe ekipet e menaxhimit të programeve i përbërë nga 23 anëtarë

sipas njësisve shpenzuese buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2022-2024.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, U... Finiq Sh.a etj., gjë e cila vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktik të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Titulli i gjetjes 1: *Nga Bashkia Finiq projektvendimi dhe relacioni për buxhetin e vitit 2022 është dërguar jashtë afateve pranë Këshillit Bashkiak.*

Situata:

Për vitin 2022, titullari i Bashkisë Finiq, ka paraqitur në Këshillin Bashkiak shkresën e datës 07.12.2021, për miratim PBA 2022-2024 dhe buxhetin e vitit 2022, e cila është jashtë afateve të parashikuara në dispozitat ligjore.

Vendimi i miratuar nga Këshilli Bashkiak është bazuar në projektvendimin dhe relacionin e hartuar nga Drejtori i Financës znj. L. M dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. K. K, konkretisht miratuar me VKB nr. 51, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2/1 prot., datë 17.01.2022.

Kriteri:

Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 1, ku përcaktohet që: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për miratimin në këshill projektbuxhetin vjetor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor”.

Ndikimi/Efekti:

Dërgimi i projektvendimit dhe relacionit për miratimin e buxhetit jashtë afateve ligjore ndikon në shqyrtimin dhe vendimmarrjen e gabuar.

Shkaku: Mos respektimi i afateve për miratimin e buxhetit.

Rëndësia: E mesme.

Për këtë rekomandojmë: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që projektvendimi dhe relacioni për buxhetin vjetor të dërgohet për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda afateve ligjore.

Në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues, si për fazën e parë dhe për fazën e dytë të PBA 2022-2024, sipas VKB nr. 51, datë 24.12.2021. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2022-2024, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 12 programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2022-2024 janë përcaktuar “Përshkrimi” i çdo program, “Politika e programit”, “Qëllimi i Politikës së programit”, “Objektivat e politikës së programit”. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij, shpërndarja e fondeve sipas programeve paraqitet *Aneksin nr. 2/1, pika 2.1, “Programimi i shpenzimeve për vitin 2022”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Nga të dhënat e *Aneksit nr. 2/2, pika 2.1, “Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për viti 2022”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*, konstatohet se pjesa dërmuese e fondeve rreth 61.4% shkon për zërin investime.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “fondin e pagave” dhe “sigurimeve shoqërore” (600, 601), llogaritja e tyre është bazuar në nivelin aktual të punonjësve për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për Shpenzime të tjera korrente (602-609), llogaritja është bërë bazuar në kërkesat e institucioneve të vartësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “investime” (230-231), është bërë duke mbajtur në konsideratë tendencën e realizimit të të ardhurave të veta, grandit dhe fondet që vijnë nga buxheti i shtetit.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Finiq për vitin 2022, janë të analizuara në *Aneksin nr. 2/3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për vitin 2022, për artikullin “Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës” është planifikuar në vlerën 3,635 mijë lekë ose në masën 0.57%, për artikullin “Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti pasardhës” është planifikuar në vlerën 287 mijë lekë ose në masën 0.04%, për artikullin “Trashëguar nga transferta specifike” është planifikuar në vlerën 67,944 mijë lekë ose në masën 10.75%, për artikullin “Plani i të ardhurave viti ushtrimor” është planifikuar në vlerën 71,770 mijë lekë ose në masën 11.3%, për artikullin “Granti” është planifikuar në vlerën 133,251 mijë lekë ose në masën 21% dhe për artikullin “Transferta specifike” është planifikuar në vlerën 51,856 mijë lekë ose në masën 8.2%.

Titulli i gjetjes 2: Nga Bashkia Finiq nuk janë parashikuar shlyerja e detyrimeve të prapambetura në masën 100%.

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënave për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit u konstatua se:

Në buxhetin e miratuar për vitin 2022, konstatohet se jo e gjithë shuma e detyrimeve kreditore të jetë programuar për likuidim e cila sipas pasqyrave financiare më datën 31/12/2021, paraqitet në shumën totale 52,734,478 lekë ose 8.25% e buxhetit fillestar, konkretisht si më poshtë:

-Llogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm*, në vlerën 48,538,162 lekë.

-Llogaria 401-408- *Furnitor e llogari lidhura me to*, në shumën 4,196,325 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, vlera e parashikuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura paraqitet si më poshtë:

Lekë					
Periudha	Detyrime më datë 31/12/2021	Vlera e detyrimeve të planifikuara	Miratuar sipas VKB	Llogarisë 602	Llogaria 230-231
2022	52,734,477	20,880,381	VKB nr. 51, datë 24.12.2021	17,040,381	3,840,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura konstatohet se, detyrimet më datë 31/12/2021, janë në vlerën 52,734,478 lekë, ndërsa nga Bashkia Finiq në buxhetin vjetor janë parashikuar fonde në vlerën 20,880,381 lekë me një diferencë më pak planifikimi për likuidim në vlerën 31,854,097 lekë, ose një planifikim në masën 39.5%. Kjo iniciativë nuk është në përputhje me kuadrin ligjor të parashikimit dhe zbatimit të buxhetit pasi, sjell një mbartje në vazhdimësi të detyrimeve ndaj të tretëve, duke qenë se nuk u jepet prioritet detyrimeve të cilat kanë mbetur pa u likuiduar nga viti i mëparshëm. Kjo situatë mund të sjellë edhe një rritje të detyrimeve pasi, të tretëve u lind e drejta të kërkojnë interesa nga likuidimi me vonesë i faturave të prapambetura. Veprime këto në kundërshtim me

Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zhvillimit të buxhetit”, neni 101.

Kriteri:

Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zhvillimit të buxhetit”, neni 101, në të cilin citohet se:

Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim.

Ndikimi/Efekti:

Mos marrja e iniciativës për shlyerjen e detyrimeve debitore, mund të sjell pasojë financiare negative në Buxhetin e Bashkisë Finiq.

Shkaku: Mos respektimi i kuadrit ligjor për parashikimin e Buxhetit.

Rëndësia: E mesme.

Për këtë rekomandojmë: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që në hartimin e buxhetit të vitit pasardhës të mbahet në konsideratë shuma totale e detyrimeve të papaguara nga viti i mëparshëm me qëllim shmangien e pasojave financiare më tepër se vlera e detyrimit.

- *Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.*

Për të gjithë periudhën e audituar, ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Në lidhje me PBA të viteve 2022-2024 dhe krahasimin e saj me planin buxhetor të vitit 2022 rezultoi se nuk ka lëvizje thelbësore, të cilat pasqyrohen në *Aneksin nr. 2/1, pika 2.2, “Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive”, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.*

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit, të cilat janë kryer me Vendime të Këshillit të Bashkisë, të pasqyruara në *Aneksin nr. 2/2, pika 2.2, “Vendime të Këshillit të Bashkisë”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Me VKB nr. 1, datë 17.02.2022, është realizuar shpërndarja e të ardhurave të trashëguara 71,866 mijë lekë. Me VKB nr. 23, datë 23.06.2022, është miratuar shtesë buxheti në vlerën 1,079 mijë lekë emergjencat civile dhe për arsimin në vlerën 206 mijë lekë. Me VKB nr. 31, datë 22.09.2022, është miratuar rialokim i brendshëm në llogarinë 231 në vlerën 500 mijë lekë. Me VKB nr. 45, datë 03.11.2022, është miratuar shtesë ndryshim buxheti në vlerën 480 mijë lekë emergjencave pjesa tjetër ka të bëjë me rialokimin e fondeve brenda llogarisë 231.

Për viti 2022, si rezultat i këtyre ndryshimeve buxheti përfundimtar i planifikuar vlera me të cilat është rakorduar me thesarin në fund të vitit, nga 631,974 mijë lekë në fillim të vitit, në fund të vitit është për vlerën 631,974 mijë lekë. (ndihma ekonomike në vlerën 100,607 mijë lekë dhe gjendja civile në vlerën 3,808 mijë lekë).

- *Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.*

Për zbatimet e buxheteve nga Bashkia Finiq, është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Delvinë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Finiq duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror.

Titulli i gjetjes 3: *Diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, për zërat të cilët mbulohen nga të ardhurat e veta.*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës më poshtë:

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha vitet 2022, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Në mijë lekë		
		Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
1	600 "Paga"	122,761	115,171	93.8
2	601 "Sigurime shoqërore"	20,756	19,227	93
3	602 "Shpenzime operative"	93,239	90,607	97.1
4	Totali shpenzime të tjera (606, 604, 609)	1,795	1,795	100
5	Ndihma ekonomike	104,415	103,216	98.85
6	Investimet (230 + 231)	389,983	366,881	94
7	Ndihme te menjëhershme 606	3,520	3,520	100
8	466 Garancitë			
Totali		736,389	700,417	95.1

Sa më sipër për vitin 2022, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 736,389 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 700,417 mijë lekë ose në masën 95.1%, sipas artikujve: paga në masën 93.8%, sigurime në masën 93%, shpenzime operative në masën 97.1%, dhe investime në masën 94%. Sipas burimeve të financimit për vitin 2022, nga transfertat e pakushtëzuar (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 133,251 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 127,444 mijë lekë ose në masën 95.6%.

Nga këto investime nga vlera 30,068 mijë lekë planifikuar është realizuar në vlerën 24,229 mijë lekë ose në masën 80.6%, kjo për shkak se faturat për likuidim janë të muajit dhjetor 2022 që janë pasqyruar si detyrime të viti në mbylljen e pasqyrave financiare.

Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 75,405 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 71,692 mijë lekë ose në masën 95.07%.

Nga këto, paga nga vlera 40,601 mijë lekë planifikuar është realizuar në vlerën 35,956 mijë lekë ose në masën 88.55%, Sigurime shoqërore nga 5,795 mijë lekë është realizuar në vlerën 4,550 mijë lekë ose në masën 78.5%, shpenzime operative nga 26,212 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 25,386 mijë lekë ose në masën 96.8% dhe investime nga 15,917 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 2,123 mijë lekë ose në masën 13.3%, kjo për shkak i mosrealizimit të të ardhurave vjetore të cilat nga vlera 91,018 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt për vlerën 71,770 mijë lekë.

Pra planifikimi i shpenzimeve buxhetore nuk është real dhe i mbështetur në burime të sakta financimi për të ardhurat e veta. Po ashtu në planifikimin e shpenzimeve nuk janë marrë në konsideratë faturat e pa likuiduara të vitit paraardhës që për vitin 2022 janë në vlerë n 52,734 mijë lekë ose në masën 7.7% e buxhetit fillestar.

Në planifikimin e shpenzimeve nuk janë marrë në konsideratë faturat e pa likuiduara të vitit paraardhës që për vitin 2021 janë në vlerën 52,734 mijë lekë , nga e cila janë planifikuar në buxhetin e vitit vijuar vlera prej 20,880,381 mijë lekë ose 39.5 % e totalit, të dhëna sipas pasqyrës si vijon.

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr./datë	Llog 602	Llog. 230-231
Viti 2021	52,734,477	20,880,381	51/24.12.2021	17,040,381	3,840,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 486,652 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 396,707 mijë lekë ose në masën 85%. Nga këto investime nga mijë 416,161 lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 340,628 mijë lekë ose në masën 81.8% kjo për shkak se kë to diferenca janë për arsye se nuk çelur fondet sipas buxhetit nga Ministria e Linjës (Infrastrukturës dhe Energjisë).

Nga fondet e deleguara treguesit e buxhetit janë planifikuar për 105,628, mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 104,373 mijë lekë ose në masën 99%.

Sa më sipër u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitin 2022 të ketë mosrealizime kjo paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Vitet	Programimi dhe realizimi i të Ardhurave		Diferenca	Planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave në Buxhet		Diferenca
	Plani	Fakti		Plani fillim Buxhetit	Fakti në thesar sipas realizimit dhe i trashëguar.	
Viti 2021	89,553	68,985	20,528	91,018	71,770	19,248

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Sipas planifikimit dhe realizimit në buxhet për vitin 2021, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore gjithsej nga 91,018 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë çelur në thesar sipas realizimit faktik dhe ato të trashëguara në vlerën 71,770 mijë lekë ose 78.8 %, **me një mosrealizim në vlerën 19,248 mijë lekë**. Miratimi i buxhetit faktik për vitin 2022 është me VKB nr. 1, datë 02.03.2023, dhe miratimi nga Prefekti i Qarkut Vlorë me nr. 279/1 prot., datë 24.03.2023.

Kriteri:

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 27.02.2020, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Ndikimi/Efekti:

Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të planifikimit jo të mbështetur në të ardhurat reale, bënë që pritshmëritë sidomos në investime të mos përputhen me planifikimin, plotësimin e nevojave reale të planifikuara dhe ulje të performancës të njësisë vendore.

Shkaku: Planifikim i pa studiuar mire i buxhetit.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Bashkia Finiq, nëpërmjet Drejtorinë e Financës dhe të Ardhurave dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, të marrë masa për një planifikim të

studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuara dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigojohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj).

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se; Vlera e raportuar nga Bashkia Finiq në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31/12/2022, është 53,602,990 lekë (40,334,560 lekë të cilat i përkasin llog. 602 + 13,267,870 lekë i përkasin llog 230+231). Të dhënat analitike paraqiten në *Aneksin nr. 2/1, pika 2.4, "Pagesa të kryera nëpërmjet Bankës në lidhje me respektimin e afatit 30-ditor për periudhën 01/01/2022-31/12/2022"*, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

Detyrimet e prapambetura viti 2022:

Titulli i gjetjes 4: *Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura, viti 2022.*

Situata:

Bashkia Finiq në datën 01/01/2022, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 36,914,135 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2022 vlera 14,616,267 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 14,616,267 lekë, ose 100 % e vlerës së planifikuar, diferenca prej 0 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 11,457,782 lekë, duke çuar në 31/12/2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 33,755,650 lekë.

Përsa trajtuar më sipër më datë 01/01/2022, Bashkia Finiq ka detyrime të prapambetura me burim financimi nga granti, në vlerën 15,820,343 lekë, Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2022 vlera 6,264,114 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 6,264,114 lekë, ose 100 % e vlerës së planifikuar, është krijuar gjatë vitit 2022 detyrim me vlerë 4,910,479 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31/12/2022 në vlerën 14,466,708 lekë.

Pra në total, gjatë vitit 2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31/12/2022, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01/01/2022), është ulur me 3,158,485 lekë, ose në masën prej 10 %.

Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime në vlerën 16,477,322 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 2,461,510 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 122,400 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 14,694,418 lekë.

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetin respektiv paraqitet si vijon:

Lekë

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr./datë	Llog.602	Llog.230+231	Vendime gjyqësore
Viti 2021	52,734,477	20,880,381	51/24.12.2021	16,380,901	3,840,0000	659,480

Në shumën e paplanifikuar përfshihen dhe vendimet gjyqësore dhe detyrimet që rrjedhin nga energjia elektrike, të mbartura ndër vite.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të periudhës 31/12/2022, janë në vlerën 48,222,358 lekë .

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31/12/2021	Detyrimi i krijuar në periudhën 01/01/2022-31/12/2022	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31/12/2022
Investime	18,753,722	18,711,222	37,464,944	22,063,262	15,401,682
Investime nga FZHS	0				
Mallra dhe shërbime	33,321,276	139,441,542	172,762,818	140,064,542	32,698,276
Vendime gjyqësore	659,480	122,400	781,880	659,480	122,400
Të tjera					
Totali	52,734,478	158,275,164	211,009,642	162,787,284	48,222,358

Burimi të dhënave: *Bashkia Finiq*

Kriteri:

Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Ndikimi/Efekti:

Likuidimi me ritme të ngadalta të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë njësinë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur është shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

Shkaku: Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

Për këtë rekomandojmë: Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Finiq dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

- Mbi vendimet gjyqësore

Gjatë periudhës së ushtrimit 2022, ka pasur shtesa detyrimesh nga vendimet gjyqësore. Në total janë likuiduar përgjatë vitit 2022 vendime gjyqësore në vlerën 659,480 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkisë Finiq.

Raportet e Monitorimit

Për vitin 2022, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre nëpërmjet emailëve përkatëse.

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHSH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2022 janë financuar me fonde të buxhetit të shtetit 7 investime publike, për 2 prej të cilave kontrata është lidhur në vitin 2020, për 4 investime kontrata është lidhur në vitin 2021, ndërsa kontratë është lidhur në vitin 2022 sipas të dhënave në tabelën në vijim:

Tabela mbi financimet e kontratave për investime, burimet e financimit si dhe likuidimet sipas viteve.

Nr	Objekti i kontratës	Fond Planifikimi	Burimi i Financimit	Kontrata me subjektin			Subjekti i kontraktuar	Pagesa sipas periudhave				Mbetet pa likuiduar
				Nr. Datë	Afati	Vlera me TVSH		Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	
I.Me fonde nga Ministrinë e Linjës dhe donacione												
1	Ujesjellesi Rajonal i Finiqit (Linja e jashtme) Burimet e Merkos	595,296	Buxheti i shtetit			559,835	BO "SH..." SHPK & "F..." SHPK		211625	195000	148514	
2	Supervizion punimesh për objektin "Ujesjellesi Rajonal i Finiqit nga burimet e Merkos"	5,077	Buxheti i shtetit			4442	BO "H..." sh.p.k & "A. MK" shpk		1380	1300	1762	0
3	U Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistuese te ujesjellësit Krongj – Finiq	301,087	Buxheti i shtetit			300169	BO "SH..." SHPK & "F..." SHPK			160217	62652	77,300
4	Mbikëqyrje punimesh për objektin "Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistuese te ujesjellësit Krongj – Finiq	3,992	Buxheti i shtetit			3984	BO "SH..." SHPK & "F..." SHPK			1598	400	1,986
5	Ndërtim ujesjellësi rajonal nga burimet e Leshnicës	472,588	Buxheti i shtetit	290 dt 29.01.2023	31.08.2023	462,294	"S..." sh.p.k			124467	68000	269,827
6	Mbikëqyrje punimesh për objektin "Ndërtim ujesjellësi rajonal nga burimet e Leshnicës"	4,981	Buxheti i shtetit			4920	BO "SH..." SHPK & "F..." SHPK			1296	700	2,924
7	Kolaudim Ujesjellesi i Merkos					668					668	352,037

- Realizimi i të ardhurave dhe përdorimi i tyre.

Realizimi i të ardhurave dhe përdorimi i tyre për periudhën nga data 01/01/2022, deri më 31/12/2022, sipas aktrakordimeve me Degën e Thesarit Delvinë, analiza e detajuar për të ardhurat e vitit 2022, paraqitet si më poshtë:

Përshkrimi	Në mijë lekë	
	Plan 2022	Fakt 2022
Të ardhurat të veta të trashëguara viti 2021	3,635	3,635
Të trashëguara nga transf.specifike 2021	67,944	67,944
Të trashëguara nga transf.pakushtëzuara 2021	287	287
Të ardhurat e veta të vitit 2022	91,018	71,770
Grante të pakushtëzuara viti 2022	125,140	133,251
Grante specifike të vitit 2022, të detajuara:		
-Nga FZHSH		
-Nga Ministrinë e Linjës	466,252	303,231
-Donatorë të ndryshëm		1,500
-Transf buxheti, invalid, ndihma etj. (606)	104,415	104,415
-Nga huatë		
Totali	858,691	736,389

Përdorimi i të ardhurave viti 2022

Në mijë lekë

Emërtimi	Fakt 2022				% nga përdorimi i të ardhurave të veta
	Gjithsej	Tr.Pakushtëzuar	Të ardhurat e veta	Transf.e kushtëzuar dhe specifike	
230-Projekte					
231-Investime	366,881	24,229	2,123	340,529	0.57
600-Paga	115,171	49,816	35,956	29,399	31,2
601-Sigurime shoqërore	19,227	9,908	4,551	4,768	23,6
602-Shpenzime operative	90,607	43,490	25,386	21,731	28
604-Transf.Institucioneve	1,795		716	1,079	38,8
606-Transf. Buxh.Fam.Ind	103,007		2,960	100,047	3
Kuotë qarku					
Të tjera	3,729			3,729	
	700,417	127,443	71,692	501,282	10.23

- Vlera e kontratave të pambyllura ndërvite dhe të palikujduara deri më 31/12/2022

Lekë

Nr.	Objekti kontratës	OE fitues	Vlera total kontrate me TVSh	Likuiduar deri me 31/12/2022	Mbetet per likuidim	Burim financimi
1	Rikualifikimi I Sheshit Livadhja	G...	59,319,176	18,019,247	11,299,929	Ardhurat e Bashkise

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Bashkinë Finiq jepet nga pasqyrat në vijim:

Pasqyra e pagave për vitin 2022 Bashkia Finiq.

Në mijë lekë

Emertimi	Plan	Fakt
Kap.1 (Granti)	600	82,159
	601	16,902
Kap.5(Te ardhurat)	600	40,601
	601	5,975

Vlera e parashikuar për realizimin e procedurave të prokurimit për vitin 2022, në artikullin (602/231) është në vlerën 147,305,284 lekë si më poshtë:

- Prokurimeve me vlera të larta në vlerën 134,577,599 lekë.
- Prokurime me vlera të vogla në vlerën 12,727,685 lekë.

Nga prokurimet me vlera të larta janë parashikuar në fushën e investimeve në vlerën prej 89,653,572 lekë, dhe në fushën e shërbimeve/blerjeve në vlerën 44,924,027 lekë.

Ndërsa realizimi në fakt i procedurave të prokurimeve për vitin 2022, në artikullin (602/231) është në vlerën 112,227,251 lekë si më poshtë:

- Prokurimeve me vlera të larta për vlerën 104,576,746 lekë.
- Prokurime me vlera të vogla në vlerën 7,650,506 lekë.

Prokurimet me vlera të larta janë realizuar në fushën e investimeve në vlerën 80,664,983 lekë, dhe në fushën e shërbimeve/blerjeve në vlerën 23,911,763 lekë.

Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2022, për artikullin (602/231) janë në vlerë 8,434,377 lekë si më poshtë:

- Prokurimeve me vlera të larta për vlerën 7,563,600 lekë.
- Prokurime me vlera të vogla në vlerën 870,777 lekë.

Prokurimet me vlera të larta, janë realizuar në fushën e investimeve në vlerën 31,188,835 lekë, dhe në fushën e shërbimeve/blerjeve në vlerën 28,650,801 lekë.

Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022, ngarkohet me përgjegjësi: znj. L. M, me detyrë Drejtor Ekonomik.

Nënpika 2.2.6 e programit: Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

- Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Ne strukturën organizative të kësaj Bashkie, për realizimin e këtij sistemi është përcaktuar Njësia e të ardhurave vendore, e cila është organizuar me emërtesën “Drejtoria e të ardhurave vendore”, ku ka në përbërjen e vet 12 punonjës, të ndarë në dy sektorë, e konkretisht:

1. *Spektori i kontabilizimit dhe shërbimit ndaj taksapaguesve, ku në përbërjen e tij ka 5 punonjës.*

2. *Spektori i Inspektoriatit tatimor dhe kundërvajtjeve administrative, menaxhimi i debitit, konfiskimi dhe sekuestrimi, ku në përbërjen e këtij sektori janë 7 punonjës.*

Organizimi e kësaj Drejtorie të taksave dhe tarifave vendore, krahas punonjësve që janë në zyrën qendrore, ku realizohet vlerësimi, planifikimi, si dhe rakordimet mbi realizimin e të ardhurave, funksionon dhe me punonjës të instaluar pranë Njësive Administrative (Livadhja, Finiq, Dhiver, Aliko si dhe Mesopotam), ku këta punonjës pranë njësive administrative pasi furnizohen me informacionin e plote nga ana e zyrës qendrore në bashki mbi detyrimet e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në territoret e njësive, realizojnë arkëtimet e të ardhurave.

Pranë Njësive Administrative disponohet regjistri elektronik të detyrimeve të mbartura dhe detyrimeve të vitit ushtrimor të cilat janë vlerësuar nga zyra qendrore në bashki.

Për çdo arkëtim që realizohet pranë arkave të instaluar në njësitë administrative, kryhet akt rakordimi ditor në mënyrë elektronike me zyrën qendrore të taksave në bashki, si dhe në fund të muajit bëhet akti rakordimit mujor, mbi bazën e të cilave realizohet dhe akt rakordimi me Degën e Thesarit Delvine.

Ne lidhje me vlerësimin e detyrimeve si për taksat dhe tarifave vendore në këtë bashki, për periudhën e audituar që është viti 2022, është miratuar paketa fiskale me Vendimin e Këshillit të Bashkisë me nr.48 datë 15.12.2021, të konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlore, me shkresën Nr.983/1, datë 28.12.2021.

Nga ana e Drejtorisë së taksave të Bashkisë, është bërë evidentimi dhe pasqyrimi i të ardhurave në regjistrin e detyrimeve që ekziston pranë kësaj Drejtorie.

Ne regjistër janë pasqyruar detyrimet për çdo subjekt (biznesi apo dhe familje), kjo për çdo lloj taksë apo tarifë vendore, të ndarë sipas njësive administrative dhe për çdo fshat, si për detyrimet e prapambetura po kështu dhe detyrimet e vitit ushtrimor.

- Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Titulli i gjetjes 1: *Nga Bashkia Finiq nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi) dhe për të gjithë subjektet.*

Situata:

Nga auditimi i kryer mbi gjendjen e subjekteve fizike apo juridike në fund të vitit 2021, shtesat apo pakesimet e realizuara gjatë vitit 2022, si dhe gjendja e tyre në fund të vitit 2022, paraqitet sa me poshtë:

Lloji Biznesit	Viti 2022				
	Gjendja me 01/01/2022	Regjistrime të reja	Biznese të mbyllura	Pezulluar	Gjendja me datën 31/12/2022
Sub.Fizike	146	8	6	2	146
Sub.Juridike	76	-	2		74
Gjithsej	222	8	8	2	220

Duke analizuar të dhënat e trajtuara në pasqyrën sa me sipër, konstatohet një ulje të numrit të bizneseve *nga fundi i vitit 2021 që ishin 222 subjekte, (146 subjekte fizike dhe 76*

subjekte juridike) në **fund të vitit 2022 ishin 220 subjekte**, (146 subjekte fizike dhe 74 subjekte juridike). Pra kemi **pakësim për 2 biznese juridike**.

Për periudhën e audituar që është viti 2022, vërehet se kemi **regjistrime të reja** nga 8 biznese fizike, gjithashtu vërehet se kemi **mbyllje të aktivitetit** nga 8 biznese të vogla, përkatësisht 6 biznese fizike dhe 2 biznese juridike. Po kështu konstatohet se janë dhe 2 biznese fizike të cilat kanë pezulluar aktivitetin.

Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan të dhënat e subjekteve fizike dhe juridike, duke analizuar dosjen e çdo subjekti që administrohej pranë kësaj drejtorie të taksave dhe tarifave vendore, si për dokumentacionin e krijimit të çdo subjekti ashtu dhe për vlerësimin e detyrimeve të tyre, ku u konstatua se:

1- Janë hapur dosjet personale për çdo biznes ku në to administroheshin të gjitha të dhënat sipas kërkesave të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme me nr. 655/1 datë 06.02.2007 dhe Ministrisë së Financave me nr 125/4 datë 31.01.2007 “*Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore*”, por nga vlerësimi i tyre është konstatuar se:

- Nga 146 subjekte fizike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Finiq, janë të regjistruar pranë QKB dhe disponojnë Nipt 121 subjekte fizike, ndërsa **25 subjekte ushtrojnë aktivitet, paguajnë taksat dhe tarifat vendore, por nuk figurojnë të pajisur me Nipt nga ana e QKB**, përkatësisht:

Ne Nj.A Finiq nga 47 subjekte, 44 subjekte disponojnë Nipt, ndërsa 3 subjekte janë pa Nipt.

Ne Nj.A Aliko nga 11 subjekte, 6 subjekte disponojnë Nipt, ndërsa 5 subjekte janë pa Nipt.

Ne Nj.A Dhiver nga 14 subjekte, 14 subjekte disponojnë Nipt.

Ne Nj.A Mesopotam nga 32 subjekte, 30 subjekte disponojnë Nipt, ndërsa 2 subjekte janë pa Nipt.

Ne Nj.A Livadhja nga 42 subjekte, 27 subjekte disponojnë Nipt, ndërsa 15 subjekte janë pa Nipt.

- Në lidhje me 2 subjektet të cilat kanë kaluar në statusin “**subjekte të pezulluara**” rezultonte se nuk disponohej në dosjen e subjektit kërkesa që tatim paguesi kërkon pezullim aktiviteti, proces verbali që tregon datën e ndërprerjes së veprimtarisë dhe likuidimin e plote të detyrimeve nga ky subjekt, si dhe nuk disponohej shkresa e kësaj drejtorie për në QKB.

Pra pezullimi i aktivitetit për të dyja rastet, pavarësisht se nuk figurojnë debitore në regjistrin e të ardhurave të Bashkisë, pezullimi pa konfirmimin nga Drejtoria e të ardhurave të Bashkisë është realizuar në kundërshtim me kërkesat ligjore. Po kështu nuk disponohej asnjë lloj proces verbali mbi verifikimin në teren nëse këto subjekte ushtrojnë aktivitet apo jo, duke mos lënë **gjurme auditimit në verifikimin e tyre**.

- Në lidhje me **8 subjektet të cilat rezultojnë se kanë mbyllur aktivitetin gjatë vitit 2022**, subjekte të cilat figurojnë të çregjistruara në regjistrin e të ardhurave të Bashkisë, nuk disponohej asnjë lloj dokumentacioni që të faktonte likuidimin e detyrimeve deri në momentin e shkëputjes, apo dhe shkresa zyrtare që këto subjekte kanë paraqitur për mbyllje të aktivitetit. Nga vlerësimi i kryer rezultoi se 4 nga subjektet e mbyllura, pavarësisht mangësive dokumentare në dosjet e subjekteve, figurojnë dhe debitore pranë Bashkisë Finiq, për mos likuidim të taksave dhe tarifave vendore deri në fund të vitit 2022, për vlerën prej **1,757,602 lekë**, e përkatësisht:

Subjekti “**S...**” *sh.pk* , rezultoi debitor në vlerën **268,520 lekë**.

Subjekti “**F...**” *sh.p.k.* , rezultoi debitor në vlerën **1,391,102 lekë**.

Subjekti **A...** , rezultoi debitor në vlerën **66,240 lekë**.

Subjekti **N...** , rezultoi debitor në vlerën **31,740 lekë**.

Kriteri:

Ligji nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-

104, Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

Ndikimi/Efekti:

Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2022 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetore i të ardhurave të Bashkisë Finiq.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masat e menjëhershme për verifikimin e statusit të këtyre subjekteve në teren, si dhe të kërkohet zbatimi i procedurave sipas kërkesave të Ligjit nr.9920, date 19/05/2008 “Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, për përfitimin e këtij statusi. Po kështu të kërkohet menjëherë arkëtimi i detyrimeve të pa likuajuara nga ana e këtyre subjekteve që është në vlerën **1,757,602** lekë.

Titulli i gjetjes 2: *Nuk është kryer një planifikim i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ku t'i referohet kërkesave reale të institucionit.*

Situata:

Nga auditimi i kryer nga grupi i auditimit mbi detyrimet që u lind çdo subjekti për të paguar taksa dhe tarifa vendore, duke ju referuar detyrimeve të përcaktuar në paketën fiskale të miratuar me VKB nr 48 datë 15.12.2021, si dhe regjistrin të llogaritjes së detyrimeve për çdo subjekt dhe çdo lloj detyrimi,(që na është vënë në dispozicion nga kjo zyre) është konstatuar se:

- Në planifikimin vjetor për biznesin e vogel dhe biznesin e madh, duke ju referuar regjistrin të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave, figuron vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021, si dhe detyrimet e vitit 2022, për të gjitha bizneset, por duhet theksuar se detyrimi i mbartur në vite nuk figuron i pasqyruar sipas llojit të detyrimit por është i evidentuar në total.

- Në regjistrin e bizneseve është përfshirë debia e mbartur, por nuk dilte kjo debi sipas llojit të detyrimit për çdo zë taksë apo tarifë vendore.

Paraqitja e vlerës së debisë së mbartur, detyrimet e vitit 2022, si dhe arkëtimet përkatëse, paraqiten në *Aneksin nr. 2/3, pika 2.6, “Përmbledhje e vlerës së debisë të mbartur për taksapaguesit familjare, në fund të vitit 2021, arkëtimet e realizuara gjatë 2022, si dhe mbetja e kësaj debie në fund të vitit 2022.”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Nga auditimi i bërë mbi të dhënat e trajtuara në pasqyre që u përkasin të dhënave të regjistrin, rezulton se nga vlera e debisë për bizneset e cila figuron me datën 31/12/2021 në vlerën **15,279,572 lekë**, gjatë vitit 2022 nga kjo vlerë është arkëtuar vetëm **1,092,110 lekë**, ose arkëtuar në masën **7.15 %**. Me një **mos realizim** në vlerë absolute prej **14,187,462 lekë**, ose në masën **92.85%**. Në *Aneksin nr. 2.4, pika 2.6, paraqitet “Përmbledhje e vlerës së detyrimit për bizneset për vitin 2022, arkëtimet e realizuara gjatë 2022, si dhe mbetja pa u arkëtuar nga ky detyrim në fund të vitit 2022”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Nga auditimi i bërë mbi të dhënat e trajtuara në pasqyre që u përkasin të dhënave të regjistrin, rezulton se nga vlera e detyrimeve për bizneset të pasqyruar si detyrim i vitit 2022 që është në vlerën **12,924,342 lekë**, gjatë vitit 2022 nga kjo vlerë është arkëtuar

vetëm **10,521,603 lekë**, ose arkëtuar në masën **81.4 %**. Me një *mos realizim* në vlerë absolute prej **2,402,739 lekë**, ose në masën **18.6%**.

Grupi i auditimit vlerëson detyrimin total për taksapaguesit biznese, kjo për vitin 2022, ku rezulton se, detyrimi për këtë kategori taksapaguesish për vitin 2022, është në vlerën **28,203,914 lekë** (15,279,572 lekë vlera e debisë me datën 01/01/2022 + 12,924,342 lekë vlera e detyrimit që lindi gjatë vitit 2022 = 28.203.914 lekë).

Nga kjo vlerë është *arkëtuar gjatë vitit 2022* në shumën **11,613,713lekë** (1,092,110 lekë nga vlera e debisë me 31/12/2021 + 10,521,603 lekë nga vlera e detyrimit që lindi gjatë vitit 2022 = 11,613,713 lekë).

Nga vlera totale e detyrimit që është 28,203,914 lekë janë arkëtuar gjatë vitit 2022, në vlerën prej 11,613,713 lekë, ku në *fund të vitit 2022 rezulton një detyrim i pa arkëtuar nga taksapaguesit biznese në vlerën prej 16,590,201 lekë*, (28,203,914 lekë – 11,613,713 lekë = 16,590,201lekë).

Pra kemi një realizim për taksapaguesit biznese për vitin 2022, në masën 41.18%, ose me një mos realizim në vlerë absolute për 16.590.201 lekë.

Referuar planit të buxhetit të paraqitur nga Drejtoria e të ardhurave vendore për vitin 2022, i miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë dhe miratuar nga prefektura e Vlorës figuron se detyrimi për vitin 2022 për *taksapaguesit biznese* të jetë në vlerën **15,062,000 lekë** dhe jo në vlerën **28,203,914 lekë** që figuron në regjistrin e të ardhurave.

Pra planifikuar si detyrim për vitin 2022, me pak për një vlerë prej 13,141,914 lekë, (28,203,914 lekë – 15,062,000 lekë = 13,141,914 lekë).

Nga vlerësimi i bërë *mbi mënyrën e ndjekjes dhe arkëtimit të të ardhurave*, është konstatuar se në fillim të çdo viti ushtrimor nga ana e Drejtorisë të të ardhurave të Bashkisë pasi është plotësuar regjistri me të gjitha të dhënat për çdo taksa pagues, dërgohet në çdo njësi administrative pjesa e detyrimeve sipas përkatësisë.

Arkëtimet realizohen nëpërmjet arkave të ngritura në çdo njësi administrative, ku në fund të ditës kuadron me arkën qendrore mbi arkëtimet e realizuara. Si dhe në fund të çdo muaji bëhet akt rakordimi me Thesarin Delvine.

- në rruge bankare, që realizohet kryesisht nga ana e subjekteve juridike dhe fizike.

- Janë kryer *rakordimet mujore apo dhe vjetore* me Institucionet të cilat shërbejnë si agjente në arkëtimin e të ardhurave, si me Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor Sarande, për të ardhurat që realizohen nga taksa e regjistrimit të mjeteve të transportit, edhe me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Sarande, për të ardhurat që realizohen nga tatimi mbi fitimin, etj.

- Referuar akt Rakordimit vjetor me Thesarin Delvine, rezulton se realizimi i të ardhurave për vitin 2022, është në vlerën **71,770,056 lekë**, (vlerë e pasqyruar sipas arkëtimit të realizuar si nëpërmjet arkës apo dhe bankës në regjistër) ***ku si plan detyrimit në Thesar figuron vlera prej 91,051,000 lekë.***

Ne vlerën e realizuar nuk është e ndarë sa është vlera e arkëtuar nga detyrimet e vitit ushtrimor 2022 dhe sa është nga detyrimet e mbartura deri në fund të vitit 2021.

- Nga ana e kësaj drejtorie, e cila është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e pa paguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, si ligji nr.9920 datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Për hapat që duhet të ndërmerren me qellim mbledhjen detyrimeve të paguara” rezulton se subjektet janë njoftuar periodikisht për çdo vit, si dhe në rastet e vonësive për pagesa u është dërguar letër-kujtuese si për debinë e mbartur, ashtu edhe për detyrimet e vitit. Po kështu janë kërkuar në rruge zyrtare për 14 raste, në bankat e nivelit të dyte bllokime të llogarive bankare të taksapaguesve debitore.

Ne lidhje me arkëtimin e detyrimeve, me shkresën nr. 170 prot, datë 08.06.2022, është kërkuar bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë të të Ardhurave Vendore të Bashkisë dhe Policisë Bashkiake, për mbështetje në programin e aksionit të përbashkët për mbledhjen e detyrimeve të debitorëve.

Në vijim po paraqesim në formë tabele planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për periudhën e audituar vitin 2022, ku planifikimi dhe realizimi është verifikuar në bazë të të dhënave që disponon Drejtoria e të ardhurave, duke ju referuar regjistrin të pasqyrit të tyre apo dhe gjithë dokumentacioni tjetër që na është vënë në dispozicion si dhe akt rakordimet me Degën e Thesarit Delvine. Në *Aneksin nr. 2.5, pika 2.6, paraqitet "Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2022"*, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga analiza e të dhënave të pasqyrës nr. 2.5, pika 2.6 rezulton se:

Për periudhën e audituar viti 2022, plani i të ardhurave është miratuar në shumën **91.051 mijë lekë**, realizuar në fakt për shumën **72,096,506 mijë lekë**, ose në masën **78.82 %**.

Niveli i të ardhurave në masën 78.82%, konstatohet me mosrealizim në disa prej të ardhurave, e konkretisht nga:

-**Tarifa e varrezave**, ku nga **1.200 mijë lekë** të planifikuara, janë realizuar vetëm **629,326 mijë lekë**, ose në masën **52,44%**, me një diferencë në vlerë absolute me pak për **570,674 mijë lekë**.

-**Qera nga ndërtesat**, ku nga **2.200 mijë lekë** të planifikuara, janë realizuar vetëm **171 mijë lekë**, ose në masën **7,72%**, me një diferencë në vlerë absolute me pak për **2.029 mijë lekë**.

-**Qera për 35-99 vite për toka të mbjella**, ku nga **2.500 mijë lekë** të planifikuara, janë realizuar vetëm **1.431,125 mijë lekë**, ose në masën **57,25%**, me një diferencë në vlerë absolute me pak për **1.068,875 mijë lekë**.

- **Tarifa e azhurnimit**, ku nga **3.696 mijë lekë** të planifikuara, janë realizuar në vlerën **72 mijë lekë**, ose në masën **1.95%**, me një mos arkëtim në vlerë absolute prej **3.624 mijë lekë**.

Nga vlerësimi i grupit të auditimit, në lidhje me rezultatin si në planifikim ashtu dhe në realizim, pasqyruar në pasqyrën e mësipërme, referuar regjistrin të të ardhurave që disponon Drejtoria e të ardhurave në bashki, *planit të buxhetit* miratuar me VKB, *pasqyrave financiare*, si dhe *akt rakordimit përfundimtar me Thesarin e Delvines*, del në konkluzionin se:

- në planifikimin buxhetor të të ardhurave për vitin 2022 me sistemimet e kryera, është konstatuar se figuron një detyrim nga të ardhurat e veta në vlerën **91.051 mijë lekë**, në një kohë që në regjistrin e Drejtorisë se të ardhurave ky plan figuron për vlerën **264.863,312 mijë lekë**, pra me një diferencë prej **173.812,312 mijë lekë**, pa u pasqyruar në planin buxhetor të vitit.

Në vlerësimin buxhetor prej **91.051 mijë lekë**, është trajtuar vlera e detyrimit të vitit 2022 në shumën prej **76.874,941 mijë lekë** dhe detyrime të prapambetura për vlerën **14.176,059 mijë lekë**. Pra kemi një planifikim jo real për një vlerë prej **173.812,312 mijë lekë**, vlerë që përbëhet nga detyrimet e prapambetura deri në fund të vitit 2021, vlerë e cila figuron në regjistrin e të ardhurave apo dhe në pasqyrat financiare të fund vitit 2021.

Referuar këtyre të dhënave mbështetur në regjistër apo dhe në pasqyrat financiare të fund vitit 2021, rezulton se realizimi real i të ardhurave për vitin 2022, është në masën **27.1%**.

- Nuk ka pasqyrim në planin buxhetor, në regjistër, si dhe në pasqyrat financiare, të një detyrimi prej **5,300,000 lekë**, të trajtuar në auditimin e realizuar nga ana e KLSH me materialin e auditimit të datës 01.11.2022, si "**tarifë vendore për pajisjen me leje tregtimi për shitjen e karburanteve**".

- në disa tarifa apo dhe taksa të cilat janë trajtuar me një realizim të lartë, është konstatuar se nuk ka një bashkërendim me sektorët e tjerë përgjegjës për vlerësimin e detyrimeve sipas parashikimeve dhe burimeve që disponojnë për realizimin e të ardhurave, kjo për hartimin e një buxheti sa me afër realitetit.

- Nga vlerësimi i kryer, nga inspektori i të ardhurave në bashki, referuar të dhënave të regjistrin rezulton se në fund të vitit 2022, gjendja e debitorëve ka arritur vlerën prej **213.212,631 mijë lekë**. Duhet theksuar se arkëtimet mbi vlerat e planifikuara ishin në shumën **51.650,681 mijë lekë** dhe jo në vlerën **71.770,056 mijë lekë** që figurojnë në akt rakordimin e thesarit. Diferenca e vlerës prej **20.119,375 mijë lekë** përfaqëson të ardhur të

pa planifikuar në buxhetin e vitit ushtrimor si dhe të pa pasqyruar në regjistrin e të ardhurave, ku analiza e debitorëve pasqyrohet në pasqyrën e mëposhtëm:

Analiza e debitorëve të mbartur dhe detyrimet e vitit ushtrimor, për periudhën e audituar, paraqitet sa me poshtë:

Në/ 000 lekë

Nr	EMERTIMI	Debitore me 31/12/2021	Detyrime t e vitit 2022	Shuma e detyrimeve	Arkëtuar nga debitorët në vitin 2022	Arkëtuar nga detyrimet e Vitit 2022	Shuma e arkëtimeve	Mbetje 31/12/2022
1	Nj.A Finiq	54,919,467	19,499,145	74,418,612	3,732,636	10,072,955	13,805,591	60,613,021
2	Nj.A. Livadhja	50,042,854	15,723,832	65,766,686	1,186,382	9,894,771	11,081,153	54,685,533
3	Nj.A. Aliko	31,978,094	18,037,877	50,015,971	3,517,027	3,719,697	7,236,724	42,779,247
4	Nj.A. Dhiver	19,275,542	8,186,535	27,462,077	3,654,344	2,171,483	5,825,827	21,636,250
5	Nj.A. Mesopotam	31,772,414	15,427,552	47,199,966	3,455,597	10,245,789	13,701,386	33,498,580
	TOTALI	187,988,371	76,874,941	264,863,312	15,545,986	36,104,695	51,650,681	213,212,631

Referuar të dhënave të trajtuara sa me lartë, dalim në konkluzionin se nga ana e Drejtorisë të të ardhurave të Bashkisë, duhet të bëhet analiza e plote dhe analitike e debisë së pasqyruar në regjistrin dhe pasqyrat financiare, analiza e plote dhe analitike e të ardhurave që janë me tejkalim apo dhe me mos realizim sipas zërave, duke vlerësuar bazën e llogaritjes së detyrimeve apo dhe arsytet e tjera që kanë krijuar këtë situatë.

Kriteri:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32, Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:

Mos planifikimi i saktë i të ardhurave të pritshme nga taksat dhe tarifave vendore ndikon në hartimin e buxhetit të bashkisë, në angazhimet që parashikohen të ndërmerren gjatë vitit buxhetor. Për të ardhurat të cilat vijnë nga detyrimet prapambetura nga taksat dhe tarifave të cilat janë të paplanifikuara, shpërndahen sipas zërave por nuk ka një ndarje të ardhurave nga detyrimet e prapambetura dhe ato aktuale duke mos pasqyruar qartë se cili është burimi i tyre duke ndikuar në nivelin e realizimit të plan-faktit të të ardhurave vjetore të Bashkisë Finiq.

Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për bashkërendimin e punës me të gjithë sektorët e tjerë të cilët funksionojnë në planifikimin e të ardhurave, duke përcaktuar qarte vlerat e të ardhurave që duhet planifikuar sipas burimit të krijimit të tyre. Në planifikim buxhetor për vazhdimësinë të pasqyrohen qarte vlera e debisë së mbartur si dhe detyrimi vjetor që është pasqyruar në regjistrin e të ardhurave. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë të të ardhurave të Bashkisë të merren masat e menjëhershme për vlerësimin e detyrimeve të subjekteve që merren me tregtinë e hidrokarbureve, duke arkëtuar detyrimin prej **5,600,000 lekë**, në rast të kundërt të vlerësohen kërkesat e ligjit deri në pezullimin e aktivitetit.

- Auditim në lidhje me subjektet që tregtojnë karburante.

Titulli i gjetjes 3: *Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me licencë të bashkisë dhe papaguar tarifafat përkatëse.*

Situata:

Nga auditimi i kryer mbi subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre në territorin e Bashkisë Finiq, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si psh:

- Nuk është krijuar një regjistër i posaçëm për këto subjekte, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti.

- Nuk është vepruar në mbledhjen e detyrime specifike për kategori biznesi, ku nga ana e KLSH është lënë një detyrim për pajisjen me lejet përkatëse për tregtimin e tyre, si dhe nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet, kjo në zbatim të VKM nr. 970, datë 02/12/2015, ndryshuar me Vendimin nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02/12/2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, ku parashikohet se:

“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”

“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.”

Sipas bazës ligjore të trajtuar sa me lartë, të gjitha subjektet që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit, pas datës se hyrjes në fuqi të këtij vendimi për rinovimin e licencës, duhet të paguajnë këtë detyrim.

Nga vlerësimi i kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se:

- Nga auditimi i mëparshëm që është kryer nga KLSH me raportin përfundimtar të auditimit të datës 01.11.2022, është trajtuar se në reference të ligjshmërisë të trajtuar sa me lartë për subjekteve që ushtrojnë këtë aktivitet, ku sipas vlerësimeve rezulton të jenë 5 subjekte me një detyrim të pa likuajduar në vlerën **5.300.000 lekë, ndërkohë që nga ana e institucionit nuk është marrë asnjë masë veprimi.**

- Në lidhje me këto subjekte është bërë regjistrimi në regjistrin e të ardhurave vetëm për taksat dhe tarifafat vendore pa trajtuar dhe detyrimet që lindin nga kërkesat e VKM me nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02/12/2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. Grupi i auditimit duke marrë në konsideratë vlerën e detyrimit të mësipërm, si dhe duke vlerësuar detyrimin që lind për vitin 2022 mbështetur në pikën 10 të VKM nr 344 datë 19.04.2017 vlerëson se shumica progresive e detyrimit me datë 01/01/2022 është **5.800.000 lekë.**

Vlerat e detyrimeve, arkëtimet dhe gjendjen debitore me datë 31/12/2022, për këto subjekte:

Nr	Emri i Subjektit	ADRESA	Pajisur me leje	Detyrimi			Likuiduar Ne Vitin 2022	Vlera e palikujduara me datë 31/12/2022
				Detyrimi deri me 31/12/2021 Llog. Nga KLSH	Detyrimi i Vitit 2022	Detyrim gjithësej 2022		
1	T...	Vrion	po	1,100,000	100,000	1,200,000	200,000	1,000,000
2	G...	SMT	po	1,000,000	100,000	1,200,000		1,200,000

Nr	Emri i Subjektit	ADRESA	Pajis	Detyrimi			Likuidua	Vlera e
3	K...	Livadhja	po	1,000,000	100,000	1,100,000		1,100,000
4	B...	Vrion	-	1,100,000	100,000	1,100,000		1,100,000
5	B...	Dermish	-	1,100,000	100,000	1,200,000		1,200,000
	Totali			5,300,000	500,000	5,800,000	200,000	5,600,000

Referuar të dhënave të pasqyrës, regjistrit të të ardhurave, si dhe akt rakordimit me thesarin, rezulton se nga detyrimet e mësipërme ashte likjuar vetëm **200.000 lekë** nga subjekti T.

Nga vlerësimet rezulton se subjektet B... me adrese në Vrion dhe B... me adrese në Dermish, jo që nuk kanë likjuar detyrimet por vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa rinovuar lejen përkatëse për tregtimin e karburanteve për vitin 2022.

-Mos llogaritja e detyrimit nga tarifatat për licencat e tregtimit të karburanteve nga ana e **DAV ka sjelle të ardhur të munguar për Bashkinë Finiq në vlerën 5,600,000 lekë**. Gjithashtu nga ana e kësaj drejtorie **nuk janë marrë masa për ripajisjen e subjekteve B... me licensën e tregtimit**. Veprim ky në kundërshtim me VKM nr.970 datë 02/12/2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. Kreu II, pikat 3,14 ku citohet se:

“Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore..... Përsëritja e licencave bëhet nga organi që ka dhënë licencën, kundrejt një kërkesë të personit juridik, e cila shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re,.....”.

Kriteri:

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 170, datë 25/04/2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02/12/2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15.

Ndikimi/Efekti:

Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Finiq në vlerën 5,600,000 lekë.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitet pa dokumentacion të rregullt.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për evidentimin e diferencave të pamblidhura nga agjentët tatimorë sipas llojit të taksës apo tarifës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat e nevojshme për penalizimin e Agjentëve Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pamblidhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore”, neni 17. Të krijojë bazën e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të kryhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

- **Të ardhurat nga asetet e fondit pyjor kullor:**

Titulli i gjetjes 4: Të ardhura të munguara nga dhënia me qira e aseteve

Situata:

Grupi i auditimit bëri kërkesë për kontratat e qirave të fondit pyjor/kullosor lidhur me subjektet të cilat ushtrojnë aktivitete në sektorin e burimeve minerare të Bashkisë Finiq dhe Njësive Administrative. Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në AKBN, konkretisht, në Regjistrin e Lejeve Minerale, Drejtorinë Rajonale të Bashkisë Finiq, Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se; për vitin 2022 por edhe para kësaj periudhe, në territorin e Bashkisë Finiq kanë ushtruar aktivitet subjektet si më poshtë:

Auditimi u krye në mbështetje të Ligjit nr. 9693, datë 19/03/2007 "Për fondin kullosor", VKM nr. 632, datë 11/06/2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje bari", VKM nr. 391, datë 21/06/2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", VKM nr. 1064, datë 22/12/2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 391, datë 21/06/2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", VKM nr. 799, datë 29.09.2010 "Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme" si dhe Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr. 2, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari".

Nga auditimi mbi kontratat e lidhura me kompanitë celulare për dhënien me qira të pyje kullotave për Antenat celulare rezultoi:

Kontratat e lidhura me shoqërinë "V..." ShA

Midis kësaj shoqërie dhe Bashkisë Finiq është rinovuar kontrata jo noteriale e datës 20.12.2013 me ish komunën Livadhja me afat kontratë prej 5 vjet, prej datës 20.10.2013 – 19.10.2018. Vlera vjetore e qirasë është përcaktuar **130,000 lekë/vit** për një sipërfaqe prej 10 m² ose 0,001 ha, në të cilën përcaktohet se është llogaritur në mbështetje të VKM nr. 1064, datë 22/12/2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21/06/2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave". Por, kontrata e rinovuar nuk na u vu në dispozicion për auditim nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave, e cila merret me ndjekjen e arkëtimit të detyrimit.

Sipas të dhënave të vena në dispozicion nga Drejtoria e Tatim taksave të Bashkisë, detyrimi vjetor i këtij subjekti është regjistruar **130,000 lekë**, detyrim, që për vitin 2022, është shlyer me M. Arkëtimet e datave 20.04.2022 dhe 20.10.2022 për shumat përkatëse **65,000 lekë secila**.

Ndërsa, nuk figuron debitor për vitet e kaluara.

Kontrata e lidhur me shoqërinë "T..." ShA

Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion, me këtë shoqëri nga ana e Bashkisë është lidhur kontrata jonoteriale e datës 25.11.2016, me afat kontratë prej 9 vjet, prej datës 18.09.2016 – 17.09.2025. Vlera vjetore e qirasë është përcaktuar 330.000 lekë/vit për një sipërfaqe prej 300 m² ose 0,03 ha.

Auditimi i rregullshmërisë se kësaj kontratë është bërë në auditimin e mëparshëm të kryer nga ana jone, prandaj, për këtë kontratë u verifikua vetëm pagesa e detyrimit të përcaktuar në te.

Sipas të dhënave të vena në dispozicion nga Drejtoria e Tatim taksave të Bashkisë, detyrimi vjetor i këtij subjekti është regjistruar **360,000 lekë dhe jo 330,000 lekë**, kjo, sipas rekomandimit të lënë në Raportin e auditimit të kryer nga KLSH.

Për këtë, është bërë një shtese kontratë nr. 3042 Prot., datë 29.10.2021 me "O...", e cila ka blere kompaninë "T..." për ndryshim të vlerës se kontratës, pasi llogaritja ishte bërë gabim, ku përcaktohet se për periudhën 18.12.2021 - 17.09.2025, qiraja vjetore do të jetë **360,000 lekë në vit** (12 muaj x 100 lekë/m²/muaj x 300 m²) dhe qiraja do të paguhet parapagim në bazë vjetore.

Detyrimi për vitin 2022 është shlyer nëpërmjet Bankës me M.A e datave 09.02.2022 për shumën **180,000 lekë** (paguar tremujori i katërt i vitit 2021 + tremujori i parë i vitit 2022), M.A. datë 11.05.2022 për **90,000 lekë**, M.A. datë 04.08.2022 për shumën **90,000 lekë** dhe M.A. datë 10.01.2023 për shumën **90,000 lekë**.

Detyrimi nuk është likuiduar në bazë vjetore, por me tremujore.

Gjithashtu, janë transferuar nga ish komunat, kontratat për dhënie me qira të sipërfaqes kullimore dhe pyjore, kontratat e të cilave janë lidhur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor për aktivitete të ndryshme si bar-restorant, kënd lojërash, ambient pushimi, mbarështim faune të egër, akuakulture dhe importim ujë i pijshëm. Janë lidhur kontrata të tilla me **4 subjekte**, nga të cilët, për **dy subjekte** nuk ka dokumentacion të depozituar në Bashki (**A. I dhe I. D**), megjithëse është i njohur detyrimi. Afatet e këtyre kontratave janë nga 10 vjet (1 kontratë) dhe 49 vjet (3 kontrata).

Gjithashtu janë lidhur edhe **2 kontrata** nga Bashkia Finiq me subjektet L. A dhe S. S.

Nga auditimi i shlyerjes se detyrimeve që rrjedhin nga këto kontrata, rezultoi si me poshtë:

1. A. I, i cili ka detyrimin vjetor në shumën **20,000 lekë** nuk ka shlyer detyrimin e vitit 2022 si dhe figuron debitor edhe për vitet e kaluara në shumën **126,000 lekë**, gjithsej **146,000 lekë**.

2. S. S (Mbarështim faune të egër + kënd lojërash), ka lidhur 2 kontrata, njëra me vlerën **30,000 lekë/vit** dhe tjetra me vlerë **36,000 lekë/vit**, vlera, të cilat nuk janë paguar për vitin 2022 si dhe figuron debitor për vitin e kaluara në shumën **96,000 lekë** për kontratën e pare dhe **111,600 lekë** për kontratën e dyte, **gjithsej 207,600 lekë**. **Se bashku me detyrimin e vitit 2022, ky subjekt rezulton debitor në shumën totale 273,600 lekë**.

Me këtë subjekt është rinovuar kontrata me sipërfaqe 15.000 m² dhe vlerë 30,000 lekë, për të cilën, është lidhur aneks kontrata nr.2702 Prot., datë 11.10.2022 për **Mbarështim faune të egër + kënd lojërash**, me afat 11.10.2022 - 11.10.2032, për një sipërfaqe prej 1,5 ha me detyrim vjetor në shumën **69,000 lekë**, i cili, për vitin 2022 është paguar me M.A. nr.1044, datë 11.10.2022.

Pra, nga ana e Bashkisë nuk është vlerësuar mospagimi i detyrimeve që rrjedhin nga dy kontratat e para, por është rinovuar kontrata, në një kohë, që kjo kontratë nuk duhej të lidhej pa u shlyer detyrimi i pashlyer me pare.

3 I. D (s'ka dokumentacion), është lidhur kontrata për një sipërfaqe prej 0,3 ha dhe me një detyrim vjetor prej **66.000 lekë/vit**, të cilit në vitin 2022 i ka mbaruar kontrata, por deri në fund të vitit 2022 figuron debitor për shumën **283.800 lekë** (4 vite).

4. Me L. A (A...) është lidhur kontrata nr.3386, datë 16.10.2020 për mbarështim të flores se egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, ku është përcaktuar afati 15.01.2018 - 14.01.2028, me afat 10 vjeçar, pra, kontrata është lidhur me mbrapa se ky subjekt të këtë filluar aktivitetin dhe detyrimi vjetor në vlerën **576.000 lekë**, llogaritur sipas VKM nr.1064, datë 22/12/2010 "Për disa ndryshime në VKM nr 391, datë 21/06/2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".

Ky detyrim, është likuiduar për vitin 2022 çdo 3/mujor sipas përcaktimit në kontratë, ku, janë llogaritur edhe kamatëvonesat në masën 0,01 % për çdo ditë vonese, nëpërmjet Bankës me M.P. datë 13.04.2022 për shumën **144,100 lekë**, M.P. datë 28.07.2022 për shumën **144,200 lekë**, M.P. datë 27.10.2022 për shumën **144,000 lekë** dhe M.P. datë 29.12.2022 për shumën **144,000 lekë**, **Gjithsej 576.300 lekë, ku përfshihet edhe shuma 300 lekë, ngelur debitor nga viti i kaluar. Pra**, ky subjekt i ka shlyer të gjitha detyrimet. Gjithashtu, nga Bashkia janë lidhur 2 kontrata për dhënie me qira të godinave në pronësi të Bashkisë, e konkretisht:

5. Me S. Ç është lidhur kontrata nr. 2733, datë 13.10.2020 për dhënie me qera të një Ambjenti prej 90 m² në shkollën 9 - vjeçare Krane, për ushtrimin e aktivitetit tregtar dhe lokal shërbimi, ku është përcaktuar afati 15.09.2022 - 14.09.2023, me afat 1 vjeçar, pra, kontrata është lidhur me mbrapa se ky subjekt të këtë filluar aktivitetin, si dhe është përcaktuar detyrimi mujor në vlerën **9,000 lekë/muaj** (90 m² x 100 lekë/m²) dhe detyrimi vjetor në vlerën **108,000 lekë**, llogaritur sipas VKM nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës se dhënies me qera, enfitoize apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar dhe "Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë", nenet 659 - 704 dhe 801 - 825.

Ky detyrim, është likuiduar për vitin 2022.

6. Me V. XH është lidhur kontrata nr. 3106, datë 05.11.2021 për dhënie me qera të një Ambjenti prej 90 m2 tek ish Kopshti i fëmijëve Dyrmish, për banese, ku është përcaktuar afati 05.11.2021 - 05.11.2022, me afat 1 vjeçar, por nuk është përcaktuar detyrimi mujor dhe detyrimi vjetor. në pikën "Vlehtë e kontratës" të kësaj kontratë shprehet se, "detyrimi do të paguhet sipas përcaktimeve që do të beje Drejtoria e të Ardhurave dhe Pronave Publike, ku fatura do të jetë pjese e kësaj kontratë".

Ne fakt, nga të dhënat e marra nga Drejtoria e të Ardhurave për pagesën e detyrimeve që rrjedhin nga të gjitha kontratat e lidhura nga Bashkia, vlera vjetore e kësaj kontratë është **108,000 lekë**, detyrim, i cili për vitin 2022 është likuiduar me M.A. nr.2, datë 04.01.2023.

Si konkluzion, rezulton se, nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë, nuk janë kryer kontrolle për zbatimin e kushteve të kontratës për subjektet debitore, si dhe nuk janë marre masa për arkëtimin e detyrimeve deri në zgjidhjen e kontratës. Gjithsej, detyrimi i papaguar për 3 subjekte është në shumën **703,400 lekë, kërkuar për arkëtim e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Finiq.**

Kriteri: Ligjit nr. 9693, datë 19/03/2007 "Për fondin kullor", VKM nr. 632, datë 11/06/2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje bari", VKM nr. 391, datë 21/06/2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", VKM nr. 1064, datë 22/12/2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 391, datë 21/06/2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", VKM nr. 799, datë 29.09.2010 "Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme" si dhe Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr. 2, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari".

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Finiq në vlerën 703,400 lekë.

Shkaku: Mos respektimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës debitore prej **703,400 lekë** nga **3 subjekte debitore**, përkatësisht, nga A. I për shumën **146,000 lekë**, S. S për shumën **273,600 lekë** dhe I. D për shumën **283,800 lekë**.

- *Auditim mbi dhënien me qira të fondit kullor*

Titulli i gjetjes 5: *Mos arkëtim detyrimi nga subjektet që ushtrojnë në aktivet e Bashkia Finiq, fontit kullor.*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit që na u vu në dispozicion, rezultoi si me poshtë:

Me VKM nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", ndryshuar me VKM nr. 134, datë 3.3.2021 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 8.6.2016 të KM "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar është miratuar lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Finiq", sipas të cilit janë transferuar **gjithsej 28246,37 ha**, nga e cila, **18141,76 ha sipërfaqe kullote, 9561,26 ha sipërfaqe pyjore dhe 543,35 sipërfaqe shkëmbore**.

Nga ana e Bashkisë nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë pranë ASHK Sarande në zbatim të VKM nr. 799, datë 29.09.2010 "Për caktimin e tarifave të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme", në

të cilën shprehet se procedura për token pyjore dhe kullimore kryhet nga njësitë vendore pa tarifa aplikimi. për këtë, nga ana e Sektorit të Pyjeve kullimore ngrihet pretendimi se, nga ana e Kompanisë D..., e cila ka marrë përsipër regjistrimin e tyre, nuk është paraqitur në Bashkinë Finiq produktin përfundimtar.

Nuk janë pasqyruar në kontabilitet tek llogaria 211 "Pyjet, kullotat dhe plantacionet", pasi nuk janë pasqyruar në aktivin e bilancit vjetor.

Nga ana e sektorit të pyjeve dhe kullimore është hartuar një regjistër për kullotat e gatshme për sezonin veror 2022 me sipërfaqe totale prej **14.767,7 ha**, nga e cila sipërfaqe kullimore **11255,73 ha** me kapacitet **29675 krerë dhen, 6060 krerë dhi dhe 134 krerë të trasha** dhe sipërfaqe pyjore **3511,97 ha** me kapacitet **8741 krerë dhi** dhe për sezonin dimëror 2022 – 2023 me një sipërfaqe totale kullimore prej **9.695,42 ha**, nga e cila sipërfaqe kullimore **7739,87 ha** me kapacitet kullimore **22815 krerë dhen, 3481 krerë dhi dhe 114 krerë të trasha** dhe sipërfaqe pyjore **1955,55 ha** me kapacitet kullimore **4889 krerë dhi**. **Gjithsej, sipërfaqe kullimore e planifikuar për dhënie me qera 24.462,42 ha.**

Pra, nga sipërfaqja totale që ka në administrim Bashkia sipas VKM të mësipërm është planifikuar për t'u dhënë me qera vetëm 86.6 % e saj, duke mos e shfrytëzuar të gjithë sipërfaqen kullimore, veprim, që shkakton mungesë të ardhurash për Bashkinë.

Sipas këtij regjistri të ardhurat që do të mblidhen nga këto kullotat janë në shumën **4,059,300 lekë nga kullotat verore dhe 9,137,900 lekë nga kullotat dimërore, gjithsej 13,197,200 lekë**, vlerë kjo, që përputhet me planin e të ardhurave për vitin 2022 - 2023 protokolluar me nr.1125, datë 11.05.2022, miratuar nga kryetari i Bashkisë.

Siç konstatohet, kjo sipërfaqe është shumë e vogël në krahasim me sipërfaqen e miratuar me VKM. Pra, nuk kemi një evidentim të saktë të kapaciteteve për të gjithë sipërfaqen kullimore në administrim të Bashkisë, si dhe regjistri nuk është firmosur nga hartuesi I tij, gjë, e cila duhet të bëhet me komision të përcaktuar nga titullari me specialistet e fushës.

Për vitin 2022, me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.48, datë 15.12.2021 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022" të konfirmuar nga Institucioni I Prefektit Vlore me shkresën Nr.983/1, datë 28.12.2021, janë miratuar tarifat për dhënien me qira të sipërfaqeve kullimore e pyjore për kullotje, përkatësisht, për kullotat dimërore dhe verore 300 lekë/krerë dhen e dhi, 2400 lekë/krerë të trasha njëthundrake dhe 3000 lekë/krerë të trasha dythundrake. Siç shihet, këto tarifa janë me të larta se tarifat e përcaktuara në VKM nr.632, datë 11/06/2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje".

Për vitin 2022, nga kjo Bashki janë lidhur **99 kontrata** qiraje me afat 6 - muhor, nga të cilat, **20 kontrata për kullotat verore me një sipërfaqe kullimore prej 1731,45 ha dhe 79 kontrata për kullotat dimërore me një sipërfaqe prej 5195,51 ha, gjithsej 6926,96 ha.**

Pra, për sezonin veror është shfrytëzuar vetëm 11,72 % e sipërfaqes së përcaktuar në regjistër dhe të miratuar nga titullari dhe për sezonin dimëror 2022 - 2023 është shfrytëzuar vetëm 53,58 % e sipërfaqes së përcaktuar në regjistër dhe të miratuar nga titullari.

Gjithashtu, janë lidhur edhe **7 kontrata** me afat 10 – vjeçar, të trashëguara nga ish komunitat me një sipërfaqe prej **565,55 ha** për **1290 krerë dhen dhe 45 krerë të trasha** për vlerën totale vjetore prej **197,500 lekë**, prej të cilave, **3 kontrata** mbarojnë me 31.05.2023 dhe **4 prej tyre** mbarojnë me 31.05.2025.

Nga auditimi I dosjeve të kontratave të lidhura, rezultoi se është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Mjedisit Nr.2, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotat e kositje bari", e konkretisht;

1. Nuk është hartuar plani i mbarështimit me të gjithë treguesit teknike të përcaktuar në pikën 1 të kreut II të Udhëzimit të mësipërm, por ka planifikuar të fillojë me një nga

ekonomitë me sipërfaqe të vogël, Ekonominë pyjore/kullosore Konispol e cila është përlllogaritur me vlerën rreth 5,000,000 lekë me TVSh.

2.Nga ana e Zyrës se Pyje kullotave nuk është shpallur lista e kullotave të gatshme për kullotje dhe sipërfaqet që përjashtohen nga kullotja, në muajin Shkurt të çdo viti, me të gjitha të dhënat përkatëse, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 2 të Udhëzimit të mësipërm.

3.Nga ana e kërkuesve të marrjes me qira të kullotave është paraqitur kërkesë me shkrim në zyrën përkatëse, por jo brenda datës 10 Mars për kullotat verore dhe brenda datës 10 Korrik për kullotat dimërore me të dhënat përkatëse, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 3 dhe 4 të Udhëzimit të mësipërm.

4.Ne disa raste mungon certifikata veterinare e cila lëshohet çdo vit nga shërbimi veterinar, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 5/a të Udhëzimit të mësipërm.

5.Ne disa raste mungon vërtetimi nga NJA/bashkia për vendbanimin dhe numrin e bagëtive që kërkuesi ka në pronësi, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 5/b të Udhëzimit të mësipërm.

6.Ne shumicën e rasteve kontratat e lidhura për kullotat dimërore 2022 - 2023 janë lidhur me vonese, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e sipërpërmendur.

6.Nga ana e strukturave përgjegjëse për pyjet dhe kullotat nuk janë mbajtur proces verbalet e mbledhjeve për marrjen në shqyrtim të kërkesave dhe nuk janë hartuar vendimet përkatëse për miratimin apo mosmiratimin e tyre, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 9 të Udhëzimit të mësipërm.

7.Për të gjitha kontratat e lidhura, nuk është hartuar proces verbali I dorëzimit të kullotës i firmosur nga të dy palët, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 15 të Udhëzimit të mësipërm.

8.Nga ana e qiradhënësit, Bashkisë, nuk janë bërë sondazhe gjatë kullotjes për të mos lejuar futjen e bagëtive në kullote jashtë kapacitetit kullosor të kontraktuar, në kundërshtim me kreun III “Kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullosor për kullotje”, pika 7 të Udhëzimit të mësipërm.

Nga krahasimi kërkesës se paraqitur nga qiramarrësi, numrit të krerëve të vaksinuar sipas certifikatës veterinare, vërtetimit për numrin e krerëve si dhe kontratës se lidhur, rezultuan raste, ku kontrata është lidhur për numër krerësh me pak ose me shumë se numri i krerëve për të cilët është kërkuar sipërfaqe kullosore në kërkesë apo numrin e krerëve sipas certifikatës veterinare apo vërtetimit të matrikullimit.

Për këtë, nga ana e Sektorit të Pyje kullotave pretendohet se ka raste që blegtorët kontraktajnë bashkëlidhur me kullotën e Bashkisë toka arë të qytetarëve ose kullota private nga ish pronar të cilët i kanë përfituar këto prona me VKKP, por nga ana e tyre nuk na u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për vërtetimin e tyre.

- Analitikisht, nga auditimi i kontratave të lidhura, rezultuan me shkelje e mangësi, kontratat si me poshtë;

Për kontratat verore të vitit 2022

1. Me GJ. P është lidhur kontrata nr.1438 Prot. me 07.06.2022 për 250 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 22.04.2022 është kërkuar sipërfaqe për 370 krerë po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare ky subjekt ka 370 krerë, pra, kontrata është lidhur për **120 krerë me pak për vlerën 36.000 lekë (120 x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

2. Me V. P është lidhur kontrata nr.1639 Prot. me 27.06.2022 për **115 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 11.04.2022 është kërkuar sipërfaqe për **180 krerë** ndërsa, sipas certifikatës veterinare ky subjekt ka **110 krerë**, pra, ka mospërputhje të numrit të krerëve. Kontrata është lidhur për **70 krerë me pak se sa është kërkuar për vlerën 21,000 lekë (70 x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

3. Me **A. V** është lidhur kontrata nr.1437 Prot. me 07.06.2022 për 249 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 22.04.2022 është kërkuar sipërfaqe për 370 krerë, ndërsa, sipas certifikatës veterinare ky subjekt ka 350 krerë dhen + 30 krerë dhi, pra, kontrata është lidhur për **131 krerë të imta me pak për vlerën 39.300 lekë (131 x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

4. Me **E. T** është lidhur kontrata nr.1997 Prot. me 03.08.2022 për 396 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 22.04.2022 është kërkuar sipërfaqe për 90 krerë lope, po kështu edhe sipas certifikatës veterinare ky subjekt ka 90 krerë lope, pra, kontrata është lidhur për **vlerën 97,200 lekë (90 lope x 2400 lekë/krerë - 396 krerë dhen x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

5. Me **Y. Z** është lidhur kontrata nr.1421 Prot. me 06.06.2022 për 300 krerë dhen + 100 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës 23.03.2022 është kërkuar sipërfaqe për 50 krerë lope, po kështu edhe sipas certifikatës veterinare ky subjekt ka 50 krerë lope, megjithëse vlera përputhet.

6. Me **Q.T** është lidhur kontrata nr.1545 Prot. me 15.06.2022 për 176 krerë dhi, por, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i Bashkisë Delvine që kap vlerën **5,000 lekë (50m² + 50 m²) x 50 lekë/m², kërkuar për zhdëmtim.**

7. Me **A. H** është lidhur kontrata nr.1654 Prot. me 26.06.2022 për 167 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës 22.04.2022 është kërkuar sipërfaqe për 370 krerë ndërsa, sipas certifikatës veterinare ky subjekt ka 363 krerë dhen, pra, kontrata është lidhur për **196 krerë të imta me pak për vlerën 58.800 lekë (196 x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

8. Me **L. I** është lidhur kontrata nr.1989 Prot. me 01.08.2022 për 126 krerë dhi, ndërsa, sipas certifikatës veterinare ky subjekt ka 200 krerë të imta + 47 krerë gjedhe, pra, kontrata është lidhur për **74 krerë të imta me pak për vlerën 22.200 lekë (74 x 300 lekë/krerë).**Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i Bashkisë Delvine që kap vlerën **5.000 lekë (50m² + 50 m²) x 50 lekë/m². Gjithsej, 27.200 lekë, kërkuar për zhdëmtim.**

9. Me **A. K** është lidhur kontrata nr.2487 Prot. me 22.09.2022 për 222 krerë dhen, në një kohë që, sipas kërkesës datë 09.12.2022 është kërkuar sipërfaqe për 300 krerë dhi, sipas certifikatës veterinare ky subjekt ka 250 krerë dhi dhe sipas vërtetimit të matrikullimit ka 406 krerë dhi, pra, kontrata është lidhur për 78 krerë të imta me pak se kërkesa, 184 krerë me pak se vërtetimi i matrikullimit dhe 28 krerë me pak se certifikata veterinare. Pra, kemi mospërputhje të numrit të krerëve. Duke marrë për bazë kërkesën, rezulton se kontrata është lidhur për **78 krerë me pak për vlerën 23.400 lekë (78 x 300 lekë/krerë).** Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i Bashkisë Delvine që kap vlerën **5,000 lekë (50m² + 50 m²) x 50 lekë/m². Gjithsej, 28,400 lekë, kërkuar për zhdëmtim.**

Nga dokumentacioni rezulton se ka mospërputhje të datave si dhe lidhje e kontratës me vonese, pasi kërkesa mban datë, 09.12.2022, kontrata mban datën 22.09.2022, pra, kërkesa është bërë pas lidhjes se kontratës, gjë, që tregon për veprime fiktive të kryera nga sektori i pyje kullotave.

10. Me **A. M** është lidhur kontrata nr.1471 Prot. me 09.06.2022 për 118 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 17.05.2022 është kërkuar sipërfaqe për 50 krerë lope, ndërsa, sipas certifikatës veterinare dhe vërtetimit të matrikullimit, ky subjekt ka 55 krerë lope, pra kontrata është lidhur **me pak për vlerën 96,600 lekë (55 krerë lope x 2400 lekë/krerë - 118 krerë dhen x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

11. Me **Z. B** është lidhur kontrata nr.1480 Prot. me 10.06.2022 për 150 krerë dhen + 134 krerë dhi + 10 të trasha, në një kohë që sipas kërkesës se datës 20.05.2022 është kërkuar sipërfaqe për 425 krerë dhi + 35 krerë lope, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 450 krerë të imta + 35 krerë gjedhe, pra kontrata është lidhur **me pak për vlerën**

124,800 lekë ((450 krerë të imta x 300 lekë/krerë + 35 krerë gjedhe x 3000 lekë/krerë) - (184 krerë dhen x 300 lekë/krerë + 10 gjedhe x 3000 lekë/krerë)), kërkuar për zhdëmtim.

12. Me H. G është lidhur kontrata nr.2013 Prot. me 04.08.2022 për 190 krerë dhi, në një kohë që sipas vërtetimit të matrikullimit, ky subjekt ka 200 krerë të imta, pra kontrata është lidhur **me pak 10 krerë të imta për vlerën 3,000 lekë (10 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

13. Me A. G është lidhur kontrata nr.1342 Prot. me 15.06.2022 për 190 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës 29.03.2022 është kërkuar sipërfaqe për 200 krerë dhen + 60 krerë dhi, pra kontrata është lidhur **me pak 70 krerë të imta për vlerën 21,000 lekë (71 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

14. Me A. SH është lidhur kontrata nr.1513 Prot. me 14.06.2022 për 266 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës 29.03.2022 është kërkuar sipërfaqe për 250 krerë dhi, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 100 krerë të imta, ndërsa sipas vërtetimit të matrikullimit ka 400 krerë të imta, pra, kemi mospërputhje të dhënash. Duke marrë për bazë vërtetimin e matrikullimit, kontrata është lidhur **me pak për 134 krerë të imta për vlerën 40,200 lekë (134 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

Gjithsej, vlera e arkëtuar me pak dhe e kërkuar për zhdëmtim, për kullotat verore është në shumën **598,500 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Finiq.**

- Për kontratat dimërore 2022 - 2023

1. Me K. N është lidhur kontrata nr.199 Prot. me 25.01.2023 për 104 krerë dhi, në një kohë që, sipas certifikatës veterinare ky subjekt ka 100 krerë dele dhe 20 krerë dhi, pra, kontrata është lidhur për **16 krerë të imta me pak për vlerën 4,800 lekë (16 x 300 lekë/krerë).** Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i NJA Qesarat, që kap vlerën **5,000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²).** Gjithsej shuma prej **9,800 lekë, kërkuar për zhdëmtim.**

Nga dokumentacioni rezulton se ka lidhje e kontratës me vonese, megjithëse afati i saj është 01.12.2022 - 31.05.2023.

2. Me J. V është lidhur kontrata nr.202 Prot. me 25.06.2022 për 226 krerë dhen + 10 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës 07.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për 89 krerë lope, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 89 krerë lope, pra kontrata është lidhur **me pak për vlerën 196.200 lekë (89 krerë lope x 3000 lekë/krerë - 236 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

3. Me V. H është lidhur kontrata nr.157 Prot. me 19.01.2023 për 37 krerë dhen + 41 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për 250 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 270 krerë dhen, pra kontrata është lidhur **me pak për vlerën 57,600 lekë (192 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

4. Me N. P është lidhur kontrata nr.151 Prot. me 19.01.2023 për 100 krerë dhen + 115 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës 26.10.2022 është kërkuar sipërfaqe për 240 krerë dhen + 60 krerë dhi + 60 krerë lope, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 240 krerë dhen + 60 krerë dhi dhe 60 krerë gjedhe + 2 njëhundrake dhe sipas vërtetimit të matrikullimit ka 110 krerë gjedhe. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Duka marrë parasysh kërkesën e bërë prej tij, kontrata është lidhur **me pak 85 krerë të imta dhe 60 krerë lope për vlerën 205.500 lekë (85 krerë të imta x 300 lekë/krerë + 60 krerë lope x 3000 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

5. Me S. P është lidhur kontrata nr.150 Prot. me 19.01.2023 për 35 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 26.10.2022 është kërkuar sipërfaqe për 62 krerë lope, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 62 krerë lope, pra kontrata është lidhur **me**

pak për vlerën 175.500 lekë (62 krerë lope x 3000 lekë/krerë - 35 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

6. Me **J. L** është lidhur kontrata nr.138 Prot. me 17.01.2023 për 23 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për 150 krerë dhen, ndërsa, nuk ka paraqitur certifikatë veterinare dhe vërtetim matrikullimi. Pra kontrata është lidhur **me pak se sa është kërkuar në kërkesë për 127 krerë dhen për vlerën 38,100 lekë (127 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

7. Me **I. M** është lidhur kontrata nr.135 Prot. me 17.01.2023 për 24 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për 70 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 70 krerë dhen, pra kontrata është lidhur **me pak për 46 krerë dhen në vlerën 13,800 lekë (46 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

8. Me **P. K** është lidhur kontrata nr.129 Prot. me 16.01.2023 për 294 krerë dhen + 195 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për 150 krerë dhen + 20 krerë lope, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 150 krerë dhi. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve, ndërsa vërtetimi i matrikullimit nuk është depozituar. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 144 krerë dhen dhe 195 krerë dhi, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.**

9. Me **T. K** është lidhur kontrata nr.128 Prot. me 16.01.2023 për 250 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për 265 krerë dhen + 55 krerë lope, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 265 krerë dhen+ 55 krerë lope, pra kontrata është lidhur **me pak për 15 krerë dhen dhe 55 krerë lope në vlerën 210,000 lekë (55 krerë lope x 3000 lekë/krerë + 15 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

10. Me **I. Ç** është lidhur kontrata nr.127 Prot. me 16.01.2023 për 151 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës 15.01.2023 është kërkuar sipërfaqe për 200 krerë dhi, ndërsa, nuk ka paraqitur certifikatë veterinare dhe vërtetim matrikullimi. Pra kontrata është lidhur **me pak se sa është kërkuar në kërkesë për 49 krerë dhi për vlerën 14,700 lekë (49 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

11. Me **L. K** është lidhur kontrata nr.108 Prot. me 13.01.2023 për 123 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për 250 krerë dhi, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 250 krerë dhi, pra kontrata është lidhur **me pak për 27 krerë dhi në vlerën 81,000 lekë (27 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

12. Me **V. L** është lidhur kontrata nr.09 Prot. me 16.01.2023 për 430 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 15.09.2022 është kërkuar sipërfaqe për 200 krerë dhen, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 100 krerë lope, pra kontrata është lidhur **me pak për vlerën 171,000 lekë (100 krerë lope x 300 lekë/krerë - 430 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

13. Me **H. G** është lidhur kontrata nr.52 Prot. me 09.01.2023 për 53 krerë dhen + 22 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës 12.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për 160 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 160 krerë dhen, pra kontrata është lidhur **me pak për 88 krerë të imta në vlerën 27,000 lekë (88 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

14. Me **Z. M** është lidhur kontrata nr.53 Prot. me 09.01.2023 për 20 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për 85 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 85 krerë dhen, pra kontrata është lidhur **me pak për 65 krerë të imta në vlerën 19,500 lekë (65 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

15. Me **O. XH** është lidhur kontrata nr.51 Prot. me 09.01.2023 për 26 krerë dhi, në një kohë që në kërkesën e datës 29.09.2022 nuk është përcaktuar numri i krerëve si dhe nuk janë depozituar certifikata veterinare dhe vërtetimi i matrikullimit.

16. Me F. T është lidhur kontrata nr.15 Prot. me 04.01.2023 për 25 krerë dhi, në një kohë që, sipas kërkesës datë s'ka është kërkuar sipërfaqe për 100 krerë dhi, ndërsa mungon certifikata veterinare dhe vërtetimi i matrikullimit, pra, kontrata është lidhur për **75 krerë të imta me pak për vlerën 22,500 lekë (75 x 300 lekë/krerë)**. Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i Bashkisë Delvine, që kap vlerën **5,000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²)**. **Gjithsej, 27,500 lekë, kërkuar për zhdëmtim.**

17. Me S. N është lidhur kontrata nr.3332 Prot. me 30.12.2022 për 92 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 29.09.2022 është kërkuar sipërfaqe për **240 krerë dhen**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **220 krerë dhen**, pra kontrata është lidhur **me pak se sa nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare për 128 krerë dhen në vlerën 38,400 lekë (128 krerë të imta x 300 lekë/krerë)**, kërkuar për zhdëmtim.

18. Me K. Ç është lidhur kontrata nr.3315 Prot. me 29.12.2022 për 140 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 09.09.2022 është kërkuar sipërfaqe për **207 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **207 krerë dhen**, pra kontrata është lidhur **me pak se sa nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare për 167 krerë dhen në vlerën 20,100 lekë (167 krerë të imta x 300 lekë/krerë)**, kërkuar për zhdëmtim.

19. Me N. V është lidhur kontrata nr.3297 Prot. me 23.12.2022 për **203 krerë dhen + 6 krerë gjedhe**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 07.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për **72 krerë lope**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **72 krerë lope**, pra kontrata është lidhur **me pak në vlerën 137,100 lekë {(72 krerë lope x 3000 lekë/krerë) - (203 krerë të imta x 300 lekë/krerë + 6 krerë gjedhe x 3000 lekë/krerë)}**, kërkuar për zhdëmtim.

20. Me A. G është lidhur kontrata nr.3273 Prot. me 23.12.2022 për 25 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 28.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për **100 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **100 krerë dhen**, pra kontrata është lidhur **me pak se sa nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare për 75 krerë dhen në vlerën 22.500 lekë (75 krerë të imta x 300 lekë/krerë)**, kërkuar për zhdëmtim.

21. Me F. GJ është lidhur kontrata nr.2630 Prot. me 05.10.2022 për **172 krerë dhen + 185 krerë dhi**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 10.09.2022 është kërkuar sipërfaqe për **50 krerë lope**, ndërsa mungon certifikata veterinare dhe vërtetimi i matrikullimit, pra kontrata është lidhur **me pak në vlerën 42.900 lekë ((50 krerë lope x 3000 lekë/krerë) - (357 krerë të imta x 300 lekë/krerë))**, kërkuar për zhdëmtim.

22. Me A. M është lidhur kontrata nr.3223 Prot. me 15.12.2022 për **300 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 14.09.2022 është kërkuar sipërfaqe për **50 krerë lope**, ndërsa sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **55 krerë lope**, pra kontrata është lidhur **me pak se sa nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare në vlerën 75.000 lekë ((55 krerë lope x 3000 lekë/krerë) - (300 krerë të imta x 300 lekë/krerë))**, kërkuar për zhdëmtim.

23. Me I. B është lidhur kontrata nr.3208 Prot. me 13.12.2022 për **238 krerë dhen + 60 krerë dhi**, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për **300 krerë dhi**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **300 krerë dhi**, pra kontrata është lidhur **me pak se sa nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare për 2 krerë të imta në vlerën 600 lekë (2 krerë të imta x 300 lekë/krerë)**, kërkuar për zhdëmtim.

24. Me K. V është lidhur kontrata nr.3209 Prot. me 13.12.2022 për **246 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për 150 krerë dhi, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **150 krerë dhi**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve, ndërsa vërtetimi i matrikullimit nuk është depozituar. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 146 krerë dhen, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.**

25. Me V. K është lidhur kontrata nr.3194 Prot. me 12.12.2022 për **50 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka, nuk është përcaktuar numri i krerëve, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **300 krerë dhen**, pra kontrata është lidhur **me pak se**

nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare për 250 krerë të imta në vlerën 75.000 lekë (250 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

26. Me V. K është lidhur kontrata nr.3217 Prot. me 14.12.2022 për **55 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 28.09.2022 është kërkuar sipërfaqe për **50 krerë dhen + 20 krerë dhi**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **80 krerë dhi**, pra kontrata është lidhur **me pak se nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare për 25 krerë të imta në vlerën 7.500 lekë (25 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

27. Me L. SH është lidhur kontrata nr.3189 Prot. me 09.12.2022 për **30 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 05.12.2022 është kërkuar sipërfaqe për **150 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **150 krerë dhen**, pra kontrata është lidhur **me pak se nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare për 130 krerë të imta në vlerën 39.000 lekë (130 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

28. Me TH. S është lidhur kontrata nr.3167 Prot. me 06.12.2022 për **50 krerë dhen + 6 krerë dhi**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 18.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për **200 krerë dhen**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **150 krerë dhen**, pra kontrata është lidhur **me pak se nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare për 94 krerë të imta në vlerën 28.200 lekë (94 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

29. Me A. K është lidhur kontrata nr.3142 Prot. me 02.12.2022 për **130 krerë dhen + 200 krerë dhi**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 03.08.2022 është kërkuar sipërfaqe për **120 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **120 krerë dhen**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve, ndërsa vërtetimi i matrikullimit nuk është depozituar. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 210 krerë të imta, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.**

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i Bashkisë Delvine, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim.**

30. Me K... D është lidhur kontrata nr.3166 Prot. me 06.12.2022 për **79 krerë dhen + 54 krerë dhi**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 25.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për **180 krerë dhen**, ndërsa mungon certifikata veterinare dhe vërtetimi i matrikullimit, pra kontrata është lidhur **me pak se numri i përcaktuar në kërkesë për 47 krerë në vlerën 14.100 lekë (47 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

31. Me E. T. është lidhur kontrata nr.3157 Prot. me 05.12.2022 për **58 krerë dhen + 279 krerë dhi**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 26.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për **90 krerë lope**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **90 krerë dhen**, ndërsa sipas vërtetimit të matrikullimit ka **66 krerë lope**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, kontrata është lidhur me pak se nr. i përcaktuar kërkesë dhe në certifikatën veterinare në vlerën 168.900 lekë ((90 krerë lope x 3000 lekë/krerë) - (337 krerë të imta x 300 lekë/krerë)), kërkuar për zhdëmtim.**

32. Me A. V është lidhur kontrata nr.3098 Prot. me 24.11.2022 për **432 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për **300 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **300 krerë dhen**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve, ndërsa vërtetimi i matrikullimit nuk është depozituar. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 132 krerë të imta, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.**

33. Me L. Z është lidhur kontrata nr.3094 Prot. me 24.11.2022 për **35 krerë dhen + 275 krerë dhi**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 15.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për **60 krerë dhen + 68 krerë dhi**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **128 krerë dhen dhe sipas vërtetimit të matrikullimit të vitit 2021 ka 109 krerë**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 182 krerë të imta, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.**

34. Me M. M është lidhur kontrata nr.3025 Prot. me 15.11.2022 për 243 krerë dhen + 209 krerë dhi, gjithsej, 452 krerë të imta, në një kohë që sipas kërkesës se datës 12.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për 188 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare dhe vërtetimit të matrikullimit, ky subjekt ka 188 krerë dhen. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me shumë për 264 krerë në vlerën 79.200 lekë.

Po kështu, me këtë subjekt është lidhur edhe kontrata nr.3066 Prot. me 21.11.2022 për 150 krerë dhen me të njëjtën kërkesë të datës 12.07.2022 për 188 krerë dhe të njëjtën certifikatë veterinare sipas të cilës ky subjekt ka 188 krerë dhen. Pra, kontrata është lidhur me tepër për 150 krerë të imta në vlerën 45.000 lekë.

Pra, për këtë subjekt janë lidhur dy kontrata për të njëjtat të dhëna të paraqitura prej tij.

Këto veprime tregojnë për shpërdorim të fondit kullosor që administrojnë Bashkia.

35. Me L. I është lidhur kontrata nr.3052 Prot. me 17.11.2022 për 176 krerë dhen, në një kohë që në kërkesën e datës 09.09.2022, nuk është përcaktuar numri i krerëve, ndërsa sipas certifikatës veterinare dhe vërtetimit të matrikullimit, ky subjekt ka 247 krerë dhen. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak për 71 krerë të imta në vlerën 21.300 lekë (71 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i Bashkisë Sarand, që kap vlerën **5.000 lekë (50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²). Gjithsej, 26.300 lekë, kërkuar për zhdëmtim.**

36. Me S. J është lidhur kontrata nr.3022 Prot. me 15.11.2022 për 315 krerë dhen + 112 krerë dhi, në një kohë që në kërkesën e datës 28.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për 283 krerë dhen + 22 krerë dhi, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 283 krerë dhen + 22 krerë dhi. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak për 122 krerë të imta në vlerën 36.600 lekë (122 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

37. Me V. P është lidhur kontrata nr.3026 Prot. me 15.11.2022 për 250 krerë dhen + 96 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës s'ka është kërkuar sipërfaqe për 250 krerë dhi, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 117 krerë dhen + 28 krerë dhi, gjithsej 145 krerë të imta. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 201 krerë të imta, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.

38. Me T. S është lidhur kontrata nr.2990 Prot. me 10.11.2022 për 11 krerë dhen + 52 krerë dhi, në një kohë që në kërkesën e datës 01.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për 70 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 70 krerë dhen. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak për 7 krerë të imta në vlerën 2.100 lekë (7 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

39. Me XH. B është lidhur kontrata nr.2799 Prot. me 19.10.2022 për 70 krerë dhi, në një kohë që sipas kërkesës se datës 04.09.2022 është kërkuar sipërfaqe për 350 krerë dhi, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 350 krerë dhi. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve, ndërsa vërtetimi i matrikullimit nuk është depozituar. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak për 280 krerë të imta, në vlerën 84.000 lekë (280 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i Bashkisë Delvine, që kap vlerën **5.000 lekë (50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej 89.000 lekë.**

40. Me G. M është lidhur kontrata nr.2779 Prot. me 17.10.2022 për 180 krerë dhen, në një kohë që sipas kërkesës se datës 23.09.2022 është kërkuar sipërfaqe për 450 krerë dhen, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 350 krerë dhen + 6 krerë njëthundrake, ndërsa sipas vërtetimit të matrikullimit ka 66 krerë lope. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare për 170 krerë dhen dhe 6 krerë njëthundrake

në vlerën 69.000 lekë ((6 krerë lope x 3000 lekë/krerë) + (170 krerë të imta x 300 lekë/krerë)), kërkuar për zhdëmtim.

41. Me I. D është lidhur kontrata nr.2299 Prot. me 01.09.2022 për **361 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 16.08.2022 është kërkuar sipërfaqe për **50 krerë lope**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **50 krerë dhen**, ndërsa sipas vërtetimit të matrikullimit ka **66 krerë lope**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, kontrata është lidhur me pak se nr. i përcaktuar kërkesë dhe në certifikatën veterinare në vlerën 41.700 lekë ((50 krerë lope x 3000 lekë/krerë) - (361 krerë të imta x 300 lekë/krerë)), kërkuar për zhdëmtim.**

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i Bashkisë Sarande, që kap vlerën **5.000 lekë (50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²)**, kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej **46.700 lekë.**

42. Me A. Z është lidhur kontrata nr.230 Prot. me 01.09.2022 për **130 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 02.08.2022 është kërkuar sipërfaqe për **165 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **165 krerë dhen**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve, ndërsa vërtetimi i matrikullimit nuk është depozituar. Pra, **rezulton se, kontrata është lidhur me pak për 35 krerë të imta, në vlerën 10.500 lekë (35 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i Bashkisë Sarande, që kap vlerën **5.000 lekë (50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²)**, kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej **15.500 lekë.**

43.Me V.P. është lidhur kontrata nr.2298 Prot. me 01.09.2022 për **335 krerë**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 28.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për **180 krerë dhi**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare dhe vërtetimit të matrikullimit, ky subjekt ka **110 krerë dhi**, gjithsej **145 krerë të imta**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullimore, për 225 krerë të imta, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullisor.**

44. Me K. T është lidhur kontrata nr.2281 Prot. me 31.08.2022 për **245 krerë dhen**, në një kohë që në kërkesën e datës 05.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **240 krerë dhen**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **250 krerë dhen**. Pra, **rezulton se, kontrata është lidhur me pak për 5 krerë të imta në vlerën 1.500 lekë (5 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

45.Me S. Q është lidhur kontrata nr.2280 Prot. me 31.08.2022 për **446 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës se datës 02.07.2022 është kërkuar sipërfaqe për **125 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **125 krerë dhen**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullimore, për 321 krerë të imta, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullisor.**

46. Me A. K është lidhur kontrata nr.2279 Prot. me 31.08.2022 për **122 krerë dhi**, në një kohë që në kërkesën e datës 01.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **300 krerë dhi**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **300 krerë dhi**. Pra, **rezulton se, kontrata është lidhur me pak për 178 krerë të imta në vlerën 53.400 lekë (178 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.** Gjithashtu, për të, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i Bashkisë Delvine, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²)**, kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej **58.400 lekë.**

47. Me F. GJ është lidhur kontrata nr.2769 Prot. me 31.08.2022 për **158 krerë dhi**, në një kohë që në kërkesën e datës 15.09.2022, është kërkuar sipërfaqe për **120 krerë dhi**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **120 krerë dhi**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullimore, për 138 krerë të imta, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullisor.**

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i Bashkisë Delvine, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim.**

48. Me P. G është lidhur kontrata nr.2760 Prot. me 14.10.2022 për 101 krerë dhi, në një kohë që në kërkesën e datës 07.09.2022, është kërkuar sipërfaqe për 110 krerë dhen + 30 krerë dhi, ndërsa sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 145 krerë dhen. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 44 krerë të imta në vlerën 13.200 lekë (44 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

49. Me R. XH është lidhur kontrata nr.2762 Prot. me 14.10.2022 për 35 krerë dhen, në një kohë që në kërkesën e datës 08.09.2022, është kërkuar sipërfaqe për 100 krerë dhen, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, e cila është e vitit 2021, ky subjekt ka 50 krerë dhen. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 15 krerë të imta në vlerën 4.500 lekë (15 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

50. Me S. Ç është lidhur kontrata nr.2752 Prot. me 14.10.2022 për 215 krerë dhen + 10 krerë të trasha, në një kohë që në kërkesën e datës 05.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për 100 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 100 krerë dhen. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 115 krerë të imta, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.

51. Me H. H është lidhur kontrata nr.2734 Prot. me 13.10.2022 për 6 krerë dhen + 254 krerë dhi , në një kohë që në kërkesën e datës 20.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për 350 krerë dhi, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 350 krerë dhi. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 30 krerë të imta në vlerën 9.000 lekë (30 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i NJA Picar, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej 14.000 lekë.**

52. Me S. K është lidhur kontrata nr.2723 Prot. me 12.10.2022 për 89 krerë dhen, në një kohë që në kërkesën e datës 20.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për 145 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 145 krerë dhen. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 56 krerë të imta në vlerën 16.800 lekë (56 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

53. Me F. G është lidhur kontrata nr.2670 Prot. me 07.10.2022 për 125 krerë dhen, në një kohë që në kërkesën e datës 20.08.2022, është kërkuar sipërfaqe për 271 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 271 krerë dhen. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 146 krerë të imta në vlerën 43.800 lekë (146 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

54. Me SH. XH është lidhur kontrata nr.2704 Prot. me 11.10.2022 për 40 krerë dhen, në një kohë që në kërkesën e datës 20.08.2022, është kërkuar sipërfaqe për 140 krerë dhen, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 190 krerë dhen. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 150 krerë të imta në vlerën 45.000 lekë (150 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

55. Me M. K është lidhur kontrata nr.2647 Prot. me 06.10.2022 për 270 krerë dhen + 5 krerë të trasha, në një kohë që në kërkesën e datës 30.08.2022, është kërkuar sipërfaqe për 570 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 570 krerë dhen. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në

Çertifikatën veterinare në vlerën 75.000 lekë ((570 krerë të imta x 300 lekë/krerë) - (270 krerë të imta x 300 lekë/krerë + 5 krerë të trasha x 3000 lekë/krerë)), kërkuar për zhdëmtim.

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i Bashkisë Delvine, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej 80.000 lekë.**

56. Me E. D është lidhur kontrata nr.2597 Prot. me 03.10.2022 për 40 krerë dhen + 206 krerë dhi, në një kohë që në kërkesën e datës 08.08.2022, është kërkuar sipërfaqe për 50 krerë dhen + 200 krerë dhi, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 250 krerë të imta Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 4 krerë të imta në vlerën 1.200 lekë (4 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

57. Me SH. K është lidhur kontrata nr.2598 Prot. me 03.10.2022 për 238 krerë dhi, në një kohë që në kërkesën e datës 15.09.2022, është kërkuar sipërfaqe për 250 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 250 krerë të imta Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 12 krerë të imta në vlerën 3.600 lekë (12 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i NJA Picar, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej 8.600 lekë.**

58. Me F. T është lidhur kontrata nr.2631 Prot. me 05.10.2022 për 206 krerë dhi, në një kohë që në kërkesën e datës 23.08.2022, është kërkuar sipërfaqe për 400 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 400 krerë të imta Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 194 krerë të imta në vlerën 58.200 lekë (194 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i NJA Kurvelesh (Gusmar), që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej 63.200 lekë.**

59. Me S. G është lidhur kontrata nr.2441 Prot. me 19.09.2022 për 201 krerë të imta + 5 krerë të trasha, por, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i NJA Picar, Gjirokastër që kap vlerën 5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim.

60. Me K. T është lidhur kontrata nr.2569 Prot. me 29.09.2022 për 418 krerë dhen, në një kohë që në kërkesën e datës 05.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për 400 krerë dhen, ndërsa sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 300 krerë dhen dhe sipas vërtetimit të matrikullimit të vitit 2021 ka 525 krerë dhen. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 118 krerë të imta, në krahasim me numrin e përcaktuar në certifikatën veterinare, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit , subjekti është banor i Bashkisë Delvine, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim.**

61. Me Ç. B është lidhur kontrata nr.2539 Prot. me 27.09.2022 për 130 krerë dhen, në një kohë që në kërkesën e datës 10.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për 210 krerë dhen, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka 210 krerë të imta Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 80 krerë të imta në vlerën 24.000 lekë (80 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.

62. Me DH. DH është lidhur kontrata nr.2554 Prot. me 28.09.2022 për **434 krerë dhen**, në një kohë që në kërkesën e datës 10.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **300 krerë dhen**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **440 krerë të imta Pra**, rezulton se, kontrata është lidhur **me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 6 krerë të imta në vlerën 1.800 lekë (6 krerë të imta x 300 lekë/krerë)**, kërkuar për zhdëmtim.

63. Me G. M është lidhur kontrata nr.2549 Prot. me 28.09.2022 për **27 krerë dhen + 1 krerë të trasha**, në një kohë që në kërkesën e datës 18.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **110 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **110 krerë të imta Pra**, rezulton se, kontrata është lidhur **me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 83 krerë të imta në vlerën 24.900 lekë (83 krerë të imta x 300 lekë/krerë)**, kërkuar për zhdëmtim.

64. Me K. T është lidhur kontrata nr.2488 Prot. me 22.09.2022 për **138 krerë dhen**, në një kohë që në kërkesën e datës 05.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **240 krerë dhen**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **250 krerë të imta. Pra**, rezulton se, kontrata është lidhur **me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 112 krerë të imta në vlerën 33.600 lekë (112 krerë të imta x 300 lekë/krerë)**, kërkuar për zhdëmtim.

65. Me Z. B është lidhur kontrata nr.2454 Prot. me 20.09.2022 për **336 krerë dhen + 10 krerë të trasha**, në një kohë që në kërkesën e datës 18.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **450 krerë dhi**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **485 krerë të imta. Pra**, rezulton se, kontrata është lidhur **me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare në vlerën 14.700 lekë (450 krerë të imta x 300 lekë/krerë - (336 krerë të imta x 300 lekë/krerë + 10 krerë të trasha x 3000 lekë/krerë))**, kërkuar për zhdëmtim.

66. Me Z. XH është lidhur kontrata nr.2440 Prot. me 19.09.2022 për **374 krerë dhen + 135 krerë dhi, gjithsej 509 krerë të imta**, në një kohë që në kërkesën e datës 20.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **450 krerë dhen + 150 krerë dhi, gjithsej 600 krerë të imta**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **555 krerë të imta. Pra**, rezulton se, kontrata është lidhur **me pak se sa numri i përcaktuar në Çertifikatën veterinare për 46 krerë të imta në vlerën 13.800 lekë (46 krerë të imta x 300 lekë/krerë)**, kërkuar për zhdëmtim.

67. Me Z. A është lidhur kontrata nr.2436 Prot. me 19.09.2022 për **310 krerë dhen + 5 krerë të trasha**, në një kohë që në kërkesën e datës 21.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **288 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **288 krerë dhen** dhe sipas vërtetimit të matrikullimit ka **303 krerë dhen**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 22 krerë të imta + 5 krerë të trasha, në krahasim me numrin e përcaktuar në çertifikatën veterinare, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.**

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i Bashkisë Sarandë, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²)**, kërkuar për zhdëmtim.

68. Me H. B është lidhur kontrata nr.2435 Prot. me 19.09.2022 për **348 krerë dhen + 80 krerë dhi + 5 krerë të trasha**, në një kohë që në kërkesën e datës 21.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **600 krerë dhen**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **300 krerë dhen** dhe sipas vërtetimit të matrikullimit ka **530 krerë dhen**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, kontrata është lidhur me pak në vlerën 15.600 lekë (46 krerë të imta x 300 lekë/krerë - 143.400 lekë kontrata)**, kërkuar për zhdëmtim.

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i fshatit Golem Gjirokastër, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²)**, kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej **20.600 lekë**.

69. Me Y. Z është lidhur kontrata nr.2429 Prot. me 16.09.2022 për **178 krerë dhen**, në një kohë që sipas kërkesës së datës 06.09.2022 është kërkuar sipërfaqe për **50 krerë lope**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **50 krerë lope**, pra kontrata është lidhur **me pak se nr. i përcaktuar në certifikatën veterinare në vlerën 96.600 lekë ((50 krerë lope x 3000 lekë/krerë) - (178 krerë të imta x 300 lekë/krerë)), kërkuar për zhdëmtim.**

70. Me B. R është lidhur kontrata nr.2423 Prot. me 15.09.2022 për **138 krerë dhi**, në një kohë që në kërkesën e datës 21.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **150 krerë dhi**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **150 krerë të imta. Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se sa numri i përcaktuar në Certifikatën veterinare për 12 krerë të imta në vlerën 3.600 lekë (12 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i fshatit Golem Gjirokastër, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej 8.600 lekë.**

71. Me A. SH është lidhur kontrata nr.2337 Prot. me 08.09.2022 për **144 krerë dhen + 1 krerë të trasha**, në një kohë që në kërkesën e datës 15.08.2022, është kërkuar sipërfaqe për **250 krerë dhi**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **100 krerë dhi** dhe sipas vërtetimit të matrikullimit ka **400 krerë**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, kontrata është lidhur me pak se numri i përcaktuar në vërtetimin e matrikullimit për 256 krerë të imta në vlerën 76.800 lekë (256 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i NJA Fshat Memaliaj, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej 81.800 lekë.**

72. Me SH. K është lidhur kontrata nr.2333 Prot. me 08.09.2022 për **131 krerë dhi**, në një kohë që në kërkesën e datës s'ka, është kërkuar sipërfaqe për **250 krerë dhen**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **250 krerë dhen** dhe sipas vërtetimit të matrikullimit ka **120 krerë**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. Pra, **rezulton se, kontrata është lidhur me pak se numri i përcaktuar në certifikatën veterinare për 119 krerë të imta në vlerën 35.700 lekë (119 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

Gjithashtu, për te, nuk është llogaritur vlera për qendër stani dhe ngrehine, pasi sipas vërtetimit të vendbanimit, subjekti është banor i NJA Fshat Memaliaj, që kap vlerën **5.000 lekë ((50m² + 50 m²) x 50 lekë/m²), kërkuar për zhdëmtim. Gjithsej 40.700 lekë.**

73. Me SH. K është lidhur kontrata nr. s'ka Prot. datë s'ka për **160 krerë dhen**, në një kohë që në kërkesën e datës s'ka, është kërkuar sipërfaqe për **160 krerë dhen**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **200 krerë dhen + 3 krerë njëhundrahe**. Pra, ka mospërputhje të këtyre vërtetimeve. **Pra, rezulton se, kontrata është lidhur me pak se numri i përcaktuar në certifikatën veterinare për 40 krerë të imta në vlerën 12.000 lekë (40 krerë të imta x 300 lekë/krerë), kërkuar për zhdëmtim.**

74. Me DH. N është lidhur kontrata nr.2392 Prot. me 19.09.2022 për **286 krerë dhen**, në një kohë që në kërkesën e datës 15.07.2022, është kërkuar sipërfaqe për **160 krerë dhen + 20 krerë dhi**, ndërsa, sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **108 krerë dhen**. Pra, **rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 178 krerë të imta, në krahasim me numrin e përcaktuar në certifikatën veterinare, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.**

75. Me V. G është lidhur kontrata nr.2064 Prot. me 30.08.2022 për **200 krerë dhen**, në një kohë që në kërkesën e datës 07.08.2022, është kërkuar sipërfaqe për **100 krerë dhi**, po kështu, edhe sipas certifikatës veterinare, ky subjekt ka **100 krerë dhi**. Pra, rezulton se, është dhënë me tepër sipërfaqe kullosore, për 100 krerë të imta, në krahasim me numrin e përcaktuar në certifikatën veterinare, veprim, që tregon për shpërdorim të fondit kullosor.

Gjithsej, vlera e arkëtuar me pak dhe e kërkuar për zhdëmtim, për kullotat dimërore 2022 - 2023 është 2.950.000 lekë. Në total, vlera e arkëtuar me pak dhe e kërkuar për zhdëmtim, për kullotat verore 2022 dhe kullotat dimërore 2022 - 2023 është në shumën **3,548,500 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Finiq.**

Kriteri: Ligji nr. 9385, datë 04/05/2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19/03/2007, “Për Fondin Kullor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10/10/2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08/06/2016, VKM nr. 1374, datë 10/10/2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08/06/2016 dhe VKM nr. 391, datë 21/06/2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22/12/2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Finiq në vlerën 3,548,500 lekë.

Shkaku: Mos respektimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës së detyrimit prej **3,548,500 lekë** nga subjektet përkatës sipas trajtimit analitik të bërë në kapitullin e auditimit të kontratave të lidhura për dhënien me qira të sipërfaqeve kullorore.

- *Auditim mbi dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara*

Titulli i gjetjes 6: Të ardhura të munguara nga dhënia me qira e toka bujqësore të pandara.
--

Situata:

Për periudhën e audituar 01/01/2022 – 31/12/2022 nga kjo bashki nuk është lidhur asnjë kontratë për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave të qirasë të lidhura nga ish komunat, sot NJA të kësaj bashkie, rezultoi se, janë lidhur nga ish komuna Mesopotam, **gjithsej 208 kontrata** me një sipërfaqe totale prej **271,3 ha**, nga të cilat **195 kontrata me afat 99 vjet** dhe **13 kontrata me afat 35 vjet**. Nga kontratat e lidhura, **36 kontrata janë lidhur në vitin 2011 ndërsa 172 kontrata janë lidhur në vitin 2013.**

Nga këto, me Vendime të Këshillit të Bashkisë Finiq janë zgjidhur **20 kontrata për mosrespektim të kushteve të kontratës**, e konkretisht, **12 kontrata me afat 99 vjet** me VKB nr. 46, datë 26.08.2020, konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Vlore me shkresën nr.895/1, datë 14.09.2020, **6 kontrata** me VKB nr. 54, datë 24.12. 2021 dhe **2 kontrata** me VKB nr. 55, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Vlore me shkresën nr.2/1, datë 17.01.2022.

Nga **20 kontratat** e zgjidhura me VKB nr. 46, datë 26.08.2020, kontrata e lidhur me subjektin V. R., nuk është zgjidhur pasi ishte bërë gabim miratuar me VKB nr.52, datë 29.12.2022. Pra, janë zgjidhur gjithsej **19 kontrata.**

Gjithashtu, janë lidhur nga ish komuna Finiq, gjithsej **16 kontrata** për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara me një sipërfaqe totale prej **9,153 ha**, nga të cilat, **5 kontrata me afat 99 vjet**, **5 kontrata me afat 35 vjet** dhe **6 kontrata me afat 10 vjet. Këto të fundit e kanë afatin deri me 25.11.2023.**

Te gjitha kontratat e lidhura nuk janë notoriale si dhe nuk janë regjistruar në ZRPP vendore, në kundërshtim me nenin 2, pika "dh" të "Kontratës tip për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë", miratuar me Urdhrin Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe

Mbrojtjes se Konsumatorit Nr.13, datë 15.1.2013 "Për miratimin e përmbajtjes se "kontratës tip" për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara".

Nga **208 kontratat** e lidhura me ish komunën Mesopotam janë zbatuar planet e biznesit për mbjellje me ullishte apo dru frutore **115 kontrata** dhe nuk janë zbatuar **93 kontrata**, ndërsa, nga **16 kontratat** e lidhura nga ish komuna Finiq janë zbatuar **7 kontrata** dhe nuk janë zbatuar **9 kontrata**.

Nga verifikimi i kryer, rezultoi se, nga **189 subjekte të ish komunës Mesopotam**, rezultojnë debitorë për vitin 2022, **9 subjekte**, për shumën totale **75.158 lekë, ku, 68.016 lekë është detyrimi vjetor dhe 7.142 lekë është kamatëvonesa.**

Ndërsa, persa i përket debitorëve të krijuar në vite, deri në fund të vitit 2022, **rezultojnë debitorë 25 subjekte për shumën totale 4.558.478 lekë, ku, 1.392.673 lekë janë detyrimet dhe 3.165.805 lekë janë kamatvonesa. Po kështu, figurojnë debitorë për mospagimin e kamat vonesës në vite, 136 subjekte për shumën totale 10.605.571 lekë. Gjithsej, shuma totale e detyrimeve të paarkëtuara deri në fund të vitit 2022 është 15.164.049 lekë, nga e cila, 1.392.673 lekë janë detyrime dhe 13.771.376 lekë janë kamatëvonesa.**

Nga **16 subjekte të ish komunës Finiq**, rezultojnë debitorë për vitin 2022, **9 subjekte**, për shumën totale **50,388.16 lekë, ku 37,324 lekë është detyrimi vjetor dhe 13,064 lekë është kamatëvonesa.**

Ndërsa, persa i përket debitorëve të krijuar në vite, deri në fund të vitit 2022, rezultojnë debitorë 14 subjekte për shumën totale **1,742,093 lekë, ku 377,476.57 lekë janë detyrimet dhe 1,364,616.65 lekë janë kamatëvonesa.** Theksojmë se, ndjekja e arkëtimit të detyrimeve bëhet nga Drejtoria e Tatim Taksave të Bashkisë.

Gjithsej, detyrimi i paarkëtuar se bashku me kamat vonesën për të gjitha kontratat është në shumën **16,906,142 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Finiq.**

Nga ana e Drejtorisë se Administrimit dhe Mbrojtjes se tokës nuk janë kryer kontrole periodike nëse janë përmbushur kushtet e kontratës se qirasë brenda afateve kohore me proces verbale të rregullta, nuk janë hartuar dhe dërguar njoftim detyrimet për pagesën e detyrimit të qerasesi dhe nuk janë zgjidhur kontratat për **74 subjekte** që nuk kanë përmbushur kushtet e kontratës.

Nga ana e Bashkisë nuk është bërë përditësimi, inventarizimi dhe regjistrimi i tokave bujqësore të pandara në pronësi në ASHK, në kundërshtim me kreun IV "Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme, publike, shtetërore" të Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

Kriteri:

Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014, datë 24/04/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", Ligji nr. 7501, datë 19/07/1991, "Për tokën" i ndryshuar, Ligji nr. 8312, datë 26/03/1998, "Për tokat bujqësore të pandara", VKM nr. 531, datë 21/08/1998, "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30/03/2001, VKM nr. 373, datë 20/06/2018, "Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", VKM nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", pikat 1-3, pika 7, dhe UKM nr. 1, datë 18.07.2012, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara".

Ndikimi/Efekt: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Finiq në vlerën 172,195 lekë. Parregullsi në procesin e dhënies së ndërtesave me qira.

Shkaku: Mos respektimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumë debitore prej **16,906,142 lekë** nga **41 subjektet** që rezultojnë debitore nga mospagimi i detyrimit të marrjes me qira të tokës bujqësore të pandare.

Auditim mbi administrimin e ujitjes dhe kullimit

Auditimi mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit, u realizua në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga M.B.ZH.R dhe Administratës së Ujrave të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”, Nenit 74 të Rregullores së brendshme, ku përcaktohen “Struktura dhe detyrat funksionale, për Drejtorinë e administrimit të ujrave, të pyjeve, të livadheve dhe të kullotave”, si dhe paketës fiskale të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë dhe miratuar nga Institucioni i Prefektit.

Titulli i Gjetjes 7: *Mos marrje masash dhe mos arkëtim i të ardhurave nga ujitja e tokave bujqësore.*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e ujitjes dhe kullimit, pranë sektorit të ujitjes dhe kullimit të Bashkisë Finiq, u konstatua se:

Për periudhën e auditimit 01/01/2022 deri me 31/12/2022, nga ana e Bashkisë Finiq, është miratuar paketa fiskale, me Vendim të Këshillit të Bashkisë me nr. 48 datë 15.12.2021 “për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Finiq”, miratuar në Prefekturën Vlore, me shkresën nr.983/1 prot, datë 28.12.2021.

Ne këtë paketë fiskale në paragrafin “**Tarifat që do të përdoren për ujitjen e tokave bujqësore**”, janë miratuar tarifat për ujitjen e tokave bujqësore, sipas kërkesave të ligjit nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “**Për administrimin e ujitjes dhe kullimit**”, nenit 19 “**Miratimi i tarifave**” përkatësisht:

- a. Tarifë për ujitjen e tokave me rrjedhje të lirë, të jetë në vlerën **2.000 lekë/ha/sezon.**
- b. Tarifë për ujitjen e tokave me ngritje mekanike (fshataret përdorin pompa për të realizuar marrjen e ujit), të jetë në vlerën **1.000 lekë/ha/sezon.**
- c. **për pike lidhje në ujësjellësit e rezervuarëve, poshtë saraçineskës së ujësjellësit, do të këtë tarifë 1.500 lekë.**
- ç. Gjatë procesit të ujitjes për çdo fshat do të bëhet konvertimi i tarifës në vartësi të sipërfaqes së mbjelle dhe mënyrës së ujitjes sipas paketës fiskale.

Për administrimin e këtyre tarifave, janë ngarkuar Drejtoria e Bujqësisë, Sektori i menaxhimit të ujrave, si dhe Drejtoria e të ardhurave dhe pronave publike.

Nga vlerësimi i grupit të auditimit, në lidhje me mbështetjen ligjore në përcaktimin e tarifave që po përdoren për ujitjen e tokave bujqësore, përcaktuara në paketën fiskale, për vitin 2022, është konstatuar se:

- në **paketën fiskale nuk ka një përcaktim të tarifës sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, nenit 18 “Tarifat e shërbimit të ujitjes”** pika 2 ku trajton se “**Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve ose vëllimit të ujit të përdorur për çdo ujitje apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohë**”.

- **Nga ana e Bashkisë Finiq nuk është përcaktuar në paketën fiskale, asnjë lloj tarifë për mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit**, kjo në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “**Për administrimin e ujitjes dhe kullimit**”, nenit 17 “**Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës**” ku përcaktohet qarte se : “**Bashkia mbledh tarifë vjetore të mirëmbajtjes për çdo sipërfaqe toke, brenda zonës së saj të ujitjes, kjo brenda datës 31Janarit të çdo viti. për këtë detyrim njoftohet me shkrim zotëruesi i tokës,**

ku në këtë tarifë përfshihen shpenzimet e mirëmbajtjes të sistemit të ujitjes, si dhe koston e pastrimit të kanaleve kulluese”.

Nga vlerësimi i aseteve të transferuara nga Bordi i kullimit Finiq, për Bashkinë Finiq, është konstatuar se:

Nga ana e Bordit të Kullimit Finiq, në zbatim të kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga M.B.Z.H.R dhe Administratës së Ujrave të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”, është bërë transferimi i Infrastrukturës ujitëse dhe kullues për në Bashkitë duke i shoqëruar me tabelat përkatëse. Për Bashkinë Finiq, është mbajtur proces verbali i datës 24.03.2016, nga përfaqësuesit e Bordit Rajonal të Kullimit Finiq, me përfaqësuesit të Bashkisë Finiq, në prezencë të përfaqësuesit të Prefekturës Vlore z. V. H, në rolin e supervisorit, mbi transferimin e Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit si dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, nga Bordi i Kullimit Finiq për Bashkinë Finiq, rezulton se Bashkisë Finiq i janë transferuar përkatësisht:

Skema ujitëse Bashkia Finiq (Total aftësi ujitëse) 9.550 ha.

- Aftësi ujitëse me kanale (rrjedhje e lirë) gjithsej 6.308 ha.
- Aftësi ujitëse me rezervuare (rrjedhje e lirë) gjithsej 2.346 ha.
- Aftësi ujitëse me stacione pompimi gjithsej 896 ha.
- Disponohen 8 rezervuare me aftësi vaditëse prej 581 ha

Skemat kulluese Bashkia Finiq (Total aftësi kulluese) 4.627 ha.

Me proces verbalin e datës 08/06/2016, është marre në dorëzim nga Bashkia Finiq ***mjeti i llojit Eskavator model BENATI të Tipit 316.***

Me proces verbalin e datës 06.04.2017, është marre në dorëzim nga Bashkia Finiq ***mjeti i llojit Eskavator model VOLVO të Tipit EC220D.***

Nga vlerësimi i kryer pranë Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, mbi funksionimin e sistemit në drejtim të “*planifikimit të nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit*” kjo në zbatim të kërkesave të ligjit nr.24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” kreu IV, neni 15 “Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive” është konstatuar se:

1. Nuk disponohej plani i masave për vënien në gatishmëri të veprave ujitëse dhe kulluese.

2. Nuk ekzistonte programi i ujitjes apo dhe kullimit, ku të ishin pasqyruar qarte:

- Evidentimi i kulturave bujqësore të mbjella dhe sipërfaqet përkatëse, për çdo fermer.
- Përcaktimi i nevojave për ujë për ujitje për çdo fermer.
- Hartimi i grafikut paraprak të ujitjes.
- Evidentimi i gjendjes fizike të skemave ujitëse, për dërgimin e ujit në parcela.
- Evidentimi i gjendjes fizike të kanaleve ujitës dhe kullues.

3. Nuk është realizuar “Monitorimi” i shpërndarjes së ujit për ujitje, e konkretisht:

- Monitorimi i shpërndarjes së ujit për fermerët mbi bazën e sipërfaqes.
- Monitorimi i evidencës numrin e ujitjeve, sasinë e ujit, sipërfaqen e ujitur, për çdo fermer.
- Monitorimi i realizimit të punimeve në kullim.

Referuar Informacionit të Drejtorisë së Ujitjes e Kullimit, pa datë, trajtohet se detyrimi i paraqitur pranë Drejtorisë së të ardhurave të Bashkisë është bërë në bazë fshati, pa përcaktuar kriteret bazë që janë kërkesat e ligjit nr. 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” kreu IV, neni 15 “Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive” neni 16 “Burimet e të ardhurave” pasi *nuk janë përcaktuar dhe ndjekur tarifën për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes apo kullimit, si dhe nuk ka tarifë të qarte në shërbim sipas kërkesave të nenit 18 “Tarifa e shërbimit të ujitjes”.*

Sipas tabelës së vënë në dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes e Kullimit të Bashkisë, kjo mbi “*Te dhënat për sipërfaqen e tokës së mbjelle dhe tarifën e ujitjes në lekë/ha sipas fshatrave*”, rezulton se:

- Sipërfaqja e tokës së mbjelle gjithsej, sipas Nj.A dhe sipas fshatrave është për ***5.565,3 ha.***

- Sipërfaqja e tokës se ujitur gjithsej, sipas Nj.A dhe sipas fshatrave është për **1.074,5 ha**.

Nga kjo:

- Ujitur me rrjedhje të lirë, është **703,5 ha**

- Ujitur me ngritje mekanike, është **371 ha**

Bazuar në tarifata e përcaktuara në paketën fiskale për vitin 2022, janë planifikuar si detyrim **1.778.000 lekë**, e cila përbëhet:

-Nga sipërfaqja e planifikuar për vaditje me rrjedhje të lirë 703,5 ha x 2.000 lekë/ha = **1.407.000 lekë**.

-Nga sipërfaqja e planifikuar për vaditje me ngritje mekanike 371 ha x 1.000 lekë/ha = **371.000 lekë**.

Nga vlerësimi pranë Drejtorisë se taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë, rezulton se për vitin 2022, detyrimi i llogaritur është për **3.335 familje** në vlerën prej **1.764.270 lekë**.

Nga ky detyrim është arkëtuar gjatë vitit 2022 nga **1.372 familje** në vlerën **712.164 lekë**, ku ngelet pa arkëtuar nga detyrimi i vitit 2022 nga **1.963 familje** në vlerën **1.052.106 lekë**.

Llogaritur detyrimin që është i mbartur (debi) për periudhën 2017 deri në fund të vitit 2021 (kjo sipas të dhënave të Drejtorisë se taksave dhe tarifave të Bashkisë) me datën 01/01/2022 figuron për **3.454 familje** në vlerën **3.061.081 lekë**.

Gjatë vitit 2022 nga ky detyrim i prapambetur është arkëtuar detyrim nga **382 familje** në vlerën **647.744 lekë**, dhe ngelet në fund të vitit 2022 një detyrim i pa arkëtuar i mbartur deri në fund të vitit 2021 për **3.072 familje** në vlerën prej **2.413.337 lekë**.

Pra detyrimi total i pa arkëtuar nga furnizimi me ujë për vaditje (sipas statistikave të Bashkisë) deri në fund të vitit 2022 është për vlerën 3,465,443 lekë. (2.413.337 debi e mbartur + 1.052.106 lekë debi e krijuar në fund të 2022 = 3,465,443 lekë).

Nga grupi i auditimit është konstatuar se:

- Nuk disponohet asnjë proces verbal i rregullt monitorimi i sipërfaqes që figuron në ujë, ku sipas proces verbalit të Bordit, sipërfaqja e transferuar është **9.550 ha**, sipas evidencave të Drejtorisë së Bujqësisë (Sektori i Ujitjes dhe Kullimit) **figuron sipërfaqe e mbjelle në ujë 5.565.3 ha**, pa përcaktuar se me çfarë kultura është mbjelle, ku në fakt në statistikave të këtij sektori janë trajtuar se nga sipërfaqja e mbjelle janë vaditur vetëm **1.074,5 ha**, ku dhe për këtë nuk ka asnjë proces verbal monitorimi.

Pra kemi një sipërfaqe prej **4.491 ha**, nga sipërfaqja e mbjelle për të cilën nuk trajtohet asnjë lloj detyrimi vaditjeje. (sip. e mbjelle 5.565,5 ha - sip. e vaditur 1.074,5 ha = 4.491 ha)

- Nuk disponohet asnjë akt marrëveshje mes fermerëve apo dhe fshatareve me Bashkinë, mbi kërkesën që kanë për vaditje në reference të kulturave që disponojnë. Mbi bazën e se cilës do të bej dhe llogaritja e shpërndarjes së ujit sipas nevojave apo dhe llogaritja e detyrimit për shërbimin që do ju kryej.

- Evidenca e të dhënave mbi bazën e llogaritjes së detyrimit, nga ana e Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, është përcaktuar në sipërfaqe të mbjelle, sipërfaqen e vaditur sipas llojit të vaditjes (me rrjedhje të lirë apo me ngritje mekanike) referuar tarifave të paketës fiskale, por në Drejtorinë e taksave në regjistrin e detyrimeve figuronin në bazë familjesh, ku për vitin 2022 figuronin se është vaditur nga çdo familje vetëm 0.26 ha ose 317 lekë/ha.

Për këtë nuk disponohet asnjë e dhënë e pasqyruar me akt konvertimi i tarifës në vartësi të sipërfaqes së mbjelle dhe mënyrës së ujitjes sipas pikës “ç” të paketës fiskale.

- Nuk disponohet asnjë lloj monitorimi që të përcaktoje detyrimin sipas kërkesave të paketës fiskale për

“ pike lidhje në ujësjellësit e rezervuarëve, poshtë saraçineskës së ujësjellësit”, që ka tarifën **1.500 lekë**.

- Nuk na është vënë në dispozicion asnjë lloj njoftimi dërguar për detyrimet e mbartura apo dhe për detyrimin e vitit ushtrimor në fermerë apo familje debitorësh, në një moment që ky detyrim në fund të vitit 2022, vetëm për sipërfaqen që pretendohet se është vaditur është në vlerën **3,465,443 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për **Bashkinë Finiq**.

Mungesa e një evidentimi të plote dhe të saktë, të të dhënave për sipërfaqen e tokës që mbyllet sipas llojit të kulturave për çdo fermer, hartimin e planit të masave për krijimin e gatishmërisë së sistemit të ujitjes dhe kullimit, për përballimin e nevojave si dhe planifikimi i realizimit të të ardhurave për shërbimin që kryejnë, tregojnë për një performancë të dobët nga ana e kësaj njësie shërbimi.

Kriteri:

Ligji nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, Ligjit nr. 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” kreu IV, neni 15 “Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive” neni 16 “Burimet e të ardhurave” pasi nuk janë përcaktuar dhe ndjekur tarifatat për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes apo kullimit, si dhe nuk ka tarifë të qarte në shërbim sipas kërkesave të nenit 18 “Tarifa e shërbimit të ujitjes”, nenit 17 “*Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës*”, nenit 18 “*Tarifat e shërbimit të ujitjes*” pika 2 .

Ndikimi/Efekt: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Finiq në vlerën 3,465,443 lekë.

Shkaku: Mos respektimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Njësisë së Ujitjes dhe Kullimit pranë Bashkisë Finiq te bëjë monitorimin e të gjithë sipërfaqes së mbjelle për cdo kulture, te monitorojë kërkesat për vaditje dhe te vlerësojë detyrimin sipas kërkesave të ligjit nr. 24/2017, date 09.03.2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.

- Drejtoria e Taksave në bashkëpunim me Njësinë e Ujitjes dhe Kullimit, të marrin masa të menjëhershme për njoftimin e të gjithë fermerëve mbi detyrimet që kanë pa likuaduar për arkëtimin e detyrimeve të mbartura dhe të pa arkëtuara deri në fund të vitit 2022, për vlerën **3,465,443 lekë**.

Pika 2.3 e programit. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022.

- *Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.*
- *Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.*
- *Opinionin mbi pasqyrat financiare.*

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:**

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22/11/2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

- **Hartimi i pasqyrave financiare:**

Për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes,

paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr.2.Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Finiq për vitin 2022 janë të nënshkruara nga z. K. K Kryetar i Bashkisë Finiq në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. L. M me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Financës (hartuesi i llogarive vjetore) në cilësinë e nëpunësit zbatues të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Delvinë me shkresën nr. 716 prot., datë 28.03.2023, brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar më datë 31.03.2023.

- Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferencë. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj,.. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhërpagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj,.. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj..

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- *Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:*

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e **Pasqyrave Financiare të Bashkisë Finiq** për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën 01/01/2022, deri më datën 31/12/2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Delvinë për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në Cash viti 2022.

- *Procesi i inventarizimit:*

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të

detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Për vitin 2022, Kryetari i Bashkisë Finiq ka nxjerr Urdhrin nr. 5, datë 17.11.2022, me objekt “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të vetë institucionit dhe Njësive Administrative Aliko, Mesopotam, Livadhja dhe Dhiver”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, procesi i inventarizimit është kryer dy herë radhazi nga i njëjti komision i cili ka ushtruar këtë funksion edhe në vitin 2021, në zbatim të Urdhrit nr. 221, datë 18.11.2020, të Kryetarit të Bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 84.

Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t’i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit por nga komisioni i inventarizimit është mbajtur përmbledhësja/procesverbali dhe lista e aktiveve të cilat janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” (pjesërisht për ish-Komunën Mesopotam dhe Finiq për analizën përpara vitit 2015, aktive të transferuara) dhe llogarinë 212 “Ndërtime dhe konstruksione” (pjesërisht për ish-Komunën Livadhja dhe Finiq për analizën përpara vitit 2015, aktive të transferuara). Kjo problematikë është trajtuar në mënyrë të hollësishme në vijim të materialit konkretisht në analizën e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” dhe llogarisë 212 “Ndërtime dhe konstruksione”.

1. Titulli i gjetjes: *Në pasqyrat financiarë janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën 4,309,706 lekë ndërkohë që ende nuk ka një vendimmarrje nga strukturat drejtuese të institucionit për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit.*

Situata:

Me Urdhrin nr. 172, datë 30.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për t’u nxjerrë jashtë përdorimit nga komisioni i inventarizimit. Nga komisioni i vlerësimit është mbajtur procesverbali i datës 31.01.2023, ku janë propozuar për të nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën totale 4,309,706 lekë. Gjithashtu me Urdhrin nr. 173, datë 30.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Deri më datën 26.05.2023, në të cilën përfundon faza e auditimit në terren nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit aktivet në vlerën 4,309,706 lekë, por ky proces ka mbetur në fazën për miratim nga Këshilli Bashkiak.

Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve Afatgjata (kosto historike)” konstatohet se, vlera 4,309,706 lekë është pasqyruar si nxjerrje jashtë përdorimit në referencën e llogarisë 21-28, “II. Totali i Aktiveve Afatgjata Materiale” llogaria 218 “Inventar ekonomik” ndërkohë që këto aktive nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit.

Kriteri:

Standardi Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata jo Materiale” i përmirësuar, “Çregjistrimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale”, pika 73 dhe pika 74,

Ndikimi/Efekt: Mos pasqyrim i saktë i llogarisë 218 “Inventar ekonomik”.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Nga Drejtoria e Financës të merren masa të menjëhershme për sistemimin dhe kontabizlimin e vlerës 4,309,706 lekë në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” e cila ka të bëjë me parregullsinë e nxjerrjes jashtë kontabilitetit të aktiveve të cilat ende nuk kanë marrë miratimin përkatës nga strukturat drejtuese të institucionit për asgjësimin e tyre.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2022, të pozicionit financiar të Bashkisë Finiq (pasqyrat financiare të konsoliduara), Formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Lekë	
Aktiviteti Neto janë të barabarta me Aktiviteti - Pasiviteti = Aktiviteti Neto	2,469,347,334
Aktiviteti	2,839,251,967
Pasiviteti	369,904,633
Aktiviteti Neto	2,469,347,334

Lekë	
Aktiviteti Afatshkurtra më datë 31/12/2022 paraqiten në vlerën	
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	109,204,301
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	17,314,771
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	295,419,765

A. AKTIVET

I. Aktiviteti Afat Shkurtra

1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31/12/2022	31/12/2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	109,204,301	129,042,931	(19,838,630)
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		109,204,301	129,042,931	(19,838,630)

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 109,204,301 lekë përbëhet nga gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 34,719,433 lekë (fondi i trashëguar përbëhet nga: 3,713,636 lekë të ardhurat e veta + 6,094,335 lekë transferta e pakushtëzuar + 24,911,462 lekë transferta specifike) dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 74,484,868 lekë. Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31/12/2022	31/12/2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
31	Materiale	4,927,580	4,177,570	750,010
32	Inventar i imët	12,387,191	20,740,885	(8,353,694)
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0

37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		17,314,771	24,918,455	7,603,684

2. Titulli i gjetjes: Mos kuadrim i diferencës së lëvizjes së inventarit.

Situata:

Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31/12/2022, paraqitet në vlerën 17,314,771 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 4,927,580 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 12,387,192 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 7,603,684 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë. Kjo situatë ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të vlerës 7,603,684 lekë në llogarinë 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve”.

Kriteri:

Udhëzimi nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, nënpika 19.

Ndikimi/Efekti: Mos kuadrim i llogarive.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Nga Drejtoria e Financës të analizohet vlera 7,603,684 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar së diferencës të ndryshimit të gjendjes së inventarit, sistemi të kryhet sipas trajtimit kontabël kalimin e vlerës nga llogaria 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

-**Llogaria 312 “Materiale”,** ka vlerën 4,927,580 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë	
Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2022	4,177,570
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022	6,626,381
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	5,876,371
Gjendja në 31/12/2022	4,927,580

-**Llogaria 327 “Inventarë i imët”,** ka vlerën 12,387,191 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë	
Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2022	20,740,885
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022	2,029,000
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	10,382,694
Gjendja në 31/12/2022	12,387,191

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31/12/2022	31/12/2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0

435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë të ndryshëm	235,532,290	210,123,062	25,409,228
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	59,887,475	64,052,274	-4,164,799
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Totali		295,419,765	274,175,336	21,244,429
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënies me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0
Totali		0	0	0

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datën 01/01/2022, në vlerën 210,123,062 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31/12/2022, paraqitet në vlerën 235,532,290 lekë me një rritje në vlerën 5,409,228 lekë. Në mënyrë analitike të dhënat paraqiten si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2022	210,123,062
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	24,173
Gjendja debitore në 31/12/2022	235,532,290

Vlera e mësipërme e pasqyruar në bilanc prej 235,323,149 lekë përbëhet nga:

Lekë				
Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01/01/2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31/12/2022
K. E	1,176,000			1,176,000
Z. L	53,057			53,057
TH. TH	50,207		24,173	26,034
G. K	11,787			11,787
K. P	11,550			11,550
LL. B	13,800			13,800
N. A	12,600			12,600
D. A	13,568			13,568
L. R	59,696			59,696
2... Shpk	436,837			436,837
J... Shpk	446,465			446,465
A... SHPK	419,448			419,448
2... Shpk	635,259			635,259
G... Shpk	706,106			706,106
T... Shpk	70,111			70,111
K... Shpk	247,676			247,676
K... Shpk	1,503,707			1,503,707
K... Shpk	2,819,588			2,819,588
K... Shpk	873,598			873,598
D... Shpk	3,384,066			3,384,066
D... Shpk	3,649,012			3,649,012
V... Shpk	181,355			181,355
V... Shpk	349,680			349,680
SH... SHPK	1,250,971			1,250,971
SH...C.	437,089			437,089
A... shpk	315,187			315,187
A... shpk	809,676			809,676
E...	178,640			178,640
K...	1,392,866			1,392,866
E...	617,520			617,520
Totali	22,134,691			22,319,659
Debitorët per taksa tarifa	187,988,371			213,212,631
Grand Totali	210,123,062		24,173	235,532,290

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Nga të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave dhe Pronave Publike të cilat janë paraqitur pranë Drejtorisë së Financës ka pasqyruar vlerën e detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore si më poshtë:

Lekë

Njësitë Administrative	Detyrimet më 31/12/2021	Faturuar në vitin 2022	Vlera e detyrimeve më 31/12/2022	Arkëtuar gjithsej në vitin 2022	Mbetja e detyrimeve më 31/12/2022	Arkëtuar në vitin 2022 për të prapambeturat
Finiq	54,919,467	19,499,145	74,418,612	13,805,591	60,613,021	3,732,636
Livadhja	50,042,854	15,723,832	65,766,686	11,081,153	54,685,533	1,186,382
Aliko	31,978,094	18,037,877	50,015,971	7,236,724	42,779,247	3,517,027
Dhiver	19,275,542	8,186,535	27,462,077	5,825,827	21,636,250	3,654,344
Mesopotam	31,772,414	15,427,552	47,199,966	13,701,386	33,498,580	3,455,597
Totali	187,988,371	76,874,941	264,863,312	51,650,681	213,212,631	15,545,986

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 59,887,475 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 59,887,475 lekë, si dhe përbëhet nga:

Lekë

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”	
Çelje e vitit 2022	64,052,274
Shtesa (K)	281,749,538
Pakësime (D)	285,914,341
Gjendja debitore në 31/12/2022	59,887,475

Lekë

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	6,662,374
Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	41,559,983
Paga personeli llogaria 42	9,475,106
Tatimi mbi të ardhurat llogaria 431	487,159
Sigurime shoqërore llogaria 435	1,528,107
Sigurime shëndetësore 436	174,746
Totali	59,887,475

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 0 lekë kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.1.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 17,924,027 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 491,400 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 27,242,667 lekë ndërsa më datë 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,934,420 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	40,685,687
	2	Amortizim i akumuluar	22,761,660
	3	Gjendja në 01/01/2022	17,924,027
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	491,400

	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	4	Kosto historike	41,177,087
	5	Amortizim i akumuluar	27,242,667
	6	Gjendja më datë 31/12/2022	13,934,420

Lekë

Nr.	Studime-Projektme (kosto historike)	Gjendja 01/01/2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31/12/2022
	Objekte inventari				
1	Projektim rikonstrukcion rruga Dermish-Cerkovice (viti 2017)	941,623			
2	Projekti ujësjellësi Vagalat	3,260,783			
3	Projekti linja e jashtme ujësjellësi Finiq (viti 2019)	10,619,300			
4	Projekti rehabilitimi i kanalit Filipeu	2,427,401			
5	Projekti ndërtimi i ministadiumit te qendrës Finiq	1,527,210			
6	Projekti i rehabilitimit te rrugës Muzine-Dhrovjan	2,054,105			
7	Projekti KK3 Mesopotam Finiq(inv.ish komuna Finiq)	373,000			
8	Projekti Kk3 SMT-Finiq(inv.ish komuna Finiq)	391,000			
9	Projekti KK3 Finiq-Karahaxh(inv.ish komuna Finiq)	382,000			
10	Projekti rrugës Blerimas-Finiq(inv.ish komuna Finiq)	600,000			
11	Projekti i ujesjellesit Finiq(inv.ish komuna Finiq)	298,000			
12	Projekti rruga hyrëse Bregas(inv.ish komuna Finiq)	342,000			
13	Ish komuna Finiq	868,106			
14	Ish komuna Livadhja	3,692,388			
15	Ish komuna Dhiver	5,015,600			
16	Ish komuna Aliko	1,714,070			
17	Ish komuna Mesopotam	1,756,500			
18	Hartim dokumentacioni per regi.fillestar ZK1013 (viti 2021)	4,422,600			
Çelje më datë 01/01/2022		40,685,687			
1	Hartim dokumentacioni per regi. Fillestar ZK1013 (viti 2021)		491,400		
Gjendja më datë 31/12/2022		40,685,687	491,400	0	41,177,087

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

3. Titulli i gjetjes: Përfshirja në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” vlera 8,030,494 lekë e paanalizuar si dhe mos sistemi i kësaj llogarie duke paraqitur në këtë llogari në mënyrë jo të drejtë edhe vlerën e projekteve prej 3,369,024 lekë, investimet e të cilave kanë përfunduar.

Situata: Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera prej 8,030,494 lekë e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve, për pasojë nuk është kryer inventarë fizik. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq, Livadhja, Dhiver dhe Mesopotam si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Finiq. Analiza e detajuar për sistemimin e llogarisë nga viti 2021 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione”				
Nr.	Emërtimi	Vlera e pa analizuar në vitin 2021	Analizuar në inventarin e vitit 2022	Pa analizuar në inventarin e vitit 2022
1	Ish-Komuna Finiq e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	868,106	0	868,106
2	Ish-Komuna e Livadhja e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	3,692,388	0	3,692,388
3	Ish-Komuna e Dhiver e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	5,015,600	3,302,100	1,713,500
4	Ish-Komuna e Aliko e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	1,714,070	1,714,070	0
5	Ish-Komuna e Mesopotam e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	1,756,500	0	1,756,500
Totali		13,046,664	5,016,170	8,030,494

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Lekë

Nr.	Ish-Komuna Dhiver	Vlera
1	Studim rruga Karallat	580,000
2	Studim çezma Dhiver	160,100
3	Studim rrugë të brendshme Dhiver	450,000
4	Studim Ujësllësi Navaricë	300,000
5	Studim Ujësllësi Dhiver	920,000
6	Studim rruga Memoraq-Dhiver	892,000
Totali		3,302,100

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Lekë		
Nr.	Ish-Komuna Aliko	Vlera
1	Punime topografike	221,260
2	Studim ndërtim Ujësjiellësi Berdenesh	107,572
3	Studim rikonstruksioni i rrugës Cuke-Kanali i Cukës	232,456
4	Studim sistem asfaltimi i rrugës Cuke-Kanal-Cukës	512,783
5	Studim projektim i rrugëve Qenurjo, Pllake, Tremul dhe Ambulanca Cuke	640,000
Totali		1,714,071

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Gjithashtu në këtë llogari është kontabilizuar edhe vlera 3,369,024 lekë kosto historike e cila i përket 2 projekteve (Projektim rikonstruksion rruga Dermish-Cerkovice (viti 2017) në vlerën 941,623 lekë + Projekti rehabilitimi i kanalit Filipeu në vlerën 2,427,401 lekë), të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë.

Kriteri:

VKM nr. 783, datë 22/11/2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime”, Udhëzimi nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.

Ndikimi/Efekti:

Aktivi i bilancit për llogarinë 202 “Studime dhe projekte” nuk pasqyron vlerën e saktë të kësaj llogarie, për rrjedhojë ulje e vlerës reale të investimeve të përfunduara dhe rritje artificialisht e vlerës së projekteve, deformim të dhënash për këto dy llogari.

Shkaku: Mos zbatimi i rregullave kontabël.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 3,369,024 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

4. Titulli i gjetjes: *Mos dokumentim i plotë në bilanc, i aktiveve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe aktiveve të llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”.*

Situata:

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 300,000 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 300,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2022	300,000
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31/12/2022	300,000

Lekë

Toka, troje Terrene (kosto historike)	Gjendja 01/01/2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31/12/2022
Objekte sipas inventarit fizik				
Toka Troje Terrene	300,000	0	0	300,000
Totali	300,000	0	0	300,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, për koston historike në vlerën 300,000 lekë Bashkia Finiq nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c”.

Gjithashtu Bashkia Finiq nuk ka marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, konkretisht në total 45 ndërtesa me sipërfaqe 140,821 m², 103 sipërfaqe tokë 19,551,687 m²/ml dhe 223 ha dhe 416 sipërfaqe truall 929,652 m²/ml si më poshtë:

Emërtimi	Ndërtesa	Sipërfaqe	Tokë	Sipërfaqe	Truall	Sipërfaqe
Bashkia Finiq	45	140,821 m ²	0		6	6,540 m ²
Njësia Administrative Aliko	0	0	65	8,652,272 m ² /ml dhe 223 ha	98	500,744 m ² /ml
Njësia Administrative Dhiver	0	0	1	1,240,000 m ² /ml	3	12,500 m ² /ml
Njësia Administrative Livadhja	0	0	14	4,870,578 m ² /ml	7	21,100 m ² /ml
Njësia Administrative Mesopotam	0	0	23	4,788,837 m ² /ml	302	388,768 m ² /ml
Totali	45	140,821 m²	103	19,551,687 m²/ml dhe 223 ha	416	929,652 m²/ml

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 01/01/2022, paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në këtë llogari nuk janë pasqyruar 21,912.62 ha sipërfaqe nga të cilat: 12,012.45 ha sipërfaqe “Kullotë” dhe 9,900.17 ha sipërfaqe “Pyje”, në zbatim të VKM nr. 134, datë 03.03.2021, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” të ndryshuar”.

Kriteri:

Udhëzimi nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c”.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare paraqesin informacion të gabuar për llogarinë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së institucionit.

Shkaku:

Mos krijim i regjistrit të aktiveve për pronat e mësipërme. Mos marrja e masave për inventarizimin e pasurisë që paraqitet në llogarinë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, mos pasqyrimin e vlerave të tyre në aktivin e pasqyrave financiare. Mos marrja e masave për regjistrimin e pasurive të kësaj llogarie në ASHK.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Bashkia Finiq të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e asetëve si pasuri e saj në ASHK.

-Llogaria 212 “Ndërtim konstruksione” më datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 241,587,032 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 14,204,559 lekë, dhe amortizim të akumuluar në vlerën 52,836,864 lekë ndërsa më datë 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 253,375,721 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

			Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	292,008,026
	2	Amortizim i akumuluar	50,420,994
	3	Gjendja në 01/01/2022	241,587,032
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	14,204,559
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	4	Kosto historike	306,212,585
	5	Amortizim i akumuluar	52,836,864
	6	Gjendja më datë 31/12/2022	253,375,721

						Lekë
Nr.	Studime-Projektme (kosto historike)		Gjendja 01/01/2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31/12/2022
	Objekte inventari					
1	Ndërtesa e Bashkisë (zyrat e ish komunës)		5,437,043			
2	Ish-çerdhe fshati Bregas		152,000			
3	Qendra Shëndetësore Finiq		883,259			
4	Varreza Blerimas		386,558			
5	Varreza Çlirim		400,000			
6	Varreza Bregas		778,651			
7	Varreza Karahaxh		100,150			
8	Shkolla Finiq		3,291,680			
9	Shkolla Karahaxh		1,073,068			
10	Shkolla Blerimas (e vjetra)		1,110,733			
11	Shkolla Çlirim		1,165,924			
12	Shkolla Buronje		32,801			
13	Ndërtesa Shkolla Vrion		938,766			
14	Shkolla Bregas		5,532,679			
15	Shkolla fillore dhe kopshti Blerimas		17,056,225			
16	Ambulanca Karahaxh		622,497			
17	Kopshti Vrion		163,612			
18	Qendra Shëndetësore Finiq		697,600			
19	Të tjera sipas bilancit viti 2015 Finiqi		4,547,402			
20	Ndërtesa zyra NjA Mesopotam		6,767,088			
21	Vatra e Kulturës Krane		220,000			
22	Vatra e Kulturës Dhrovjan		6,774,913			
23	Vatra e Kulturës Ardhasove		132,000			
24	Vatra e Kulturës Livine		286,000			
25	Shkolla 9 vjeçare Mesopotam		1,956,000			
26	Shkolla fillore Mesopotam		136,000			
27	Ndërtesa e Shkollës Livine		343,000			
28	Ndërtesa e Shkollës Krane		627,000			
29	Ndërtesa e Shkollës Muzine		319,000			
30	Ndërtesa e Shkollës Pece		165,000			
31	Ndërtesa e Shkollës Ardhasove		165,000			
32	Shkolla 9 vjeçare Bistricë		407,821			
33	Shkolla Fitore		385,000			
34	Shkolla Kostar		72,000			
35	Shkolla krongj		40,000			
36	Shkolla Kardhikaq		110,000			

Nr.	Studime-Projektme (kosto historike)	Gjendja 01/01/2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31/12/2022
	Objekte inventari				
37	Shkolla Velahove	66,000			
38	Të tjera sipas bilancit viti 2015 Mesopotam	3,355,202			
39	Ndërtesa pompë uji Aliko	400,000			
40	Ish-vatra e Kulturës Aliko	150,000			
41	Zyrat e ish-Komunës Aliko	30,097,097			
42	Shkolla fillore e vjetër Aliko	1,500,000			
43	Kompleksi sportiv Aliko	5,000,000			
44	Ndërtesa Shkolla Neohor	1,557,000			
45	Ndërtesa Ambulanca Neohor	300,000			
46	Kopshti fshati Rahulle	220,000			
47	Shkolla fillore Rahulle	910,000			
48	Zyrat e Këshillit Rahulle	100,000			
49	Ndërtesa e Shkollës Halo	177,000			
50	Vatra e Kulturës Halo	1,458,000			
51	Shkolla 8 vjeçare Pllake	9,000,000			
52	Ndërtesa Shkolla Fanar	1,040,000			
53	Zyrat e Këshillit Fanar	125,000			
54	Ish-kopshti Fanar (ambulanca)	1,000,000			
55	Shkolla fillore Qenurjo	1,115,000			
56	Qendra shëndetësore Qenurjo	2,000,000			
57	Shkolla fillore Jerme	8,800,000			
58	Lapidari Jerme	250,000			
59	Ambulanca Janicat	948,778			
60	Ambulanca Malcan	815,802			
61	Shkolla fillore Dhiver	2,282,102			
62	Ambulanca Cerkovice	700,000			
63	Shkolla Navarice	687,139			
64	Ndërtesa NJA Dhiver	3,771,498			
65	Zyra e informacionit Finiq	5,055,093			
66	Reparti ushtarak Krane	191,446			
67	Rikonstr.shkolla Vrion	1,945,100			
68	Rikonstrukcion i shkollave	1,413,545			
69	Rikonstrukcion ndërtesat e bashkisë	1,556,413			
70	Teprica e ish-Komunes Livadhja	98,725,094			
71	Qendra Kulturore Livadhja	42,019,247			
Çelje më datë 01/01/2022		292,008,026			
1	Rikonstrukcion i Ambulancës Mesopotam		3,227,240		
2	Shtese 2 klasa Shkolla 9-vjeçare Mesopotam		1,668,827		
3	Rikonstrukcion i sheshit Livine		982,455		
4	Qendra Etnografime Livadhja		8,326,037		
Gjendja më datë 31/12/2022		292,008,026	14,204,559	0	306,212,585

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

5. Titulli i gjetjes: Përfshirja në llogarinë 212 “Ndërtme konstruksione” vlera 99,236,804 lekë e paanalizuar në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Situata:

Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtme konstruksione” për vlerën historike 292,008,026 lekë, është përfshirë vlera prej 99,236,804 lekë, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Analiza e detajuar për sistemimin e llogarisë nga viti 2021 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 212 “Ndërtme konstruksione”				
Nr.	Emërtimi	Vlera e pa analizuar në vitin 2021	Analizuar në inventarin e vitit 2022	Pa analizuar në inventarin e vitit 2022
1	Ish-Komuna Finiq e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	4,547,402	4,035,692	511,710
2	Ish-Komuna e Livadhja e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	98,725,094	0	98,725,94

3	Ish-Komuna e Dhiver e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	0	0	0
4	Ish-Komuna e Aliko e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	0	0	0
5	Ish-Komuna e Mesopotan e pa analizuar në inventarin e vitit 2021	3,355,202	3,355,202	0
Totali		106,627,698	7,390,894	99,236,804

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Lekë

Nr.	Ish-Komuna Finiq	Vlera
1	Ambulancat (6 fshatra)	833,054
2	Shkollat (6 fshatra)	702,668
3	Depo uji fshati Karahaxh	499,970
Totali		4,035,692

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Lekë

Nr.	Ish-Komuna Mesopotam	Vlera
1	Qendra Shëndetësore Mesopotam	138,000
2	Infermiera Kostar	73,000
3	Infermiera Krane	22,000
4	Infermiera Fitore	1,424,782
5	Infermiera Dhrovjan	33,000
6	Infermiera Krongj	135,000
7	Infermiera Bistricë	28,000
8	Infermiera Sirakat	1,424,420
9	Infermiera Velahove	77,000
Totali		3,355,202

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Kriteri:

Udhëzimi nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Ndikimi/Efekti:

Shkaku: Mos zbatimi i rregullave kontabël.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” më datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 1,762,993,935 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 354,838,673 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 115,462,800 lekë ndërsa më datë 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,117,832,608 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,878,456,735
	2	Amortizim i akumuluar	115,462,800
	3	Gjendja në 01/01/2022	1,762,993,935
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	354,838,673
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	4	Kosto historike	2,233,295,408
	5	Amortizim i akumuluar	115,462,800
	6	Gjendja më datë 31/12/2022	2,117,832,608

Lekë

Nr.	Studime-Projektme (kosto historike)	Gjendja 01/01/2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31/12/2022
	Objekte inventari				
	Gjendja në 01/01/2022	187,8456,735	35,4838,673	0	2,233,295,408
	Rikualifikimi i Sheshit Livadhja		3,000,000		3,000,000
	Ujësullësi Burimet e Merkos		148,514,480		148,514,480
	Kolaudimi Burimet e Merkos		667,935		667,935
	Supevizim punimesh Ujësullësi i Merkos		1,762,044		1,762,044

	Ujësllësi Krongj-Finiq linjat e brendshme		62,651,675		62,651,675
	Supevizim punimesh Ujësllësi Krongj-Finiq		400,000		400,000
	Ujësllësi Burimet e Leshnicës		68,000,000		68,000,000
	Supevizim punimesh Ujësllësi i Leshnicës		700,000		700,000
	Furnizim vendosje pompa Muzinë		2,854,262		2,854,262
	Rikonstruksion i rrugës Dermish Jerme		29,494,715		29,494,715
	Rikonstruksioni i rrugës Dermish Navaricë		22,956,648		22,956,648
	Mbikëqyrje punimesh rruga Dermish Cerkovice		840,000		840,000
	Blerje Materiale ndërtimi viti 2021-2022		8,516,068		8,516,068
	Blerje Materiale ndërtimi 2022-2023		2,774,100		2,774,100
	Blerje Materiale elektrike 2022-2023		928,956		928,956
	Mbikëqyrje punimesh Dermish Jerme		300,000		300,000
	Mbikëqyrje punësh Restaurim kanali Th Filipeu		477,790		477,790
	Totali	187,8456,735	354,838,673		2,233,295,408

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Nga auditimi konstatohet se, në llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” pasqyruar në bilanc për vlerën historike 1,878,456,735 lekë, është përfshirë vlera prej 223,919,792 lekë, që i përket investimeve të papërfunduara për objektet konkretisht “*Ndërtimi i Ujësllësit Rajonal nga burimet e Leshnicës Bashkia Finiq*” me vlerë 194,463,572 lekë, “*Rikonstruksioni i rrugës Karroq*” me vlerë 6,499,572 lekë dhe “*Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë*” me vlerë 22,956,648 lekë me ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27/12/2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin nr. 05, datë 21/02/2022, “*Për disa ndryshime në udhëzimin e Udhëzimi nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.*

(*Shënim kjo problematikë është përmbledhur në gjetjen mbi mos kontabilizimin e kontratave të pa përfunduara në llogarinë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”*).

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” më datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 6,761,469 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 263,028 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 31,817,615 lekë ndërsa më datë 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 5,187,398 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	36,741,985
	2	Amortizim i akumuluar	29,980,516
	3	Gjendja në 01/01/2022	6,761,469
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	263,028
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	4	Kosto historike	37,005,013
	5	Amortizim i akumuluar	31,817,615
	6	Gjendja më datë 31/12/2022	5,187,398

Lekë						
Nr.	Studime-Projektme (kosto historike)		Gjendja 01/01/2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31/12/2022
	Objekte inventari					
1	Gjendja në 01/01/2022		36,741,985			37,005,013
2	Pompe uji			39,990		
3	Depozite 10 kv uji			69,800		
4	Blerje motoshare			67,438		
5	Blerje prerëse bari			85,800		
	Totali		36,741,985	263,028		37,005,013

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

-Llogaria 215 “Mjete transporti” më datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 12,886,903 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe amortizim të akumuluar në vlerën 69,722,974 lekë ndërsa më datë 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie

paraqitet në vlerën 11,108,511 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	80,831,485
	2	Amortizim i akumuluar	67,944,582
	3	Gjendja në 01/01/2022	12,886,903
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	0
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	4	Kosto historike	80,831,485
	5	Amortizim i akumuluar	69,722,974
	6	Gjendja më datë 31/12/2022	11,108,511

Lekë					
Nr.	Studime-Projektme (kosto historike)	Gjendja 01/01/2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31/12/2022
	Objekte inventari				
1	Gjendja në 01/01/2022				
2	Autoveturë 6 + 1 Land Rover	1,896,000			
3	Autoveturë 4 + 1 Mitsubishi	1,498,600			
4	Autoveturë 4 + 1	1,494,000			
5	Autoveturë 5 + 1	1,416,000			
6	Autoveturë	600,000			
7	Motocikleta Dayang	150,000			
8	Motocikleta Dayang	100,000			
9	Zetora 3 Copë	4,170,200			
10	Kamion Vetëshkarkues	4,999,999			
11	Vinc me kosh (Atego)	4,836,000			
12	Eskavator me goma	4,872,000			
13	Autoveturë 8 + 1 (Benzinë + Gaz)	0			
14	Kamion Benz Mercedes	0			
15	Eskavator me zinxhir Benati	0			
16	Eskavator me zinxhir Volvo	9,055,196			
17	Kamion Man	3,022,584			
18	Kamion Mercedes Benz	936,000			
19	Autoveturë 4 + 1	2,928,000			
20	Autoveturë 4 + 1	800,000			
21	Eskavator me goma	4,985,865			
22	Kamiocinë Atp (Ford)	1,487,500			
23	Atp-Pick Up 4 x 4 Naftë	1,487,500			
24	Atp-Pick Up 4 x 4 Naftë	1,487,500			
25	Autobuz 16.1 Naftë	1,500,000			
26	Autobuz 22 + 1 Naftë	2,998,800			
27	Autobuz Urban Naftë	4,915,979			
28	Apv-Zjarrfikëse Mercedes Benz	2,988,000			
29	Apv-Zjarrfikëse	2,988,000			
30	Makinë Pastrimi	7,379,762			
31	Autoambulancë	2,200,000			
Totali		80,841,485			

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

-Llogaria 218 "Inventar ekonomik" më datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 22,766,251 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 3,081,677 lekë, pakësim në vlerën 4,581,884 lekë dhe amortizim i akumuluar në vlerën 33,868,777 lekë ndërsa më datë 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 15,574,472 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	50,943,466
	2	Amortizim i akumuluar	28,177,215
	3	Gjendja në 01/01/2022	22,766,251
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	3,081,667
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	4,581,884
	4	Kosto historike	49,443,249
	5	Amortizim i akumuluar	33,868,777
	6	Gjendja më datë 31/12/2022	15,574,472

6. Titulli i gjetjes: Mungesa e një regjistri kontabël për aktivet për aktivet afatgjata apo afatshkurtra.

Situata:

Nga auditimi i llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje, plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, 214 “*Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune*”, janë të pa analizuara në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitet, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6, Udhëzimi nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74, dhe Udhëzimi nr. 05, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Ndikimi/Efekti:

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivitet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të institucionit dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së institucionit si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

Shkaku: Mos implementimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Bashkia Finiq, Drejtoria e Financës të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

7. Titulli i gjetjes: *Pasqyrim jo i saktë i llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” duke mos përfshirë investimet të cilat janë në proces.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2022 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat, për vlerën prej 223,919,792 lekë që i përkasin llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” objekti “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal nga burimet e Leshnicës Bashkia Finiq” me vlerë 194,463,572 lekë, “Rikonstruksioni i rrugës Karroq” me vlerë 6,499,572 lekë dhe “Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë” me vlerë 22,956,648 lekë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0 lekë, kur ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhej pasqyruar në vlerën gjithsej 223,919,792 lekë.

Kriteri:

Udhëzimi nr. 05, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku: Mos zbatimi i rregullave kontabël.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Drejtorja e Financës në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Finiq më 31/12/2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	6,662,374	4,196,325	2,466,049
42	Detyrime ndaj personelit	9,475,106	8,754,172	720,934
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	487,159	994,877	(507,718)
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	1,528,107	1,409,056	119,051
436	Sigurime shëndetësore	174,746	159,695	15,051
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	74,484,868	57,176,344	17,308,524
467	Kreditorë të ndryshëm	41,559,983	48,538,153	(6,978,170)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	235,532,290	210,123,062	25,409,228
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		369,904,633	331,351,684	38,552,949

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në datën 31/12/2022, është në vlerën 6,662,374 lekë paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Finiq. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Lekë

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2022	4,196,325
Shtesa (K)	37,550,052
Pakësime (D)	35,084,002
Gjendja debitoare në 31/12/2022	6,662,375

Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në shumën 6,662,374 lekë përbëhet nga:

Lekë

Faturat e pa likuiduara deri më datë 31/12/2022			
Nr.	Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	Subjektet	Detyrimi
1	Blerje materiale elektrike	OE “N...” SHPK	1,563,600
2	Blerje karburant	OE “G...”	1,274,770

3	Blerje karburant	OE "G..."	1,186,740
4	Blerje karburant	OE "G..."	1,275,830
5	Blerje karburant	OE "G..."	808,300
6	Blerje tonera	OE "B..."	120,000
7	Blerje kompjuter + printer	OE "P..."	120,000
8	Blerje dosje arkive	OE "A..."	41,760
9	Materiale ndërtimi	OE "P..." SHPK	85,000
10	Pjesë për mirëmbajtje Eskavator Volvo	OE "T..." SHPK	125,274
11	Kancelari	OE "M..."	61,100
12	Blerje materiale elektrike	OE "N..." SHPK	1,563,600
13	Blerje karburant	OE "G..."	1,274,770
14	Blerje karburant	OE "G..."	1,186,740
15	Blerje karburant	OE "G..."	1,275,830
16	Blerje karburant	OE "G..."	808,300
17	Blerje tonera	OE "B..."	120,000
18	Blerje kompjuter + printer	OE "P..."	120,000
Totali			6,662,374

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

8. Titulli i gjetjes: *Detyrimet e prapambetura të pa likuiduara. Marrja e angazhimeve për kryerjen e shpenzimeve përtej kufirit të fondeve buxhetore të disponuara realisht, në llogarinë e thesarit.*

Situata:

1. Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 4,196,325 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 37,550,052 lekë dhe pakësim në vlerën 35,084,002 lekë ndërsa në datën 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 6,662,374 lekë e cila përbëhet nga 18 shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash et., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

2. Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 48,538,153 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 120,725,112 lekë dhe pakësim në vlerën 127,703,283 lekë ndërsa në datën 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 41,559,983 lekë.

Kriteri:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 50, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 85, pika 2.

Ndikimi/Efekti:

Krijimi i detyrimeve të prapambetura, duke mbartur këto detyrime për periudhat e tjera kontabël të mëvonshme, detyrim i buxhetit koherent dhe atij pasardhës.

Shkaku:

Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoj shpenzimet e vitit pasardhës, Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtorja e Financës të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 41,559,983 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlera 9,475,106 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2022 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”	
Çelje e vitit 2022	8,754,172
Shtesa (K)	99,238,208
Pakësime (D)	98,517,274
Gjendja debitore në 31/12/2022	9,475,106

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023, konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	Vlera
1	11.01.2023	251,798
2	11.01.2023	84,789
3	11.01.2023	36,306
4	11.01.2023	46,045
5	11.01.2023	33,637
6	11.01.2023	63,358
7	11.01.2023	3,562,111
8	11.01.2023	229,247
9	11.01.2023	35,973
10	11.01.2023	95,262
11	11.01.2023	361,021
12	11.01.2023	529,567
13	11.01.2023	305,579
14	11.01.2023	658,105
15	11.01.2023	177,920
16	11.01.2023	49,396
17	11.01.2023	73,781
18	11.01.2023	700,601
19	11.01.2023	168,754
20	11.01.2023	159,757
21	11.01.2023	212,835
22	11.01.2023	257,821
23	11.01.2023	188,633
24	16.01.2023	45,275
25	16.01.2023	40,950
26	16.01.2023	73,886
27	16.01.2023	75,887
28	16.01.2023	108,506
29	16.01.2023	663,512
30	16.01.2023	149,676
31	16.01.2023	35,705
Totali		9,475,106

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 487,159 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Lekë

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”	
Çelje e vitit 2022	994,877
Shtesa (K)	4,691,852
Pakësime (D)	5,199,570
Gjendja debitore në 31/12/2022	487,159

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	Vlera
24	16.01.2023	10,961
25	16.01.2023	9,525
26	16.01.2023	34,890
27	16.01.2023	12,612
28	16.01.2023	9,795
29	16.01.2023	334,627
30	16.01.2023	56,606
31	16.01.2023	18,143
Totali		487,159

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2022 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 1,528,107 lekë dhe 174,746 lekë.

Lekë	
Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”	
Çelje e vitit 2022	1,409,056
Shtesa (K)	17,553,353
Pakësime (D)	17,434,302
Gjendja debitore në 31/12/2022	1,528,107
Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”	
Çelje e vitit 2022	159,695
Shtesa (K)	1,990,961
Pakësime (D)	1,975,910
Gjendja debitore në 31/12/2022	174,746

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023 konstatohet se:

Lekë		
Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
24	16.01.2023	67,510
25	16.01.2023	61,058
26	16.01.2023	109,292
27	16.01.2023	113,151
28	16.01.2023	161,790
29	16.01.2023	982,521
30	16.01.2023	154,291
31	16.01.2023	53,240
Totali		1,702,853

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

9. Titulli i gjetjes: Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në pasqyrat financiare.

Situata: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Finiq në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 74,484,868 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Delvinë.

Lekë	
Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2022	57,176,344
Shtesa (K)	17,308,624
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31/12/2022	74,484,968

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Lekë					
Nr.	Kreditorë për mjete nën ruajtje	Gjendja 01/01/2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31/12/2022
1		57,176,344	17,308,524		74,484,868
2	Rikonstruksion i Rrugës Dermish Jerme		1,474,736		
3	Ujësjetllësi Burimet e Merkos		7,425,724		
4	Rikonstruksion Ujësjetllësi i Krongj Finiq		3,107,132		
5	Rikonstruksion Ujësjetllësi Leshinicës		3,400,000		
6	Rikonstruksion i Shkollës Mesopotam		83,441		
7	Rikonstruksion i sheshit fshati Livine		45,123		
8	Rikonstruksion i rrugës Dermish Navarice		1,147,833		
9	Ndërtim i Qendrës Etnografike Muzeale Livadhja		624,535		
Totali		57,176,344	17,308,524	0	74,484,868

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Për 20 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Finiq janë ngurtësuar fonde në vlerën 20,228,104 lekë për të cilat nuk është bërë zhblokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Delvinë, për të cilat është përbushur afati i

garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Kombëtare dhe Administrative dhe Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 20,228,104 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Kriteri:

Udhëzimi nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15/02/2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë : Kryetari i Bashkisë Finiq, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Kombëtare dhe Administrative të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 48,538,153 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 120,725,112 lekë dhe pakësim në vlerën 127,703,283 lekë ndërsa në datën 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 41,559,983 lekë. Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 41,559,983 lekë ku së bashku me llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 6,662,374 lekë, llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerë 9,475,106 lekë, llogarinë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 487,159 lekë, llogarinë 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 1,528,107 lekë dhe llogarinë “Sigurime shëndetësore” në vlerën 174,746 lekë në total kjo vlerë kuadrone me llogarinë 4342 “Operacione me shtetit (të drejta) në vlerën 59,887,475 lekë”.

Lekë	
Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2022	48,538,153
Shtesa (K)	120,725,112
Pakësime (D)	127,703,283
Gjendja kreditore në 31/12/2022	41,559,983

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Lekë				
Nr.	Fatura	Datë	Emërtimi	Vlera
1	Energjia elektrike	-	Muajt Maj - Dhjetor 2020 + prapambetura	13,439,680.47
2	Energjia elektrike	-	Muajt Janar-Nëntor 2021	2,829,208
3	Energjia elektrike	-	Muaji Nëntor 2022	1,283,565
4	Energjia elektrike	-	Muaji Dhjetor 2022	1,096,873
5	Shpenzime postare	-	Muaji Nëntor 2022	59,590
6	Shpenzime postare	-	Muaji Dhjetor 2022	59,590
7	Konsumi i ujit	-	Muaji Nëntor 2022	18,189
8	Konsumi i ujit	-	Muaji Dhjetor 2022	17,052
9	10	23.12.2021	Rikonstruksioni i MZSH-së	671,484
10	6	27.12.2022	Hartim dokumentacioni për regjistrim fillestar të tokave	6,000,000
11	7490	10.12.2022	Internet	22,000
12	28	06.05.2022	Mirëmbajtje mjete të rënda	42,880
13	66	13.12.2022	Mirëmbajtje mjete të rënda	286,800
14	5	30.09.2022	Vlerësim pasuri e paluajtshme	15,000
15	9	19.10.2022	Mbikëqyrje objekte shkollore	21,000
16	344	05.10.2022	Certifikim punonjës	16,200
17	19	04.09.2022	Kolaudim Shkolla “Mesopotam”	3,840
18	904	23.12.2022	Shërbim foni për evente	150,000
19	3260	13.12.2022	Kontroll teknik	2,950

Nr.	Fatura	Datë	Emërtimi	Vlera
20	63	10.04.2019	Rikualifikim "Sheshi Livadhja"	11,300,176
21			Vlerësim Ujësjetllësi	3,613,546
22	49	03.06.2022	Supervizim objekti "Jerme"	421,960
23	5	29.08.2022	Mbikëqyrje "Shkolla Mesopotam"	32,000
24	6	29.08.2022	Mbikëqyrje "Ujësjetllësi Muzinë"	34,000
25	23-2017- 2264/1136	22.12.2017	Vendim Gjykatë	122,400
Totali				41,559,983

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

-Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Finiq në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 235,532,290 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"	
Çelje e vitit 2022	210,123,062
Shtesa (K)	76,874,941
Pakësime (D)	51,674,854
Gjendja debitore në 31/12/2022	235,532,290

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31/12/2021, ka qenë në vlerën 39,833,754 lekë ndërsa në datën 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 42,281,793 lekë ose me rritje në vlerën 2,448,039 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	Lekë	
		31/12/2022	31/12/2021
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	42,281,793	39,833,754
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	297,615	150,195
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	297,615	150,195
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	26,120,036	25,466,336
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	26,120,036	25,466,336
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	15,846,142	14,217,223
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	15,846,142	14,217,223
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksa kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31/12/2021, ka qenë në vlerën 22,449,199 lekë ndërsa në datën 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 21,972,945 lekë se me zbritje në vlerën 476,254 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	Lekë	
		31/12/2022	31/12/2021
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	21,972,945	22,449,199
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	11,987,428	12,097,152
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	1,500,000	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	10,487,428	12,097,152
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	9,985,517	10,352,047

7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	9,792,582	10,107,687
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	0	0
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	0	0
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjopa, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	192,935	244,360
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	0	0

3. Të ardhura të tjera:

-**Llogaria 72 “Grante korente”**, në datën 31/12/2021, ka qenë në vlerën 337,544,533 lekë ndërsa në datën 31/12/2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 295,605,926 lekë ose me zbritje në vlerën 41,938,607 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	Lekë	
		31/12/2022	31/12/2021
72	V. GRANTE KORENTE	295,605,926	337,544,533
720	1. Grant korent i brendshëm	295,605,926	337,544,533
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	228,203,132	266,800,048
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	3,291,485	2,937,605
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	0	0
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	4,223,834	3,754,602
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	0	0
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	59,887,475	64,052,278
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	2. Grant korent i huaj	0	0

-**Llogaria 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”**, në datën 31/12/2021, ka qenë në vlerën 0 lekë ndërsa në datën 31/12/2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 7,603,684 lekë ose me rritje në vlerën 7,603,684 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	Lekë	
		31/12/2022	31/12/2021
73	VII. Ndryshimi i gjendjes së inventarit	7,603,684	0

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-**Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** në datën 31/12/2021, ka qenë në vlerën 122,666,861 lekë, ndërsa në datën 31/12/2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 118,520,640 lekë ose me zbritje në vlerën 4,146,221 lekë.

-**Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”**, në datën 31/12/2021, ka qenë në vlerën 19,212,058 lekë, ndërsa në datën 31/12/2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 19,874,265 lekë ose me rritje në vlerën 662,207 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Delvinë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	Lekë	
		31/12/2022	31/12/2021
6001	Paga, personel i përhershëm	118,520,640	122,666,861
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	17,889,136	17,267,028
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	1,985,129	1,945,030
Totali		138,394,905	141,878,919

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31/12/2021, ka qenë në vlerën 56,794,545 lekë ndërsa në datën 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 86,094,650 lekë ose me rritje në vlerën 29,300,105 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Delvinë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	Lekë	
		31/12/2022	31/12/2021
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	86,094,650	56,794,545
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,241,008	4,581,070
6021	Materiale dhe shërbime speciale	2,908,002	1,909,706
6022	Shërbime nga të tretë	31,902,188	16,823,516
6023	Shpenzime transporti	28,438,506	17,981,555
6024	Shpenzime udhëtimi	712,400	477,804
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	10,980,183	6,724,289
6026	Shpenzime për qiramarrje	0	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	0	0
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	9.912,363	8,296,605

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Finiq nuk ka pasur subvencione.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 1,792,328 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 103,086,583 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Llogaria	Emërtimi	Lekë	
		31/12/2022	31/12/2021
	V. TRANSFERIME KORENTE	104,878,911	94,390,103
604	1. Transferta korente të brendshme	1,792,328	501,502
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë	1,238,704	501,502
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	553,624	0
605	2. Transferime korente me jashtë	0	0
6051	Transferime për organizata ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime për qeveritë e huaja	0	0
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja	0	0
6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit	0	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	103,086,583	93,888,601
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	99,566,583	93,888,601
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore	3,520,000	

10. Titulli i gjetjes: *Mos kuadrim i diferencës ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve me llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor”.*

Situata:

Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se, për vitin 2022 totali i te ardhurave në vlerë është 367,464,348 lekë dhe totali shpenzimeve është 329,368,466 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 38,095,882 lekë nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerë 34,719,433 lekë me një diferencë në vlerën 3,376,449 lekë.

Kriteri:

Udhëzimi nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave

financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 4 “Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8), nënpika 4.1 “Shpenzimet në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe operacionet që lidhen me to”.

Ndikimi/Efekti:

Mos kuadrim i llogarive.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë : Nga Drejtoria e Financës të analizohet vlera 3,376,449 lekë e cila ka të bëjë me mos kuadrimin e diferencës ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sistemimi të kryhet sipas trajtimit kontabël në llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor”.

- Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

11. Titulli i gjetjes: *Përfitimi i shërbimeve pa procedurë prokurimi.*

Situata:

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 3 raste janë zhvilluar projekte artistike, aktivitete kulturore, shërbime catering apo rikonstruksion ambientesh për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjin nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Analiza e detajuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Fatura	Përshkrimi	OE fitues	Vlera	Urdhër Shpenzimi
1	Nr. 3, datë 17.06.2023	Aktivitet për titull nderi dy mjek	K...	65,000	Nr. 588, datë 20.12.2022
	Nr. 3, datë 17.06.2023	Promovim librash (aktivitet koktej)	K...	80,000	
	Nr. 3, datë 17.06.2023	Aktivitet kulturor për festën kombëtare	K...	96,000	
	Nr. 3, datë 17.06.2023	Aktivitet kulturor për turizmin	K...	91,000	
	Nr. 3, datë 17.06.2023	Qira Ambjenti	K...	160,000	
2	Nr. 3, datë 13.05.2023	Aktiviteti binjakëzim i Bashkisë Finiq - Tripoli	S...	486,000	Nr. 203, datë 17.05.2022
3	Nr. 7, datë 24.05.2022	Rikonstruksion shtëpie (fond emergjence)	A...	241,128	Nr. 250, datë 13.06.2022
Totali				1,219,128	

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e këtyre shpenzimeve është kryer sipas Vendimit nr. 51, datë 24.12.2021, të Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë me shkresën nr. 2/1 prot., datë 17.01.2022. Nga Bashkia Finiq për periudhën nga data 01/01/2022 deri më 31/12/2022, për 3 subjekte është likuiduar shuma 1,219,128 lekë. Vlera 1,219,128 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.

Kriteri:

Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligji nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

Ndikimi/Efekti:

Shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në vlerën 1,219,128 lekë.

Shkaku: Nuk janë respektuar dispozitat ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë : Nga Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria e Financës të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. L. M me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues.

- *Mbi strukturën organizative të Bashkisë Finiq.*

Për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me Urdhrin nr. 71, datë 16.05.2022, të Kryetarit të Bashkisë, dhe Vendimin nr. 53, datë 24.12.2021, të Këshillit Bashkiak me objekt “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Finiq dhe Njësive Administrative për vitin 2022” ndërsa niveli i pagave është miratuar me Vendimin nr. 52, datë 24.12.2021, të Këshillit Bashkiak me objekt “Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Finiq dhe Njësive Administrative, për vitin 2022”, për të cilat është shprehur ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2/1 prot., datë 17.01.2022.

Me Urdhrin nr. 96, datë 30.05.2022, të Kryetarit të Bashkisë me objekt “Për një shtesë prej 4 (katër) punonjës zjarrfikës”, struktura organizative nga 204 punonjës shkon në 208 punonjës duke u bazuar në vendimin e sipërpërmendur të Këshillit Bashkia ku është shprehur edhe ligjshmëria e Prefektit të Qarkut Vlorë me shkresën nr. 439/1 prot., datë 17.05.2022.

12. Titulli i gjetjes: *Mungesë e rregullave të përcaktuara qartë për rekrutimin e punonjësve të cilët rregullojnë marrëdhëniet e punës me anë të Kodit të Punës.*

Situata:

Nëpunësit e Bashkisë Finiq i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1 “Mjedisi i kontrollit, Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore”.

Nga auditimi konstatohet se, mungojnë rregulla të shkruara dhe kritere për zhvillimin dhe administrimit e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe rregulla lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë për punonjësit e Bashkisë Finiq të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Kriteri:

Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

Ndikimi/Efekti:

Situatë jo transparente mbi procedurat e rekrutimit të punonjësve.

Shkaku: Mos implementim i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Nga Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative paraqitet si më poshtë:

Viti	Muajt	Plani/Numër punonjës Nëpunës Civil	Realizimi/Numër punonjës Nëpunës Civilë	Punonjës me Kod Pune që janë vendosur në pozicionet me Shërbim Civil	Diferenca	Plani/Numër punonjës Kod Pune	Realizimi/Numër punonjës Kod Pune	Diferenca
2022	Janar	57	34	13	10	147	142	5
2022	Shkurt	57	34	13	10	147	145	2
2022	Mars	57	34	13	10	147	145	2
2022	Prill	57	34	13	10	147	138	9
2022	Maj	57	34	13	10	147	144	3
2022	Qershor	57	34	13	10	151	139	12
2022	Korrik	57	34	13	10	151	143	8
2022	Gusht	57	34	13	10	151	143	8
2022	Shtator	57	34	13	10	151	142	9
2022	Tetor	57	34	13	10	151	139	12
2022	Nëntor	57	34	13	10	151	143	8
2022	Dhjetor	57	34	13	10	151	141	10

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura konstatohet se, për vitin 2022 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil realizimi i strukturës është në masën 60% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 88%. Në total realizimi i strukturës është në masën 90%.

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative të Bashkisë Finiq konstatohet se në total struktura është e përbërë nga 57 punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Shërbim Civil dhe 147 punonjës me Kod Pune. Në strukturën e punonjësve civil janë bashkuar edhe 13 punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se, vendet vakante të cilat janë hapur për shërbimin civil nuk janë plotësuar si pasojë e mos aplikimit nga personat e interesuar.

Listë pagesat përfshijnë pagën e grupit (klasifikimin e diplomës së nivelit të dytë në master shkencor ose profesional sipas rasti), pagën për funksion (niveli i klasifikuar), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa vjetërsi (klasifikimi në vit, % dhe në vlerë), paga bruto, ndalesat (sipas rasti, pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 9.5%, pagesat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore 1.7% tatimi mbi pagën). Listë prezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale dhe

paga maksimale në përputhje me VKM nr. 158, datë 12.03.2022, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës janë aplikuar vetëm për punonjësit e MZSH-së (punonjës zjarrfikës), ndërsa për punonjësit e tjerë të institucionit nuk ka, për shkak se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit.

13. Titulli i gjetjes: *Bashkia Finiq në gjashtë raste ka kryer emërimet e punonjësve në kundërshtim me kriteret e pozicionit të punës.*

Situata:

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit konstatohet se, për gjashtë punonjës të emëruar përpara periudhës objekt auditimi të cilët rregullojnë marrëdhëniet punës me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, arsimi i tyre nuk përputhet me kriteret e pozicionit të punës. Të dhënat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Kategoria	Nëpunës Civil	Emër Mbiemër	Arsimi sipas Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar	Arsimi i punonjësve
	Klasa				
Sek/ Përgjithshëm	I-b	N/ Civil	V. XH	Jurist, Ekonomist, Master Shkencor	Shkenca Shoqërore
Specialist i Shërbimit Social	IV-a	N/Civil	M. TH	Shkenca Shoqërore Bachelor, Profesional, Master Shkencor	Arsim të Mesëm
Drejtori	II-b	N/Civil	A. M	Agronomi Bachelor, Master Shkencor, Master Profesional	Agronomi Bachelor, Turizëm Master Profesional
Specialist i menaxhimit dhe mbrojtjes të tokës	IV-a	N/Civil	V. SH	Agronomi Bachelor/Master Shkencor, Master Profesional	Administrim Publik, Bachelor
Specialist Topograf	IV-a	N/ Civil	I. DH	Topografi Bachelor, Master Shkencor, Master Profesional	Arsim të Mesëm
Specialist Sekretari-Arkivi	IV-a	N/Civil	T. R	Shkenca Shoqërore, Master Shkencor, Master Profesional	Arsim të Mesëm

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq.

Kriteri: Ligji nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos efektivitet në përdorim e burimeve njerëzore.

Shkaku: Mos respektimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa që, emërimet e nëpunësve civilë të kryhen në zbatim të kritereve të pozicionit të punës duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. K. K me detyrë Kryetar i Bashkisë

znj. I. E me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Pika 2.4 e programit. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të lartë, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

- *Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.*

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia

vendore për punë e shërbime mallra, sipas Aneks 2.4.1 bashkëlidhur Projekt Raporti Auditimit.

- Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 – 31.12.2022 nga subjekti Bashkia Finiq, konstatohet se janë zhvilluar gjithsej **10** procedura prokurime me vlera të larta me fond limit 110,897 mijë lekë dhe **15** procedura me vlerë të ulët me fond limit **8,489** mijë lekë, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

Në 000/lekë

Periudha viti 2021	Proc me vlere te larte			Diferenca me fond limit	
	Nr.	Fond limit	Vlere kontrate	Vlera	%
I. Procedura te realizuara gjithsej, nga e cila	10	110,897	87,147	23,750	21.4
- Të hapura	3	78,788	57,245		
- E hapur e thjeshtuar	4	14,609	12,693		
- Shërbim konsulence	1	15,000	14,825		
_Negocim pa shpallje	1	2,500	2,382		
II. Procedura me vlerë të ulët	15	8,489	6,375		
Totali I + II	25	119,387	93,522	25,865	21.6
Vlerësuar për auditim	8	107,981	84,673		
Shprehur ne %	80	97	97		

Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratave të lidhura është me një diferencë për verën 25,368 mijë lekë ose 21.6% e vlerës së fondit.

Në këto procedura kanë marrë pjesë 25 OE, nga ku janë skualifikuar 4 OE.

Mbi bazën e materialitetit të bërë nga grupi i KLSH, nga **10** procedura prokurimi të zhvilluara me fond limit **110,897** mijë lekë, janë vlerësuar për auditim nga **8 procedura** me fond limit **107,981** mijë lekë ose 97% e totalit të procedurave.

Nga auditimi i 18 procedurave me fond limit 1,846,197 mijë lekë janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 6 procedura me vlerë të fondit limit 526,921 mijë lekë ose 16.4% e vlerës së fondit limit të audituar. Shkeljet kanë konsistuar në këto drejtime:

Titulli i gjetjes 1: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë, duke përdorur kritere të ekzagjeruar, të panevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe të pa-argumentuara, konstatuar kjo në 4 procedura prokurimi.

Situata:

Nga auditimi i **8 procedura** me fond limit **107,981** mijë lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në **aplikimin e kriterëve** të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara gjithsej **3 procedura** me fond limit **21,692** mijë lekë, kritere të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit
1	Hartim Dokumentacioni për Regjistrimin Fillestar te tokave bujqësore per fshatrat Caush,Finiq,Mavropull	15,000,000
2	Mirëmbajtje e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditëse	4,192,500
3	zëvendësim pompe ne stacionin e pompave te ujësjellësit te fshatit Muzine	2,500,000

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj.

Vendosja si kriteret e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “Për prokurimin publik”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

- Mos argumentimi i kërkesave për numrin e punonjësve të mjeteve në raport me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit , etj.

Kriteri:

Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efektiviteti:

Aplikimi i kriterëve jo të mirëargumentuara, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mos përdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa e konkurrencës.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Njësia e Prokurimit*).

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Finiq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, eficensë dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

Titulli i gjetjes 2: *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave duke kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e pjesëmarrjes, konstatuar kjo në 10 procedura prokurimi.*

Situata:

Nga auditimi i **8 procedura** me fond limit **107,981** mijë lekë të vlerësuara për auditim, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **3 procedura** me vlerë të fondit limit **24,166** mijë lekë ose 22.3% e vlerës së fondit limit të audituar, ku OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimi të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit
1	Blerje materiale elektrike	3,333,333
2	Blerje materiale ndërtimi	16,666,666
3	Pjese këmbimi dhe riparim mjetesh	4,166,666

Kriteri:

Në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

Ndikimi/Efektiviteti:

KVO, ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE në paligjshmëri të LPP, pasi nuk plotëson kriteret e DT.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave*)).

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë: Bashkia Finiq, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Rastet e shkeljeve sipas procedurave paraqiten si vijon:

1- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje materiale ndërtimi”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 14, datë 24.5.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 14, datë 24.5.2022	4. Komisioni VO nr. 14/1, datë 24.5.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”,	I. B V. L S. J	K. TH A. K F. TH
5. Fondi Limit (pa TVSh) 16,666,666 lekë, me financim Viti 2022 në vlerën 1,666,666 lekë. Viti 2023 në vlerën 15,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “J...” ShPK me vlerën e ofertës 14,856,930 lekë pa TVSh, me afat 90 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 89.1 %.
8. Data e hapjes së tenderit 5.8.2022 REF -34748-08-06-29	9. Burimi Financimit Bashkia Finiq.	10. Operatorë Ekonomike 3: a- Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 3 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP

b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 14/9, datë 2.12.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 14,856,930 lekë me afat 16 muaj	

Burimi të dhënave: *Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).*

- **Vlerësimi i kritereve:**

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

Në pikën 2.2.2 të DST është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqes bilanc e viteve 2019,2020,2021 kjo e shoqëruar me akt ekspertizë të ekspertit kontabël. Konstatohet se nga njësia ky kriter është trajtuar me dy standarte, pasi në procedura me vlerë të lartë si ajo me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navarice”, me fond limit 45 milionë lekë nuk është kërkuar.

Në pikën 2.3.2 të DST është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë të punësuar minimalisht 5 punonjës.

Në pikën 2.3.3 të DST është kërkuar që OE pjesëmarrës të ketë 3 drejtues mjetesh për autobetonier dhe 1 për mjet vetëshkarkues.

Këto kritere nuk janë të mirëargumentuara, pasi kemi të bëjmë me blerje malli dhe jo FV.

Konstatohet se DST nuk janë nënshkruar njëri nga anëtarët e NJP, konkretisht ing. V. L.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: znj. I. B me detyrë juriste në Drejt Juridike, z. V. L me detyrë Drejtori i PZHT dhe z. S. J me detyrë specialist në Drejt/ Shërbimeve.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2045, datë 9.8.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

1. Shoqëria “J...” shpk me ofertë 14,856,930 lekë.
2. Shoqëria “I...” shpk me ofertë ekonomike 16,007,935 lekë.
3. Shoqëria “S...” shpk me ofertë 15,801,930 lekë.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “J...” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

a- Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi është jashtë periudhës së zhvillimit të procedurës. Kështu subjekti ka paraqitur vërtetim nr. 2022-3159578, datë 23.6.2022 ku përfshihet dhe muaj Majë 2022. Por sipas të dhënave procedura zhvillohet me datë 5.8.2022, pra nuk është deklaruar muaj qershor 2022.

Konkluzioni: Nga sa trajtuar më sipër shoqëria “J...” shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST. Në këto kushte KVO duhet të vijonte me OE e mbetur në garë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: z. K. TH me detyrë Drejtor i Shërbimeve, z. A. K me detyrë Përgjegjës Sektori i Ujitjes dhe Kullimit, z. F. TH me detyrë Përgjegjës Sektori i

shërbimeve të ndriçimit publik, dekorit dhe mirëmbajtjes së objekteve dhe varrezave publike.

2- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrugës Dërmish-Navaric”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Dërmish-Navaric.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 13, datë 24.5.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 13, datë 24.5.2022	4. Komisioni VO nr. 13/1, datë 24.5.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”,	I. B A. K S. J	K. TH V. L F. TH
5. Fondi Limit (pa TVSh) 45,455,502 lekë, me financim Viti 2022 në vlerën 25,757,358 lekë. Viti 2023 në vlerën 19,698,144 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “A...” ShPK me vlerën e ofertës 26,816,567 lekë pa TVSh, me afat 90 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 58.9 %.
8. Data e hapjes së tenderit 19.8.2022 REF -37173-07-26-2022	9. Burimi Financimit Ministria e Financës + Bashkia Finiq.	10. Operatorë Ekonomike 3: a- Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 3 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
13. Lidhja e kontratës Nr. 2578, datë 29.9.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 26,816,567lekë me afat 90 ditë	

Titulli gjetjes: Mos llogaritja e saktë e fondit limit

Situata:

Me vendim të KB nr. 1, datë 17.2.2022 “Për një ndryshim në VKB nr. 51, datë 24.12.2021 është miratuar fondi për prokurimin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Dërmish-Navaric” me vlerë 45,455,502 lekë pa TVSh, ku një pjesë është financim i MF dhe një pjesë është financim me të ardhurat e Bashkisë Finiq.

Preventivi është hartuar nga specialistët **ing. A. K**, bazuar në çmimet sipas VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i çmimeve sipas manualit, konstatohet se ato janë nuk janë në zbatim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015, i ndryshuar, konkretisht:

Nr.	Analizë	Emërtimi I punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi		Diferenca në çmim (6-7)	Vlera (5*8)
					Preventives	VKM nr. 629		
1	2	3	4	5	6	7	8	9
2	An	Prerje asfalti, sakrifikim shtresë asfalti (Sklarifikime shtresë asfalti eksiztues me makineri)	m2	1800	362	190	172	309,600
3	An.9	Nënshtresë zhavori (nën tombiuna). Mbushje me zhavorr pas mureve. Ky është emertimi sipas manualit VO: Zhavor nen tombina, përfshihet si në zë pune tek zëri tombina. Preventivi nuk përmban tombina	m3	20	1260	1037	223	4,460
4	An-130 (sipas VKM nr. 629,	Vijëzimi shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12	ml	7600	275	249	26	1,976,020

Nr.	Analizë	Emërtimi I punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi		Diferenca në çmim (6-7)	Vlera (5*8)
					Preventives	VKM nr. 629		
1	2	3	4	5	6	7	8	9
	rezulton An-129	cm (sprait)						
								2,290,080

Nga sa trajtuam mësipërm vlera e privativit është rënduar më shumë prej 2,290,080 lekë, veprime me efekt negativ në buxhetin e bashkisë Finiq.

Kriteri:

Në kundërshtim VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi ing. A. K me detyrë Përgjegjës Sektor i Ujitjes dhe Kullimit

Ndikimi/Efekti:

Veprime me efekt negativ në buxhet për vlerën 2,290,080 lekë

Shkaku: Përgjegjësi e personave në llogaritjen e fondit limit.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë: Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës ose me subjekte të licencuar për saktësinë e llogaritjes së fondit limit në përputhje me çmimet e manualit për të shmangur mos efektivitetin e fondeve të prokuruar për vlerën **2,290,080 lekë.**

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

Në pikën 2.4.2 të DST është kërkuar që OE pjesëmarrjes të ketë licensë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve inerte që kanë ndikim në mjedis (kodi III.2.B).

Në zbatim të pikës (a) e nenit 1 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 “Për vlerësimin në mjedis”, me qëllim sigurimin e nje niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Këto ekspertiza janë ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit , relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis.

Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, diskriminues, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: znj. I. B me detyrë juriste në Drejt Juridike, z. A. K me detyrë Përgjegjës Sektor i Ujitjes dhe Kullimit dhe z. S. J me detyrë specialist në Drejt/ Shërbimeve.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2177, datë 25.8.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

4. Shoqëria “J...” shpk me ofertë 34,753,954 lekë.
5. Shoqëria “A...” shpk me ofertë ekonomike 26,816,567 lekë.
6. Bashkimi i OE “N... + L...” shpk me ofertë 15,801,930 lekë.

Me PV nr. 2322, datë 6.9.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në përfundim KVO ka vendosur se nga 3 OE pjesëmarrës janë skualifikuar 0 (zero) OE.

Nga Bashkia Finiq përfaqësuar nga njësia e prokurimi dhe KVO (I. B, A. K, S. J, K. TH, V. L dhe F. TH), me shkresën nr. 1171/2, datë 01.06.2023 (prot KLSH nr. 312/5, datë 9.6.2023) janë paraqitur kundërshti në lidhje me mos llogaritjen e saktë të fondit limit, duke kundërshtuar se:

Pretendim i subjektit:

Ne lidhje me vlerësimin e procedurës sipas se cilës është konstatuar se KVO nuk ka vlerësuar drejte dokumentacionin e paraqitur nga OE fitues pasi nuk plotëson te gjitha kërkesat e DST te miratuar nga AK konkretisht subjekti nuk plotëson kriterin;

“Nuk ka deklaruar në SPE kopje të deklaratave të xhiros për vitet 2019,2020,2021”.

“Nuk është paraqitur deklarata që stafi inxhinierik i kërkuar nuk është angazhuar në subjekte të tjera private dhe shtetërore”.

Lidhur me pikën e parë ju bëjmë me dije se vërtetimi i xhiros i OE “A...” shpk është deklaruar në SPE.

Sa i përket vërejtjes së dytë , ju bëjmë me dije se me ndryshimet ligjore kërkesa për mos angazhim të stafit drejtues inxhinierik, përfshihet në Shtojcën nr.8 “Formularin përmbledhës të vetdeklarimit” kapitulli B”.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit, grupi mori në konsideratë argumentet e paraqitura në lidhje me vlerësimin e procedurës, duke konkluduar se vlerësimi është bërë i saktë nga KVO.

3- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale elektrike”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 7, datë 14.4.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 7, datë 14.4.2022 I. B F. TH F. M	4. Komisioni VO nr. 7/1, datë 14.4.2022 I. K K. TH A. K
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”,		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,333,333 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “N...” ShPK me vlerën e ofertës 2,999,680 lekë pa TVSh, me afat 90 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 89.9 %.
8. Data e hapjes së tenderit 25.5.2022 REF -28820-05-12-2022	9. Burimi Financimit Bashkia Finiq.	10. Operatorë Ekonomike 4: a- Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 3 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
7. Lidhja e kontratës Nr. 1736, datë 4.7.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 2,999,680 lekë me afat 20 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

- Vlerësimi i kritereve:

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuan kritere në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 1291, datë 25.5.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 3 OE, *konkretisht:*

1. OE "A..." shpk me ofertë 3,216,660 lekë pa TVSh.
2. OE "N..." shpk me ofertë 2,999,680 lekë pa TVSh.
3. OE "H..." shpk me ofertë 2,959,345 lekë pa TVSh.

Me PV nr. 1452, datë 7.6.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në përfundim KVO ka vendosur se nga 3 OE të skualifikojë 1 OE dhe kualifikoje 2 OE, si vijon:

Është skualifikuar shoqëria "H..." shpk me ofertë 2,959,345 lekë, për arsye se nuk janë paraqitur mostrat e mallrave të kërkuara sipas pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik për kërkesat e veçanta për kualifikim ku citohet: "Operatorët ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: "Mostra për secilin artikull të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor para datës së hapjes së ofertave".

Nga auditimi i dokumentacionit mbi skualifikimin e OE, konstatohet se KVO ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP, pasi OE e skualifikuar nuk plotësonin kërkesat e DST të miratuara nga AK, trajtuar gjerësisht në Projekt Raport Auditim.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria "N..." shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

a- Nga të dhënat e shtojcës 8 (vetëdeklarim), konstatohet se nuk është plotësuar në përputhje me kuadrin ligjorë, pasi rubrikat janë të paplotësuara dhe nuk është shënuar targa e mjetit, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 162, datë 21.12.2020 "për prokurimin publik", neni 82, pika 5, VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6.

b- Mjeti me targë i paraqitur nga subjekti nuk ka dokumentacion të saktë, pasi policia e sigurimit mban datën 9.3.2022, ndërsa procedura zhvillohet me datë 25.5.2022.

c- Nuk plotëson pikën 2.3.3 të DST, që OE duhet të dorëzojë dëshmi për plotësimin e kërkesave.

d- Nuk plotëson pikën 2.3.2 që OE të paraqesë liçensë profesionale për prodhimin e mallrave, objekt i kontratës.

e- Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga shoqëria, konstatohet se është me gabime aritmetike që kalon 2%. Konkretisht shoqëria paraqet ofertë pa TVSh në shumën 2,999,680 lekë. Ndërkohë po të mbledhës të dhënat e ofertës vlera e sajë është 2,974,680 lekë pa TVSh me një gabim për 7%, në kundërshtim me pikën 2 e nenit të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 të LPP dhe nenit 82 pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të PP".

Konkluzioni: Nga sa trajtuar më sipër shoqëria "N..." shpk nuk është në kushtet e plotësimi të kriterëve të DST. Në këto kushte KVO duhet të vijonte me OE e mbetur në garë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit", **duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: z. I. K me detyrë Zv/Kryetar, z. A. K me detyrë Përgjegjës Sektori i ujitjes dhe kullimit, z. K. TH me detyrë Drejtor i Shërbimeve.**

Titulli gjetjes: Mos zbatimi i kushteve të kontratës.

Situata:

Midis shoqërisë “N...” Shpk dhe Bashkia Finiq, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 1736, datë 4.7.2022 për “Blerje materiale elektrike” me vlerën 2,999,680 lekë pa TVSh. me afat 20 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës (neni 6 i kontratës).

Referuar të dhënave të financës, kontrata nuk është zbatuar sipas kushteve të sajë, konkretisht të nenit 17 të sajë.

Kështu sipas Drejtorisë së Financës është likuajduar vetëm vlera 928,956 lekë me USH nr. 490, datë 9.11.2022 sipas faturës nr. 108/2022, datë 4.11.2022, bërë hyrje me FH nr. 23/1, datë 25.7.2022 në shumën 772,800 lekë dhe nr. 31, datë 4.11.2022 në shumën 156,264 lekë.

Nga subjekti është paraqitur për likujdim fatura nr. 120/2022, datë 7.12.2022 në shumën 1,563,600 lekë faturë e cila nuk është likuajduar nga Bashkia Finiq.

Në zbatim të nenit 6 të kontratës nr. 1736, datë 4.7.2022 afati për zbatimin e sajë është **20 ditë** nga data e nënshkrimit, **pra nga data 4.7.2022 deri me datë 24.7.2022.**

Nga sa sipër subjekti nuk ka plotësuar kushtet e kontratës për dorëzimin e mallit në afat. Gjithashtu një pjesë të mallit akoma nuk është paraqitur nga subjekti për likujdim dhe bërë hyrje. Kështu deri në fund të vitit 2022 subjekt ka bërë hyrje vlerën 2,492,556 lekë me TVSh nga vlera 3,599,616 lekë me TVSh, **me një diferencë në shumën 1,107,060 lekë.**

Nga sa trajtuam më sipër për mos dorëzim malli brenda **20 ditëve**, në zbatim të pikës 17.1⁴ të nenit 17 të kontratës nr. 1736, datë 4.7.2022, ndajë subjekti bashkia Finiq për periudhën nga 24.7.2022 deri me datë 31.12.2022, duhet të llogarisë penaltitet në shumën **561,540 lekë** $\{(3,599,616 \text{ lekë} \times 25\%) = 899,904 \times 4/1000 \times 156 \text{ ditë vonesë}\}$, **veprime me efekt financiar negativ në bashkinë Finiq.**

Kriteri:

Në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 1736, datë 4.7.2022.

Ndikimi/Efekti:

Mos zbatimi i kushteve të kontratës çojnë në keqmenaxhim të fondeve me efekt negativ për vlerën 561,540 lekë.

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave të Bashkisë Finiq: **z. F. TH me detyrë Përgjegjës Sektori Mirëmbajtjes në Drejt/Shërbimeve Publike si person përgjegjës për zbatimin e kontratës, kjo sipas urdhrin nr. 116, datë 5.7.2022.**

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike bashkia Finiq të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **561,540 lekë** nga shoqëria “N...” shpk, për mos zbatim të kontratës nr. 1736, datë 4.7.2022.

4- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Pjesë këmbimi dhe riparim mjetes”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Pjesë këmbimi dhe riparim mjetes”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 02, datë 8.2.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 02, datë 8.2.2022	4. Komisioni VO nr. 2/1, datë 8.2.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar”,	E. M M. C V. K	I. K K. TH A. K

⁴ Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditorë do të jetë 4/1000 e vlerës së kontratës së mbetur nga cmimi i përgjithshëm i kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,166,666 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “V... + J...” ShPK me vlerën e ofertës 3,949,200 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 89.9 %.
8. Data e hapjes së tenderit 9.3.2022 REF -20542-02-24-2022	9. Burimi Financimit Bashkia Finiq.	10. Operatorë Ekonomike 1: a- Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 1 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
7. Lidhja e kontratës Nr. 817, datë 31.3.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 3,949,200 lekë me afat deri me 31.12.2022	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kritere në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 78 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me vendim të KB nr. 51, datë 24.12.2021 është miratuar fondi për prokurimin me objekt “Pjesë këmbimi dhe riparim mjetesh” me vlerë 5,000,000 lekë pa TVSh, shkrehur nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2/1, datë 17.01.2022.

Kjo procedurë është botuar në APP me formular njoftim kontrate në buletin nr. 26, datë 28.2.2022. Nga OE pjesëmarrjes dhe APP nuk ka pasur ankesa për DST.

Me datë 9.3.2022 ora 10.⁰⁰ në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”, nga anëtari i NJP z. V. K (person i autorizuar) në faqen zyrtare të APP.

Pas përfundimit të dorëzimit të ofertave, anëtarët e KVO në mënyrë të pavarur kanë bërë vlerësimin.

Konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht bashkimi i OE “V... + J...” PF.

Me datë 9.3.2022 pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO arrin në konkluzionin se plotëson kriteret e DST dhe shpallet fitues.

Me datë 9.3.2022 është ngarkuar në sistem SPE, formulari i njoftim fituesit i cili është publikuar datë 10.3.2022.

Me datë 18.3.2022 është mbajtur PV i pranimit të dokumentacionit të fituesit.

Midis shoqërisë “V... + J...” Shpk dhe Bashkia Finiq, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 817, datë 31.3.2022 për “Pjesë këmbimi dhe riparim mjetesh” me vlerën 3,949,200 lekë pa TVSh. me afat punimesh deri me 31.12.2022.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “V... + J...” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

f- Nga të dy shoqëritë nuk është plotësuar pika 2.3.2 e DST ku OE duhet të ketë pikë servisi në territorin e Bashkisë Finiq dhe një sipërfaqe të përgjithshme jo më pak se 500 m². Sipas të dhënave konstatohet se ky kriter nuk plotësohet, pasi:

Subjekti V... PF, ka paraqitur certifikatë pronësie nr. 2925, datë 4.5.2020 në ZK 1722, nr. Pas 574/2/nd, vol 14, fq 21 me adresë QF Gjashtë dhe sipërfaqe ndërtese 352 m².

Subjekti J... PJ ka paraqitur certifikatë pronësie nr. 15, datë 14.5.2021 në ZK 1413, nr. Pas 467/10/2, vol 2, fq 73 me adresë Delvinë dhe sipërfaqe ndërtese 94.35 m². Pra gjithsej sipërfaqja e deklaruar është **446.35 m²** dhe kjo jashtë territorit të Bashkisë Finiq.

g- Nga bashkimi i OE nuk është bërë deklarata që merr përsipër kryerjen e shërbimit të transportit për mjetet në rast defektesh.

Konkluzioni: Nga sa trajtuar më sipër shoqëria “V... + J...” shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese për rritjen e numrit të OE në garë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, **duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: z. I. K me detyrë Zv/Kryetar, z. A. K me detyrë Përgjegjës Sektorit i ujitjes dhe kullimit, z. K. TH me detyrë Drejtor i Shërbimeve.**

5- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Mirëmbajtje e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 03, datë 01.3.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 03, datë 01.3.2022	4. Komisioni VO nr. 13/1, datë 01.3.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar”,	I. B A. K A. M	I. K K. TH K. D
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,192,500 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “A...” ShPK me vlerën e ofertës 3,270,812 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 78 %.
8. Data e hapjes së tenderit 21.3.2022 REF -21070-03-02-2022	9. Burimi Financimit Bashkia Finiq.	10. Operatorë Ekonomike 6: a- Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 5 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
13. Lidhja e kontratës Nr. 947, datë 14.4.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 3,270,812 lekë me afat 40 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

- Vlerësimi i kriterëve:

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 825, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme per ekzekutimin e shërbimeve të kontratës, të lëshuar nga Ministrisë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Liçensë për zbatim punimesh pikat.

NP 7	A	Ujesjelles,gazsjelles,vepra kullimi e vaditje.
NS 18	A	Punime topogjeodezike

Këto kategori liçensë nuk janë të mirëargumentuara pasi nuk janë të lidhura me tipologjinë e procedurës me zërat e preventivit.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: znj. I. B me detyrë juriste në Drejt Juridike, z. A. K me detyrë Përgjegjës Sektori i Ujitjes dhe Kullimit dhe z. A. M me detyrë specialist në Drejt/ Shërbimeve.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me vendim të KB nr. 51, datë 24.12.2021 është miratuar fondi me vlerë 5,031,000 lekë pa TVSh, shkrehur nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2/1, datë 17.01.2022 me objekt “*Mirëmbajtje e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës*”.

Me urdhrin e prokurimit nr. 03, datë 01.3.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 4,192,500 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “*E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike*” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 54, datë 01.3.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 21.3.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 02.3.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 03, datë 01.3.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 21.3.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Kjo procedurë është botuar në APP me formular njoftim kontrate në buletin nr. 29, datë 7.3.2022. Nga OE pjesëmarrës dhe APP nuk ka pasur ankesa për DST.

Nuk ka pasur ankesa nga OE.

Ka pasur rekomandim të APP për disa prej kriterëve të veçanta të DST, dërguar elektronikisht me datë 8.3.2022, rekomandime të cilat janë marrë në konsideratë nga AK.

Me datë 21.3.2022 ora 10.00 në zbatim të udhëtimit nr. 7, datë 30.7.2021 “për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”, nga anëtari i NJP z. V. K (person i autorizuar) në faqen zyrtare të APP.

Pas përfundimit të dorëzimit të ofertave, anëtarët e KVO në mënyrë të pavarur kanë bërë vlerësimin.

Konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 6 OE, konkretisht:

- 1- Shoqëria “A...” shpk me ofertë 3,270,812 lekë.
- 2- Bashkimi i OE “E... + C...” shpk me ofertë 3,692,516 lekë.
- 3- Shoqëria “J...” shpk me ofertë 3,681,559 lekë.
- 4- Shoqëria “M...” me ofertë 3,640,670 lekë.
- 5- Shoqëria “N...” shpk me ofertë 3,854,544 lekë.
- 6- Shoqëria “S...” shpk me ofertë 3,450,827 lekë.

Në përfundim të vlerësimit të dokumentacionit, KVO nga 5 OE ka skualifikuar i OE, konkretisht shoqërinë “S...” shpk me ofertë 3,450,827 lekë, pasi:

- *Bilanci vitit 2019 nuk është shoqëruar me ekspert kontabël megjithëse plotëson kushtet.*

- *Formulari përmbledhës seksioni (D) është deklaruar që mjetet nuk do të angazhohen në kontrata të tjera, po ashtu dhe stafi teknik, ndërkohë që mjete me targë (kamion vetëshkarkues) dhe ing. Ndërtimit z. E. S janë të angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Finiq për objektin :Rikonstruksion i shkollës fshati Mesopotam”.*

Nga auditimi i dokumentacionit mbi skualifikimin e OE, konstatohet se KVO ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP, pasi OE e skualifikuar nuk plotësonin kërkesat e DST të miratuara nga AK.

Në zbatim të nenit 91, pika 2 e ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 të LPP, i dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 neni 83 pika 2 është bërë verifikimi i gabimeve aritmetike, nga ku rezultojë se nuk kishte gabime.

Gjithashtu në zbatim të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 të LPP dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, neni 82 pika 4, u bë verifikimi për ofertën anomalisht të ulët, nga ku rezulton se nuk ka.

Në përfundim KVO në zbatim të udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimeve me mjete elektronike”, ka vendosur të klasifikojë në vend të parë shoqërinë 14.3.2022 vend të parë shoqërinë “A...” shpk me ofertë 3,270,812 lekë me ofertë më të leverdishme me datë 29.3.2022.

Me datë 9.3.2022 pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO arrin në konkluzioni se plotëson kriteret e DST dhe shpallet fitues.

Me datë 30.3.2022 është ngarkuar në sistem SPE, formulari i njoftim fituesit i cili është publikuar datë 31.3.2022.

Midis shoqërisë “A...” Shpk dhe Bashkia Finiq, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 947, datë 14.4.2022 për “*Mirëmbajte e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës*” me vlerën 3,270,812 lekë pa TVSh. me afat punimesh 40 ditë.

Titulli gjetjes: *Mos zbatimi në afat I kushteve të kontratës.*

Situata:

Midis shoqërisë “A...” shpk dhe Bashkia Finiq, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 947, datë 14.4.2022 për “*Mirëmbajte e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës*” me vlerën 3,270,812 lekë pa TVSh, me afat 40 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës (neni 6), **ose nga data 14.4.2022 deri me datë 3.6.2022**

Pagesat e kryera sipas situacioneve:

Mirëmbajte e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditëse	60/11.05.2022	2,335,109	207/18.05.2022	2,335,109
	129/30.08.2022	1,589,358	442/06.10.2022	1,589,109
		3,924,467		3,924,218

Nga të dhënat konstatohet se një situacion është jashtë afateve të kontratës ose me **86 ditë vonesë**.

Nga sa më sipër për përfundim të punimeve brenda afatit ose me 88 ditëvonesë, në zbatim të pikës 14 pika 14.1⁵ të kontratës nr. 947, datë 14.4.2022, ndajë subjekti bashkia Finiq për periudhën nga 14.7.2022 deri me datë 30.8.2022, duhet të llogarisë penalitet në shumën 287,831 $\{(3,270,812 \text{ lekë} \times 25\%) = (817,703 \times 4/1000 \times 88 \text{ ditë})\}$.
Gjatë fazës së auditimit në terren nga Drejtoria e Shërbimeve nuk u paraqitur dokumentacion mbi kushtet e zbatimit të kontratës.

Kriteri:

Në kundërshtim me nenin 6 të kontrata nr. 947, datë 14.4.2022 për “*Mirëmbajte e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës*”.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i kushteve të kontratës, ka pasojë në buxhetin e bashkisë Finiq për vlerën 287,831 lekë.

Shkaku:

Përgjegjësi **z. A. K me detyrë Përgjegjës Sektori i ujitjes dhe kullimit, A. M me detyrë Drejtor Drejtoria e Bujqësisë dhe Ujitje - Kullimit, si dhe z. K. D me detyrë Specialist I menaxhimit dhe mbrojtjes të tokës si person përgjegjës për zbatimin e kontratës, kjo sipas urdhrin nr. 68, datë 19.4.2022.**

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Shërbimeve për menaxhimin e kontratave të analizojë dosjen e procedurës me objekt “*Mirëmbajte e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës*”, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 68, datë 19.4.2022 (mbi afatin e punimeve), dhe në rast të mungesës së dokumentacionit mbështetës të marri masa në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Finiq duke ndjekur të gjitha rrugët

⁵ Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditorë do të jetë 4/1000 e vlerës së kontratës së mbetur nga cmimi i përgjithshëm i kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **287,831 lekë nga subjekti “A...” shpk.**

6- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Zëvendësim pompe në statcioni e pompave të ujësjellësit të fshatit Muzinë”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Zëvendësim pompe në statcioni e pompave të ujësjellësit të fshatit Muzinë.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 16, datë 3.6.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 16, datë 3.6.2022	4. Komisioni VO nr. 16/1, datë 3.6.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Me negociim pa shpallje paraprake”,	I. B A. K L. M	K. TH M. C S. J
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,500,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “I...” ShPK me vlerën e ofertës 2,382,752 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 95.2 %.
8. Data e hapjes së tenderit 13.6.2022 REF -318760-06-2022	9. Burimi Financimit Bashkia Finiq.	10. Operatorë Ekonomike 2: a- Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 1 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
13. Lidhja e kontratës Nr. 1640, datë 27.6.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 2,382,752 lekë me afat 15 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Nga të dhënat konstatohet se procedurë e përdredhur “Me negociim pa shpallje paraprake”, është në kundërshtim me pikën (c)⁶ të nenit 47- *Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*, rë ligjit nr. 162, datë 21.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe neni 52 - *Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*, të VKM nr. 285, datë 19.5.2022 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, **veprime të cilat ngarkojmë me përgjegjësi zj. I. B me detyrë Juriste në Drejtorinë Juridike.**

Preventivi është hartuar nga specialistët **ing. A. K**, bazuar në çmimet sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuan kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 825, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensë profesionale të Kat NP -11/A, pasi referuar zërave të punimeve nuk ka punime që justifikojnë këtë kategori liçensë.

⁶ c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti ose enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negociim ose procedurat me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për kontratat e nënshkruara në përfundim të një procedure prokurimi sipas kësaj shkronje, nuk mund të përdoret procedura me negociim, pa shpallje paraprake për mallra, shërbime ose punë shtesë, sipas parashikimeve në këtë nen

Ky kriter është i paargumentuara pasi referuar zërave të punimeve nuk justifikojnë kërkesat për to, duke ngarkuar me përgjegjësi **z. A. K me detyrë Përgjegjës Sektori i Ujitjes dhe Kullimit si personi në hartimin e specifikimeve teknike.**

- **Zhvillimi procedurës.**

Me vendim të KB nr. 51, datë 24.12.2021 është miratuar fondi për prokurimin me objekt “Zëvendësim pompe në stacioni e pompave të ujësjellësit të fshatit Muzinë” me vlerë 2,500,000 lekë pa TVSh.

Me urdhrin e prokurimit nr. 16, datë 3.6.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 2,500,000 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “Me negociim pa shpallje paraprake” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 16/1, datë 3.6.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 13.6.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 6.6.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 16, datë 3.6.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 13.6.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Nga OE pjesëmarrjes dhe APP nuk ka pasur ankesa për DST. Nuk ka pasur ankesa nga OE.

Me datë 13.6.2022 ora 10.00 në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”, nga anëtari i NJP z. V. K (person i autorizuar) në faqen zyrtare të APP.

Pas përfundimit të dorëzimit të ofertave, anëtarët e KVO në mënyrë të pavarur kanë bërë vlerësimin.

Konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

7- Shoqëria “I...” shpk me ofertë 2,382,752 lekë.

8- Shoqëria “O...” shpk me ofertë 2,422,000 lekë.

Në përfundimi të vlerësimit të dokumentacionit, KVO nga 2 OE ka kualifikuar 2 OE.

Midis shoqërisë “I...” Shpk dhe Bashkia Finiq, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 1640, datë 27.6.2022 për “Zëvendësim pompe në stacioni e pompave të ujësjellësit të fshatit Muzinë” me vlerën 2,382,752 lekë pa TVSh. me afat punimesh 15 ditë.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “I...” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK.

Pika 2.5 e programit. Mbi zbatimin e procedurave të lejeve të ndërtimit dhe zhvillimit.

Bashkia Finiq ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.2, datë 10.02.2021.

Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për periudhën 01.01.2022- 31.12.2022

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Finiq, gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022, janë zhvilluar aplikimet dhe miratimet për lejet e ndërtimit të paraqitura.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Finiq, rezulton se janë miratuar **leje ndërtimi**, ndër të cilat:

1- Leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar 2 leje ndërtimi.

- 2- Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **0 leje** ndërtimi.
- 3- Leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m² janë miratuar **0 leje** ndërtimi.
- 4- Leje për shtesë në ndërtimin ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar **0 leje** ndërtimi.
- 5- Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni janë miratuar **0 leje**.
- 6- Leje ndërtimi për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit janë miratuar **1 leje**.
- 7- Leje për ndryshim funksioni dhe **leje** ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni, janë miratuar **0 leje**.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit dhe dhënia e certifikatave të përdorimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m²:

Nr.	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Preventivi sipas subjektit / Lekë
1.	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	“Objekt akomoduese në funksion të agroturizmit”	V. LL	Vendim Nr. 107, datë 15/04/2022	52,105,451 Lekë
2.	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	“Magazinë për produkte bujqësore 1 kat”	A. A	Vendim Nr.1492 datë 10.6.2022	8,059,712 Lekë

Titulli gjetjes 1. Miratim i lejes së ndërtimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për lejen e ndërtimit të miratuar me vendim Nr. 107, datë 15/04/2022, të Kryetarit të Bashkisë Finiq për objektin “Objekt akomoduese në funksion të agroturizmit”, me zhvillues V. LL, në Vrion, Finiq

Situata:

Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, për të cilën është marrë vendimi Nr.107, datë 15/04/2022, i Kryetarit të Bashkisë Finiq për objektin “Objekt akomoduese ne funksion te agroturizmit”, me zhvillues **V. LL**, në Vrion, Finiq, u konstatua si më poshtë:

1.Bashkia Finiq ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren Vendore të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.2, datë 10.02.2021. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, nga mbivendosja e parcelës me planin, konstatohet se parcela bën pjesë pjesërisht në njësinë strukturore FQ_B_B2_566/1 mbi 50% e sipërfaqes dhe në njësinë strukturore FQ_UB_A1_16/1, të paraqitur në mbivendosjen e mëposhtme. Gjithashtu në dokumentet e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, statusi i tokës është arë dhe nuk është konvertuar në statusin truall. **Për këtë arsye, kondicionet urbane dhe kriteret nevojiten të bazohen në të parametrat e përcaktuara në njësinë FQ_B_B2_566/1.**

Në bazë të të dhënave të njësisë FQ_B_B2_566/1, njësia bën pjesë në sistemin B_Bujqësor dhe për kategorinë e tokës bujqësore 90% dhe 10 % për bujqësi + banim.

Duke ju referuar Rregullores Vendore, në Nenin 31 përcaktohet së në njësitë që i përkasin sistemit bujqësorë lejohet zhvillimi i aktiviteteve agroturistike dhe ekoturistike, me kushtet e pasqyruara më poshtë.

Në pikën 1 dhe në pikën 4, të Nenit 31 përcaktohet se duhen marrë miratimet nga institucionet përgjegjëse dhe duhet të njoftohen zyrtarisht Ministrinë e Linjës për zhvillimin e agroturizmit në zonë. **Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-Leje nuk pasqyrohet mendimi dhe miratimi nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe nga Ministria e Turizmit.**

3. Në bazë të VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, Neni 15, pika (c), në planin e vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese **nuk pasqyrohet rievimi topografik i punuar nga një inxhinier topograf i licensuar.**

4. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, “Neni 34, pika 2, përcaktohet se distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:

$d = nr. k \text{ obj. A} + nr. k \text{ obj. B} + 2m$. Në bazë të planvendosjen së miratuar, distanca minimale ndërmjet objekteve është ruajtur 2.9 metra -3.3 metra, **nga distanca minimale prej 4 metrash që duhet respektuar për objektet në lartësinë e 1 kati, sipas formulës $1k + 1k + 2 m = 4 \text{ metra}$.**

5. Duke u bazuar tek ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, në bazë të Nenit 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika1, përcakton se:" Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.”

-Llogaritja në bazë të çmimit për metër katror, duke ju referuar çmimit të entit të banesave është si më poshtë: $600 \text{ m}^2 \times 32 \text{ 739 leke/m}^2 \times 2\% = 392,868 \text{ Lekë}$

-Llogaritja me vlerën e preventivit: $52,105,451 \text{ lekë} \times 2\% = 1,042,109.02 \text{ Lekë}$

Llogaritja e vlerës sipas bashkisë është 1,043,000 Lekë, të pasqyruar më poshtë.

Titulli gjetjes 2. *Miratim i lejes së ndërtimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për lejen e ndërtimit të miratuar me vendim Nr. 1492, datë 10/06/2022, të Kryetarit të Bashkisë Finiq për objektin:” Magazinë për produkte bujqësore 1 kat”, me zhvillues A. A, në Finiq.*

Situata:

Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, për të cilën është marrë vendimi Nr.1492, datë 10/06/2022, të Kryetarit të Bashkisë Finiq për objektin:” Magazinë për produkte bujqësore 1 kat”, me zhvillues A. A, në Finiq, u konstatua si më poshtë:

1. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, nga mbivendosja e parcelës me planin, konstatohet se parcela bën pjesë në njësinë strukturore FQ_B_EB1_19/4. Njësia bën pjesë në sistemin B_Bujqësor, në kategorinë EB Ekonomi Bujqësore 100%. Në dokumentet e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, statusi i tokës është arë dhe tipologjia e ndërtimit është në funksion të bujqësisë. Duke qenë që objekti “Magazinë për produkte bujqësore 1 kat” është një tipologji ndërtimi që bën pjesë në objektet që janë në funksion të bujqësisë, për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial dhe duhet të jetë në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit si dhe marrjen e konfirmimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të VKM-së Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar.

2. Në bazë të VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, Neni 15, pika c, në planin e vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen

ekzistuese **nuk pasqyrohet rievimi topografik i punuar nga një inxhinier topograf i licensuar.**

4. Duke u bazuar tek ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, në bazë të Nenit 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika1, përcakton se: "Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri."

Mënyra e llogaritjes së taksë së ndikimit në infrastrukturë në bazë të preventivit është si më poshtë: 8,059,712 Lekë x 2% = 161,194.24 lekë.

Llogaritja e vlerës sipas bashkisë është 161,500 Lekë, të pasqyruar më poshtë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:

K. K, me detyrë Kryetari i Bashkisë Finiq

I. DH, me detyrë Specialist topograf në DPTZH

V. L, me detyrë Drejtor i PZHT

Pika 2.6 e programit. Mbi veprimtarinë e Inspektoriati Mbrojtjes Territorit.

Në lidhje me plotësimin e kritereve arsimore të punonjësve të IMT-së, sipas përcaktimeve të nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme" janë konstatuar:

Duke ju referuar përcaktimeve të nenin 11 të ligjit Nr. 183/2014 datë 24.12.2014, të arsimimit të kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit përcaktohet se: "Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në Fakultetin e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit", nga 3 punonjës të inspektoratit të mbrojtjes së territorit, 2 punonjës nuk e plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/ inspektorë.

Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Finiq, të paraqitur në tabelën e mëposhtme, dy inspektorë nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës:

1. z.A. M, me pozicion inspektor, ka përfunduar arsimin e mesëm;
2. z.I. B, me pozicion inspektori ka përfunduar arsimin e mesëm; të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Data e largimit nga puna ose ndryshim i pozicionit
1	S. S	Kryeinspektor	Arsimimi i Lartë Diplomë Master I Shkencave në të Drejtën Civile	Nr. 94 datë 30.06.2020	07.11.2022_Ndryshim i pozicionit të punës
2	A. M	Inspektor	Arsimimi i mesëm Bujqësor	Nr. 85 datë 17.06.2020	Vijon ende në proces pune
3	I. B	Inspektor	Arsimimi i mesëm Bujqësor	Nr. 69 datë 16.03.2021	Vijon ende në proces pune

Titulli i Gjetjes: Mosplotësimi i kritereve arsimore i punonjësve të IVMT-së

Situata:

Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Finiq, nga 3 punonjës të inspektoratit të mbrojtjes së territorit, dy prej tyre nuk kanë kualifikimin e duhur dhe nuk plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për

pozicionin e punës si inspektorë, të evidentuar më poshtë: Z. A. M, me pozicion inspektor, ka arsimim të mesëm me profil Bujqësor, ndërsa Z. I. B, me pozicion Inspektor ka arsimim të mesëm me profil Bujqësor. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Kriteri:

Ligji Nr.183/2014,datë 24.12.2014,nenin 11,të arsimimit të kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit përcaktohet se:

"Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në Fakultetin e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit".

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e formimit profesional të nevojshëm për pozicionin e punës, ndikon në zbatimin e detyrës si inspektor në Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Finiq.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë për shpalljen e pozicioneve të punës në strukturën e IMTV për punësimin e punonjësve të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

- Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IVMT.

Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Finiq, gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, nuk ka marrë asnjë vendim për "Dënim me gjobë", duke mos kryer ushtruar kontrole dhe verifikime për zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit duke mos kryer detyrën funksionale për të cilën janë punësuar.

Në raport me vendimet e marra nga IVMT për prishjen e objekteve pa leje dhe ekzekutimin e vendimeve të IVMT-së, janë pasqyruar më poshtë të dhënat e vendosura në dispozicion nga Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit. Më poshtë pasqyrohet tabela e vendimeve "Për prishje objekti", për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 dhe vendimet e ekzekutuara:

Në bazë të vendimeve dhe të dhënave të vendosura në dispozicion, janë marrë 3 vendime për prishje objekti, nga të cilat asnjë vendim nuk është ekzekutuar dhe nuk evidentohen masa të ndërmarra për ekzekutimin e tyre.

Nr.	Emër	Mbiemër	Nr. Vendimit	Datë	Lloji i objektit	Ekzekutuar
1	S	D	25	05.05.2022	Mur me blloqe betoni	Vendimi nuk është ekzekutuar
2	S	D	26	05.05.2022	Porte metalike	Vendimi nuk është ekzekutuar
3	I	A	32	05.05.2022	Gardh	Vendimi nuk është ekzekutuar

Burimi i të dhënave: Bashkia Finiq

Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IVMT për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative, u konstatuan 3 vendime për prishje objekti të cilat janë të pa ekzekutuara nga IVMT, në bazë të legjisllacionit në fuqi.

Titulli i Gjetjes 2: *Mosekzekutimi i vendimeve nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Finiq.*

Situata:

Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, nga 3 vendime për prishje objekti asnjë prej këtyre vendimeve nuk është ekzekutuar nga IVMT-ja. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Kriteri:

Ligji Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, Neni 13, dhënia e vendimeve administrative dhe afatet, Ligji Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, Neni 15, kundërvajtjet administrative të kryeinspektorëve/inspektorëve dhe gjobat, Ligji Nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9/neni 22.

Ndikimi/Efekti:

Mosekzekutimi i vendimeve të marra ndikon në lejimin e zhvillimeve të ndërtimeve informale.

Shkaku:

Mos zbatim i legjislacionit nga IVMT për ndjekjen e hapave ligjorë për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi. Gjithashtu për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi, IVMT të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

- *Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IVMT lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi, në zbatim të ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, “Për inspektimin e ndërtimit”, Neni 10, Neni 12, Neni 15 dhe në zbatim të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, i ndryshuar, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 50, Neni 51, Neni 52.*

Në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të lejeve të ndërtimit u evidentuan 2 objekte të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi dhe një objekt i cili ka përfunduar punimet pa deklaruar fillim punimesh, dhe është në përdorim pa u pajisur me certifikatë përdorimi, të pasqyruara më mëposhtë:

Titulli i Gjetjes 3: *Janë ndërtuar objekte pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaruar fillimin e punimeve dhe pa u pajisur me certifikatë përdorimi.*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe verifikimi i bërë në terren mbi procedurat e ndjekura nga IMTV Finiq, në lidhje me zbatimin në terren të kushteve për lejet e ndërtimit dhe veprimtaria e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë, rezultoi se:

1.Nga verifikimi në terren dhe nga foto ajrore evidentohet ndryshimi i gjurmës së dy objekteve dhe shtim volumesh ndërtimore, pa u pajisur me leje ndërtimi, në pronësi të **Znj.**

D. Q. Nga foto ajrore pasqyrohet qartë gjendja e parcelës në vitin 2021 dhe gjendja e parcelës në vitin 2022 pas ndërhyrjeve me ndërtime të reja në të.

Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Finiq, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim **të ligjit 107, Neni 51, Inspektimi e Neni 52, Kundërvajtje administrative dhe ligji 9780**, ka sjellë si pasojë shtimin e volumeve të ndërtimit të objektit pa u pajisur me leje ndërtimi.

2. Nga verifikimi në terren dhe nga foto ajrore evidentohet që në parcelën me pronësi të **Z. H. D**, në fshati Vrion është shtuar një volum në ndërtimin ekzistues, të pajisur me leje ndërtimi me vendimin Nr. 96, datë 23.09.2021. Objekti ka përfunduar punimet pa bërë deklaratë fillim punimesh dhe është në përdorim pa u pajisur me certifikatë përdorimi. Nga verifikimi i realizimit të ndërtimit të terren evidentohet që fasada veriore nuk është realizuar në përputhje me projektin e ndërtimit. Gjithashtu evidentohet që objekti ka përfunduar punimet dhe është në përdorim pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Finiq, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim **të ligjit 107, Neni 51, Inspektimi e Neni 52, Kundërvajtje administrative dhe ligji 9780**, ka sjellë si pasojë mosrealizimin e ndërtimit në përputhje me projektin e ndërtimit dhe përdorimin e tij pa u pajisur me leje ndërtimi.

Inspektoriat i Ndërtimit të Territorit në Bashkinë Finiq nuk ka plotësuar detyrat funksionale, në zbatim të kuadrit ligjor për Inspektimit.

Kriteri:

Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, neni 12, Ushtrimi i kontrollit dhe ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 51, Inspektimi.

Ndikimi/Efekti:

Zbatimi i realizimit të punimeve të ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informale të ndërtimeve, pa u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar dhe në legjislacionin në fuqi. Ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Finiq.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë: Nga IVMT Finiq të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi. Gjithashtu për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi, IVMT të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Për sa më lart, mbajnë përgjegjësi:

Zj. S. S, me pozicion Kryeinspektori IVMT Finiq, nga periudha 30.06.2021 -07.11.2022,

Zj. A. M, me pozicion inspektor i IVMT-së Finiq, nga periudha 17.06.2020 e në vijim,

Z. I. B, me pozicion inspektor i IVMT-së Finiq, nga periudha 16.03.2021 e në vijim

Pika 2.7 e programit. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimet e mëparshme.

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

KLSH-ja ka dërguar në Bashkinë Finiq rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 689/7 datë 01.11.2022. Nga Bashkia Finiq për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk ka kthyer përgjigje as në afatin e **20 ditëve** dhe as në aftin e 6 mujorit, në kundërshtim me nenet 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga Bashkia Finiq nuk është hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve”, si dhe nuk është **raportuar në** Këshillin Bashkiak, mbi rezultatet e auditimit të kryera nga KLSH dhe marrjen e masa për zbatimin e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika 5 e nenit 50-Auditimi i jashtëm.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk është zbatuar 10 masa.

b. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar 6 masë me vlerë 200,267 mijë lekë, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 6 masa, ku nga vlera e rekomanduar prej 200,267 mijë lekë është arkëtuar vlera 18,215 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 182,052 mijë lekë.

d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 4 masa të pranuar plotësisht, rezulton se nuk është zbatuar asnjë masë.

A. Masa organizative

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë publike. Të hartohen rregulla për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik. Të hartohet strategjia e riskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

Menjëherë

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Finiq të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të veta si: llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, 214 “*Instalime teknike*, duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre Aseteve.

Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

Menjëherë

4.1 Rekomandimi: Drejtorja e Financës në Bashkinë Finiq, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 30,809,350 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Delvinë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Menjëherë

5.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës në Bashkinë Finiq, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”,

deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Menjëherë

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq nëpërmjet personave përgjegjës, të marrë masa të menjëhershme, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtori Sarandë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë

8. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e të Ardhurave Bashkia Finiq, të marrë masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Finiq, të marrë masa si vijon:

- Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e paguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe për çdo program.
- Planifikimin e procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (*faturave të palikujduara*), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbime/ investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Finiq.
- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.
- Të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.
- Të monitorojë dhe miratojë raportet 4 mujore e buxhetit.

Menjëherë

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Kontratave të përcjellë pranë Drejtorive Rajonale Tatimore përkatëse, të gjitha rastet kur faturat e shitjeve janë paraqitur me vonesë dhe pa shkaqe nga momenti i kryerjes së punimeve/shërbimit, me qëllim vlerësimin e mos deklarimit në afat për TVSH në shitje.

Menjëherë

11.1. Rekomandimi: Bashkia Finiq nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për menaxhimin e aseteve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasë për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë dhe plotësimin e nevojave për komunitetin, por dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre procedura.

Menjëherë

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përsheptimin e zbatimit për ato

që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1116/8 datë 01.11.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

Menjëherë

B. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **5,300,000 lekë** nga **3 subjektet**, respektivisht;

- vlera **1,100,000 lekë** nga subjekti “T...” ShPK;
- vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti “G...” ShPK;
- vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti “K...” ShPK;
- vlera **2,200,000 lekë** nga subjekti “B...” ShPK

Menjëherë

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave Bashkia Finiq, të marrin të gjitha masat dhe të mos lejojnë lidhjen e kontratave të shërbimi/investimit me subjektet fituese pa likuaduar detyrimet për taksat vendore sipas paketave fiskale.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **108,000 lekë**, respektivisht:

- vlera **54,000 lekë**, ndaj subjektit ”M...”.
- vlera **54,000 lekë**, ndaj subjekti “E...”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Finiq, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale, respektivisht:

1. **Znj. L. M**, me detyrë Drejtore e Financës.
2. **Z. I. N**, me detyrë Drejtor i Ardhurave
3. **Z. TH. Z** me detyrë P/ Ardhura Vendore
4. **Z. J. B**, me detyrë P/ Ardhura Vendore

Menjëherë

Kriteri:

Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **5,408 mijë lekë**.

Shkaku:

Neglizhencë dhe papërgjegjshmëri e strukturave drejtuese, **z. K. K**, me funksion Kryetar i Bashkisë Finiq, **znj. L. M**, me funksion Drejtor Finance, **z. I. N** me funksion Drejtor i Taksave Bashkia Finiq, **znj. I. E**, me funksion Drejtor i Burimeve Njerëzore, **z. Z. K**, me detyrë Përgjegjës Sektori i Pyjeve dhe Kullotave.

Rëndësia: I Lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për përshpejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 689/7 datë 01.11.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”.

Më hollësisht janë trajtuar në Aneksin 7.1 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIM

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

Në Bashkinë Finiq, nuk është miratuar kodi i etikës profesionale në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në papajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit” pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 dhe neni 16 pika 2. Gjithashtu, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar.

Lidhur me identifikimin e aktiviteteve më risk, hapjen e regjistrimit të riskut si dhe menaxhimin e tij, në Bashkinë Finiq, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore pasi nuk është caktuar koordinatori i riskut në kundërshtim me kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010. Për rrjedhojë nuk është miratuar Strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e riskut.

Nga ana e Titullarit të Bashkisë Finiq, nuk janë nxjerrë urdhër me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, por njësitë organizative kanë të përcaktuar detyrat e tyre në rregulloren e funksionimit të brendshëm të institucioni.

Nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 27. Për rrjedhojë, Planet e Zhvillimit Strategjik dhe planet buxhetore afat mesëm, nuk janë miratuar nga GMS-ja në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 dt. 29.3.2012 “Procedura e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.

Informimi dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 34-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve.
- Të ngrëjë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar.
- Të caktojë koordinatorin e riskut.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në F...t kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen me risk të lart, të tilla si:

prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 35-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Finiq të marrë masa për planifikimin në programet e auditimit të veprimeve kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si F... me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor) është në vlerën 1,211,327 mijë lekë, i miratuar me VKB nr. 94, datë 28.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Finiq të vitit 2022 dhe PBA-ve 2022-2024”, por jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27/04/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 3, ku përcaktohet që: “Bazuar në vlerësimin e të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor, miraton projektbuxhetin sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji”. Vendimi i miratuar nga Këshilli Bashkiak është bazuar në projektvendimin dhe relacionin e hartuar nga Drejtori i Financës dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Finiq sipas shkresës me nr. 6785 prot., datë 24/12/2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Finiq për vitin 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”. Ky dokumentacion është dërguar pranë Këshillit Bashkiak jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27/04/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 1, ku përcaktohet që: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për miratimin në këshill projektbuxhetin vjetor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 43-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që projektvendimi dhe relacioni për buxhetin vjetor të dërgohet për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda afateve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënave për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit u konstatua se: Në buxhetin e miratuar për vitin 2022, konstatohet se jo e gjithë shuma e detyrimeve kreditore të jetë programuar për likuidim e cila sipas pasqyrave financiare më datën 31/12/2021, paraqitet në shumën totale 52,734,478 lekë ose 8.25% e buxhetit fillestar, ndërsa në buxhetin vjetor janë parashikuar fonde në vlerën 20,880,381 lekë me një diferencë më pak planifikimi për likuidim në vlerën 31,854,097 lekë, ose një planifikim në masën 39.5%. Kjo iniciativë nuk është në përputhje me kuadrin ligjor të parashikimit dhe zbatimit të buxhetit pasi, sjell një mbartje në vazhdimësi të detyrimeve ndaj të tretëve, duke qenë se nuk u jepet prioritet detyrimeve të cilat kanë mbetur pa u likuiduar nga viti i mëparshëm. Kjo situatë mund të sjellë edhe një rritje të detyrimeve pasi, të tretëve u lind e drejta të kërkojnë interesa nga likuidimi me vonesë i faturave të prapambetura. *Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e*

Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zhvillimit të buxhetit", neni 101. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 43-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që në hartimin e buxhetit të vitit pasardhës të mbahet në konsideratë shuma totale e detyrimeve të papaguara nga viti i mëparshëm me qëllim shmangien e pasojave financiare më tepër se vlera e detyrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e vetë Bashkisë Finiq së bashku me transferta e pa kushtëzuara, për 2022 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Konkretisht shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 736,389 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 700,417 mijë lekë ose në masën 95.1%, sipas artikujve: paga në masën 93.8%, sigurime në masën 93%, shpenzime operative në masën 97.1%, dhe investime në masën 94%. Sipas burimeve të financimit për vitin 2022, nga transferta e pakushtëzuar (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 133,251 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 127,444 mijë lekë ose në masën 95.6%.

Nga këto investime nga vlera 30,068 mijë lekë planifikuar është realizuar në vlerën 24,229 mijë lekë ose në masën 80.6%, kjo për shkak se faturat për likuidim janë të muajit dhjetor 2022 që janë pasqyruar si detyrime të viti në mbylljen e pasqyrave financiare.

Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 75,405 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 71,692 mijë lekë ose në masën 95.07%.

Nga këto, paga nga vlera 40,601 mijë lekë planifikuar është realizuar në vlerën 35,956 mijë lekë ose në masën 88.55%, Sigurime shoqërore nga 5,795 mijë lekë është realizuar në vlerën 4,550 mijë lekë ose në masën 78.5%, shpenzime operative nga 26,212 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 25,386 mijë lekë ose në masën 96.8% dhe investime nga 15,917 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 2,123 mijë lekë ose në masën 13.3%, kjo për shkak i mosrealizimit të të ardhurave vjetore të cilat nga vlera 91,018 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt për vlerën 71,770 mijë lekë.

Pra planifikimi i shpenzimeve buxhetore nuk është real dhe i mbështetur në burime të sakta financimi për të ardhurat e veta. Po ashtu në planifikimin e shpenzimeve nuk janë marrë në konsideratë faturat e pa likuiduara të vitit paraardhës që për vitin 2022 janë në vlerë n 52,734 mijë lekë ose në masën 7.7% e buxhetit fillestar.

Në planifikimin e shpenzimeve nuk janë marrë në konsideratë faturat e pa likuiduara të vitit paraardhës që për vitin 2021 janë në vlerën 52,734 mijë lekë , nga e cila janë planifikuar në buxhetin e vitit vijuar vlera prej 20,880,381 mijë lekë ose 39.5 % e totalit Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008, "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 139/2015, datë 17/12/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", UMF nr. 10, datë 27.02.2020, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023", i ndryshuar, Udhëzimi nr. 23, datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Nga transferta e pakushtëzuar sektoriale treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 486,652 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 396,707 mijë lekë ose në masën 85%. Nga këto investime nga mijë 416,161 lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 340,628 mijë lekë ose në masën 81.8% kjo për shkak se kë to diferenca janë për arsye se nuk çelur fondet sipas buxhetit nga Ministria e Linjës (Infrastrukturës dhe Energjisë).

Nga fondet e deleguara treguesit e buxhetit janë planifikuar për 105,628, mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 104,373 mijë lekë ose në masën 99%.

Sipas planifikimit dhe realizimit në buxhet për vitin 2021, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej nga 91,018 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë çelur në thesar sipas realizimit faktik dhe ato të trashëguara në vlerën 71,770 mijë lekë ose 78.8 %, **me një mosrealizim në vlerën 19,248 mijë lekë.**

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Finiq në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 43-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Finiq, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, të marrin masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Finiq në datën 01/01/2022, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 36,914,135 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2022 vlera 14,616,267 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 14,616,267 lekë, ose 100 % e vlerës së planifikuar, diferenca prej 0 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 11,457,782 lekë, duke e çuar në 31/12/2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 33,755,650 lekë. Bashkia Finiq ka detyrime të prapambetura me burim financimi nga granti, në vlerën 15,820,343 lekë, Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2022 vlera 6,264,114 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 6,264,114 lekë, ose 100 % e vlerës së planifikuar, është krijuar gjatë vitit 2022 detyrim me vlerë 4,910,479 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31/12/2022 në vlerën 14,466,708 lekë. Pra në total, gjatë vitit 2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31/12/2022, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01/01/2022), është ulur me 3,158,485 lekë, ose në masën prej 10 %. Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime në vlerën 16,477,322 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 2,461,510 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 122,400 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 14,694,418 lekë. Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion. Veprime jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 43-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës

të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Finiq dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 10 procedurave të vlerësuara për auditim për periudhën 01/01/2022 – 31/12/2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në **aplikimin e kriterëve** të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara gjithsej **3 procedura** me fond limit **21,692 mijë** lekë, kriterë të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit
1	Hartim Dokumentacioni për Regjistrimin Fillestar te tokave bujqësore per fshatrat Caush,Finiq,Mavropull	15,000,000
2	Mirëmbajtje e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditëse	4,192,500
3	zëvendësim pompe ne stacionin e pompave te ujësllësit te fshatit Muzine	2,500,000

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj.

Vendosja si kriterë e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht çënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “Për prokurimin publik”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

- Mos argumentimi i kërkesave për numrin e punonjësve të mjeteve në raport me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit , etj, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *“Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”* dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 111-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Finiq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kriterë të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit të dhëna në bashkinë Finiq, rezultoi se:

Leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **2 leje** ndërtimi.

Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **0 leje** ndërtimi.

Leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m² janë miratuar **0 leje** ndërtimi.

Leje për shtesë në ndërtimin ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar **0 leje** ndërtimi.

Leje ndërtimi për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni janë miratuar **0 leje**.

Leje ndërtimi për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit janë miratuar **1 leje**.

Leje për ndryshim funksioni dhe **leje** ndërtimi për rikonstrukcion me ndryshim funksioni, janë miratuar **0 leje**.

Bashkia Finiq ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren Vendore të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.2, datë 10.02.2021.

Nga grupi i KLSH u audituar dy leje ndërtimit me përzgjedhje nga ku rezultojë se:

1- Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, për të cilën është marrë **Vendimi Nr.107, datë 15/04/2022**, i Kryetarit të Bashkisë Finiq për objektin “Objekt akomoduese ne funksion te agroturizmit”, me zhvillues **V. LL**, në Vrion, Finiq.

- Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, nga mbivendosja e parcelës me planin, konstatohet se parcela bën pjesë pjesërisht në njësinë strukturore FQ_B_B2_566/1 mbi 50% e sipërfaqes dhe në njësinë strukturore FQ_UB_A1_16/1, të paraqitur në mbivendosjen e mëposhtme. Gjithashtu në dokumentet e pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, statusi i tokës është arë dhe nuk është konvertuar në statusin truall. **Për këtë arsye, kondicionet urbane dhe kriteret nevojiten të bazohen në parametrat e përcaktuara në njësinë FQ_B_B2_566/1.**

Duke ju referuar Rregullores Vendore, në Nenin 31 përcaktohet së në njësitë që i përkasin sistemit bujqësorë lejohet zhvillimi i aktiviteteve agroturistike dhe ekoturistike, me kushtet e pasqyruara më poshtë.

- Në bazë të VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, Neni 15, pika (c), në planin e vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese **nuk pasqyrohet rievimi topografik i punuar nga një inxhinier topograf i licensuar.**

- Në bazë të VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, Neni 15, pika 1/1, në dokumentacionin që nevojite për pajisjen me leje ndërtimi nuk pasqyrohen projektet e mëposhtme:

iii) projektet e instalimeve hidrosanitare dhe të ngrohje-ftohjes;

iv) projektin për mbrojtjen nga zjarri, në rastet kur është e detyrueshme me ligj;

v) projektin e eficientës energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj.

- Në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, “Neni 34, pika 2, përcaktohet se distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:

$d = nr. k \text{ obj. A} + nr. k \text{ obj. B} + 2m$. Në bazë të planvendosjen së miratuar, distanca minimale ndërmjet objekteve është ruajtur 2.9 metra -3.3 metra, **nga distanca minimale prej 4 metrash që duhet respektuar për objektet në lartësinë e 1 kati, sipas formulës $1k + 1k + 2 m = 4 \text{ metra}$.**

2- Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²”, për të cilën është marrë **Vendimi Nr.1492, datë 10/06/2022**, të Kryetarit të

Bashkisë Finiq për objektin:” Magazinë për produkte bujqësore 1 kat”, me zhvillues A. A, në Finiq, u konstatua si më poshtë:

- Në bazë të VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, Neni 15, pika c, në planin e vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese **nuk pasqyrohet rilevimi topografik i punuar nga një inxhinier topograf i licencuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 127-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Finiq gjatë dhënies së lejeve të ndërtimit të marrë masa për:

- Respektimin e Planit të Përgjithshëm Vendore dhe Rregulloren Vendore të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.2, datë 10.02.2021.

- Respektimin e lejuar të përdorimi të tokës sipas legjislacionit në fuqi.

- Respektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.

- Respektimin e intensitetit të ndërtimit në zbatim të planit të përgjithshëm vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Me Urdhrin nr. 172, datë 30.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për t’u nxjerrë jashtë përdorimit nga komisioni i inventarizimit. Nga komisioni i vlerësimit është mbajtur procesverbali i datës 31.01.2023, ku janë propozuar për të nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën totale 4,309,706 lekë. Gjithashtu me Urdhrin nr. 173, datë 30.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Deri më datën 26.05.2023, në të cilën përfundon faza e auditimit në terren nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit aktivet në vlerën 4,309,706 lekë, por ky proces ka mbetur në fazën për miratim nga Këshilli Bashkiak.

Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve Afatgjata (kosto historike)” konstatohet se, vlera 4,309,706 lekë është pasqyruar si nxjerrje jashtë përdorimit në referencën e llogarisë 21-28, “II. Totali i Aktiveve Afatgjata Materiale” llogaria 218 “Inventar ekonomik” ndërkohë që këto aktive nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit. Veprime këto në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata jo Materiale” i përmirësuar, “Çregjistrimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale”, pika 73 dhe pika 74. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa të menjëhershme për sistemimin dhe kontabilizimin e vlerës 4,309,706 lekë në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” e cila ka të bëjë me parregullsinë e nxjerrjes jashtë kontabilitetit të aktiveve të cilat ende nuk kanë marrë miratimin përkatës nga strukturat drejtuese të institucionit për asgjësimin e tyre.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

10. Gjetje nga auditimi: Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31/12/2022, paraqitet në vlerën 17,314,771 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 4,927,580 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 12,387,192 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 7,603,684 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë. Kjo situatë ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të vlerës 7,603,684 lekë në llogarinë 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve”. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09/03/2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, nënpika 19. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të analizojë vlerën prej 7,603,684 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar së diferencës të ndryshimit të gjendjes së inventarit. Sistemi të kryhet sipas trajtimit kontabël kalimin e vlerës nga llogaria 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera prej 8,030,494 lekë e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve, për pasojë nuk është kryer inventarë fizik. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq, Livadhja, Dhiver dhe Mesopotam si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Finiq. Gjithashtu në këtë llogari është kontabilizuar edhe vlera 3,369,024 lekë kosto historike e cila i përket 2 projekteve (Projektim rikonstruksion rruga Dermish-Cerkovice (viti 2017) në vlerën 941,623 lekë + Projekti rehabilitimi i kanalit Filipeu në vlerën 2,427,401 lekë), të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël”, Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

11.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 3,369,024 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

12. Gjetje nga auditimi: 1. Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 300,000 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 300,000 lekë. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, për koston historike në vlerën 300,000 lekë Bashkia Finiq nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c”.

Gjithashtu Bashkia Finiq nuk ka marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, konkretisht në total

45 ndërtesa me sipërfaqe 140,821 m², 103 sipërfaqe tokë 19,551,687 m²/ml dhe 223 ha dhe 416 sipërfaqe truall 929,652 m²/ml.

2. Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 01/01/2022, paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në këtë llogari nuk janë pasqyruar 21,912.62 ha sipërfaqe nga të cilat: 12,012.45 ha sipërfaqe “Kullotë” dhe 9,900.17 ha sipërfaqe “Pyje”, në zbatim të VKM nr. 134, datë 03.03.2021, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” të ndryshuar”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të marrë masat për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë.

Të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale, si dhe të merren masa për regjistrimin e asetëve si pasuri e saj në ASHK.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtime konstruksione” për vlerën historike 292,008,026 lekë, është përfshirë vlera prej 99,236,804 lekë, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09/03/2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 31/12/2023

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, janë të pa analizuar në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet. Veprime Këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e

aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74, dhe Udhëzimin nr. 05, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09/03/2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

Deri me datë 31/12/2023

15. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2022 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat, për vlerën prej 223,919,792 lekë që i përkasin llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” objekti “Ndërtimi i Ujësjetës Rajonal nga burimet e Leshnicës Bashkia Finiq” me vlerë 194,463,572 lekë, “Rikonstruksioni i rrugës Karroq” me vlerë 6,499,572 lekë dhe “Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë” me vlerë 22,956,648 lekë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0 lekë, kur ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhet pasqyruar në vlerën gjithsej 223,919,792 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 05, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09/03/2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: 1. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në datën 01/01/2022, ka qenë në vlerën 4,196,325 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 37,550,052 lekë dhe pakësim në vlerën 35,084,002 lekë ndërsa në datën 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 6,662,374 lekë e cila përbëhet nga 18 shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash et., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

2. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 48,538,153 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 120,725,112 lekë dhe pakësim në vlerën 127,703,283 lekë ndërsa në datën 31/12/2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 41,559,983 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50, dhe VKM nr. 285, datë 19/05/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 85, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria Ekonomike të marrë masa të menjëhershme për pagesat e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 41,559,983 lekë. Gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e

faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Brenda datës 31/12/2023

17. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Finiq në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 74,484,868 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për 20 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Finiq janë ngurtësuar fonde në vlerën 20,228,104 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Delvinë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Kombëtare dhe Administrative dhe Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 20,228,104 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09/03/2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15/02/2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Kombëtare dhe Administrative të marrë masa për kalimin e fondeve të secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Brenda datës 31/12/2023

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se, për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 367,464,348 lekë dhe totali shpenzimeve është 329,368,466 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 38,095,882 lekë nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerë 34,719,433 lekë me një diferencë në vlerën 3,376,449 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09/03/2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 4 “Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” *(Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8)*, nënpika 4.1 “Shpenzimet në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe operacionet që lidhen me to”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të analizojë vlerën prej 3,376,449 lekë e cila ka të bëjë me mos kuadrumin e diferencës ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sistemimi të kryhet sipas trajtimit kontabël në llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 3 raste janë zhvilluar projekte artistike, aktivitete kulturore, shërbime catering apo rikonstruksion ambientesh për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjin nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18/11/2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19/05/2021, “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24/11/2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e këtyre shpenzimeve është kryer sipas Vendimit nr. 51, datë 24/12/2021, të Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë me shkresën nr. 2/1 prot., datë 17/01/2022. Nga Bashkia Finiq për periudhën nga data 01/01/2022 deri më 31/12/2022, për 3 subjekte është likuiduar shuma 1,219,128 lekë. Vlera 1,219,128 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria Ekonomike të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, mungojnë rregulla të shkruara dhe kriteret për zhvillimin dhe administrimit e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe rregulla lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë për punonjësit e Bashkisë Finiq të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17/11/2016, Kapitulli III, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit konstatohet se, për gjashtë punonjës të emëruar përpara periudhës objekt auditimi të cilët rregullojnë marrëdhëniet punës me Ligjin nr. 152/2013, datë 17/10/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, arsimi i tyre nuk përputhet me kriteret e pozicionit të punës.

Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Finiq, nga 3 punonjës të inspektoratit të mbrojtjes së territorit, dy prej tyre nuk kanë kualifikimin e duhur dhe nuk plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si inspektorë. Këto anomali nuk janë në përputhje me ligjin nr. 183/2014, datë 24/12/2014, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” nenin 11 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për:

- Hartimin e rregullave të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.
- Emërimet e nëpunësve civilë të kryhen në zbatim të kriterëve të pozicionit të punës duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.
- Shpalljen e pozicioneve të punës në strukturën e IMTV për punësimin e punonjësve të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), nga 3 vendime për prishje objekti, asnjë prej këtyre vendimeve nuk është ekzekutuar nga IMT-ja si dhe nuk është kërkuar mbështetje nga IKMT Qarku Vlorë, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16/07/2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, Neni 13, dhënia e vendimeve administrative dhe afatet, Ligji nr. 9780, datë 16/07/2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, Neni 15, kundërvajtjet administrative të kryeinspektorëve /inspektorëve dhe gjokat, Ligji nr.

10279, datë 20/05/2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9/neni 22 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 129-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të ekzekutojë vendimet e marra në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Në rast të pamundësisë së vendimeve të prishjes të kërkohet bashkëpunimi me IKMT qarku Vlorë për ekzekutimin e vendimeve të prishjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe auditimi i bërë në terren mbi procedurat e ndjekura nga IMT Bashkia Finiq, në lidhje me zbatimin në terren të kushteve për lejet e ndërtimit dhe veprimtaria e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë, rezultoi se:

Në dy raste nga auditimi në terren dhe nga foto ajrore evidentohet ndryshimi i gjurmës së objekteve dhe shtim volumesh ndërtimore, pa u pajisur me leje ndërtimi.

Në një rast nga auditimi në terren dhe nga foto ajrore evidentohet shtuar një volum në ndërtimin ekzistues, të pajisur me leje ndërtimi me vendimin. Objekti ka përfunduar punimet pa bërë deklaratë fillim punimesh dhe është në përdorim pa u pajisur me certifikatë përdorimi. Nga auditimi i realizimit të ndërtimit të terren evidentohet që fasada veriore nuk është realizuar në përputhje me projektin e ndërtimit. Gjithashtu evidentohet që objekti ka përfunduar punimet dhe është në përdorim pa u pajisur me certifikatë përdorimi. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Finiq, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve, ka sjellë si pasojë mosrealizimin e ndërtimit në përputhje me projektin e ndërtimit dhe përdorimin e tij pa u pajisur me leje ndërtimi. Veprime jo në përputhje me ligjin 107, neni 51, Inspektimi e neni 52, Kundërvajtje administrative dhe ligji nr. 9780, datë 16/07/2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 129-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1. Rekomandimi: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Finiq të marrë masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi. Gjithashtu për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi, IVMT të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të kontratave të lidhura, rezultoi së është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.2, date 20/07/2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, e konkretisht;

1. Nuk është hartuar plani i mbarështimit me të gjithë treguesit teknike të përcaktuar në pikën 1 të kreut II të Udhëzimit të mësipërm.

2. Nga ana e Zyrës së Pyje kullotave nuk është shpallur lista e kullotave të gatshme për kullotje dhe sipërfaqet që përjashtohen nga kullotja, në muajin Shkurt të cdo viti, me të gjitha të dhënat përkatëse, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 2 të Udhëzimit të mësipërm.

3. Nga ana e kërkuesve të marrjes me qira të kullotave është paraqitur kërkesë me shkrim në zyrën përkatëse, por jo brenda datës 10 Mars për kullotat verore dhe brenda datës 10 Korrik për kullotat dimërore me të dhënat përkatëse, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 3 dhe 4 të Udhëzimit të mësipërm.

4. Ne disa raste mungon certifikata veterinare e cila lëshohet cdo vit nga shërbimi veterinar, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 5/a te Udhëzimit të mësipërm.

5. Ne disa raste mungon vërtetimi nga NJA/bashkia për vendbanimin dhe numrin e bagëtive që kërkuesi ka në pronësi, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 5/b te Udhëzimit të mësipërm.

6. Ne shumicën e rasteve kontratat e lidhura për kullotat dimërore 2022 - 2023 janë lidhur me vonese, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e sipërpërmendur.

6. Nga ana e strukturave përgjegjëse për pyjet dhe kullotat nuk janë mbajtur proces verbalët e mbledhjeve për marrjen në shqyrtim të kërkesave dhe nuk janë hartuar vendimet përkatëse për miratimin apo mosmiratimin e tyre, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 9 te Udhëzimit të mësipërm.

7. Për të gjitha kontratat e lidhura, nuk është hartuar proces verbali i dorëzimit të kullotës i firmosur nga të dy palët, në kundërshtim me kreun II “Procedurat e dhënies për kullote dhe kositje bari”, pika 15 te Udhëzimit të mësipërm.

8. Nga ana e qiradhënësit, Bashkisë, nuk janë bërë sondazhe gjatë kullotjes për të mos lejuar futjen e bagëtive në kullote jashtë kapacitetit kullësor të kontraktuar, në kundërshtim me kreun III “Kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullësor për kullotje”, pika 7 te Udhëzimit të mësipërm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kërkesave teknike apo dhe dhënien me qera të sipërfaqeve kullësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga vlerësimi i bërë në lidhje me funksionimin e Njesisë së Ujitjes dhe Kullimit, e cila funksionon si pjesë e Drejtorisë së Bujqësisë në Bashki, në zbatim të kërkesave të ligjit nr 24/2017, date 09/03/2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, është konstatuar se:

- në paketën fiskale nuk ka një përcaktim të tarifave për ujitjen sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 24/2017, date 09/03/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, nenit 18 “Tarifat e shërbimit të ujitjes” pika 2 ku trajton së “Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve ose vëllimit të ujit të përdorur për cdo ujitje apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe”.

- Nga ana e Bashkisë Finiq nuk është përcaktuar në paketën fiskale, asnjë lloj tarife për mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit, kjo në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 24/2017, date 09/03/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, nenit 17 “Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës”.

- Nuk disponohej plani i masave për vënien në gatishmëri të veprave ujitëse dhe kulluese.

- Nuk ekzistonte programi i ujitjes apo dhe kullimit, ku të ishin pasqyruar kërkesat për këtë shërbim.

- Nuk është realizuar “Monitorimi” i shpërndarjes së ujit për ujitje”, si dhe funksionimi i sistemit të kullimit.

- Nuk janë përcaktuar dhe ndjekur tarifat për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes apo kullimit, si dhe nuk ka tarife të qarte në shërbim sipas kërkesave të nenit 18 “Tarifa e shërbimit të ujitjes” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1. Rekomandimi: Drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Finiq të analizojë problemet e konstatuara në lidhje me burimet ujore që disponon bashkia, për të ardhur në ndihmë fermerëve, kjo për evidentimin dhe dokumentimin e sipërfaqeve të mbjella sipas kulturave përkatëse, që u kryhet shërbimi i vaditjes dhe zbatimi i tarifave për çdo shërbim të realizuar, duke kryer monitorimet përkatëse, këto në zbatim të kërkesave të ligjit 24/2017,

date 09/03/2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe te kullimit”, Manualit te dërguar nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit në MBZHRAU “Per funksionet e ujitjes dhe kullimit te transferuara te bashkitë”, si dhe paketës fiskale te miratuar me vendim te Këshillit te Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

KLSH-ja ka dërguar në Bashkinë Finiq rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 689/7 *prot*, datë 01/11/2022. Nga Bashkia Finiq për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk ka kthyer përgjigje as në afatin e 20 ditëve dhe as në aftin e 6 mujorit, në kundërshtim me nenet 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga Bashkia Finiq nuk është hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve”, si dhe nuk është raportuar në Këshillin Bashkiak, mbi rezultatet e auditimit të kryera nga KLSH dhe marrjen e masa per zbatimin e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27/04/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika 5 e nenit 50-*Auditimi i jashtëm*.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk është zbatuar 10 masa.

Konkretisht nuk janë zbatuar:

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë publike. Të hartohen rregulla për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik. Të hartohet strategjia e riskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

Menjëherë

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Finiq të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të veta si: llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, 214 “*Instalime teknike, duke bërë dhe auditimin në terren të këtyre Aseteve.*

Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

Menjëherë

4.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Finiq, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 30,809,350 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Delvinë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Menjëherë

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Finiq, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Menjëherë

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Finiq, të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq nëpërmjet personave përgjegjës, të marrë masa të menjëhershme, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtori Sarandë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë

8. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e të Ardhurave Bashkia Finiq, të marrë masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Finiq, të marrë masa si vijon:

- Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e paguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe për çdo program.
- Planifikimin e procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (*faturave të palikujduara*), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbime/ investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Finiq.
- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.
- Të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.
- Të monitorojë dhe miratojë raportet 4 mujore e buxhetit.

Menjëherë

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Kontratave të përcjellë pranë Drejtorive Rajonale Tatimore përkatëse, të gjitha rastet kur faturat e shitjeve janë paraqitur me vonesë dhe pa shkaqe nga momenti i kryerjes së punimeve/shërbimit, me qëllim vlerësimin e mos deklarimit në afat për TVSH në shitje.

Menjëherë

11.1. Rekomandimi: Bashkia Finiq nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për menaxhimin e aseteve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasitet për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë dhe plotësimin e nevojave për komunitetin, por dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre procedura.

Menjëherë

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përsheptimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1116/8 datë 01.11.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

Menjëherë

b. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar 6 masa me vlerë 200,267 mijë lekë, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 6 masa, ku nga vlera e

rekomanduar prej 200,267 mijë lekë është arkëtuar vlera 18,215 mijë lekë, duke mbetur per arkëtim vlera 182,052 mijë lekë.

Konkretisht nuk janë zbatuar:

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej 5,300,000 lekë nga 3 subjektet, respektivisht;

- vlera 1,100,000 lekë nga subjekti “T...” ShPK;
- vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “G...” ShPK;
- vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “K...” ShPK;
- vlera 2,200,000 lekë nga subjekti “B...” ShPK

Menjëherë

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave Bashkia Finiq, të marrin të gjitha masat dhe të mos lejojnë lidhjen e kontratave të shërbimi/investimit me subjektet fituese pa likujduar detyrimet për taksat vendore sipas paketave fiskale.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 108,000 lekë, respektivisht:

- vlera 54,000 lekë, ndaj subjektit ”M...”.
- vlera 54,000 lekë, ndaj subjekti “E...”.

Menjëherë

d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 4 masa të pranuar plotësisht, rezulton se nuk është zbatuar asnjë masë.

Konkretisht nuk janë zbatuar:

1. L. M, me detyrë Drejtore e Financës.
2. I. N, me detyrë Drejtor i Ardhurave
3. TH. Z me detyrë P/ Ardhura Vendore
4. J. B, me detyrë P/ Ardhura Vendore

Menjëherë

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27/11/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27/04/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 133-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për përshpejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 689/7 datë 01/11/2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”.

Brenda datës 31/12/2023

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të

kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **849,371 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Midis shoqërisë “N...” Shpk dhe Bashkia Finiq, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 1736, datë 04/07/2022 për “*Blerje materiale elektrike*” me vlerën 2,999,680 lekë pa TVSh. me afat 20 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës (neni 6 i kontratës).

Referuar të dhënave të financës, kontrata nuk është zbatuar sipas kushteve të sajë, konkretisht të nenit 17 të sajë.

Kështu sipas Drejtorisë së Financës është likuaduar vetëm vlera 928,956 lekë me USH nr. 490, datë 09/11/2022 sipas faturës nr. 108/2022, datë 04/11/2022, bërë hyrje me FH nr. 23/1, datë 25/07/2022 në shumën 772,800 lekë dhe nr. 31, datë 04/11/2022 në shumën 156,264 lekë.

Nga subjekti është paraqitur për likuidim fatura nr. 120/2022, datë 07/12/2022 në shumën 1,563,600 lekë faturë e cila nuk është likuaduar nga Bashkia Finiq.

Në zbatim të nenit 6 të kontratës nr. 1736, datë 04/07/2022 afati për zbatimin e sajë është **20 ditë** nga data e nënshkrimit, **pra nga data 04/07/2022 deri me datë 24/07/2022.**

Nga sa sipër subjekti nuk ka plotësuar kushtet e kontratës për dorëzimin e mallit në afat. Gjithashtu një pjesë të mallit akoma nuk është paraqitur nga subjekti për likuidim dhe bërë hyrje. Kështu deri në fund të vitit 2022 subjekt ka bërë hyrje vlerën 2,492,556 lekë me TVSh nga vlera 3,599,616 lekë me TVSh, **me një diferencë në shumën 1,107,060 lekë.**

Nga sa trajtuam më sipër për mos dorëzim malli brenda **20 ditëve**, në zbatim të pikës 17.1 të nenit 17 të kontratës nr. 1736, datë 04/07/2022, ndajë subjekti bashkia Finiq për periudhën nga 204/07/2022 deri me datë 31/12/2022, duhet të llogarisë penaltitet në shumën **561,540 lekë** $\{(3,599,616 \text{ lekë} \times 25\%) = 899,904 \times 4/1000 \times 156 \text{ ditë vonesë}\}$, **veprime me efekt financiar negativ në bashkinë Finiq** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 111-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Finiq të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **561,540 lekë nga shoqëria ‘N...’** shpk, për mos zbatim të kontratës nr. 1736, datë 04/07/2022.

Brenda datës 31/10/2023

2. Gjetje nga auditimi: Midis shoqërisë “A...” shpk dhe Bashkia Finiq, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 947, datë 14/04/2022 për “*Mirëmbajte e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës*” me vlerën 3,270,812 lekë pa TVSh, me afat 40 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës (neni 6), **ose nga data 14/04/2022 deri me datë 03/06/2022.**

Nga të dhënat konstatohet se situacioni me nr. faturë 129, datë 30/08/2022 për vlerën 1,589,358 lekë është jashtë afateve të kontratës ose me **86 ditë vonesë.**

Nga sa më sipër për përfundim të punimeve brenda afatit ose me 88 ditëvonesë, në zbatim të pikës 14 pika 14.1 të kontratës nr. 947, datë 14/04/2022, ndajë subjekti bashkia Finiq për periudhën nga 14/07/2022 deri me datë 30/08/2022, duhet të llogarisë penaltitet në shumën 287,831 $\{(3,270,812 \text{ lekë} \times 25\%) = (817,703 \times 4/1000 \times 88 \text{ ditë})\}$, **veprime në kundërshtim me nenin 6 të kontrata nr. 947, datë 14/04/2022 për “Mirëmbajte e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës”** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 111-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve për menaxhimin e kontratave të analizojë dosjen e procedurës me objekt “*Mirëmbajte e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës*”, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 68, datë 19/04/2022 (mbi afatin e punimeve), dhe në rast të mungesës së dokumentacionit mbështetës të marri masa në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Finiq duke

ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **287,831 lekë nga subjekti “A...” shpk.**

Brenda datës 31/10/2023

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i **8 procedura** me fond limit **107,981** mijë lekë të vlerësuar për auditim, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **3 procedura** me vlerë të fondit limit **24,166** mijë lekë ose 22.3% e vlerës së fondit limit të audituar, ku OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimi të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO është në paligjshmëri të dispozitave të LPP dhe duhej të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar me vlerë 24,166 mijë lekë, *konkretisht procedurat:*

1- **Procedura me objekt “Blerje materiale ndërtimi”**, me fond limit 16,666,666 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 3 OE, ku janë kualifikuar 3 OE, duke shpallur fitues shoqërinë “J...” me ofertë 14,856,930 lekë.

2- **Procedura me objekt “Blerje materiale elektrike”**, me fond limit 3,333,333 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 4 OE, ku janë kualifikuar 3 OE dhe skualifikuar 1 OE, duke shpallur fitues shoqërinë “N...” me ofertë 2,999,680 lekë.

3- **Procedura me objekt “Pjesë këmbimi dhe riparim mjetesh”**, me fond limit 4,166,666 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 1 OE, ku janë kualifikuar 1 OE, duke shpallur fitues shoqërinë “V... + J...” me ofertë 3,949,200 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19/05/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 111-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Me vendim të KB nr. 1, datë 17/02/2022 “Për një ndryshim në VKB nr. 51, datë 24/12/2021 është miratuar fondi për prokurimin me objekt “Rikonstrukcion i rrugës Dërmish-Navaric” me vlerë 45,455,502 lekë pa TVSh, ku një pjesë është financim i MF dhe një pjesë është financim me të ardhurat e Bashkisë Finiq. Preventivi është hartuar nga specialistët **ing. A. K.**, bazuar në çmimet sipas VKM nr. 627, datë 15/07/2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Nga auditimi i çmimeve sipas manualit, konstatohet se ato janë nuk janë në zbatim me VKM nr. 629, datë 15/07/2015, i ndryshuar, duke rënduar atë padrejtësisht për vlerën

2,290,080 lekë, veprime në mosefektivitet të fondeve dhe në kundërshtim me VKM nr. 627, datë 15/07/2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 111-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës ose me subjekte të licencuara për saktësinë e llogaritjes së fondit limit në përputhje me çmimet e manualit për të shmangur mos efektivitetin e fondeve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIKAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga vlerësimi i planit buxhetor për vitin 2022, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë me nr. 51, date 24/12/2021 “Per miratimin e buxhetit të Bashkisë Finiq për vitin 2022”, rezultojnë që vlera e të ardhurave të planifikuara për vitin 2022 të jetë në vlerën **91,051,000 lekë**, ku kjo vlerë përbehet nga detyrimet e mbartura dhe të pa arkëtuara (Debia) deri me 31/12/2021, e pasqyruar në vlerën **14,176,059 lekë** si dhe detyrimi i vitit ushtrimor 2022 që është në vlerën **76,874,941 lekë**.

Sipas të dhënave të pasqyruara në regjistrin e të ardhurave që administrohet pranë Drejtorisë të të Ardhurave, rezultojnë se të ardhurat për vitin 2022 janë në vlerën **264,863,312 lekë**, ku kjo vlerë përbehet nga detyrimet e mbartura dhe të pa arkëtuara (Debia) deri me 31/12/2021 është në vlerën **187,988,971 lekë** si dhe detyrimi i vitit ushtrimor 2022 që është në vlerën **76,874,941 lekë**. (Vlera e debisë në fund të vitit 2021 që është 187,988,971 lekë është e pasqyruar në regjistër, tek pasqyrat analitike si dhe tek pasqyrat financiare). ***Pra kemi një planifikim në planin e buxhetit të vitit 2022, me pak për vlerën 173,812,312 lekë.***

Krahas të dhënave të trajtuara rezultojnë se në planifikimin buxhetor të vitit 2022, nuk ka një bashkërendim me sektorët e tjerë përgjegjës për vlerësimin e detyrimeve sipas parashikimeve dhe burimeve që disponojnë për realizimin e të ardhurave, kjo për hartimin e një buxheti sa me afër realitetit, ku krahas të tjerave figuron pa u trajtuar fare si në buxhet apo dhe trajtuar në regjistrin e të ardhurave vlerë prej **5,800 mijë lekë** si ***“tarife vendore për pajisjen me leje tregtimi për shitjen e karburanteve”***.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezultojnë një gjendje e lartë e detyrimeve nga taksat e tarifave vendore për vlerën **213,212,631 lekë ose afërsisht 2 fish i planit të të ardhurave vjetore të parashikuara në fillim të periudhave ushtrimore**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Finiq, të cilët nuk mund t'i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe dhe që tregon se megjithë punën e bërë nga kjo administratë në rikëtimin e debitorëve, ka akoma vend për përmisim dhe në zbatim të të gjitha dispozitave ligjore për arkëtimin e tyre.

Nga të dhënat evidentohet se niveli i detyrimeve të paarkëtuara (taksa/tarifa vendore), vjen në rritjen nga njëra periudhë në tjetrën për vlerën 25,224 mijë lekë, **ku nga vlera 187,988 mijë lekë në fund të vitit 2021 në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 213,212 mijë lekë**. Gjithashtu evidentohet një numër subjektësh të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet dhe nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, janë lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite.

Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17/12/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligji nr. 68/2017, datë 27/04/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20/03/2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09/03/2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32, Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për bashkërendimin e punës me të gjithë sektorët e tjerë të cilët funksionojnë në planifikimin e të ardhurave, duke përcaktuar qarte vlerat e të ardhurave që duhet planifikuar sipas burimit të krijimit të tyre. Në planifikim buxhetor për vazhdimësinë të pasqyrohen qarte vlera e debisë së mbartur si dhe detyrimi vjetor që është pasqyruar në regjistrin e të ardhurave. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë të të ardhurave të Bashkisë të merren masat e menjëhershme për vlerësimin e detyrimeve të subjekteve që merren me tregtinë e hidrokarbureve, duke arkëtuar detyrimin prej 5,600,000 lekë, në rast të kundërt të vlerësohen kërkesat e ligjit deri në pezullimin e aktivitetit.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Finiq, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **213,212,631 lekë**.

Brenda datës 31/12/2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga vlerësimi i të dhënave mbi numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Finiq, si dhe vlerësimi i statusit të këtyre subjekteve është konstatuar se: Numri i bizneseve në ***fund të vitit 2021 ishin 222 subjekte***, (146 subjekte fizike dhe 76 subjekte juridike) ndërsa në ***fund të vitit 2022 ishin 220 subjekte***, (146 subjekte fizike dhe 74 subjekte juridike).

Nga 146 subjekte fizike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Finiq, janë të regjistruar pranë QKB dhe disponojnë Nipt 121 subjekte fizike, ndërsa **25 subjekte ushtrojnë aktivitet, paguajnë taksat dhe tarifatat vendore, por nuk figurojnë të pajisur me Nipt nga ana e QKB**.

Gjate vitit 2022, rezultojnë 8 subjekte me statusin “ **mbyllje të aktivitetit**”, si dhe 2 subjektet të cilat kanë kaluar në statusin “**subjekte të pezulluara**”, ku për këto subjekte të cilat kanë ndryshuar statusin nga subjekte aktive në pezullim apo dhe mbyllje aktiviteti, në dosjet e subjekteve nuk disponohet dokumentacioni i duhur për të përfutur këtë status, Akoma me tepër që 4 subjektet që figurojnë me status të mbyllur, figurojnë debitore pranë Bashkisë për vlerën **1,757,602 lekë**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshti me ligjin nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17/12/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.2 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masat e menjëhershme për auditimin e statusit të këtyre subjekteve në teren, si dhe të kërkohet

zbatimi i procedurave për përfitimin e këtij statusi. Po kështu te kërkohet menjëherë arkëtimi i detyrimeve te pa likujduara nga ana e këtyre subjekteve qe është në vlerën **1,757,602** lekë.

Brenda datës 31/12/2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga sipërfaqja totale nen ujë prej **9.550 ha**, e transferuar nga Bordi i Fierit në Bashkinë Finiq, sipas te dhënave te Njesisë së Ujitjes dhe Kullimit figurojnë te mbjella **5.565,3 ha**. Po sipas te dhënave te kësaj Njësie pretendohet së vaditen vetëm **1.074,5 ha**. ***Pra vaditen vetëm 19.3% te sipërfaqes së mbjelle, për te cilën nuk ekziston asnjë lloj dokumentacioni mbi monitorimin e 4.491 ha sipërfaqeje e mbjelle dhe qe nuk vaditet.***

Nga vlerësimi pranë Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore te Bashkisë, rezulton së për vitin 2022, detyrimi i llogaritur për vitin është për **3,335 familje** në vlerën prej **1,764,270 lekë**, nga e cila është arkëtuar vetëm **712,164 lekë**, ose në masen **40.36 %**.

Gjithashtu është konstatuar së në fund te vitit 2021, për zërin “Detyrim nga vaditja” i krijuar gjate periudhës 2017 deri në fund te 2021, rezulton për **3,454 familje** në vlerën **3,061,081 lekë**, ku nga ky detyrim gjate vitit 2022 është arkëtuar vetëm **647,744 lekë**, ose në masen **21.16%**.

Pra në fund te vitit 2022, detyrimi i pa arkëtuar nga zëri “Detyrim për vaditjen” është në vlerën 3,464,443 lekë.

Ne lidhje me detyrimin e vaditjes për familje në Drejtorinë e taksave te Bashkisë, nuk figuron asnjë lloj dokumentacioni qe te jetë bere konvertimi i tarifës në vartësi te sipërfaqes së mbjelle dhe mënyrës së ujitjes sipas pikës “ç” te paketës fiskale.

- Nuk disponohet asnjë lloj monitorimi qe te përcaktojë detyrimin sipas kërkesave te paketës fiskale për

“ pike lidhje në ujësjellësit e rezervuarëve, poshtë saraçineskës së ujësjellësit”, qe ka tarifën **1,500 lekë**.

- Nuk na është vene në dispozicion asnjë lloj njoftimi dërguar për detyrimet e mbartura apo dhe për detyrimin e vitit ushtrimor në fermerë apo familje debitorësh, në nje moment qe ky detyrim në fund te vitit 2022, vetëm për sipërfaqen qe pretendohet së është vaditur është në vlerën **3,465,443 lekë**.

Veprimet dhe mosveprimet be mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19/05/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17/12/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, Ligjit nr. 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” kreu IV, neni 15 “Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive” neni 16 “Burimet e të ardhurave” pasi *nuk janë përcaktuar dhe ndjekur tarifat për mirëmbajtjen e infrastrukturës se ujitjes apo kullimit, si dhe nuk ka tarifë të qarte në shërbim sipas kërkesave të nenit 18 “Tarifa e shërbimit të ujitjes”, nenit 17 “Tarifa vjetore e mirëmbajtjes se infrastrukturës” dhe nenit 18 “Tarifat e shërbimit të ujitjes” pika 2 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Njesisë së Ujitjes dhe Kullimit pranë Bashkisë Finiq të bëjë monitorimin e gjithë sipërfaqes së mbjelle për cdo kulture, te monitoroje kërkesat për vaditje dhe te vlerësoje detyrimin sipas kërkesave te ligjit nr. 24/2017, date 09/03/2017 “Mbi administrimin e ujitjes dhe te kullimit”.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq në bashkëpunim me Njësinë e Ujitjes dhe Kullimit, të marrë masa të menjëhershme të bëjë njoftimin te gjithë fermerëve mbi

detyrimet qe kane pa likujtuar për arkëtimin e detyrimeve te mbartura dhe te pa arkëtuara deri në fund te vitit 2022, për vlerën **3,465,443 lekë**.

Brenda datës 31/12/2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave verore te lidhura për vitin 2022, rezultoi se, **14 subjekte të cilët kane lidhur kontrata, rezultojnë debitor për shumën 598,500 lekë**, ndërsa, nga kontratat dimërore te lidhura për sezonin dimëror 2021- 2022, rezultojnë debitor **64 subjekte** për shumën **2,950,000 lekë**, nga krahasimi i kërkesës së paraqitur nga qiramarrësi, numrit te krerëve te vaksinuar sipas certifikatës veterinare, vërtetimit për numrin e krerëve si dhe kontratës së lidhur, ku kontrata është lidhur me pak për numër krerësh. në **total, vlera e arkëtuar me pak, për kullotat verore 2022 dhe kullotat dimërore 2022 - 2023 është 3,548,500 lekë**.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04/05/2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19/03/2007, “Për Fondin Kullor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10/10/2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08/06/2016, VKM nr. 1374, datë 10/10/2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08/06/2016 dhe VKM nr. 391, datë 21/06/2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22/12/2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës së detyrimit prej **3,548,500 lekë** nga subjektet përkatës sipas trajtimit analitik te bere në kapitullin e auditimit te kontratave te lidhura për dhënien me qira te sipërfaqeve kullimore.

Brenda datës 31/12/2023

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shlyerjes së detyrimeve qe rrjedhin nga kontratat e lidhura për dhënie me qira te sipërfaqes kullimore dhe pyjore, për aktivitete të ndryshme, rezultuan debitor **3 subjekte**, si me poshtë:

1. A. I, i cili ka detyrimin vjetor në shumën **20,000 lekë** nuk ka shlyer detyrimin e vitit 2022 si dhe figuron debitor edhe për vitet e kaluara në shumën **126.000 lekë**, gjithsej **146,000 lekë**.

2. S. S, ka lidhur 2 kontrata, njëra me vlerën **30,000 lekë/ vit** dhe tjetra me vlerë **36,000 lekë/vit**, vlera, te cilat nuk jane paguar për **vitin 2022** si dhe figuron debitor për vitit e kaluara në shumën **96,000 lekë** për kontratën e pare dhe **111,600 lekë** për kontratën e dyte, **gjithsej 207,600 lekë**. **Se bashku me detyrimin e vitit 2022, ky subjekt rezulton debitor në shumën totale 273,600 lekë**.

3. I. D (s'ka dokumentacion), është lidhur kontrata për nje siperfaqe prej 0,3 ha dhe me nje detyrim vjetor prej **66,000 lekë/vit**, te cilit në vitin 2022 i ka mbaruar kontrata, por deri në fund te vitit 2022 figuron debitor për shumën **283,800 lekë** (4 vite).

Gjithsej, detyrimi i papaguar për 6 subjektet është **në shumën 703,400 lekë**.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19/03/2007 "Për fondin kullor", VKM nr. 632, datë 11/06/2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje bari", VKM nr. 391, datë 21/06/2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, VKM nr. 1064, datë 22/12/2010 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 391, datë 21/06/2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, VKM nr. 799, datë 29.09.2010 "Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme" si dhe Udhëzimit të Ministrisë të Mjedisit Nr. 2, datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave

e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës debitoare prej **703,400 lekë** nga **3 subjekte debitoare**, përkatësisht, nga A. I për shumën **146,000 lekë**, S. S për shumën **273,600 lekë** dhe I. D për shumën **283,800 lekë**.

Brenda datës 31/12/2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer, rezultoi se, nga **189 subjekte të ish komunës Mesopotam** që kanë marrë me qira toka bujqësore të pandara, rezultojnë debitoare për vitin 2022, **9 subjekte**, për shumën totale **75,158 lekë, ku, 68,016 lekë është detyrimi vjetor dhe 7,142 lekë është kamatëvonesa.**

Ndërsa, përsa i përket debitorëve të krijuar në vite, deri në fund të vitit 2022, rezultojnë debitoare 25 subjekte për shumën totale 4.558.478 lekë, ku, 1,392,673 lekë janë detyrimet dhe 3,165,805 lekë janë kamatëvonesa. Po kështu, figurojnë debitoare për mospagimin e kamat vonesës në vite, 136 subjekte për shumën totale 10,605,571 lekë.

Gjithsej, shuma totale e detyrimeve të pa arkëtuara deri në fund të vitit 2022 është 15,164,049 lekë, nga e cila 1,392,673 lekë janë detyrime dhe 13,771,376 lekë janë kamatëvonesa.

Ndërsa, nga 16 subjekte të ish komunës Finiq, rezultojnë debitoare për vitin 2022, 9 subjekte, për shumën totale 50,388.16 lekë, ku, 37,324 lekë është detyrimi vjetor dhe 13,064 lekë është kamatëvonesa.

Ndërsa, përsa i përket debitorëve të krijuar në vite, deri në fund të vitit 2022, rezultojnë debitoare 14 subjekte për shumën totale 1,742,093 lekë, ku, 377,476.57 lekë janë detyrimet dhe 1,364,616.65 lekë janë kamatëvonesa.

Gjithsej, detyrimi i paarkëtuar së bashku me kamat vonesën për të gjitha kontratat është në shumën 16,906,142 lekë, që përbën të ardhur të munguar për Bashkinë.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29/07/1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014, datë 24/04/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligji nr. 7501, datë 19/07/1991, “Për tokën” i ndryshuar, Ligji nr. 8312, datë 26/03/1998, “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21/08/1998, “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30/03/2001, VKM nr. 373, datë 20/06/2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, VKM nr. 54, datë 05/02/2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pikat 1-3, pika 7, dhe UKM nr. 1, datë 18/07/2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq të marrë masa për arkëtimin e shumës debitoare prej **16,906,142 lekë** nga **41 subjektet** që rezultojnë debitoare nga mospagimi i detyrimit të marrjes me qira të tokës bujqësore të pandare.

Brenda datës 31/12/2023

C. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Finiq, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05/03/2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja

“e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale, respektivisht:

1. I. N, me detyrë Drejtor i Ardhurave

Për shkeljet e konstatuara:

Mos ndjekjen e të gjitha hapa ligjore në arkëtimin e debitorëve nga subjektet fizik. Juridik dhe abonentët familjarë për vlerën **213,212,631 lekë** ose afërsisht 2 fish i planit të të ardhurave vjetore të parashikuara në fillim të periudhave ushtrimore, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Finiq, veprime në kundërshtim me nenin 89-*Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve*, neni 90-*Urdhër bllokimet*, dhe neni 92-*Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë, duke lënë jashtë një pjesë të konsiderueshme të tyre, por dhe subjekte me detyrime nga viti në vit*, neni 93-*Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë* dhe neni 94-*Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër*, si dhe nuk është kërkuar “*kallëzim penal*”, bazuar në nenin 181-*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 52-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

2. I. B me detyrë juriste në Drejt Juridike.

3. V. L me detyrë Drejtor i PZHT.

4. S. J me detyrë specialist në Drejt/ Shërbimeve.

5. A. M me detyrë specialist në Drejt/ Shërbimeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht në praktikat:*

- “Hartimi i dokumentacionit për regjistrimin fillestare të tokave bujqësore për fshatrat Caush, Finiq dhe Mavropull”, me fond limit 15,000,000 lekë.
- “Mirëmbajtje e tokave bujqësore dhe kanaleve vaditës”, me fond limit 4,192,500 lekë.
- Zëvendësim i pompës në statcioni e pompave të ujësjellësit të fshatit Muzinë” me fond limit 2,500,000 lekë.

6. K. TH me detyrë Drejtor i Shërbimeve.

7. F. TH me detyrë Përgjegjës Sektori i shërbimeve të ndriçimit publik, dekorit dhe mirëmbajtjes së objekteve dhe varrezave publike.

8. I. K me detyrë Zv/Kryetar.

9. A. K me detyrë Përgjegjës Sektori i Ujitjes dhe Kullimit.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte më të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92,

“Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, *konkretisht në praktikat:*

- “Blerje materiale elektrike” me fond limit 3,333,333 lekë.
- “Blerje materiale ndërtimi” me fond limit 16,666,666 lekë.
- “Pjesë këmbimi dhe riparim mjetesh” me fond limit 4,166,666 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2..4, faqe 111-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10. L. M me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës.

-Për mos sistemimin dhe kontabilimzi e vlerës 4,309,706 lekë në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” e cila ka të bëjë me parregullsinë e nxjerrjes jashtë kontabilitetit të aktiveve të cilat ende nuk kanë marrë miratimin përkatës nga strukturat drejtuese të institucionit për asgjësimin e tyre.

-Për mos analizimin e vlerës prej 7,603,684 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar së diferencës të ndryshimit të gjendjes së inventarit, vlerë e cila është kontabilizuar në llogarinë 73 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” dhe jo në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

-Për mos kontabilizimin e aktiveve materiale dhe jo materiale, për pagesa dhe vlera pjesore të AQT të cilat duhet të evidentohen në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të inventimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave të kontabilizohet në llogaritë sipas klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

-Për mos analizimin e vlerës 3,376,449 lekë e cila ka të bëjë me mos kuadrin e diferencës ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve me llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor”. Veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi konkretisht, SKK nr. 5, “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo Materiale” i përmirësuar, “Çregjistrimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale”, pika 73 dhe pika 74, dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21/02/2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09/03/2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, nënpika 19,

Klasa 23, pika 4 “Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8), nënpika 4.1 “Shpenzimet në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe operacionet që lidhen me to” *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 83-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

VI. ANEKSE

Anekset e mëposhtme, tabelat dhe pasqyrat janë pjesë përbërëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditim

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSE

VI. ANEKSE

Anekset e mëposhtme, tabelat dhe pasqyrat janë pjesë përbërëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, ku në mënyrë më të zgjeruar trajtohen çështje të caktuara.

Aneksi 1.2

Struktura e kësaj njësie auditimi, në formë tabelore për periudhën e audituar për vitin 2021, paraqitet Aneksi 1.2 Bashkëlidhur Projekt Raport Auditimit. si më poshtë:

PERIUDHA	FUNKSIONI	ARSIMI	JETË RSI NE PUN E	JETË RSI NË AUDI TIM/ VITE	ÇERTIFIKI MI	TRAJ NIME TE VIJUESHM E
PËR VITIN 2021						
STEFAN KALULLI	DREJTORI I NJËSISË	ËKONOMIST	37	30	NE VITIN 2005	PO
MIRANDA MEZINI	PËRGJEGJËS SEKTORI	ËKONOMISTE	31	26	NE VITIN 2005	PO
ALKET PREMTI	AUDITUES	FINANCIER	13	4	NE VITIN 2019	PO

Pasqyra e angazhimeve në misione auditimi, viti 2022

Nr	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit në vitin 2022									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit		
			A. të përputhshmërisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara			Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
1	Drejt. Financës/ Auditimi i detyrimeve te prapambetura	1	1							1	
2	Bashkia Finiq (Mbi monitorimin e zbatimit te rekomandimeve	1	1							1	
3	Shoqëria "U..." sha Finiq, mbi funksionimin e shoqërisë.	1					1			1	
4	Drejt. Financës se Shoqërisë/Auditimi i detyrimeve te prapambetura	1	1							1	
5	Shoqëria "U..." sha Finiq (Mbi monitorimin e zbatimit te rekomandimeve)	1	1							1	
	Totali	5	4	0	0	0	1	0	0	5	0

Pasqyra e gjetje me shpërblim dëmi, viti 2022 000/lekë

Nr.	Subjekti i Audituar	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMIT										Shuma e dëmit ekonomik
		Prokurim, blerje & investime	Paga, shpërblime, trajttime, komisione.	Fondet e sig. Shoq, sig. Shëndetësore, përkujdesje shoqërore	Tatime, taksa, dogana	Administrim prone, pasurie	Privatizime, shitje, qiradhënie	Koncesione, ankande	Legalizime, Urbanistikë, kthim pronash	Kreditim, subvencione	Të tjera	
a.	1	2.1	2.2	2.3	2.4	2.5	2.6	2.7	2.8	2.9	2.10	3
2	Shoq. "U..." sha Finiq				16,67							16,67
	Totali		0	0	16,67	0	0	0	0	0	0	16,67

Gjatjet sipas F...ve të aktivitet, viti 2022
Ne numër

Nr.	Subjekti i Audituar	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE										Gjithsej
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq, sig. Shëndetësore, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve, Urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera	
1	Bashkia Finiq (Detyrimet e prapambetura)										2	2
	Masa Organizative										2	2
	Masa Shpërblim demi											
3	Shoqëria "U..." sha	2			4	1					13	20
	Masa Organizative	2			1	1					13	17
	Masa Shpërblim demi				3							3
	Totali	2	0	0	4	1	0	0	0	0	15	22

Aneksi nr. 2/1, pika 2.1

“Programimi i shpenzimeve për vitin 2022”

000/Lekë

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2022	
		Vlera	Realizimi në %
1	Këshilli	0	-
2	Plani Menaxhim Administrativ	120,633	0.19%
3	Pastrim Gjellbërim	59,708	9.44%
4	Arsimi Parashkollor	12,518	1.98%

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2022	
		Vlera	Realizimi në %
5	Shërbimi Zjarrfikës	17,129	2.71%
6	Ujitja Kullimi	18,037	2.85%
7	Rrugët Rurale	86,696	13.7%
8	Administrim Pyjor	7,223	1.14%
9	Emergjencia Civile	1,078	0.17%
10	Ujësjetësi	3,500	0.55%
11	Ujësjetës Investime	282,831	44.7%
12	Investime BE	22,621	3.57%
Totali i shpenzimeve		631,974	100%
Ndhurma ekonomike		100,607	
Gjendja Civile		3,808	
Grand Totali		736,389	

Aneksi nr. 2/2, pika 2.1,

“Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për viti 2022”.

000/Lekë

Nr.	Shpenzimet sipas ndarjes ekonomike	Viti 2022	
		Vlera	Realizimi në %
1	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)	134,398	22.5%
2	Shpenzime operative (602)	90,607	15.1%
3	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar	84,185	14%
4	Fondet emergjencë dhe fondet rezervë	1,079	0.41%
5	Investime (230+231) nga buxheti i shtetit	282,696	47.3%
6	Shpenzime (603+604+606)	4,156	0.69%
Shuma		597,121	100%

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Finiq për vitin 2022”.

000/Lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2022		Plani i Viti 2022	
		Të ardhurat	Shpenzime	Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	3,635		3635	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	287		287	
3	Trashëguar nga transferta specifike	67,944		67944	
4	Të trashëguara nga FZHR	0		0	
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	71,770		71,770	
6	Granti	133,251		133,251	
7	Transferta specifike	51,856		51,856	
8	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)		134,398		134,398
9	Shpenzime operative (602)		90,607		90,607
10	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar		84,185	20,400	84,185
11	Fondet emergjencë dhe fondet rezervë		1,079		1,079
12	Investime (230+231) nga buxheti i shtetit	303,231	282,696	303,231	282,696
13	Shpenzime (603+604+606)		4,156		4,156
Totali i buxhetit		631,974	597,121	631,974	597,121

“Krahasimi i planeve me PBA 2022-2024”.

Nr.	Përshkrimi	Plan përfundimtar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Diferenca
1	Shpenzimet për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	137,759	137,759	0
2	Shpenzimet (602, 604, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	73,905	73,905	0
3	Investime – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	391,113	391,113	0
4	Investime nga FZSHH	0	0	0
Total i planit fillestar		602,777	602,777	0
	Shtesat dhe ndryshimet gjatë vitit	29,197	8,797	20,400
5	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	134,398	134,398	0
6	Shpenzime (602, 604, 606,609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	92,402	92,402	0
7	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	366,881	366,881	0
8	Investime nga FZSHH	0	0	0
9	Pagesa 5 % garanci	3,440		3,440
	Totali shtesa + ndryshime	632556	631,974	0

Plani përfundimtar		Plani përfundimtar	Sipas PBA 2022-2024	Diferenca
1	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	145,458	145,458	0
2	Shpenzime (602, 604,606, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	95,842	95,842	0
3	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	390,674	390,674	0
4	Investime nga FZSHH	0	0	0
5	Pagesa 5 % garanci	0	0	0
Shuma e planit vjetor		631,974	631,974	0

“Vendime të Këshillit të Bashkisë”.

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli				
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma	
Viti 2021	_51_/24.12.2021	682,410	Nr 1/17.02.2022	71866	600+601	6268		6,268	
					602	3282		3,282	
					231	62316		62,316	
					604	1079		1,079	
					23 dt 23.06.2022	600	206		206
					31				
					22.09.2022	231	500	-500	0
						602	4271		4,271
					45/03.11.2022	231	3840		3,840
						606	480		480
						Investime me pak		133,330	-130,330
						Realiz ardhurat me pak		19248	-19248
						231	15000		15,000
	231	5400		5,400					
Totali Viti 2022	682,410			101,662	152,496	631,974			

“Pagesa të kryera nëpërmjet Bankës në lidhje me respektimin e afatit 30-ditor për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”.

Nr.	Periudha	Llog.602		Llog.230+231		Shuma	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
2	Viti 2022						
1	K... Shpk			20	5,000,000	20	5,000,000
2	L... shpk			42	1,419,828	396	1,419,828
				50	1,422,498	396	1,422,498
3	J...	20	238,800			163	238,800
	J...			80	902,455	447	902,455
	J...	93	1,299,789			446	1,299,789
4	T...	2	15,000			110	15,000
5	J...	3	1,242,000			109	1,242,000
6	A...	828	44,000			167	44,000

Nr.	Periudha	Llog.602		Llog.230+231		Shuma	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
	A...	1693	22,000			167	22,000
	A...	2850	22,000			552	22,000
	A...	3380	22,000			552	22,000
	A...	3992	22,000			552	22,000
	A...	4709	22,000			552	22,000
	A...	5399	22,000			552	22,000
	A...	6025	22,000			552	22,000
	A...	6758	22,000			552	22,000
7	E...	212	118,800			159	118,800
8	N. H	4	705,600			165	705,600
	N. H	57	60,000			580	60,000
9	B. L	4	120,442.2			201	120,442.2
	B. L	9	93,952.75			201	93,952.75
	B. L	14	107,977.9			201	107,977.9
	B. L	19	103,862			201	103,862
	B. L	34	115,696.9			601	115,697
	B. L	40	152,912			601	152,912
	B. L	45	268,647.5			601	268,647
	B. L	50	139,105.9			601	139,106
	B. L	55	150,797.5			601	150,798
	B. L	61	112,180			601	112,180
10	B. H	5	99,000			202	99,000
	B. H	9	91,000			202	91,000
11	faturat shkurt -prill		176,508			106	72,722
	Faturat qershor		37,296			346	173,063
	Faturat korrik -gusht		41,422			346	60,000
12	G...	8	2,090,220			108	2,090,220
	G...	2583	2,126,724			206	2,126,724
	G...	4252	3,425,100			448	3,375,100
	G...	4827	2,620,992			448	2,620,992
	G...	5537	3,421,572			598	3,421,572
	G...	129	1,589,358			442	1,589,358
	G...	54	1,947,240			440	1,129,139
	G...					444	818,101
13	C...	1768	41,880			581	41,880
14	K...	3	492,000			588	492,000
15	L...			28	2854262	489	2,854,262
		7	509,095			441	509,095
16	konsum dhjetor 2021		1,904,585			208	1,904,585
	konsum janar mars 2022		4,931,170			208	1,730,562
	konsum prill qershor 2022		3,620,009			353	4,931,170
	konsum korrik 2022		1,030,090			357	2,919,537
	konsum gusht-shtator 2022		2,708,614			404	1,227,680

Nr.	Periudha	Llog.602		Llog.230+231		Shuma	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
	konsum tetor 2022		1,587,148			505	3,068,082
	O...	86	59,745.6			213	59,746
17	N...	74	263,027.9			574	263,028
18	K. B	5	235,200			579	235,200
19	Q...	153	20,000			557	20,000
20	S... Shpk			38	1,668,827	443	1,668,827
	Totali		40,334,560.2		13,267,870		53,602,990

Aneksi nr. 2/1, pika 2.6,

“Përmbledhje e vlerës së debisë të mbartur për taksapaguesit familjare, në fund të vitit 2021, arkëtimet e realizuara gjatë 2022, si dhe mbetja e kësaj debie në fund të vitit 2022.

NJ.A.	Emertesa e detyrimit	Debitorët gjendje me datën 31.12.2021		Arkëtuar gjatë vitit 2022		Debitorët gjendje me datën 31.12.2021	
		Nr. Fam	Lekë	Nr. Fam	Lekë	Nr. Fam.	Lekë
FINIQ	Toke Bujqësore	690	9,042,718	114	1,484,139	576	7.558.579
	Taksë Ndërtese	836	4,021,928	112	526,057	724	3.495.871
	Tarifë Ndriçimi	904	2,361,388	117	428,100	787	1.933.288
	Tarifë Pastrimi	904	4,465,801	117	582,000	787	3.883.801
	Tarifë Vaditje	748	705,933	110	139,289	638	566.644
Shuma			20,597,768		3,159,585		17,438,183
LIVADHJA	Toke Bujqësore	1,944	29,552,453	226	3,460,730	1,718	26,091,723
	Taksë Ndërtesë	1,927	6,354,199	154	718,906	1,773	5,635,293
	Tarifë Ndriçimi	1,930	3,645,402	149	497,003	1,781	3,148,399
	Tarifë Pastrimi	1,930	4,698,761	85	423,374	1,845	4,275,387
	Tarifë Vaditje	965	464,749	97	96,071	868	368,678
Shuma			44,715,564		5,196,084		39,519,480
ALIKO	Toke Bujqësore	1,098	18,482,624	103	2,089,129	995	16,393,495
	Taksë Ndërtesë	1,111	3,564,240	85	510,982	1,026	3,053,258
	Tarifë Ndriçimi	1,111	2,079,800	85	313,200	1,026	1,766,600
	Tarifë Pastrimi	1,111	3,950,781	85	406,647	1,026	3,544,134
	Tarifë Vaditje	992	1,294,750	88	221,964	904	1,072,786
Shuma			29,372,195		3,541,922		25,830,273
DHIVER	Toke Bujqësore	963	7,418,487	228	1,934,955	735	5,483,532
	Taksë Ndërtesë	957	2,816,372	139	399,275	818	2,417,097

NJ.A.	Emertesa e detyrimit	Debitorët gjendje me datën 31.12.2021		Arkëtuar gjatë vitit 2022		Debitorët gjendje me datën 31.12.2021	
		Nr. Fam	Lekë	Nr. Fam	Lekë	Nr. Fam.	Lekë
	Tarifë Ndriçimi	929	2,608,265	111	347,239	818	2,261,026
	Tarifë Pastrimi	929	3,320,901	82	400,284	847	2,920,617
	Tarifë Vaditje						
Shuma			16,164,025		3,081,753		13,082,272
MESOPOTAM	Toke Bujqësore	1,090	8,210,809	118	1,475,761	972	6,735,048
	Taksë Ndërtesë	1,096	1,942,480	120	543,800	976	1,398,680
	Tarifë Ndriçimi	1,198	1,268,500	100	436,900	1,098	831,600
	Tarifë Pastrimi	1,098	1,727,800	88	435,100	1,010	1,292,700
	Tarifë Vaditje	749	595,649	87	190,420	662	405,229
Shuma			13,745,238		3,081,981		10,663,257
TOTALI BASHKIA FINIQ	Toke Bujqësore	5,785	72,707,091	789	10,444,714	4,996	62,262,377
	Taksë Ndërtesë	5,927	18,699,219	610	2,699,020	5,317	16,000,199
	Tarifë Ndriçimi	6,027	11,963,355	679	2,022,442	5,348	9,940,913
	Tarifë Pastrimi	5,927	18,164,044	457	2,247,405	5,470	15,916,639
	Tarifë Vaditje	3,454	3,061,081	382	647,744	3,072	2,413,337
TOTALI			124,594,790		18,061,325		106,533,465

Aneksin nr. 2/2, pika 2.6

“Permbledhje e vlerës se detyrimit për taksapaguesit familjare, për vitin 2022, arkëtimet e realizuara gjatë 2022, si dhe mbetja pa u arkëtuar nga ky detyrim në fund të vitit 2022

NJ.A.	Emertesa e detyrimit	Detyrimet për vitin 2022		Arkëtuar gjatë vitit 2022		Debitor nga detyrimet e vitit 2022, me 31.12.2022	
		Nr. Familjeve	Lekë	Nr. Familjeve	Lekë	Nr. Familjeve	Lekë
FINIQ	Toke Bujqësore	1059	3,091,226	382	1,305,044	677	1,786,182
	Taksë Ndërtesë	1,171	1,677,354	348	471,956	823	1,205,398
	Taksë Trualli						
	Tarifë Ndriçimi	1,270	2,159,700	392	667,300	878	1,492,400
	Tarifë Pastrimi	1,268	2,156,400	393	668,300	875	1,488,100
	Tarifë vorrezash	1,272	381,600	394	118,200	878	263,400
	Tarifë Vaditje	1,017	350,890	367	136,064	650	214,826
Shuma			9,817,170		3,366,864		6,450,306
LIVADHJA	Toke Bujqësore	1,906	5,307,803	592	1,912,373	1,314	3,395,430

NJ.A.	Emertesa e detyrimit	Detyrimet për vitin 2022		Arkëtuar gjatë vitit 2022		Debitor nga detyrimet e vitit 2022, me 31.12.2022	
		Nr. Familjeve	Lekë	Nr. Familjeve	Lekë	Nr. Familjeve	Lekë
	Taksë Ndërtësë	1,964	2,828,701	573	833,811	1,391	1,994,890
	Taksë Trualli						
	Tarifë Ndrëçimi	1,967	3,345,245	578	984,145	1,389	2,361,100
	Tarifë Pastrimi	809	1,375,700	316	536,760	493	838,940
	Tarifë Vorreza	1,967	590,100	575	172,500	1,392	417,600
	Tarifë Vadtje	673	284,320	318	129,996	355	154,324
Shuma			13,731,870		4,569,585		9,162,285
ALIKO	Toke Bujqësore	1,098	5,658,203	350	1,802,461	751	3,855,742
	Taksë Ndërtësë	1,128	1,579,200	288	403,200	840	1,176,000
	Taksë Trualli						
	Tarifë Ndrëçimi	1,131	1,922,700	289	491,300	842	1,431,400
	Tarifë Pastrimi	1,132	1,924,400	289	491,300	843	1,433,100
	Tarifë Vorrezash	1,131	339,300	288	86,500	843	252,800
	Tarifë Vadtje	892	644,350	324	233,700	568	410,650
	Tarifë azhornimi	281	5,574,000	4	99,000	277	5,475,000
Shuma			17,642,153		3,607,461		14,034,692
DHIVER	Toke Bujqësore	1,304	2,230,044	341	584,987	963	1,645,057
	Taksë Ndërtësë	1,324	1,329,664	299	303,755	1025	1,025,909
	Taksë Trualli						
	Tarifë Ndrëçimi	1,281	2,177,700	275	467,011	1006	1,710,689
	Tarifë Pastrimi	641	1,089,700	126	214,406	515	875,294
	Tarifë Vorrezash	1,330	399,000	293	88,026	1,037	310,974
	Tarifë Vadtje						
Shuma			7,226,108		1,658,185		5,567,923
MESOPOTAM	Toke Bujqësore	1,096	3,627,810	546	1,670,613	550	1,957,197
	Taksë Ndërtësë	1,100	1,540,000	544	761,600	556	778,400
	Taksë Trualli						
	Tarifë Ndrëçimi	1,105	1,878,500	544	924,700	561	953,800
	Tarifë Pastrimi	674	1,145,800	271	460,700	403	685,100
	Tarifë Vorrezash	1,104	331,200	543	162,900	561	168,300
	Tarifë Vadtje	753	484,710	363	212,404	390	272,306
Shuma			9,008,020		4,192,917		4,815,103
TOTALI BASHKIA FINIQ	Toke Bujqësore	6,463	19,915,086	2,211	7,275,478	4,255	12,639,608
	Taksë Ndërtësë	6,670	8,954,919	2,052	2,774,322	4,635	6,180,597
	Taksë Azhornimi	281	5,574,000	4	99,000	277	5,475,000
	Tarifë Ndrëçimi	6,755	11,483,845	2,078	3,534,456	4,676	7,949,389
	Tarifë Pastrimi	4,525	7,692,000	1,395	2,371,466	3,129	5,320,534

NJ.A.	Emertesa e detyrimit	Detyrimet për vitin 2022		Arkëtuar gjatë vitit 2022		Debitor nga detyrimet e vitit 2022, me 31.12.2022	
		Nr. Familjeve	Lekë	Nr. Familjeve	Lekë	Nr. Familjeve	Lekë
	Tarifë Vorrezash	6,804	2,041,200	2,093	628,126	4,711	1,413,074
	Tarifë Vadiqe	3,335	1,764,270	1,372	712,164	1,963	1,052,106
TOTALI			57,425,321		17,395,012		40,030,309

Aneksi nr. 2/3, pika 2.6, “

Permbledhje e vlerës së debisë të mbartur për taksapaguesit familjare, në fund të vitit 2021, arkëtimet e realizuara gjatë 2022, si dhe mbetja e kësaj debie në fund të vitit 2022

NJ.A.	Emertesa e detyrimit	Debitorët gjendje me datën 31.12.2021		Arkëtuar gjatë vitit 2022		Gjendja e debitorëve të mbartur me datën 31.12.2022	
		Nr.	Lekë	Nr.	Lekë	Nr.	Lekë
FINIQ	Tot.Biz. I vog.		1,572,347		142,684		1.429.663
	Taksë Ndërtese	32	660,812	3	23,688	29	637.124
	Taksë Trualli	11	70,176	2	2,496	9	67.680
	Tarifë Ndricimi	30	204,634	3	22,000	27	182.634
	Tarifë Pastrimi	33	592,074	3	94,500	30	497.574
	Tarifë Tabele	12	1,940			12	1.940
	Leje ushtr.aktiv	11	29,420			11	29.420
	Kamatevonese	2	13,291			2	13.291
	Tot. B.i madh		6,563,166		205,884		6.357.282
	Taksë Ndërtese	17	1,847,217	2	30,324	15	1.816.893
	Taksë Trualli	13	463,416	2	23,324	11	440.092
	Tarifë Ndricimi	22	280,550	2	21,000	20	259.550
	Tarifë Pastrimi	20	2,127,495	2	131,000	18	1.996.495
	Tarifë Tabele	8	323,190			8	323.190
	Leje ushtr.aktiv	8	27,000			8	27.000
	Tarifë për hap.pub	1	102,900			1	102.900
	Te tjera shfr.vert.etj		1,391,102	1	236		1.390.866
	Kamatevonese	3	296			3	296
Shuma			8,135,513		348,568		7,786,945
LIVADHJA	Tot.Biz.I vog.		2,591,465		241,864		2.349.601
	Taksë Ndërtesë	39	707,766	4	92,783	35	614.983
	Taksë Trualli	3	8,064	1	1,200	2	6.864
	Tarifë Ndricimi	42	606,734	4	26,733	38	580.001
	Tarifë Pastrimi	43	951,417	6	108,383	37	843.034

NJ.A.	Emertesa detyrimit e	Debitorët gjendje me datën 31.12.2021		Arkëtuar gjatë vitit 2022		Gjendja e debitorëve të mbartur me datën 31.12.2022	
		Nr.	Lekë	Nr.	Lekë	Nr.	Lekë
	Tarifë Tabele	12	8,250			12	8.250
	Kamate	32	309,234	1	12,765	31	296.469
	Tot. B.i madh		309,700		31,920		277.780
	Taksë Ndertese	3	51,520	1	24,920	2	26.600
	Tarifë Ndricimi	4	25,200	1	7,000	3	18.200
	Tarifë Pastrimi		177,500				177.500
	Tarifë Tabele		34,500				34.500
	Kamata		20,980				20.980
Shuma			2,901,165		273,784		2,627,381
	Tot.Biz.I vog.		683,997		87,131		596.866
	Taksë Ndërtesë	13	245,020	4	39,744	9	205.276
	Taksë Trualli	2	2,160	1	720	1	1.440
	Tarifë Ndricimi	9	117,747	4	21,667	5	96.080
	Tarifë Pastrimi	10	287,870	2	25,000	8	262.870
	Tarifë Tabele	8	31,200			8	31.200
	Tot. B.i madh		285,000				285.000
	Taksë Ndertese	1	7,500			1	7.500
	Tarifë Ndricimi	1	5,000			1	5.000
	Tarifë Pastrimi	2	271,880			2	271.880
	Tarifë Tabele	1	620			1	620
Shuma			968,997				881,866
	Tot. Biz.i vog.		542,245		148,725		393.520
	Taksë Ndërtesë	12	234,203	4	62,958	8	171.245
	Taksë Trualli	3	1,800	2	1,200	1	600
	Tarifë Ndricimi	14	80,867	3	22,917	11	57.950
	Tarifë Pastrimi	17	159,235	4	61,650	13	97.585
	Taksë Tabele	6	1,320			6	1.320
	Tarifë vend.transp.	1	14,740			1	14.740
	Kamatvonesa	8	50,080			8	50.080
	Tot. B.i madh		994,905		77,136		917.769
	Taksë Ndertese	6	138,690	1	17,136	5	121.554
	Taksë Trualli		36,817			3	36.817
	Tarifë Ndricimi	8	52,133	2	20,000	6	32.133
	Tarifë Pastrimi	10	705,620	2	40,000	8	665.620
	Tarifë Tabele	2	360			2	360
	Kamatvonesa	3	61,285			3	61.285
Shuma			1,537,150		225,861		1,311,289
MESOPOTAM	Tot Biz.i vog.		1,160,128		100,306		1.059.822

NJ.A.	Emertesa detyrimit ^e	Debitorët gjendje me datën 31.12.2021		Arkëtuar gjatë vitit 2022		Gjendja e debitorëve të mbartur me datën 31.12.2022	
		Nr.	Lekë	Nr.	Lekë	Nr.	Lekë
	Taksë Ndërtësë	6	339,293	2	36,842	4	302.451
	Taksë Trualli		3,960				3.960
	Tarifë Ndricimi	6	188,437	2	14,000	4	174.437
	Tarifë Pastrimi	9	575,175	3	49,464	6	525.711
	Tarifë Tabele	1	12,200			1	12.200
	Tarifë vendore trans.						
	Kamatvonesa		41,063				41.063
	Tot. B.i madh		576,619		56,460		520.159
	Taksë Ndertese	1	73,253			1	73.253
	Taksë Trualli	4	40,836	3	36,960	1	3.876
	Tarifë Ndricimi	4	41,995	3	19,500	1	22.495
	Tarifë Pastrimi	4	418,200			4	418.200
	Tarifë Tabele	1	120			1	120
	Tarifë tjetër vend.	1	2,200			1	2.200
Shuma			1,736,747		156,766		1,579,981
TOTALI BASHKIA FINIQ	Tot Biz.i vog.		6,550,182		720,710		5,829.472
	Taksë Ndërtësë	102	2,187,094	17	256,015	85	1.931.079
	Taksë Trualli	19	86,160	6	5,616	13	80.544
	Tarifë Ndricimi	101	1,198,419	16	107,317	85	1.091.102
	Tarifë Pastrimi	112	2,565,771	18	338,997	94	2.226.774
	Tarifë Tabele	39	54,910			39	54.910
	Kamatevonesa	42	413,668	1	12,765	41	400.903
	Leje ushtr.aktiv	11	29,420			11	29.420
	Tarifë vend.trans.	1	14,740			1	14.740
	Tot. B.i madh		8,729,390		371,400		8.357.990
	Taksë Ndertese	28	2,118,180	4	72,380	24	2.045.800
	Taksë Trualli	17	541,069	5	60,284	12	480.785
	Tarifë Ndricimi	39	404,878	8	67,500	31	337.378
	Tarifë Pastrimi	36	3,700,695	4	171,000	32	3.529.695
	Leje usht.aktiv	8	27,000			8	27.000
	Tarifë për hap.pub	1	102,900			1	102.900
	Te tjera		1,393,302	1	236		1.393.310
	Kamatvonesa	6	82,561			6	82.561
	Tarifë Tabele	12	358,790			12	358.561
TOTALI			15,279,572		1,092,110		14,187,462

Permbledhje e vlerës së detyrimit për bizneset për vitin 2022, arkëtimet e realizuara gjatë 2022, si dhe mbetja pa u arkëtuar nga ky detyrim në fund të vitit 2022”.

NJ.A.	Emertesa e detyrimeve	Detyrimi për Vitin 2022		Arkëtuar në Vitin 2022		Debitore biznesi nga detyrimi i vitit 2022 me datë 31.12.2022	
		Nr.	Lekë	Nr.	Lekë	Nr.	Lekë
FINIQ	Tot.Biz. I vog.	47	1,408,920		1,074,572		334.348
	Taksë Ndërtese	40	391,188	33	312,144	7	79.044
	Taksë Trualli	18	160,332	14	125,028	4	35.304
	Tarifë Ndricimi	40	340,700	38	258,200	2	82.500
	Tarifë Pastrimi	45	516,700	38	379,200	7	137.500
	Tot. B.i madh	42	4091,090		3,473,807		617.283
	Taksë Ndertese	33	780,528	24	621,544	7	158.984
	Taksë Trualli	28	534,144	21	437,063	7	97.081
	Tarifë Ndricimi	41	441,000	35	373,000	6	68.000
	Tarifë Pastrimi	41	2116,518	35	1,875,000	6	241.518
	Tarifë Tabele	4	218,900	3	167,200	1	51.700
Shuma		89	5,500,010		4,548,379		951,631
LIVADHJA	Tot.Biz.I vog.	42	779,726		357,140		422.586
	Taksë Ndërtesë	41	178,836	17	87,416	4	91.420
	Taksë Trualli	5	7,224	2	2,424	3	4.800
	Tarifë Ndricimi	42	285,333	15	112,000	7	173.333
	Tarifë Pastrimi	30	308,333	15	155,300	15	153.033
	Tot. B.i madh	12	800,792		561,444		239.348
	Taksë Ndertese	11	114,716	7	69,524	4	45.192
	Taksë Trualli	2	20,676	1	2,880	1	17.796
	Tarifë Ndricimi	12	117,000	9	74,390	3	42.610
	Tarifë Pastrimi	12	500,000	10	366,250	2	133.750
	Tarifë të tjera	1	48,400	1	48,400		0
Shuma		54	1,580,518		918,584		661,934
ALIKO	Tot.Biz.I vog.	11	244,995		83,536		161.459
	Taksë Ndërtesë	9	70,728	3	18,816	6	51.912
	Taksë Trualli	2	6,600	1	720	1	5.880
	Tarifë Ndricimi	10	66,834	4	26,500	6	40.334
	Tarifë Pastrimi	10	100,833	4	37,500	6	63.333
	Tot. B.i madh	1	80,876		2,200		78.676
	Taksë Ndertese	1	8,876			1	8.876
	Tarifë Ndricimi	2	17,000	1	700	1	16.300
	Tarifë Pastrimi	2	55,000	1	1,500	1	53.500
Shuma		12	325,871		85,736		240,135

NJ.A.	Emertesa e detyrimeve	Detyrimi për Vitin 2022		Arkëtuar në Vitin 2022		Debitore biznesi nga detyrimi i vitit 2022 me datë 31.12.2022	
		Nr.	Lekë	Nr.	Lekë	Nr.	Lekë
DHIVER	Tot. Biz.i vog.	14	369,170		359,234		9.936
	Taksë Ndërtesë	13	128,044	11	126,160	2	1.884
	Taksë Trualli	4	2,376	4	2,376	0	0
	Tarifë Ndriçimi	13	102,500	11	94,448	2	8.052
	Tarifë Pastrimi	12	136,250	12	136,250	0	0
	Tot. B.i madh	5	350,040		22,970		327.070
	Taksë Ndertese	4	35,896	1	5,712	3	30.184
	Taksë Trualli	3	3,744	1	1,008	2	2.736
	Tarifë Ndricimi	6	60,000		16,250	6	43.750
	Tarifë Pastrimi	6	235,000			6	235.000
Tarifë Tabele	1	15,400			1	15.400	
Shuma		19	719,210		382,204		337,006
MESOPOTAM	Tot Biz.i vog.	32	825,629		753,777		71.852
	Taksë Ndërtesë	31	214,592	28	201,740	3	12.852
	Taksë Trualli	9	16,620	9	16,620	0	0
	Tarifë Ndriçimi	32	234,833	29	210,833	3	24.000
	Tarifë Pastrimi	31	359,584	28	324,584	3	35.000
	Tot. B.i madh	14	3,863,104		3,832,923		30.181
	Taksë Ndertese	11	598,388	10	574,868	1	23.520
	Taksë Trualli	6	1,856,656	6	1,851,495	1	5.161
	Tarifë Ndricimi	14	121,500	13	120,000	1	1.500
	Tarifë Pastrimi	14	542,500	14	542,500	0	0
Tarifë Tabele	1	80,410	1	80,410	0	0	
Tarifë të tjera vend.	2	663,650	2	663,650	0	0	
Shuma		46	4,688,733		4,586,700		102,033
TOTALI BASHKIA FINIQ	Tot Biz.i vog.	146	3,738,440		2,628,259		1.110.181
	Taksë Ndërtesë	125	983,388	92	746,276	33	237.112
	Taksë Trualli	38	193,152	27	147,168	11	45.984
	Tarifë Ndriçimi	137	1,140,200	97	701,981	40	438.219
	Tarifë Pastrimi	128	1,421,700	97	1,032,834	31	388.866
	Tot. B.i madh	74	9185,902		7,893,344		1.292.558
	Taksë Ndertese	60	1,538,404	42	1,271,648	18	266.756
	Taksë Trualli	39	2,415,220	29	2,292,446	10	122.774
	Tarifë Ndricimi	75	756,500	58	584,340	17	172.160
	Tarifë Pastrimi	75	3,449,018	60	2,785,250		663.768
Tarifë Tabele	6	314,710	4	247,610	2	67.100	
Tarifë të tjera	3	712,050	3	712,050		0	

NJ.A.	Emertesa e detyrimeve	Detyrimi për Vitin 2022		Arkëtuar në Vitin 2022		Debitore biznesi nga detyrimi i vitit 2022 me datë 31.12.2022	
		Nr.	Lekë	Nr.	Lekë	Nr.	Lekë
TOTALI		220	12,924,342		10,521,603		2,402,739

Aneksi nr. 2/5, pika 2.6,

“Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2022”.

në 000 lekë

Nr	LLOJI I TAKSËS	PLANI VJETOR 2022	ARKËTIMET 2022	Realizimi në %
		Plan i vjetor Viti 2022	Arkëtime nga detyrimi vjetor	Real total në %
I	SHUMA TAKSAT	46.371	40.449,074	87,23
	Taksë mbi ndertesat	10.093	7.753,884	76,82
1	a)Taksë mbi ndertesat nga banesa	6.193	5.365,842	86,64
	b)Taksë mbi ndërtesat nga biznesi	3.900	2.388,042	61,23
2	Taksë mbi token buqësore	24.406	17.756,382	72,75
3	T/B/V (Tat.i Thjeshtuar)		297,615	
	Taksë mbi ndërtimet	3.778	3.835,701	101,53
4	a) Taksë e ndikimit në inf nga leg.aluiz	3.200	2.457,15	76,78
	b)Taksë e ndërtimit të ri (leje)	410	1.378,551	336,23
	c)Taksë kalim pronësi.	168	0	0
5	Taksë Regjistrimi Automjeti me DRTSH	2.500	3.291,488	131,66
6	Taksë tabele	693	247,61	35,73
7	Taksë trualli	3.205	2.504,794	78,15
8	2% TAP të tjera	700	4.223,834	603,4
9	Taksa kull.private	610	537,766	88,16
10	Taksa të perkohëshme	386		
II	SHUMA TARIFA	24.493	18.515,219	75,59
	Tarifë ndricimi rrugor	6.689	6.975,683	104,28
1	a)Tarifë ndricimi rrugor familjar	5.139	5.538,498	107,77
	b)Tarifë ndricimi rrugor biznese	1.550	1.437,185	92,72
	Tarifë pastrimi	10.398	8.986,581	86,43
2	a)Tarifë pastrimi nga familjar	6.180	4.635,473	75
	b)Tarifë pastrimi nga biznesi	4.218	4.351,108	103,15
3	Tarifë gjelberimi	50	10	20

Nr	LLOJI I TAKSËS	PLANI VJETOR 2022	ARKËTIMET 2022	Realizimi në %
		Plan i vjetor Viti 2022	Arkëtime nga detyrimi vjetor	Real total në %
4	Tarifë për varreza	1.200	629,326	52,44
5	Tarifë për dru zjarri	250	235,3	94,12
6	Leje veprimtarie	0	0	0
7	Tarifë për apl.leje ndërtimi	60	176	293,33
8	Tarifë parkimi	250	5	2
9	Tarifë vend për lesh. vërtetimi	250	64	25,6
10	Tarifë menaxhimi I tokës(azhornimi)	3.696	72	1,95
11	Tarifë për vaditje	1.650	1.361,329	82,5
III	SHUMA të TJERA PAS.E SHERB.	20.187	12.805,763	63,43
1	Sherbime administrative	1.440	382	26,53
2	Qera kullota	11.768	7.557,945	64,22
3	Qera nga ndertesa	2.200	171	7,72
4	Qera mbjellje 35-99 vite	2.500	1.431,125	57,25
5	Leje transporti	160	248	155
6	Gjoha të pol.bashk.	160	50	31,25
7	Gjoha nga inspektoriat I ndërtimit	39	5	12,82
8	Kamata	320	45,677	14,27
9	Te ardhura nga vend.gjyq	0	77,258	0
10	Te tjera të ardhura.	1,600	1,327,758	82,98
11	Sekuestro dhe zhdëmtim.	0	10	0
12	Te ardhura nga banka RAIFF.	0	1,500	0
	Totali të ardhura	91,051	71,770,056	78,82
1	Gjendja civile	0	326,45	0
	TOTALI	91,051	72,096,506	79,18

Zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i fundit.

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **15 masa organizative**, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk është zbatuar **10 masa**.

b. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar **6 masë** me vlerë **200,267 mijë lekë**, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 6 masa, ku nga vlera e rekomanduar prej 200,267 mijë lekë është arkëtuar vlera 18,215 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera **182,052 mijë lekë**.

d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej **4 masa** të pranuar plotësisht, rezulton se nuk është zbatuar asnjë masë.

Masat	Rekomanduar	Rek. Të Zbatuara	Në Proces Zbatimi	Rek. Të Pa Zbatuara	Shprehur ne vlere në 000/lekë		
					VI. Rekomand	VI. Arketuar	VI. Mbetur
Masa Organizative	15		5	10			
Masa Për Shpërblim Dëmi	0						
Masa Për Eliminimin E Efekteve Negative	0						
Masa mungesë të ardhurash	6		6		200,267	18,215	182,052
Masa Disiplinore	4			4			
Masa Administrative	0						
Kompetence e IMTV	0						
Totali	25		11	14	200,267	18,215	182,052

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

KLSH-ja ka dërguar në Bashkinë Finiq rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 689/7 datë 1.11.2022. Ndërsa nga Bashkia Finiq për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk ka kthyer përgjigje, **duke mos respektuar afatin brenda afatit 20 ditor.**

Nuk është hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve”.

Statusi: Pa zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Finiq, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 689/7 datë 01.11.2022 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 01.5.2023 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA). **Nga Bashkia Finiq nuk është bërë raportimi brenda 6 mujorit.**

Statusi: Pa zbatuar

3. MBI RAPORTIMIN RREGULLISHT NË KËSHILLIN BASHKIAK TË ECURISË TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KLSH, SIÇ PËRCAKTOHET NË NENIN 50 -AUDITIMI I JASHTËM, PIKA 5, TË LIGJIT NR. 68/2017, DATË 27.04.2017 “PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE”.

Bashkia Finiq nuk ka hartuar planin e veprimt të zbatimit të rekomandimeve, si dhe **nuk ka raportuar në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak), bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. *Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.*

Statusi: Pa zbatuar

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Finiq, nuk janë miratuar gjurmët e auditimit, nuk është miratuar Strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, nuk është caktuar koordinatori i riskut, nuk janë nxjerrë urdhër me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar, nuk është miratuar kodi i etikës profesionale dhe nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS). Gjithashtu u konstatuan se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore, për menaxhimin e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e neni 4 pika 19 "Gjurma e auditimit", nenit 20, 21, 27 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 40 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar Kap. III, pikat 42, 47 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë publike. Të hartohen rregulla për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik. Të hartohet strategjia e riskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

Statusi: Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” është përfshirë vlera prej 13,046,664 lekë, e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve, si dhe nuk është kryer inventari fizik. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq, Livadhja, Dhivër, Aliko dhe Mesopotam, si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Finiq. Për këto vlera nuk ka informacion nëse janë projekte të cilat investimet janë kryer.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Nga verifikimi rezulton se:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga vlera totale e paanalizuar prej 13,046,664 lekë e cila i përket llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, është zberthyer vlera 5,016,170 lekë ku është kryer analiza përkatëse konkretisht: 6 projekt-studime për ish-komunën Dhivër në vlerën 3,302,100 lekë dhe 5 projekt-studime për ish-komunën Aliko në vlerën 1,714,071 lekë, por mbetet ende

vlera 8,030,494 lekë e cila është e paanalizuar/ zëbërthyer sipas studimeve dhe projekteve, për pasojë nuk është kryer inventarë fizik të trashëguara nga ish-komuna Finiq, Livadhja, Dhiver dhe Mesopotam.

Statusi: Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se nuk është kryer inventari fizik i Aktiveve Afatgjata.

Llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, 214 “*Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune*”, të paanalizuar në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 26-30, si dhe pikën 74, të UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30 (*Më bollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Finiq të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të veta si: llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, 214 “*Instalime teknike, duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre Aseteve*.”

Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

Nga verifikimi rezulton se:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”, nga Drejtoria e Financës, nuk është marrë asnjë masë për hartimin/ krijimin e regjistrit të aktiveve.

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se llogaria 466 “*Kreditorë për mjetet në ruajtje*” është për vlerën kontabël 57,176,344 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit Delvinë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduara me degën e thesari, kjo llogari për vitin 2021 është shtuar për 23 objekte për vlerën 27,190,426 lekë dhe është pakësuar në 2 raste për vlerën 823,432 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 30,809,350 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e përpara, duke ju kaluar afati i garancisë. Bashkia Finiq nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për

mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 30,809,350 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Delvinë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Nga verifikimi rezulton se:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, Bashkia Finiq ka ende të ngrutësuar fonde për 20 kontrata në vlerën 20,228,104 lekë, për të cilat nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës. Gjithashtu për vlerën 30,809,350 lekë e fondeve të ngrutësuar për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit nga Bashkia Finiq nuk janë marrë masat për nisjen e procedura sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Delvinë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 0 (zero) lekë, e cila duhej të ishte pasqyruar për vlerën 738,067,524 lekë, pasi në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se për vitin 2021 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, të cilat janë pasqyruar në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për objektet si: “Ujësjellësi Burimet e Merkos në vlerën 409,304,933 lekë”, “Rikonstruksion dhe zgjerim i Linjës ekzistuese të Ujësjellësit Krongji-Finiq, linja të reja të fshatrave Vrion Karahaxh, Çlirim Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim Bashkia Finiq” me vlerë 161,815,940 lekë, “Ndërtim Ujësjellësi Rajonal nga burimet e Leshnicës Bashkia Finiq” me vlerë 125,763,572 lekë, “Rikonstruksion i Rrugës Dermish- Jerme” me vlerë 34,683,507 lekë dhe “Rikonstruksion i Rrugës Karroq” me vlerë 6,499,572 lekë).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Nga verifikimi rezulton se:

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion kjo problematikë është konstatuar edhe në pasqyrat financiare të vitit 2022 konkretisht:

Gjendja e llogarisë më datë 31.12.2022, për llogarinë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” paraqitet në vlerën 0 lekë kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2022 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punimet dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat, për vlerën prej 223,919,792 lekë që janë kontabilizuar në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” objekti “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal nga burimet e Leshnicës Bashkia Finiq” me vlerë 194,463,572 lekë, “Rikonstruksioni i rrugës Karroq” me vlerë 6,499,572 lekë dhe “Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë” me vlerë 22,956,648 lekë.

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se gjendja e llogarisë 212 “Ndërtime konstruksione” për vlerën historike 292,008,026 lekë, është përfshirë

vlera prej 106,627,698 lekë, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq, Livadhja, dhe Mesopotam) e paanalizuar dhe ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Nga verifikimi rezulton se:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga vlera totale e paanalizuar prej 106,627,698 lekë e cila i përket llogarisë 212 “Ndërtime konstruksione”, është zbrërthyer vlera 7,390,894 lekë ku është kryer analiza përkatëse konkretisht: 3 objekte për ish-komunën Finiq në vlerën 4,035,692 lekë dhe 9 objekte për ish-komunën Mesopotam në vlerën 3,355,202 lekë, por mbetet ende vlera 99,236,804 lekë e cila është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike e trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Finiq dhe Livadhja.

Statusi: Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se për aktivet që i përkasin llog. 210 “Toka troje terrenë”, llog. 211 “Pyje plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për kosto historike në vlerën 2,299,135,899 lekë, Bashkia Finiq nuk posedon titull pronësie, veprim në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 52-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq nëpërmjet personave përgjegjës, të marrë masa të menjëhershme, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtori Sarandë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Nga verifikimi rezulton se:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, Bashkia Finiq nuk disponon pronësie për objektet/ kullota apo pyje në total:

-45 ndërtesa me sipërfaqe 140,821 m²;

-103 sipërfaqe tokë 19,551,687 m²/ ml dhe 223 ha;

- 416 sipërfaqe truall 929,652 m²/ ml;

-21,912.62 ha sipërfaqe nga të cilat: 12,012.45 ha sipërfaqe “Kullotë” dhe 9,900.17 ha sipërfaqe “Pyje”.

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezulton se për vitin 2021, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 962,414 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 890,175 mijë lekë ose në masën 92.5 %, sipas artikujve: paga në masën 95.9%, sigurime në masën 89.2 %, shpenzime operative në masën 93.6 % dhe investime në masën 90.88 %.

Nga transferta e pakushtëzuar (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 138,062 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 137,775 mijë lekë ose në masën 99,7 %. Nga vlera 45,244 mijë lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 43,682 mijë lekë ose në masën 96.5 %, kjo për shkak se faturat për likuidim janë të muajit dhjetor 2021 që janë pasqyruar si detyrime të viti në mbylljen e pasqyrave financiare.

Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 92,171 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 75,475 mijë lekë ose në masën 81.88%.

Në planifikimin e shpenzimeve nuk janë marrë në konsideratë faturat e palikujduara të vitit paraardhës (viti 2020) në vlerën **65,375,633 lekë**, duke planifikuar në buxhetin e vitit vijuar vlera prej 22,000 mijë lekë ose 36% e totalit.

Mos planifikimi i plotë i vlerës së faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore, vjen nga mos realizimi i të ardhurave vjetore ku nga vlera 89,553 mijë lekë të parashikuara është realizuar në vlerën 68,985 mijë lekë ose 77 %, pra planifikimi i shpenzimeve buxhetore nuk është real dhe i mbështetur në burime të sakta financimi për të ardhurat e veta.

Nga transferta e pakushtëzuar sektoriale treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 60,924 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 51,103 mijë lekë ose në masën 84 %. Nga këto investime nga vlera 1,000 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 0 mijë lekë kjo për shkak se nuk kanë kryer procedurë prokurimi.

Nga fondet e deleguara treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 87,017 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 86,498 mijë lekë ose në masën 99 %.

Sa më sipër u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitin 2021 të ketë mosrealizime.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, udhëzimin e MF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe udhëzimin e MF nr. 10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 29-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e të Ardhurave Bashkia Finiq, të marrë masë në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Statusi: Pa zbatuar

9. Gjetje nga auditimit: Nga të dhënat e bilancit, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën **52,734,478 lekë** nga këto: *Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”*, paraqiten në **vlerën 4,196,324 lekë** dhe detyrime të tjera në llog (467) “*Kreditorë të ndryshëm*”, paraqitet në **vlerën 48,538,153 lekë**.

Situata financiare e Bashkisë Finiq, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 dhe gjendjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 5.9 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare.

Nga të dhënat mbi faturat e palikujduara në fund të periudhave ushtrimore dhe planifikim në buxhetin pasardhës për likuidim, konstatohet se nuk ndiqet radha e pagesës, ku vërehen faturave të viteve të kaluara të cilat ose nuk parashikohen ose parashikohen me diferenca, kjo

e fundit ndodh dhe për faturat e viteve të fundit, megjithëse punimet/shërbimet kanë përfunduar dhe subjektet kanë paraqitur faturat për likuidim.

Mos planifikimi i vlerës së plotë të faturave dhe pse janë me dokumentacion të rregullt, çon në trajtim me dy standarte të subjekteve, duke penalizuar disa dhe favorizuar disa të tjera, **duke mos ndjekur radhën e pagesës sipas periudhave**, si dhe i jep mundësi padrejtësisht bashkisë që me fondet të cilat nuk planifikohen për likuidimet të këtyre faturave kreditore të planifikojë shpenzime për shërbime/ blerje mallra dhe investime jo në raport të fondet, duke krijuar dhe rritur vlerën e faturave kreditore ose thënë ndryshe borxhin që bashkia Finiq ka ndajë subjekteve të ndryshme.

Nga Bashkia Finiq për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, **nuk** janë likuiduar 21 fatura me vlerë 21,971,989 lekë **brenda afatit 30 ditore** nga momenti i paraqitjes së tyre, si dhe 4 fatura pagesa është kryer e pjesëshme, kjo për mungesë të fondeve, ku nga vlera 172,641 mijë lekë është likuiduar vlera 150,687 mijë lekë, duke mbetur për likuidim diferenca prej 21,954 mijë lekë.

Nga vlera e kontratave të lidhura dhe përfunduar për vitin 2021 prej 133,938 mijë lekë është likuiduar vlera 46,246 mijë lekë ose 34.5% e vlerës së kontratave të lidhura, veprime të cilat tregojnë se planifikimi dhe realizimi i kontratave nuk bazohet në sasinë e fondeve në dispozicion të njësisë vendore, duke çuar në rritjen e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore, kjo si rezultat i mos realizimit të të ardhurave dhe planifikimit të shpenzimeve në raport me planin dhe jo faktin e të ardhurave të realizuara në vitin paraardhës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81 dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.5.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 29-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Finiq, *të marrë masa si vijon:*

- Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe për çdo program.

- Planifikimin e procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (*faturave të palikujduara*), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbime/ investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Finiq.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- Të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.

- Të monitorojë dhe miratojë raportet 4 mujore e buxhetit.

Statusi: Pa zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dy kontratave për likuidim, u konstatua se:

a- Kontrata nr. 1942, datë 19.07.2021 e lidhur midis Bashkisë Finiq dhe bashkimit të OE “Kalivioti + Alba Konstruktion” shpk për vlerën 62,304,672 lekë me objekt “*Rikonstruktion i rrugës Dermish – Jermë*”, dhe me afat zbatimi 5 muaj nga data e fillimit të punimeve, rezulton se:

Fondi i këtij investimi ka qenë planifikuar i plotë për vitin 2021 nga MEF. Për vitin 2021 nga bashkia sipas faturave të paraqitura nga subjekti është likujduar vlera 30,897,010 lekë dhe gjatë vitit 2022 është likujduar vlera 29,494,715 lekë.

Nga të dhënat konstatohet se deri në datën e përfundimit të punimeve (datë 03.03.2022, sipas deklaramit të subjektit për përfundimin e punimeve), nga vlera totale prej 62,304,672 lekë është likujduar vlera 51,848,676 lekë sipas faturave të paraqitura nga subjekti. Ndërsa pas afateve të deklaramit është likujduar vlera 8,543,049 lekë (sipas Situacioni nr.5, faturë nr.96, datë 15.06.2021 dhe likujduar me USH nr.259, datë 16.06.2022). Pra subjekti nuk është paraqitur në afat faturën për likujdimin e detyrimit të situacioneve të mbyllura deri me datë 03.03.2022, duke mos deklaruar në afati detyrimin për likujdimin e TVSH në shitje.

b- Kontrata nr. 1741, datë 29.6.2021 e lidhur midis Bashkisë Finiq dhe bashkimit e OE “J.-K.” + “SH...” shpk për vlerën 18,377,728 lekë me TVSh me objekt “Restaurimi i Urrës - Kanali Thoma Filipeu me strukture metalike dhe B/A”, me afat zbatimi 45 ditë nga data e fillimit të punimeve, rezulton se:

Fondi i këtij investimi ka qenë planifikuar i plotë për vitin 2021 nga MEF. Për vitin 2021 nga bashkia sipas faturave të paraqitura nga subjekti është likujduar vlera 18,376,529 lekë.

Nga të dhënat konstatohet se deri në datën e përfundimit të punimeve është likujduar vlera 11,131,524 lekë sipas faturave të paraqitura nga subjekti. Ndërsa pas afateve të përfundimit (datë 25.8.2021) është likujduar vlera 7,245,005 lekë, kjo sipas faturës së paraqitur nga subjekti nr. 62/2021, datë 23.11.2021 dhe likujduar me USH nr. 461, datë 23.11.2021. Pra subjekti nuk është paraqitur në afat faturën për likujdimin e detyrimit të situacioneve të mbyllura me datë 25.8.2021, duke mos deklaruar në afati detyrimin për likujdimin e TVSH në shitje, veprime në kundërshtim me nenin 97- Fatura tatimore”, të ligjit nr. 92/2014 “Për TVSH”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 29-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Kontratave të përcjellë pranë Drejtorive Rajonale Tatimore përkatëse, të gjitha rastet kur faturat e shitjeve janë paraqitur me vonesë dhe pa shkaqe nga momenti i kryerjes së punimeve/shërbimit, me qëllim vlerësimin e mos deklarimit në afat për TVSH në shitje.

Statusi: Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Finiq, nuk ka ndjekur si duhet menaxhimin e aseteve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasë për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë nga Bashkia në plotësimin e nevojave për komunitetin dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre pasi shumica e aseteve që zotëron dhe ka në administrim, nuk janë të vlerësuara dhe të regjistruara në kontabilitet kuptohet qartë se për këtë kategori nuk është hapur regjistri kontabël, veprime në kundërshtim me Kapitullin e III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimin i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 e udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe kërkesat e VKM nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo– territorial” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 29-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Bashkia Finiq nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për menaxhimin e aseteve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasë për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë dhe plotësimin e nevojave për komunitetin, por dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre procedura.

Statusi: Pa zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e ardhurat për taksën e pasurisë (ndërtesës), rezulton se për vitin 2021 është realizuar në masën 79%, ose nga 10,093 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 7,986 mijë lekë. Megjithëse nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore është vijuar me grup pune për evidentimin në terren të sipërfaqeve të banimit për

efekt taks pasurie (taks ndërtesë), ky dokumentacion është i paplotë, pasi nuk evidentohet genplani për sipërfaqen e matur dhe në grupin e punës nuk ka asnjë specialist me profil inxhinier për kryerjen e matjeve faktike, ku të evidentohet sipërfaqja gjithsej, numri i kateve, lloji i aktivitetit ose destinacionit sipas kateve, etj.

Taksa e ndërtesës për subjektet/familjarët aplikohen në mungesë të dokumentacionit ligjorë (genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK), duke përdorur tarifë fikse 100 m², mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit të taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m² (me 2 dhe 3 kate), dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.

Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Drejtoria e PZHT për lejet e ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, megjithëse gjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimi, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale Sarandë mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi.

Veprime në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat vendore” i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 40-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Finiq, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Finiq dhe ASHK Drejtoria Sarandë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës), si dhe të vijojë puna me grupe pune në mungesë të informacionit zyrtarë për evidentimin në terren të sipërfaqeve të ndërtimit për taksën e pasurisë.

Nga verifikimi rezulton se:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, nëpërmjet shkresave zyrtare (nr. 884 dt.6.4.22 dhe nr. 736 dt.4.3.2023), i ka kërkuar Drejtorisë së PZHT-se Bashkia Finiq dhe ASHK-se Sarandë të dhëna lidhur me listën e objekteve të ndërtuara dhe sipërfaqet përkatëse për çdo fshat dhe Njësi Administrative. Për ato objekte që nuk ka dokumentacion është aplikuar taksa e ndërtesës me 100 m² siç përcaktohet dhe në paketën fiskale të vitit 2021.

Statusi: Në proces zbatimi

13. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat mbi realizimin e të ardhurave, konstaton se të ardhurat nga taksa e pasurisë (toka bujqësore) për vitin 2021 është realizuar në masën 63% ose nga vlera e planifikuar prej 27,092 mijë lekë është arkëtuar vlera 16,985 mijë lekë. Nga sa shikohet niveli i realizimit të kësaj takse është i ulët, kjo dhe për faktin se një pjesë e konsiderueshme e abonentëve familjarë nuk kanë kontrate më ujësjellësin dhe menaxhimi i sajë bëhet edhe më vështirë.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, plani për taksën e tokës bujqësore është parashikuar në vlerën 27,092,000 lekë, nga e cila vlera 6,754,126 lekë janë borxhe të parashikuara. Ndërsa plani vjetorë për taksën e tokës është për vlerën 20,337,874 lekë.

Referuar të dhënave planifikim i taksës së tokës nuk është bërë sipas ndarjes së tokës për çdo fshat dhe tarifave të përcaktuara në VKB nr. 70, datë 09.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Finiq për vitin 2021”, pasi për 56 fshatra kanë përfituar tokë të ndarë sipas ligjit nr. 7501, gjithsej 6439 familje me një sipërfaqe prej 8599.2342 lekë dhe detyrim vjetorë në shumën 20,742,852 lekë, pra më shumë se plani sipas DAV Bashkia Finiq prej **404,978 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë** (sipas aneks 2.6.2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Gjithashtu, konstatohet se Bashkia Finiq ka trashëguar nga ish-Komunat Finiq dhe Mesopotam, 224 kontrata për dhënie me qira për një periudhë 10, 35 dhe 99 vjeçare të tokës bujqësore të pandarë, nga të cilat 16 nga Njësia Administrative Finiq dhe 208 nga Njësia Administrative Mesopotam, ku:

-Për Njësinë Administrative Finiq për 16 kontrata ka rezultuar se deri më datë 31.12.2021, detyrimi vjetor paraqitet në shumën 50,000 lekë, likujduar vlera 202,100 lekë dhe mbetet për likujdim **vlera 1,613,729 lekë**.

-Për Njësinë Administrative Mesopotam për 208 kontrata ka rezultuar se deri më datë 31.12.2021, detyrimi vjetorë paraqitet në shumën 2,450,000 lekë, likujduar vlera 1,429,100 lekë dhe mbetet për likujdim vlera 1,020,900 lekë dhe detyrimi progresiv në shumën **14,987,439 lekë**, sipas listave që disponon DAV Bashkia Finiq.

Gjithsej detyrimi progresiv për totalin e kontratave të qirasë është në shumën **16,601,168 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Finiq**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”, akt i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendorë”, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 40-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (sektori i tokave), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **14,987,439 lekë**, sipas listave që disponon DAV Bashkia Finiq.

Planifikimin e saktë të taksë së tokës bujqësore në raport me numrin e familjeve që kanë përfituar tokës bujqësore në zbatim të ligjit 7501.

Nga verifikimi rezulton se:

Nga detyrimi total në shumën 14,987,439 leke që ishte me 31.12.2021, gjatë vitit 2022 për llogari të detyrime të prapambetura është arkëtuar shuma 1,403,8524 lekë, duke mbetur për likujdim vlera 13,583,915 lekë, shifra janë të pasqyruara në regjistrat përkatëse të vitit 2022.

Statusi: Në proces zbatimi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve dërguar në Bashkinë Finiq me shkresën e saj nr. 1116/8 datë 01.11.2021, rezulton se:

Nga Bashkia Finiq me shkresën nr. 84, datë 13.01.2022 është kthyer përgjigje **brenda afatit 20 ditore**. Ndërsa me shkresën nr. 872, datë 5.4.2022, duke respektuar afatin **6 mujorë**.

Me shkresën nr. 84/1, datë 13.01.2022 nga ana e Kryetarit të Bashkisë është hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve”, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve, rezulton se:

a. Nga **8 masa organizative** (pranuar plotësisht nga subjekti), janë zbatuar 6 masa dhe janë në proces zbatimi 2 masa.

b. Nga **1 (një) masë mos efektivitet**, pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

c. Nga **1 (një) masë mungesë të ardhurash** me vlerë 172,678 mijë lekë (pranuar plotësisht nga subjekti), rezulton se është në proces zbatimi, ku nga vlera e rekomanduar prej 172,678 mijë lekë është arkëtuar vlera 22,900 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim **vlera 149,777 mijë lekë**.

d. Nga **1 (një) masë disiplinore**, pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

e. Nga **12 masa administrative** (pranuar plotësisht nga subjekti), ku për **4 punonjës** është marrë masë me gjobë për vlerën **180,000 lekë** (pa kontabilizuar dhe arkëtuar) dhe për **8 punonjës** masa disiplinore me “**Vërejtje**”.

Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 66-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1116/8 datë 01.11.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

Statusi: Pa zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e ushtruar nga KLSH me program auditimi nr. 241, datë 10.02.2021 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit dërguar në subjektin Bashkinë Finiq me shkresën e saj nr. 1048/13, datë 04.05.2020”, ka rezultuar se:

- Për **14 masa shpërblim dëmi** me vlerë **77,384 mijë lekë**, e cila është në proces zbatimi.
- Për **6 masa administrative**, adresuar APP, marrë vendim për **11 punonjës** me vlerë **910 mijë lekë**, të pazbatuar.
- Për **1 (një) masë adresuar IMT Bashkia Finiq**, respektivisht mbikëqyrësin **z. R. T**, të pazbatuar.

Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 66-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përsheptimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1116/8 datë 01.11.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Finiq”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

Statusi: Pa zbatuar

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARI FAT VENDOR E, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezulton një gjendje e lartë e detyrimeve nga taksat e tarifatat vendore për vlerën **187,988,371 lekë ose afërsisht 2 fish i planit të të ardhurave vjetore të parashikuara në fillim të periudhave ushtrimore**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Finiq, të cilët nuk mund t'i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe dhe që tregon se megjithë punën e bërë nga kjo administratë në rikëtimin e debitorëve, ka akoma vend për përmisim dhe në zbatim të të gjitha dispozitatave ligjore për arkëtimin e tyre.

Nga të dhënat evidentohet se niveli i detyrimeve të paarkëtuara (taksa/tarifa vendore), vjen në rritjen nga njëra periudhë në tjetrën për vlerën 15,309 mijë lekë, *ku nga vlera 172,679 mijë lekë në fund të vitit 2020 në fund të vitit 2021 paraqiten në shumën 187,988 mijë lekë.*

Në totalin e detyrimeve, debitorët familjarë paraqiten në shumën 124,594 mijë lekë ose 66.3% e totalit të detyrimeve.

Gjithashtu evidentohet një numër subjektësh të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet dhe nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, janë lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite.

Referuar informacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Finiq me gjithë masat e mara evidentohet fakti se nuk janë ndjekur të gjitha hallkat në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve. Gjithashtu dhe ato të zbatuarat nuk janë zbatuar për të gjithë subjektet debitorë që kjo bashkia ka. Kështu bllokimi i llogarive është për vlerën 12 milionë lekë, ndërkohë që niveli i debitorëve është në shumën 187 milionë lekë ose 6.4% e totalit të detyrimeve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 89-Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve, neni 90-Urdhër bllokimit, dhe neni 92-Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë, duke lënë jashtë një pjesë të konsiderueshme të tyre, por dhe subjekte me detyrime nga viti në vit, neni 93-Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë dhe neni 94-Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër, si dhe nuk është kërkuar “kallëzim penal”, bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 40-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Finiq, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **187,988,371 lekë**.

Nga verifikimi rezulton se:

Nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Finiq sipas dokumentacionit janë dërguar 2-3 here letër kujtesa në të gjithë debitorët familjar dhe në bizneset privat. Gjithashtu me shkresë përcjellëse janë mbyllur llogaritë e bizneseve në më shumë se 30 të tilla. Kanë bashkëpunuar me zyrën e ASHK-së dhe Drejtorinë e Transportit Rrugor. Kështu nga vlera 187,988,371 lekë më 01.01.2022 në fund të vitit 31.12.2022 mbetet vlera 213,212,631 lekë, si vijon:

Borxhi më 01.01.2022 në shumën 187,988,371 lekë

Shtuar gjatë vitit 2022 në shumën 76,874,941 lekë.

Arkëtuar gjatë vitit 2022 në shumën 51,650,681 lekë, nga e cila detyrim i viteve të kaluara në shumën 15,545,986 lekë.

Borxhi më 31.12.2022 në shumën 213,212,631 lekë.

Statusi: Në proces

2. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (TNI), **për vitin 2021** janë realizuar në masën 46% ose nga vlera 3,211 mijë lekë e planifikuar është arkëtuar vlera 1,491 mijë lekë. Mos realizimi vjen si rezultat i mos lëshimit të lejeve të ndërtimit në raport me planifikimin në fillim të periudhës. Mos realizimi vjen si rezultat i mos lëshimit të lejeve të ndërtimit në raport me planifikimin në fillim të periudhës.

Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet e reja (ALUZINI), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën **6,408,207 lekë**, ku nga vlera e planifikuar prej 7,898,668 lekë është arkëtuar vlera 1,490,461 lekë, duke mbetur për likuidim vlera **6,408,207 lekë**, si mungesë të ardhurash në buxhet.

Veprime në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe Vendim të KB nr. 70, datë 9.12.2020 (paketa fiskale për vitin 2021), (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 40-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Finiq, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **6,408,207 lekë**.

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Sarandë, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së TNI.

Nga verifikimi rezulton se:

Nga Bashkia Finiq (DAV) me shkresat respektive nr. 884 date 06/04/2022 dhe shkresën nr. prot 736 date 04/03/2023 i është kërkuar ASHK –se Sarandë me listën analitike përkatëse të detyrime që personat

privat kanë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (Aluiznini), sipas Njësisë Administrative ku i është kërkuar mbështetje dhe vendosje të barez Hipotekore dhe mos dhënien e Certifikatës e pronësisë për personat që nuk shlyejnë detyrimin ndaj Bashkisë tone.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi është kjo situata për vitin 2022:

Gjendja në fillim të vitit 2022 = 6,408,208 leke

Shtuar fatura e vitit 2022 = 2,667,735 leke

Zbriten arkëtimet gjithsej për vitin 2022 = 1,669,301 leke (nga këto në vitin 2022 për llogari të vitit 2021 u arkëtuan 227,688 leke)

Mbetja e dertimeve në 31.12.2022 = **7,406,642 leke**

Statusi: Në proces

3. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave, për vitin 2021 niveli i të ardhurave nga qiratë paraqitet në masën 73.7 %, ose nga vlera 14,398 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 10,622 mijë lekë.

Nga auditimi i procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Finiq për vitin 2021, janë lidhur 123 kontrata qiraje me vlerë 10,397,104 lekë, nga të cilat likuajduar vlera 9,934,104 lekë, **duke mbetur për likuajdim vlera 463,000 lekë, e ardhur e munguar në buxhet.**

Gjithashtu, nga Bashkia Finiq (personat përgjegjës), nuk është bërë i mundur llogaritja e penalteteve për mos pagesë në afat të detyrimeve kontraktuale në zbatim të pikës 5.5 të nenit 5 të kontratës në masën 0.01% për çdo ditë vonesë nga momenti i pagesës.

Nga auditimi me zgjedhje i disa kontratave, rezultojnë se:

-Nuk është kryer inventarizimi Kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).

-Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.

-Nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullor.

-Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar fare në kontabilitet, llogaria nr. 211 "Pyjet, kullotat dhe plantacione", pasi aktiviteti i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie.

-Nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të parcelave në ASHK Drejtoria Sarandë,

-Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.

-Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.

-Nuk janë përcaktuar kriteret për dhënien me qira të tyre, nga ku kriteret prioritare si p.sh. fermerët me banim brenda territorit të njësisë, me vendndodhje afër kullotës, që mbarështojnë një numër të madh bagëtitish, të atyre që shtegtojnë tufat në ekonomi të tjera kullimore e që kanë qenë të kontraktuar sezonin e kaluar,

Në përfundim, dhënia me qira e sipërfaqeve pyll dhe kullota, pasi këto prona nuk janë të regjistruara në emër të NJQV, duke sjellë për pasojë të qenurit pronar me të drejta jo të plota por të kufizuara.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës", i ndryshuar; Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullor", neni 5, pika 2/b "Pronësia", neni 7 "Inventarizimi", neni 8 "Regjistrimi", neni 9 "Regjistri i fondi kullor", neni 14 "Planë e mbarështimit" dhe neni 15 "Bimët mjekësore", neni 29 "Organet e kontrollit", 30 "Dokumentimi", dhe 33 "Vlerësimi i dëmit" dhe 34 "Kundërvajtjet Administrative"; VKM nr. 799, datë 29.9.2010, "Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme"; VKM nr.22, datë 09.01.2008, pika 3 e vijim; pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006; Udhëzimi nr. 4, datë 10.04.2008, si dhe VKM nr. 632, datë 11.6.2009 dhe kushtet e kontratave (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 40-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (Sektori i Pyjeve), të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **463,000 lekë**, si e ardhur e munguar, respektivisht:

- vlera prej **18,000 lekë**, në ngarkim të subjektit **V. XH**.
- vlera prej **20,000 lekë** në ngarkim të subjekti **A. I**.
- vlera prej **360,000 lekë**, në ngarkim të subjektit **V...** (zona Mile).
- vlera prej **65,000** në ngarkim të subjektit **V...** (zona Karroq).

Nga verifikimi rezulton se:

Sipas dokumentacionit të paraqitur vlera prej 360,000 leke per subjektin "V..." është sistemuar me Akt-Sistemimi nr. prot 17 date 23/01/2023 bazuar ne Çertifikatën e pronësisë se kësaj sipërfaqe toke te ish-pronarit date 15/07/2020 te Zyrës se Regjistrimit te Pasurisë se Paluajtshme Sarande.

Bazuar te ky sistemim dhe ne dokumentacionin bashkëlidhur rezulton qe ky subjekt nuk ka asnjë detyrim pranë Bashkisë Finiq.

Në lidhje me rastet e tjera kemi:

Z. V. XH ka shlyer gjithë shumën e detyrimit qe përcaktobet ne kontratën e qirasë me MA nr. 2 date 04/01/2023 për vlerën 18,000 lekë.

Per subjektin V... ne zonën Karoq, shuma 65,000 leke del i paguar tepër ne 31.12.2020 ose me 01/01/2021 dhe per vitin 2021 ka derdhur 65,000 leke siç pasqyrohet dhe ne regjistrat e vitit rezulton gjithsej 130,000 leke qe është detyrimi total vjetor ,pra nuk është debitor ne datën 31.12.2021.

Z. A. I vazhdon te mbetet debitor per shumën 20,000 leke ndonëse i është dërguar letër kujtese nga zyra përkatëse .Por si debitor është ne ndjekje nga ana jone si i Arkëtueshme .

Në përfundim nga vlera 463,000 lekë, gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 443,000 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 20,000 lekë.

Statusi. Në proces

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (Sektori i Pyjeve), për të gjitha rastet e mos likuidimet në afat ë detyrimeve kontraktuale, në zbatim të nenit 5 të kontratës të llogariten kamatëvonesat në masën 0.01% për çdo ditë vonesë nga momenti i pagesës dhe në rast refuzimi të shlyerjes të kërkohet prishja e kontratës për mos zbatim të kushteve.

Nga verifikimi rezulton se:

Drejtoria e të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (Sektorin e Pyjeve), për një pjesë të personave qe kane patur me qira nga ish pyjorja kane bere rifreskim Kontrate duke paguar ne kohe detyrimet si p.sh.:

S. S, A. I. Ndërsa A. I, i ka mbaruar afati i kontratës duke mbetur debitor për shumën 20,000 leke.

Z. I. D nuk ka lidhur kontrate me ish. Pyjoren .

Statusi. Në proces

3.3. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës, si dhe të marrin të gjitha masa për inventarizimi Kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës); mbajtjen e bilancit të fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall; mbajtjen, evidentimin, administrimin e balancimit të fondit kullor; pasqyrimin në kontabilitet, në llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”; aplikimit për regjistrim të parcelave në ASHK Drejtoria Sarandë; hartimin e plan mbarështimit për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme; krijimin të ardhura nga lëndët drusore, përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës, dhe hartimin e plan mbarështimit menaxhimit të pyjeve dhe kullotave; përcaktimin e kriterëve për dhënien me qira të tyre.

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (*sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas*) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Kështu, nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se si nga ish-komunat dhe ish-bashkia qendër ashtu edhe pas konsolidimit, **nuk** është aplikuar saktë tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet (autorizime).

Nga të dhënat konstatohet se nga Bashkia Finiq nuk është aplikuar saktë taksa për rinovim të lejes së autorizimit në masën 1,000,000 lekë.

Detyrimi i munguar nga mos aplikimi i saktë dhe në 3 raste mos aplikim i taksës për rinovim të lejes paraqitet në shumën **5,300,000 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Finiq, veprime në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (*Më bollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 40-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Finiq, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **5,300,000 lekë** nga **3 subjektet**, respektivisht;

- vlera **1,100,000 lekë** nga subjekti “**T...**” ShPK
- vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti “**G...**” ShPK;
- vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti “**K...**” ShPK;
- vlera **2,200,000 lekë** nga subjekti “**B...**” ShPK

Nga verifikimi rezulton se:

Nga DAV Bashkia Finiq janë nisur shkresat për shlyerje të detyrimit sipas konstatimit të KLSH, por nga ana e tyre është kthyer përgjigje se janë në proces ankimi në KLSH.

Subjektit “B...” i është bllokuar llogaria ku gjendja e llogarisë është rreth 270,000 leke ku ende nga BKT nuk na është xhiruar shuma përkatëse sepse qëndron debitor ne Institucione te tjera. Këta subjekte i kemi ne ndjekje me mënyra te ndryshme .

Statuasi: Pa zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga DAV në Bashkinë Finiq, konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj dhe vjetorë me agjentët tatimorë, por që janë të paplota, pasi në to nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për ASHK (*nga shitja e pasurisë*), Drejtoria e Transportit (*për mjetet qarkullues*), Drejtoria Rajonale Tatimore Finiq (*tatim fitim thjeshtuar*) dhe Ndërmarrjen e U... sha (*abonentët familjarë*).

Bashkia Finiq nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Finiq nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Finiq, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari

duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse. Konstatohet se sipas Drejtorisë së të Ardhurave. Bashkia Finiq, mos arkëtimet nga ana e ASHK-së janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Finiq është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektësh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Finiq duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, udhëzimin e MF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe udhëzimin e MF nr. 12, datë 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 40-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Finiq, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

5.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifatat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Nga verifikimi rezulton se:

Nga DAV Bashkia Finiq është bashkëpunuar me Drejtorinë e Transportit Rrugor Sarandë edhe me Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë në lidhje me mbajtjen e akt-rakordimeve për vlerat e mbledhura dhe që duhet të xhirojë në adresë të bashkisë.

Nuk evidentohet që nga DAV Bashkia Finiq të jenë bartuar regjistrat me bazën e të dhënave të subjekteve.

Statusi: Në proces

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me pagesën e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Finiq, rezultoi se 3 operatorë ekonomik nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore që lindin ndaj Bashkisë Finiq për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën 108,000 lekë**, konkretisht për shoqëritë “M...” dhe “E...”, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6 dhe VKB nr. 70, datë 09.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Finiq për vitin 2021” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 40-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave Bashkia Finiq, të marrin të gjitha masat dhe të mos lejojnë lidhjen e kontratave të shërbimi/investimit me subjektet fituese pa likuiduar detyrimet për taksat vendore sipas paketave fiskale.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **108,000 lekë**, *respektivisht:*

- vlera **54,000 lekë**, ndaj subjektit “M...”.

- vlera **54,000 lekë**, ndaj subjekti “E...”.

Nga verifikimi rezulton se:

DAV Bashkia Finiq me shkresat respektive nr. 1007 date dhe datë 8/5/2023 dhe shkresa nr. 1008 date 8/5/2023 i është kërkuar subjekteve “M...” shpk dhe “E...” shpk kujtesë për shlyerje të detyrimeve, por nga ana e tyre akoma nuk është vepruar.

Statusi: Pa zbatuar

C. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Finiq, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale, respektivisht:

1. **L. M**, me detyrë Drejtore e Financës.
2. **I. N**, me detyrë Drejtor i Ardhurave
3. **TH. Z** me detyrë P/ Ardhura Vendore
4. **J. B**, me detyrë P/ Ardhura Vendore

Statusi: Pa zbatuar